


LIOTE

BIH-1

1937

Dritëro Agolli



POEZI

234..1

23

£02

468

53.820

Nyrye ndrisin

H Y R J E

p

Ndrisin portat e atij pallati
Dhe në xhamet vizatohen retë.
Ç'dreq kötej më hodhi mua fati
Të krekosem rëndë me poetë!

Unë rri në prag me librin tim.
Dera hapet, mbyllt e troket...
Por të hyj atje nuk kam guxim,
Jam fshatar i Jugut, jo poet.

Vargjet nëpër fusha i kam shkruar,
Rrëzë hije rrapesh apo shelgjesh,
Shokëve të mi ua kam lexuar,
Herë-herë vargu im pëlqehesh.

Këngët nëpër ara i kam ngritur,
Rrëzë kodrash mbushur me dëllinja;
Kur nuk kisha letër, i mërzitur,
Përmbi luspa plepi shkaravvisnja.

Vjersha ime erë ugari bje,
Vargu im bie erë luleshqerrë.
O guximi fshatarak, ku je,
Pse s'më shtyn të futem menjëherë?

Unë që kam pasur aq guxim,
Unë që jam rrahur nëpër ara
Me armikun dhe rivalin tim,
Pse tani ngurroj të dal përpara?

...Dhe nën sqetull librin kam
shtrënguar!
Këmbët tërë baltë ugari shtyj
Afër pragut shumë i shqetësuar...
Por trokas... Hap derën edhe hyj!

Ja pallati i madh me xhame shumë.
Hyjnë, dalin një nga një poetët.
Nga luginat erdha edhe unë
Të tregoj për arat dhe për vreshtat.

1956

H A R A B E L I

Dhe shpezët udhëtarë fluturuan
Me shtërg e dallëndyshe — gjithë ç'qenë,
Veç harabeli vendit nuk po luan,
Ai nuk ia beson kurrkujt folenë;

Livadheve të korrur fluturon,
Me sqep në bar çepkat e vërshëllen
Dhe duket se me shokët kuvendon,
Dhe duket se diçka përreth s'e gjen;

Dhe sytë e vegjël hedh përmbi zabel,
Vështron se si mërgohet shpezëria,
Por s'di të thotë zogu-harabel:
«Të çmendur, ju
pse ikni nga shtëpia?»

KUR PËRFYTYROJ NJË NGA LEXUESIT E MI

Sandalet shkund nga pluhuri i bardhë,
Heq festen e djersitur dhe mendon;
Një dorë fut në xhep të tij të madh
Dhe librin tim të vogël e kërkon;

Ul ballin vija-vija me mundim,
Lexon një fletë, dy... çibukun shkund...
Po sikur t'i pëlqejë libri im,
Mund ta shfletojë, ndofta, gjer në fund.

Sikur mos t'i pëlqejë,
shan me vete,

Me emrin tim të gjatë zemërohet.
Nga libri fletë gris e shtron në festë,
Të paktën kokë e lodhur t'i freskohet.

J A , P R O N A R I

Shtëpi e tij e lyer me gëlqere
Në mes të pemëve si vezë zbardh;
Përdridhet pjergulla gjer në penxhere
Dhe te plevica degët tund një dardhë.

Te porta gruaja bagëtinë pret.
Ai çibukun thith, baret mërzitur
Dhe murmurit e rëndë asaj i flet
Për llogarinë e qumështit të shitura.

Me qumësht gruaja kusitë mbush
Dhe në bodrum i shpie mos t'i prishet,
Se nga të nxehtët guri djeg si prush
Dhe kashta si baruti jashtë ndizet.

Pastaj i vrenjtur kalin e ngarkon
Dhe niset te klientët shpejt e shpejt...
Kur kthehet në shtëpi, e ledhaton
Kuletën që ka mbushur në qytetet...

Eh, ky pronar i zymtë dhe pa shokë
I drojtur rri mes botës kaq të madhe!...
Matanë mureve mbin bari nëpër tokë
Dhe bleta mbledh nektarin në livadhe...

Ç'mërzi, heronjtë e vargjeve të mia!
Për këtë oborr mjafton, se më s'do shkruaj.
Do kapërcej, do hidhem nga avllia,
Që përsëri të vij në gjirin tuaj...

Ku jeni miq, punëtorë, bujq, poetë,
Barinj, kompozitorë, peshkatarë!
E di, tek ju ka punë gaz e jetë,
Ka shqetësim, ka këngë e kitarë!

Ku jeni, miq, për ju është vargu im!
Oborri juaj ditë e natë zjen:
Dëgjoj të qeshura e kuvendim,
Gjykime për të nesërmen që vjen.

Veç mbyllur brenda avllisë si kështjellë
Ai, pronari, kalbet në merzi...
Dhe ç'më kujton kërmillin e mbështjellë
Në guaskën e pështymur në vetmi...

1956

NË UDHËTIM

1.

J a, shtëpi e bardhë
Strehëvarur pret,
Duket sikur mua
«Eja» më thërret.
Po vrapij pas lumit,
Bukën kam në xhep...
Shumë udhëtarë
Përshëndes e pjek;
Dhe me ta cigaren
Ndez e rrugën marr,
Natën kur më flihet,
Shtrihem në mullar
Dhe shikoj në gjumë
Nënën që më flet:
— Mos më ftoshesh, djalë,
Nëna po të pret.
Dhe pastaj me dorë
Ballin ma lëmon;

Eh, kjo dorë e shtrenjtë
Dhembjet m'i largon!

2.

...Prapë për udhë nisem
Shokët prapë i pjek.
Reja si balonë
Ngrihet lart në kep.
Reja si balonë!
Si të hip atje,
Buzëqeshjen time
Ta dërgoj mbi dhe...
Posi pika shiu
Ta spërkat në ara
Dhe ta mbjell në brazda,
Sikur mbillet fara!...

3.

Po ku vete unë,
Po ku shkoj kështu?
— Ku të thérresë udha,
Lugjeve diku! —
S'është hera e parë
Që rrugicat marr,
Shumë herë i lodhur
Fjeta në mullar.
Shumë herë qentë
Faqet më lëpinë,
Kur në bar të thatë
Ma panë turinë.
Shumë herë lopët
Ballin më zbuluan,

Te mullari i fshatit
Floket m'i trazuan.
Dhe pastaj e ndjeva
Shpirtin plot me këngë,
Këngët kishin hyrë
Në xhep e në mëngë...



QENI IM I PLAKUR

Ti u plake, qeni im, u plake!
Sytë i mbyll dhe dergjesh fill i vetëm.
Bukuria jote shkoi e vate
Dhe guximi yt tani nuk ndjehet.

Ç'sjell ndër mend ashtu, o qen i shtrenjtë,
Ujqit që ke mundur në përleshje
Netëve kur shqetësonin dhentë,
Netëve në verë dhe në vjeshtë?

Ç'sjell ndër mend ashtu, o qen i urtë,
Mos kujton atë që e deshe shumë,
Mos kujton atë të shkretën bushtër,
Që ia flakën bijtë e saj në lumë?

Kur në rrugë tufa shkon me zilet,
Angullin e qan sa s'mbahesh dot...
Ti kujton lëndinat dhe korijet,
Ti kujton... e dukesh se derdh lot.

Ti je plakur, qeni im, je plakur,
Po s'të rrihet, ngrihesh edhe del
Dhe ngre kokën, dhe dëgjon tej pragut
Kur zë leh një konkë në zabel...

1955



30394

NJË PËRALLËZ E VOGËL

Nga qelli u këput një yll e ra
Në mes të detit, tej në errësirë.
— Vëllezërit e përzunë — gjyshja tha —
Se s'ish për ta vëlla e shok i mirë.

VJERSHA E PARË

1.

Ku linda unë ngrinin bejte shumë
Dhe bejtet mbushnin sheshet plot me jetë.
Ato në fshat ngaherë bënин zhurmë,
Siç bën një radio, apo një gazetë.

Një plaku që jetonte në mëhallë
Nazim Berat i thoshin me të drejtë,
Se ishte bejtexhi i madh, i rrallë
Dhe fjalën si hanxhar e kish të mprehtë.

Në mbrëmje vija shpesh me bejtexhinë,
Në breg të lumit ulesha menduar,
Se doja ta mësoja mjeshterinë,
Që ishte aq e dashur, aq e çmuar!

2.

Një ditë më pat thënë duke qeshur:
«Pse s'bën dhe ti ca bejte, more djalë?
Ne kemi Xumen tonë qimezverdhur,
Që vjedh bostan dhe ul kurrizë e dalë!»

Po veç pér kurrizdalin s'kisha qejf
Të bëja bejte kot si ca të tjerë.
«Pér veshëvarurin mulla Istref
Me vargje do ta mbush që sot defterë!»

At'herë plakut djersa i ra në ballë
Dhe më vështroi me frikë në lëndinë:
«Më duket se të ha kurrizi, djalë,
Do vuash, po ta tallësh perëndinë!»

3.

Një ditë në mësim të historisë
M'u shkrep të bëja bejte pér mullanë:
«Mulla, ti ia nxjerr fundin revanisë,
Kur ne të tjerët s'kemi se ç'të hamë!»

Po një nga shokët vjershën ma kish parë
Dhe më kallzoi me vrap te kryeplaku.
Pastaj pér shpatullash më hoqën/zvarrë
Dhe gjunjëve në pluhur rrodhi gjaku...

G J U R M A

Dy shokë aherë qemë,
Të dashuronim ty,
S'do mend që njërin doje
Dhe s'mund të doje dy.

Të marrë kemi qenë,
Kur jemi rrahu r koto,
Po unë aherë isha
Vërtet një don Kishot!

Përbri shtëpisë sate
Me baxhë në pullaz,
Ai ngadalë vinte
Dhe unë e ndiqja pas.

Me të ne buzëvarur
Takoheshim në terr,
Pa thënë tungjatjeta
Dhe mbushur plot zeher...

Gjithë atë ditë s'erdha dot në vete;
Ja ky ish honorari im i parë;
Që do të thosh se vjersha s'bëhej lehtë,
Se dhe për shpatullash të hiqnin zvarrë!...

1955

Nën dritëzën e llambës
Të shihnim vjedhur ty,
Për cilin ti mendoje,
S'ë dinim ne të dy!

Po unë aherë isha
Vërtet një don Kishot,
Me ëndrra trëndafilash
E mbushja mendjen plot!

Nuk rrođhi shumë ujë
Nga lumi nëpër zall,
Kur ti u bëre nuse
Në fshatin nën një mal.

Dhe shoku im i vjetër
Të mori në shtëpi;
Ish futur gjer në palcë
Lanetja dashuri!

1954

S O R K A D H J A

1.

Një ditëzë kur zbrisja
Me shokët buzë lumit,
Nga larg një çupë pashë
Tek shkonte përmes kumit.

Tek shkontakte këmbëzbathur
E bukur, punë e madhe!
Më ngjante me thëllëzë,
Më ngjante me sorkadhe!

2.

Njëherë kur kaloja
Me kalin tim dori,
Më zu një natë e errët,
Një breshër, një stuhi.

Dhe ndala buzë lumit
Që zbriste nën brezare
Tek ndriste nëpër mjegull
Si ylli një dritare.

Me shkop në xham trokita
I lodhur i dërrmuar.
Dhe prita si gjahtari
Që malesh ka vrapuar...

3.

Po syve s'u besova,
Sikur vija nga gjumi!
Ish vajza që takova
Ku rrihte valët lumi!

Tagji m'i vuri kalit
E bar nga më të mirët,
E mori nga qilari
Që e kish për mysafirët.

Më shtroi dyshek të lartë.
Më hodhi dy jorganë...
Me ëndrrat fluturoja
Mbi Drin e mbi Bujanë

Dhe ndiqja një sorkadhe
Pas shpatit e pas lumit
Dhe kthehesha, në gjurmët
E mbetura mes kumit...

Z J A R R E T

— *baladë* —

1.

Reth zjarreve të gjithë ushtarët flenë,
Veç gjumi s'e ka zënë Skënderbenë.

Në tendë pikëlluar mendjen vret,
Kafshon mustaqen dhe me vete flet:

«Hamza, braktise tokën prindërore
Dhe rrugën e jezitit sonte more!

Lavdi e famë doje ti Hamza,
Po nderi yt në fund të detit ra!»

2.

Ah, të pagjumit Skënderbe s'i flihet,
Në këmbë natën i mërzitur ngrihet.

Dhe niset i menduar në lëndinë
Me përkrenare, shpatë e pelerinë.

Pas zjarreve ushtarët lodhur flenë
Veç rojet përshëndesin Skënderbenë.

Te koka shpatat kordhëtarët kanë
Dhe kuajt pranë bar të njomë hanë.

3.

Më tej një kordhëtar rënkon i shtrirë,
Ia lidhin shokët plagët në errësirë.

Te koka shkon i madhi Skënderbe
Dhe dhembje ndien në zemër kur e sheh!

Po kordhëtari ngrihet drejt në këmbë
Dhe dhembjen e shtrëngon, e mbyt me dhëmbë.

— O biri im, — tha Skënderbeu ngadalë,
E uli dhe e puthi m'u në ballë.

4.

Dhe shkoi në tendë e nuk e zuri gjumi,
Dëgjonte si në bar zhurmonte lumi

Mes natës nën një hënë të argjendtë
S'e hiqte kordhëtarin dot nga mendtë!

Dhe ngriti kokën lart e qetë tha:
«Përpara tij je baltë, nip Hamza!»

1956

L U M I

Lumi shket ngadalë
Rrëzë portës sonë,
Vjen e puth një valë
Barin aq të njomë.

Ç'ujë rrodhi, ç'ujë,
Rrëzë portës sime!
Rrodhi dhe me bujë,
Rrodhi me gjëmime.

Rrodhi buzë fletësh,
Rrodhi në lajthi;
U tha bar i vjetër,
Doli bar i ri...

Vargje plot më mbetën
Buzë atij lumi,
Zalleve u tretën,
Mbuluar nga kumi...

Shpesh më dalin në ëndërr
Tok me fëmijërinë,
Vijnë erë mendër,
Erë trëndelinë!

Vjen nga larg një këngë,
Këngën e merr lumi:
«Hamide të thirra,
Të zgjova nga gjumi!»

1954

2. Poema

POEMA E UDHËS

Unë dola...

Mbas meje dera u mbyll

Eduard Bagricketi.

I

Nën mal, në fshat më rrođhi fëmijëria *met*
Në kohëra të vështira dhe me mjegull...
...E sjell në mend, kur zgjatej te avllia
Dhe oborrin zinte tej e tej një pjergull;
E sjell në mend dhe pusin shekullor,
Çikrikun me litarët e tij të vjetër,
Kapakun që e hapnim ne me zor,
Të mykur e të plasur krejt nga vjetët;
E sjell në mend çatinë e shtëpisë,
Kur hipte ati im dhe pikat zinte;
I sjell në mend direkët e çatisë;
Që thyheshin, kur borë shumë binte;
E sjell në mend Baloshin, qenin tim,
Kur duart më lëpinte dhe më hidhej;
Po bukën ne e nxirrnim me mundim
Ndaj i pangopur herë-herë lidhej;

E sjell në mend babanë, kur, i lodhur
Nga puna, vinte vonë në të errur;
Opingat nxirrte vrenjtur dhe, pa folur,
Në vatër shtrinte këmbët pér t'i terur;
E sjell në mend kur grindej si i marrë
Me nënën pér «fasulet e paziera»,
Pér «rrobet që akoma s'i kish larë»,
Pér «bukën e papjekur»
E të tjera...

Nevrik ish ati im, nevrik i madh,
Po skamja mbin me grindje në shtëpi, *metejza e*
Ashtu siç mbijnë gjëmbat në livadh,
Kur moti është i thatë e nuk bie shi.

II

...Dhe mua asnjeri s'më përkëdheli,
Vec nëna herë-herë me mundim
Më ndiqte edhe lozte te zabeli,
Kur dru kërkonte vonë në perëndim.
Babai nuk kishte nge të humbte kohën
Me mua, duke bredhur cak më cak...
Nga puna, kur kthehej, ulte kokën
Dhe zhytej në mendime në oxhak.
Me qerka nuk më kolovitën kurrë
Dhe rruzuj nuk më blenë në pazar.
Mes pluhurit kam lojtur nëpër gurë,
Livadheve kam lojtur nëpër bar.
Më vjen në mend, kur plakat në mëhallë
I qaheshin tim eti veç pér mua,
Se si u theva xhamat dhe vërdallë
I sillja lopët brenda në katua;
I sjell në mend dhe shokët një nga një,
Kur bridhnim me kopetë këmbëzbathur,
Kur loznim dhe kur cirrnim pér hic gjë

Fytyrät, njëri-tjetrin duke kapur;
Më vjen në mend kur ulesha në plisa,
Nga këmba nxirrja gjëmbat me gjilpërë;
Sikur të gjithë gjëmbat po t'i mblidhja,
Do bëja një vandak, besoj, të tërë...

III

*Karmela
Belen*

Nevojën e kam ndjerë që kur isha
I vogël sa një zoçkë — mituri,
Që kur nga dera çapëzat i nisa,
Që kur në këmbë shkova gjer në avlli,
Që kur më dolën dhëmbët qumështorë
Mësova ç'do të thotë fjala «bukë»,
Që aherë e kuptova sa i gjorë
Do ish ai që lypte në atë udhë...
...Dhe rridhte fëmiri e turbulluar,
Dhe dukej se nuk ishte fëmiri,
Po ish diçka më e ashpër dhe më e vuar,
Po ish diçka që quhet pjekuri...
Me krismën e dyfeqeve në male,
Me ngritjen e raketës në errësirë,
Me vrullë e himnit «Internacionale»
I thashë fëminisë lamtumirë.
Filloi rinia ime e furishme,
Si lava e valuar ndër vullkane.
Filloi rinia ime e furishme.
Filloi ajo në rrugën partizane.

IV

..Në rrugë dola.
Nata derdhte shkrumb, *medef*
Dërgonte erë me tufan Morava

Dhe gjurmë s'kish dhe tokë s'kish gjökund.
Veç borë, natë, erë në Dumbravë.
Unë popullin e pashë:
Zgjodhi udhën,
Që lart në mal mes grykave të çon,
Unë pashë, kur të dashurit u puthën
Dhe udhën morën që në gérxh dredhon.
Po era fryn!...
Trazohet akulli me natën.
Dhe gjurmë s'ka, por rrugën unë e di!
Ndër përralla kam dëgjuar se kur shpatën
E puth, kur udhën merr nëpër stuhi,
Aherë zanat shtigjet t'i tregojnë.
— Sa marrëzi!, — me veten time them —
Le zanat që në borë nuk jetojnë,
Por edhe dreqër s'gjen!... —
...Mes netëve vrapoj në rrugën time.
Nën këmbë bora krrak e krruk kërcet.
Nga erë e dimrit ndihen fishkëllime.
Lëpin borigat era në qamet.

V

...Dhe ja, u ngjita maleve të mprehtë.
Kur shkrepri drithë e kuqe mbi dëborë,
Mëngjesi kish përzënë gjithë retë
Mbi malet shekullorë...
Në mal një burrë i gjatë si më priti
Aherë kur në çetë e takova!
Kutinë me cigare nuk ma qiti
Dhe fjalë përmallimi nuk dëgjova.
— Në qoftë se me ne kërkon të vish,
Jatakun ti këtu e ke të shtruar
Në gjirin e vëllezërve të rrish,

Në shpellat e përrenjve të motuar!
— Tregoni, djem, se ç'pasuri ne kemi,
Tregoni shokut dhomat dhe oborret,
Tregoni shokut shtretërit, ku flemë,
Tregoni shokut zjarret nën dëborë... —
Dhe shokët më treguan shpellën mbarë.
Edhe një thes me bukë sjell ndër mend,
Që ndodhesh mes dy shkrepash dysh të çarë;
S'e di pse ngula sytë në atë vend!...
...Kështu me çetën partizane shkova,
Hero unë kushedi dhe nuk kam qenë,
Po vendin tim e mbrojta dhe e çmova
Dhe mundet që dëshmor të kisha rënë!

VI

S'mbaron rinia ime, ajo rrjedh *medef*
Dhe rruga larg si birë e saj më thërret,
Më thërret në gërxh, më thërret në bar e gjeth,
Më thërret në fushë, fshat, apo qytet...
Prapë në udhë dal.
Me vete torbën kam
Dhe batanijen lidhur me kujdes.
Ku jeni, miq, sërisht mes jush sot jam!
O njerëzit e ndershëm,
Mirmëngjes!
Ju përshëndes, vëllezër, tungjatjeta!
Pranomëni dhe mua në kazermë!
Po vij nga larg nga majat e përpjeta,
Ku shkëmbin shpon e del me vrull një çezmë,
Ku rron e ndershmjë plakë, nëna ime,
Në fshatin e rrethuar me lajthi.
Më nisi në udhë flokëbardha ime,
Më vu në torbë bukë me turshi.

Edhe kur ika qante me ngadalë:
— Ngaherë nisesh larg në udhëtim,
Po si s'të lodhi udha, more djalë?
Po si s'të lodhi udha, biri im?

VII

...Dy radhë me krevate ka kazerma.
Në mes të njërsës radhë — vendi im.
Këtu pagurin kam me ujë çezme,
Atje kam torbën time me ushqim.
Jorgani im — një batanije e vjetër
Që plaku im pipinove ua mori,
Me të kam fjetur netëve në çetë,
Kur egërsonte erërat dhjetori.
Paguri im — pagur prej Gjermanie,
Peshqesh ma fali shoku komisar,
Kur buzë lumit afër një korije,
Banditëve barut u dhamë e zjarr!

VIII

Ngaherë mbrëmanet kazerma zien,
Këndoymë «Hekurudhën e rinisë»
Te trari i kazermës na shkëlqen
Kandili i vjetër dhe një copë pishë.
Të çjerrë copë-copë ndër rrëpira,
Si dreqër nxirë nga korriku — furrë...
Po ne këndoymë këngët më të mira,
Që malet rrotull nesh s'i ndien kurrë!

IX

Punonim nëpër baltë e shi, e diell,
Në tym të verdhë, vapë apo erë...
Për ne shpeshherë s'kishte as të diel,
Prandaj ndokush mërzitej, bëhej vrer...
...Kështu një shok pështyu, edhe lopatën
E hodhi afër këmbëve të mia.
Vështroi përreth si rrihte shiu baltën.
— Në djall të vejë!, — tha dhe shkau si hija.
Vështronim se si ikte nëpër shi —
Këmishëlagur shoku ynë i djeshëm,
Dhe zhdukej nëpër ujë gjurmë e tij,
Kur frýnte erë e maleve të atjeshëm.
— Eh, dezertor!, — i foli komandanti
— I poshtri!, — tha një tjetër për matanë.
Unë grushtin i mërzitur bëra gati,
Por dezertori humbi ndër ormane(!)
...Ne kishim udhën tonë, ai të tij;
Ai u zhduk në baltë i vetmuar,
Ne baltën e qëronim nëpër shi
Të gjithë tok, si miq të dashruar.
...Pastaj atje zhavorr e gurë shtruam,
Traversa lisi vumë me kujdes.
Mbi to dy vija hekuri kaluan,
Që zgjateshin çdo mbrëmje, çdo mëngjes...

X

...Kazerma jonë vete çurkë natën!
Buçasin qiejt dhe rrufeja bje.
Ky shi dhe ky rrebesh e zgjon brigadën,
Që u lodh në baltë nga puna e rëndë dje...
Jastëkët, batanijet llom u bënë,

Bile në trup na hyri ujë i ftohur.
Jelekun tim nën kokë e kam vënë,
Po dhe ai s'ka mbetur pa u njomur.
Kazerma zien. Kush shahet, kush ankohet,
— Fenerët ndizni!, — thërret dikush në shtrat.
Kurse diku një këngë po dëgjohet,
Ndonjë gazmor, siç duket, s'rri rehat.
...Ne kaq e patëm!
Akull-akull ngrimë,
Sikur mos ishte shoku kuzhinier:
— Vellezër, ejani me mua në kuzhinë,
Se zjarri flakë, — tha, — atje po merr!

XI

Ne vajza kishim plot, por vetëm një
I lojti mëndsh djelmoshat sa e panë!
Sa èndrra të çuditshme pamë për të,
Sa herë në mendime për të ramë!
Për mua s'kish më lodhje e mundim,
Për mua ish kazerma si pallat,
Ku rronte një princeshë si agim
Dhe unë isha princ me mall e fat.
Ajo s'më tha të dua, por më deshte,
Ajo s'më foli shumë, s'm'u betua...
Veçse e ndieja kur më buzëqeshte
Se do të thoshte fjalëzën «të dua».
Të dy në mbrëmje dilnim jashtë shpesh,
Kur ngjyrë e purpurtë derdhej përmbi male,
Kur tymi i kaltër zbriste shesh më shesh
Dhe rrëkëllehej fushës me ngadalë.
Filloi të hapej fjala në kazermë
Për ne të dy, për vashën «që shëtit!»
Po ku ta dinë ata ç'do të thotë zemër,

Ç'do tē thotē zjarr, që mua mē zhurit!...
Një mbrëmje ne tē dy pas bregut shkuam.
Ish natë e hëna shkiste nëpër retë. *mete*
Dhe nuk e di se si u përqafuam,
Se si u puthëm nxehëtë!...

XII

E sollëm trenin.
Udhën ne e shtruam.
Sa keq, sa keq që s'erdhi nëna ime,
Të shihte se ç'punuam e ç'ndërtuam!
Dhe tē dëgjonte shinat plot gjëmime!
Të thosh e shkreta plakë: «Ç'paski bërë!
Shtëpi me rrota ecin sërë-sërë!
...dhe vërshëllen.
Mbi djersën tonë shket.
Dhe për tē parën herë, i hutuar,
Unë hip atje, ku këngë e gaz buçet,
Me vashën që këtu kam dashuruar.
Nga prapa tym i murmë vetëm mbetet.
Dhe rruga shkon në mal e në luginë
Dhe përsëri ajo diku më thërret
Dhe përsëri një torbë kam mbi shpinë...
...Kjo udhë i ngjet poemës pa mbarim,
Ajo s'ka fund,
Ajo vrapon, vrapon...
Dhe tok me tē vazhdon tregimi im,
Vazhdon.
Vazhdon!...



(30)

K U R B A T K A

1.

T i me djep në krahë brodhe shumë,
Kur korriku gurët përvëlonte,
Kur dhjetori derdhite shiun lumë,
Kur në mal laureshëza këndonte.

Dhe mbi djep agimet — trëndafila
E shikuan flokëkacurrelë,
Hijeve të lisave bilbilat
I kënduan dhe e përkëdhelë.

Pa mësoi çunaku të këndoje
Këngët mbushur mall e mbushur shpresë,
Pa mësoi çunaku të vallëzojë,
Kur i binte nënëza dajresë.

Vite shkonin, bari, gjethi ndrrohej:
Bashkë shporta thurnit arë më arë.
Shpesh nga gjiri yt ai largohej
Dhe i binte fyellit më të qarë.

2.

Kur njëherë rrugës ju zu nata,
Buzë lumit gjetët dy-tre vetë:
Ishin djem e vajza nga estrada,
I pëlqeu tët'biri një gërnetë.

Eh, kurbatkë, grua e munduar,
Që je endur pllajave përpjetë,
Biri yt ballukengatërruar
Të kërkoi t'i blije një gërnetë!

Thure shumë shporta pas lumenjve,
Thure plot rrogoza në kënetë,
Mblodhe çaj të egër bri shkëmbenjve
Dhe i bleve çunit një gërnetë.

3.

Eh, kurbatkëzeza, nënë e mirë,
Kjo gërnetë ç'të punoi, ç'të solli!
U mërzit të bredhë çuni lirë
Nga Shkumbini, Drini e Devolli.

Dhe një ditë një nga të rinise
Nuk e di se ç'fjalë i kishte thënë
Dhe që aherë zogu të braktisi...
Bashkë me gënetën iku, nënë!

Mbete ti me shportat fillikate,
Kaçurreli hyri në estradë.
Moj kurbatkë, moj kurbatkë, ç'pate,
Ngatërresa paska jetë e gjatë!

Të kërkoi yt bir diku nga mali
Bashkë të jetonit në qytet;
Po ti veç në dimër shkon te djali,
Në pranverë rruga të thërrret.

Pse s'të rrihet ty pa shushurimë
Lumi edhe gjethi në zabel?...
Ujë do të pish nëpër burime,
Diellin ta shikosh kur hyn e del.

S'e kuption se koha e kurbatëve
Hesht si fjalë e vjetër në një frazë?
Shekulli gjëmon në mes të shpateve
Mbi beton e hekur e plasmasë...

...Lodhesh dhe pas rrugëve zë vend,
Zjarrin ndez, ngre çadrën, kur vjen nata
Dhe mendon, mendon për birin tënd...
Eh, kurbatkë, ç'të punoi estrada!

KLLANIKËT

Kllanikë të tymosur e të vjetër,
Të nxirë nga tymi e bloza shekullore,
Pranë jush janë rritur gjyshër dhe etër,
Pranë jush kaluan vitet tonë fëminore.
Ne s'mund të ndahemi nga ju menjëherë,
Por ju e shihni se koha juaj iku;
Vitet po ju zëvendësojnë me caloriferë,
Me furra e soba elektriku.
Po ne poetëve na pëlqen romantizmi,
Na pëlqeijnë fjalët:

Dhe mendojmë se do humbë lirizmi,
Kur të themi:
«Pranë oxhakut rri Asllani»,

Kllanikë, «Me calorifer ngrohet Osmani»

Se çative ju po vdisni të lumtur,
Dhe s'ka u faltë ngrohtësinë,
Sesa kur gjë në jetë më të bukur,
ngroh me gjoksin tënd njerinë.

V J E S H T A

1.

Citjanet mjegulla
I ngriti si shtriga
Dhe hidhet në shelgje
Dhe bredh ndër boriga...
Erdh vjeshta,
Erdh vjeshta e verdhë,
Lumenjtë e malit nga grykat u derdhë,
Dhe fletët e trishta i hodhi zabeli
Si fjalë idili,
Si fjalë gazeli.
Mërziten thëllëzat e njoma për djem,
Poeti figura të mira nuk gjen
Për vjeshtën — piktore,
Që rri në zabel
Me furçë në dorë dhe me akuarel.

2.

Kujt fletët e verdha ia shtojnë mërzinë?

Më flak,

Erë e vjeshtës, melankolinë!

Më lidh,

erë e vjeshtës, në pyjet pa fund,

Ku pisha e gjelbër kurorën lëkund,

Ku bredhi e lisi thérresin,

Zhurmojnë,

Sorkadhja dhe ujku ndër driza përgjojnë.

3.

Më hidh,

Erë e vjeshtës, në kopshtet me mollë

Të shoh si mbush shportat ajo shamihollë,

Të shoh si agimi mbi mollët përgjon,

Kur lëngu i ëmbël i frutit kullon...

Më hidh, erë e vjeshtës, diku në rivierë,

Që fryma e detit në faqe të më bjerë;

Të shkoj nëpër bahçë,

Të zgres që nga mali,

Të shoh si skuq ballin diku portokalli.

Nëntor 1959

UNË DHE SHKUMBINI

Po zbresim nga malet ne të dy:
Shkumbini dhe unë.
Unë kam qeleshe të bardhë mbi sy,
Ai ka shkumë.

...Ne shpesh
Na zë gjumi rrugës natën.
Ai shtrihet në kurriz,
E barku i tij,
Si barku i një kafshe të artë,
Ndrit nga hëna e shushurin në lajthi.
Dhe ia trazojnë gjumin,
Si ëndrra të liga,
Përrenjtë që i bien në bark,
Kur lëshohen ndër shkrepa nga pylli me boriga
Që larg,
që larg.
Unë shtrihem, e gjumin ma trazojnë
Mendimet për shtëpinë time,

Për yjet,
Për luftën e paqen.
Mendimet e mia!
E ku nuk shkojnë!
Ato shpeshherë janë si mendimet në selishta
Të fshatarëve tanë të malit,
Ndonjëherë rrjedhin me nxitim,
Si uji yt, Shkumbin...
Shkumbin,

ne të dy kur zbritëm në fushë na panë
Që shkonim të qetë dhe na thanë:
«E shihni? E humbën vrullin!»
Por ne shkojmë krah për krah të dy,
Ti plot shkumë,

unë me qeleshe mbi sy,
Shkojmë ngadalë nën qiell të kthjellë,
Por më të matur,
më të thellë.

VIZATIME NË PRANVERË

1.

Cuni im

E gjithë çunat e botës

Filluan të ndjekin flutura.

Lulet u ngritën nga shtrati i tokës

Dhe i veshën fustanet më të bukura

Për të shkuar në ballon e madhe të pranverës,

Ku luan orkestra e bilbilave,

E mjeshtërve të violinës.

O çuni im

Dhe ju, o çunat e botës

Me buzëqeshje të bukura,

Kérkonit flutura,

Kurse ne,

Etërit tuaj,

Le të merremi me ekonomi e politikë.

2.

Kush është ai
Që erdhi në kopsht
Me kostum të kaltër e kapelë
Të prerë sipas modës së fundit
Por jo si gagarel?
Është prilli.
Shikoni sa i kanë hije
Kostumi i kaltër
Dhe kapela e kuqe, e pastër...
Është prilli.
Ai me të gjithë përshëndetet,
Duke nxjerrë kapelen e kuqe.

3.

Era akoma lulet s'lëkund,
Fusha ka baltë,

Sot pranvera hedh në katund
Çapin e parë

Vjen nëpër llucë,
Vjen nëpër baltë,
Sjell pastaj lule,
Sjell hijeshi;
Bletës i thotë:

Vashës i thotë: nisu për mjaltë!

bëj dashuri!

1959

JUBILARE

Po, vëllezër, brodha ndofta shumë
Dhe shënova në fletorkën time
Brazda ndër lugina dhe takime,
Ujëvarë dhe përrenj me shkumë;

E ç'më duhen mua pozat, shokë!
Unë rri tani edhe vras mendtë,
Se i mbusha plot njëzet e nëntë,
Dhe sa pak i fola kësaj toke!

Tetor 1960

BALADË OPTIMISTE

1.

Buzë një shpati,
Pas lumiit të artë,
Ngrihet një shtyllë e tensionit të lartë.
Hija e hekurit zgjatet e bie
Sipër avllisë,
Përbri një shtëpie.
Gjyshja e ulur shikon pa kuptim
Hijen e shtyllës dhe shtyllën që nxin.

2.

Sharjet e grave tej mureve ndihen,
Ndajnë dy lecka,
Mallkojnë e zihen.

...Gjyshja s'ha bukë se mban ramazan;
Çupën, që s'bindet të mbajë, e shan.
Gratë me hundë të varura rrinë.

Leckat i ndanë,
U shanë, u grinë...
Gjyshja sofatit shikon pa kuptim
Hijen e shtyllës dhe shtyllën që nxin.

3.

Çupa mërzitet, do jetën e madhe.
Ditë meskine,
Mjafton kësaj radhe!
Shko, vogëlushe, me djalin që, shpesh
Telin kur lidh, që nga shtylla të qesh,
Shko, vogëlushe e flake mërzinë,
Rrezet mbi hekur e tela të ndrijnë!

Y J E T

Natë e kaltër e mbjellë me yje, *mesf*
Erën që zgjon dhe lugina dhe pyje
Shpesh ta kam ndier menduar-menduar
Shkrepave të ashpër ndër male i zgjuar.
Era ç'më flaku
Në vitet e largët,
Vitet e largëta të kohës së flakët.
Kisha një shok
Që fliste me natën...
Dukej sikur misteret zbulonte,
Emrat e yjeve në quell m'i tregonte.
Ish «astronomi» i çetës së rreptë;
Çetës mësimë për yjet i jepte...
Por një pasdite,
Një perëndim,
Plumbi armik qëlloi shokun tim.
Shtrirë në shpinë, lëngonte nga plaga,
Vdekja afrohej si merimanga.
Mbledhur mbi kokë
Me ankth e shikonim,

S'kishim ç't'i bënim, dot s'e shëronim.
Nata po bridhte
Nga shkrepat,
Nga pyjet;
Nata po mbillte,
Si grurin, yjet.
Shoku i shtrirë mbi pallton e zezë
Foli ngadalë: «yjet u ndezën!».
Sytë pas syve të shokut na vanë,
Sytë në qiell të heshtur,
Sytë përdhe i ulëm dhe pamë
Shokun, me krye nga yjet, të vdekur...

V A R G U

Këtu jam si dhi në mes të dhenve
Dhe më duket se currkush s'ma var.
Shtrembër më shikon që lart shkëmbenjve
Një njeri që minës i vë zjarr.
Tjetri buzë lumit as ngre sytë,
Vetëm pantallonat i përvesh,
Mbi një mur diç thotë një i dytë
Dhe pastaj me shokun zë e qesh.
«Njerëz, nuk më njihni?, — them me vete
Me mërzi e pak me pikëllim —
Nga qyteti s'paska ardhur ende,
Qoftë në një kopje, libri im?»
Shkrova vargje,
Letër grisa shumë,
Fola për rrugicat nëpër fshat...
Ky njeri në shkëmb, si mur mbi lumë,
Duket se më sheh pak me inat.
O njeri, përse s'më lë të qetë?
Sytë, vallë, ç'ke që nuk m'i ndan?
Çdo njeri një punë bën në jetë:

Ùnë letér nxij, ti shkëmbin çan.
Ti do thuash pse nuk marr qysqinë?
Po, edhe atë mund ta rrëmbej,
Me qysqi e nisa fëmininë
Edhe gurë mirë di të thej,
Por kam qejf që ndryshe ta çaj shkëmbin,
Që të dy t'i flakim ciflat larg,
Që të dy lumenj e mal të trembim
Me qysqi,
Me dinamit
E varg...

Ferr-Shkopet 1959

NË SHTËPI TË VJETËR

Nuk del më gjyshja në dritare
Me macen mua të më presë...
Nën një selvi, diku në varre,
Ajo po prehet, pastë ndjesë!
Sa të panjohur shoh te porta!
Të vegjël me xhaketa-çjerrë:
Kush mban domate nëpër shporta,
Kush lot me gurë — bën poterë...
Kush hap një libër, një fletore,
Kush zgjidh probleme gjeometrike,
Kush bën me lule një kurorë,
Kush pret një cingël me një thikë.
Unë, o fëmijë, prindërit tuaj
I njoh se bashkë qeshëm, qamë,
I njoh, se bashkë lidhëm duaj,
I njoh, se bashkë malit vamë.
Pse të habitur më vështroni?
E dini?
Linda, ja, këtu,
Te kjo shtëpi, ku ju qëndroni,

Te ky ahur, te këto dru...
Njëzet e tetë vjet më parë
U ndje një zë nëpër mëhallë
Nga një fëmi'i vockël fare,
Fytyrëkuq e flokërrallë.

Ja, ky fëmi' kam qenë unë
Një çerek shekulli të shkuar,
Që thirra, qava, bëra zhurmë
Te kjo shtëpi hardhimbuluar.
Nga strehët shumë pika ranë...
U ngrita,

dola nga kjo portë
Dhe brodha vendin anembanë,
Dhe udhën mora nëpër botë...

1959

BALA, LOPA IME

Qumështi s'i shteri sa u plak,
Qumështi i rriddhe si burimi.
E kullostim brigjesh cak më cak
Ku harbonte uji dhe blerimi.

Nuk u ngjante lopëve të tjera,
Ekte rëndë-rëndë si një damë,
Kish dy sy të pastër si dy lera,
Kish dy brirë të egër si dy kama.

Ishte kohë lufte, kohë zjarri.
Fshatrave rrëmbehej pasuria,
Digjej arë e grurit dhe hambari,
Digjej streha, bëhej shkrumb hardhia...

Kur vraponin fshatit tim gjermanët,
Balën nxora jashtë dhe u nisa;
Çanin erën nga të katër anët
Vërvshëllima predhash edhe krisma.

Dhe një plumb e mori nën dy brirët...
Çeli lulëkuqja mu në ballë.
Mali iu fundos mes errësirës,
Mua më spërkat i gjak i valë.

Krisën kockat... ra përmbi livadh
Dhe i mbetën hapur sytë e saj
Si dy lera pas një shiu të madh,
Turbulluar nga rrëke në maj.

Shkuan ditët... demat kur kalonin
Në atë vend ku Bala ishte vrarë,
Merrnin erë, sytë egërsionin
Dhe bërtisnin bashkë si të marrë...

MËNGJES NË PORT

— Peizazh —

Në ujë lahen dielli, vaporët, vinçat, kanxhat.
Me frymë mbush kraharorin deti.

Marinari, i kuq si dielli, ngre spirancat:
Lamtumirë!

Vapor do niset së shpejti!
Një varkë druri lëkundet nga vala,
Nga vala e kaltër adriatike
Dhe bri vaporit të madh hesht,
Hesht e vjetër, melankolike...
Direkët e vinçat puth mëngjesi i lirë,
Sirena shkruan mbi det nëntë gërma:
Lamtumirë!

NGA FLETORKA E SHËNIMEVE

Dhe erdha dje në Ferr-Shkopetë.
Ish ftohtë e binte shi me erë,
Mbi shkrepë ishin varur retë,
Në lumë zhurmë e poterë.

Nga një barakë shkoj në tjetrën,
Në salla erë djersë bie,
Po s'gjej njeri dot nëpër shtretër
Dhe asnë zë nuk ndiej atje.
Kurse dritaret e barakës
I rreh kamxhiku i shiut me zhurmë.
Pusho,

o shi,

pusho

ti pakëz,

Dhe ti,

o valë,

hesht në lumë!

Dhe dal në breg pas murit struktur:
Ky lumë duf e zulm ka ngritur,
Ndokush në ujë është futur,
Në shkëmb një tjetër është ngjitur.

Këtu buçasin plot motorë,
Më tej një minë gurë ngre,
Një lis i madh e shtie kurorën
Nga plasje mine përmbi dhé.

M'i fshikin faqet shiu dhe era,
Po unë s'ndiej;
diçka mendoj:

Sa keq,

sa keq,

që ndonjëherë

Për vogëlsira varg hartoj,

Kur brigjeve punojnë shokët,
Ku era e malit të bën gur,
Kur zënë lumë,
çajnjë tokë,
Kur shpojnë shkëmb e ngrenë mur!

...Dhe ne shpeshherë kot së koti
Në klubin tonë kohën shkojmë:
Ak'cili ish poet i zoti
Dhe mjeshtër fjale...
kuvendojmë.

Shpeshherë qahemi e themi:
Mungon ajo,
mungon dhe kjo,
Apartament sikur të kemi,
Do jemi mirë,
po g'e do!...

Kurse atje në breg të Matit
Kazermën era mend e prish
Dhe shoku ynë qëmenatë
Me shkëmb e lumë
luftën nis.

KËMISHËT

Një grua në Bistricë lan këmishë,
Një grua djersën e trupave të lodhur
Me ujin e lumiit e dërgon në det.

O duar të shkathëta!

Ju mund të bëheshit të buta si pambuk
Dhe tastjerën e pianos té preknit;
Ju faqe librash mund të shfletonit
Në biblioteka të mëdha e universitetë,
Ju dorezën e nikeltë të veturës mund të kapnit,
Ju në Tu-104 mund të ndanit çokollata,
Ju të kuqin e buzëve mund të shkonit,
Ju gjerdanët e vëthët mund të lëmonit!

O duar të shkathëta!

Ju gjithçka mund të bënët!

Në bregun e Bistricës rri e mendoj, o grua,
Rri e mendoj për duart e tua!

Ti lave shumë këmishë,
Kur zbrisnin trimat brigjeve të lumiit,
Aherë edhe njolla gjaku pastrove
Me ujin e ftohtë e lotin e përvëluar!

Rri e mendoj dhe mendimet e mia
Buçima e minave i shpërndan.
Djaloshin që fitilin e dinamitit e ndezi
E shoh të zgresë poshtë i djersirë
Me këmishë të lagur nga vapa.
Dhe gruaja atij i qesh:
— Hidhe këtu!
Unë erën e djersës ndiej.
Sa turbina vërtit kjo djersë,
Sa turbina!

T H I R R J E

Dhe tē vjen keq se le tē afërt,
Le nënën, babën dhe vëllanë
Atje në fshatin tēnd tē largët,
Atje ku ecën lumi pranë.

— Qëndro — tē thotë nënë e gjorë —
Ja, mollë e dardhë po na piqen!...
Babai ta shtrin tē ashprën dorë,
Vëllezërit s'duan tē tē hiqen.

Qëndro, qëndro, po rruga s'pret,
Ajo tymon luginës larg,
Ajo tymon e tē thërret
Dhe ti mbyll derën, del në prag.

Megjithëse keq tē vjen kur ndahesh,
Në rrugë ndjen prap një gëzim:
Kudo tē shkosh, kudo tē ndalesh
Tē presin njerëz në takim...

Dhe vjen një çast kur kthehesh prapë
Dhe ulesh plot me mall në vatër,
Shtëpia krahët do t'i hapë,
Që ti të rrish si zog i kaltër.

Nuk ka më mirë se kur kthehesh
Nga udhëtim i madh i ndritur,
Sikur je bërë më i mençëm,
Sikur je bërë më i rritur.

Ke parë njerëz, fusha, male,
Ke parë ara dhe lumenj,
Ke ecur shpejt e me ngadale
Nën shpatet mbushur me shkëmbenj...

S K U A D R A

Kutinë e konservës
E ndjekin me radhë
Në lagje fëmijët lojtarë.
Skuadër futbolli,
Potere e madhe,
Portierë me gjunjë të vrarë!
Shikoj edhe bëhem çunak pa këpucë
Me flokë të flakur në erë,
Dhe hidhem pas topit
Në baltë,
Në llucë,
Gënjej centërforë,
Portierë...
Dhe shuku i leckës,
Dhe top i futbollit
Në xhamin e fqinjitet...
Gol!
Skuadra shpërndahet në breg të Devollit
Nga frika e fqinjitet gogol.
O vitet e para!

Skuadër futbolli!
Ku jeni, çunakë-lojtarë!
Portieri i rreptë,
Kur shfrynte Devolli,
E di që mbeti i vrarë.

} Të tjerët si çerdhe
Diku ngriten jetën,
Sportistë s'u bëmë,
Tifozë ne mbetëm!

PEIZAZH NGA BALLKONI

Hënën e kuqe
Si një mëshqerrë
Dajti mbi shpatull
E mban me përtim.
Duket sikur e ka marrë ta shpjerë
Tutje për ujë, diku në burim.

M O T I V E T

Motivet?

Motivet janë vajza lozonjare,
Që buzëqeshin në rrugë e të ftojnë...
Por po s'i ndoqe pas, të lënë përfare,
Të lënë,
 fluturojnë!

Fol shpir

FOKSTROT

E dashur, mos u merr me mua kot,
Se kurrë nuk mësoj të loz fokstrot.

Më duket i vështirë ky vallzim
Dhe, siç e sheh, s'i vete shpirtit tim.

E dashur, më vjen keq, më mbetet hatri,
Kur thua: bukur lot xhaketëkaltri!

Po, po, xhaketëkaltri hidhet mirë
Dhe trupin në vallzim e mban të lirë!

Veç unë si ai nuk mësoj dot,
Ai në asfalt kalon e lot fokstrot.

Babai i tij dërrmohet në minierë
Nga fund i tokës nxjerr katran e serë,

Kurse i biri rrugëve bredh kot
Në asfaltin e babait mëson fokstrot!

1960

M A L L I

Hëna brirët lan në lumë, uji yllin e spërkat,
Unë sillem nëpër shelgje sonte natën fillikat.

Bulku fshehur pas një drize lumi iso po i mban,
Natë e viseve të mia bie erë jargavan.

Si një rrahje flete molle një të puthur afër ndiej,
Sonte njerëz dashurohen te ky mal nën këta qiej...

Edhe unë dashurova dhe në jetë patat fat,
Ndofta edhe puthjen time e dëgjoi një fillikat.

Ndofta ndezi një cigare pranë shelgut te ky vend,
Ndofta buzët i lëvizi dhe diç solli nëpër mend...

Ndofta, ndofta... lumi derdhet, flladi thinjat m'i
Natë e viseve të mia bie erë jargavan... shpërndan,

NATË NË ARË

Si mace e verdhë fshihet hëna
Përtej mullarëve me bar.
Ne pranë ledhit kemi rënë
Të flemë bashkë në ugar.

Dhe erë bar e kashtë bie,
Puhi e lumit fryn ngadalë,
Një plis me këmbë kali shtie,
Një lakuriqkë vjen vërdallë.

Dhe gjer përtej te buzë e zallit
Dëgjohen zilet e një tufe,
Bariu ia merr me mall kavallit
Dhe ia lot mendjen ndonjë çupe.

A mund të fle dot këtë natë
Në fshatin tim, në mes të ugarit,
Kur kundërmon tërfil i thatë,
Kur hënën mban sup i mullarit?

KUR BIE DËBORË

Bie dëborë këtej, bie dëborë;
Unë jam në kasolle në mal,
Toka duket e bardhë e bardhë,
Toka botën e përrallës më ngjall.

Nuk më rrighet rreth vatrës së vjetër,
Do të ngrihem dhe malin do bredh,
Le të bjerë dëborë mbi mua
Siç ka rënë përmby atë bredh.

Unë vetë kreshniku i përrallës
Çdo bregore e skutë do shkel;
Kur të lodhem, do ulem nën pishë
Edhe ty nëpër mend do të sjell.

Sytë e tu kaltëroshë të dashur
Përmes flokësh dëbore do shoh...
Malet duken të bardhë si ëndërr,
Malet unë me frymën i ngroh.

KJO GRUA

Kjo grua që bie erë çokollatë
Me mua ra dikur në dashuri;
Tani jeton me burrin në pallate,
Që ngritëm vjet në bulevard të ri.

Dhe nuk e di, e lumtur është vallë,
Me burrin zemërbardhë e shtatlartë.
Qëndroj ta përshëndes, t'i them ca fjalë,
Si kalimtar, si mik e shok i largët.

Po kokën nuk e kthen ajo nga unë,
Trak-trukun e sandales më lë pas...
Atë në djalëri e desha shumë
Betoreshim të çanim çdo tallaz!

Po bashkë s'patëm fat të lidhnim jetën,
Se donte apartament e telefona...
Unë bëja veç artikuj pér gazeten
Dhe flija redaksive mbi poltrona...

Po unë e di, akoma natën në ëndërr
I shfaqem, e hap derën bojë hiri,
I shfaqem dhe i futem drejt në zemër,
Megjithëse pranë saj fle zemërmiri.

Kjo grua që bie erë çokollatë,
Që desh nga unë apartament të ri,
Tani jeton me burrin zemërbardhë;
Jeton e lumtur?

Nuk e di!


VAJZAT NOTARE

Kush tha se s'ka sirena në dete?
Kaloj pas bregut mes vajzave notare,
Si Odiseu i Homerit plot derte,
Që urdhëroi shokët ta lidhnin me litarë,
Se s'donte të binte në duart e sirenave
Mes erërave të Erosit, mes erërave!
Po unë shokëve s'u them të më lidhin
Këto sirena s'më marrin me vete!
Rreth meje ato s'kanë si mblidhen,
E megjithatë, kush tha se s'ka sirena në dete?

Dhe ujët derdhet mbi trupin e tyre
E duket sikur diku do t'i shpjerë
— Sirena, merrmëni me vete, — them në det duke
hyrë —
Sirena, merrmëni me vete në valë e në erë!
Kish të drejtë Odiseu që u lidh me litarë!
Mua s'më iket nga vajzat notare
Dhe flas me vete:
Kush tha se s'ka sirena në dete?

P O E Z I A

C'po ndodh me mua kështu,
C'po ndodh me mua!
Jam mbushur plot mall e mërzi!
Diçka po kërkoj, diçka në jetë dua
Dhe i vrenjtur tërë ditën rri.
Dhe i vrenjtur...
 jo nga dashuria;
Tjetër gjë më mundon, më thërrret...
Ndofta ma bën me dorë poezia,
Ndofta më thotë:
 ndiqmë, poet!
Ndiqmë se shkova shumë larg, shumë larg,
Ndiqmë arave mes fletëve,
Ndiqmë bulevardeve në asfalt,
Ndiqmë trajektoreve të raketave,
Shumë larg, shumë larg!



MENDIME NË VJESHTË

1.

Po vallë

Mund të dergjem në dhomë

Ditëve të verdha

Në vjeshtë,

Kur molla mbush vitrinat me aromë,

Molla,

E para pemë që në jetë

Embëlsoi — sipas biblës — njerinë?

Do dal!

Më fton rrugicave vjeshta,

Më pëshpërit ndër pllaja

Vreshta...

2.

Kinooperatori

Merr në film

Kofinat me rrush.

Grerëzat vërtiten e ulen mbi kokrra.

Vreshta duket

Si grua

E porsadalë nga materniteti:

E pafuqishme,

E lodhur,

E qeshur...

Kinooperatori

Merr në film

Atë që lindi ajo:

kofinat me rrush.

Era fletët lëkund,

Vreshta qesh e lodhur

Dhe me rrahjen e gjetheve të saj

Grerëzat përzë nga kokrrat e rrushit në kofina,

Si nëna mizat nga fytyra e foshnjës në djep.

3.

U këput nga plepi i lartë i qetë

Dhe ra

Mbi flokët e vajzës një fletë

Dhe shëmbëlleu

Me një fjongo të verdhë të lehtë.

Por era fryu

Dhe e rrëzoi në asfalt;

Vogëlushja u ul,

E mori,

E ngriti lart,

Pastaj e vuri në një libër të trashë.

Unë rrugën ndoqa dhe në mendime rashë

Për fletën e verdhë,

Për veten time

Dhe për atë vashë.

4.

Dhe nata
Furçen në bojë të zezë
E futi
Dhe male e fusha i ngjeu.
Në vatra e furra
Drutë u ndezën,
Treni i fundit vërshëlleu.
O vërshëllima të trenave të fundit,
Mes fletëve të verdha në vjeshtë,
C'm'i zgjoni kujtimet
E largëta prej gjumit!

5.

E ndajnë diellin përgjysmë
Pishat e holla,
I ngjiten diellit si parmakë rrote
Tri mënjollë.
Zabeli skuq i përgjakur si flamur divizioni
Dhe era fletët shtyn nga honi.
Unë një fill bari përtyp mbi gur:
Në mend një varg kam,
Po dot s'e thur.
Një zog mbi degë i vetëm belbëzon,
Mendimet dhe ëndrrat m'i trazon.
Qëndro, qëndro, o zogu vocërrak,
Të thur pér diellin,
Vjeshtën dhe pér ty një varg...
Qëndro, se gjithnjë,
I mjeri unë,
Kam dashur të mbaroj një punë
Të pastër, të bukur e plot jetë
Si ky perëndim dielli në vjeshtë!

6.

Frym erë.
Molla lëkundet,
E kokrrat
Me grushte trokasın në dritaren time
— Kush është?! —
Thërresin te dera motrat.
Kujtojnë se kush erdh mes suferine.
— Janë mollët! —
Them e bie në mendime:
Nëna e mollëve shqetësohet shumë
Për kokrrat, bijat e saj,
Që i mban me vete;
Trembet mos këputen nëpër zhurmë
Dhe vriten e humbin tatëpjetë
Mes shpëndrave
Dhe gjembave të mprehtë...

7.

U hoqën ndër lulishte
Tavolinat
Dhe mbeti shkretë
Vendi i orkestrës.
Këndon eukalipti nga suferinat,
Këndon violina krenare e vjeshtës.
E dashur,
Eja të dëgjojmë muzikën
E erërave
Të topitura me shira,
Edhe ato
E sjellin me vete lirikën
E pyjeve

Dhe tē lugjeve tē dlira.
Muzikë vjeshte
Me nota bethoveniane,
Në veshët e mi
Tingëllo e ziej!
E dashur, eja,
Eja pranë!
Një froni tē lirë lulishteve do gjej!

1960

DHJETË SY

*Dje dëbora e bjeshkëve gëlltiti
pesë kufitarë, që ishin nisur të
zinin qafën e Ali Çelës, ku mund
të kalonte armiku.*

Nga ditari i kufitarit.

1.

Qëndro,
Gjeolog,
Lëre torbën tënde
Te ky obelisk pishe
Mbi përrua!
Ne me pëllëmbë,
I njohim këto vende
Dhe frymën dehëse
Të pishave e duam.
E di ç'ka ndodhur
Dimrit mbi dëborë
Këtu te kjo dëllinjë,
Te kjo pemë,
Kur unë e ti

Shënonim në fletore
Ndonjë shifër
Apo varg poeme,
Kur unë e ti
Në shtrat shikonim në èndërr
Metale
Dhe heronj dyfekëlarë?
Këtu çapiteshin
Mes mjegullës së dendur
Pas njëri-tjetrit
Pesë kufitarë;
Këtu dëborën
Shtypnin dhjetë kömbë,
Këtu shikonin
Bjeshkët dhjetë sy,
Këtu lundronin
Pesë gjokse shkëmbi
Përmes furtune,
Ere e stuhi...

2.

Kush tha
Se iku
Koha e baladës?
Me varg balade
Mund t'i jap përgjigje:
Ish koha kur poetët rrinin natën
Dhe shkruanin sesi ndër shtigje
Dëgjohej trok i kalit trak-ta-rak,
I vdekuri nga varri ishte ngritur,
Nën dritëzën e hënës shkonte larg,
Të dashurën takonte të venitur...
Vërtet

Baladat
Si käto
Mbaruan,
Po koha
E baładave
Nuk humbi.
Trego,
Baladë,
Njerëzit që shkuan
Mes erës
Zemërake zhurmëplumbi!
...I pari ra
Nga kosa e furtunës.
Përmbi qerpik
U shkrinë flokë bore.
Shikoi
Mes èndrrës
Nënën pranë Bunës,
Borigat
Edhe tokën prindërore.
C'të shihte tjetër?
S'kishte as të dashur,
As motra,
As vëllezër,
As baba.
I erdhi keq
Që nënën
Buzëplasur,
Të thinjur,
Pranë lumit Bunë e la.
...Detyra
Gjithnjë është e vështirë
Nuk zgjidhet
Pa mundim.
Në shkollë
Shpesh problemet

Zgidhte mirë,
Po shpesh
E mbushnin plot me hidhërim.
Po ç'ish ky hidhërim
Shkollar,
Ky lot?
Ai tani
Po vdes i dëshpëruar:
— Eh, qafë e Ali Çelës
E mallkuar
Eh, qafë e Ali Çelës,
S'erdha dot! —
...Lëviz të ftohtat buzë
Në dëborë:
— Detyrë! —
Era grindet
Rreth e qark.
Të tjerët përmbi shpatulla
E morën
Dhe tetë këmbë
Ecnin varg.

3.

Në bjeshkë
Rrinin hapur
Dhjetë sy;
Dy sy u mbyllën
Si agim mbi lumë.
Do thuash:
Ç'janë vetëm dy,
Dy sy,
Vëllezër,
Janë shumë!

Dy sy krijojnë një poemë,
Dy sy hartojnë një leksion
Dy sy në tokë mbjellin pemë,
Dy sy ndërtojnë një balon,
Dy sy për nënë janë shumë,
Për të një botë e tërë janë...
Dy sy u ~~mbyllën~~ si agim mbi lumë,
Dy krahë
Mbi dëborë ranë...

4.

I dyti,
Që mbi shpatull
Mbante shokun,
Filloi të shihte
Yje mes shtrëngatës;
Shtrëngoi
Me njérën dorë ballin,
Kokën,
U vrejt
Dhe ra
Mes mjegullës së natës,
Dhe ende mbante
Shokun përmbi shpinë:
«Ne
Mbetëm kufitarë
Të përjetshëm!»
Kaluan
Fjalët si një fëshfërimë
E gjetheve
Të maleve
Të atjeshme.
Dhe mbeti jetime një kitarë

Në dhomën e tij të vogël
Mes hardhive,
Mbeti ajo që dikur
Ka qeshur e ka qarë,
E përkëdhelur prej gishtërinje.
Tani s'do nxjerrë tinguj si aherë...
Mundet gishtat e një tjetri do të lozin
Me telat e saj të mjerë,
Mundet me pluhur të mbulohen;
Dhe merimanga
Të lidhë tela të çrregullt të tjerë...
Por jo,
Ajo do tingëllojë prapë!
Unë poeti
Vetë do ta marr...
Derën e dhomës tënde do ta hap,
Nga muri kitarën do ta zhvar
Dhe këngën e dashur
Me gishtat e mi do ta këndojo...
Por do këndojo edhe një këngë tjetër
Për gishtërinjtë e tu, ushtar,
Për gishtërinjtë e tu, që mbetën
Mbuluar nën dëborë në janar...
Të tjerët ndoqën rrugën e përpjetë
Dhe fshesa-erë
Fshinte
Shenja...
Gjurmë...
Dhe katër sy
U mbyllën vrik për jetë,
Kur tatëpjetë
Ortiqet bënin zhurmë.
Dhe asnjeri
S'e dintë
(Veç të treve
Që ngjiteshin

E shtynin kraharonë)
Se lart
Ndër pishat thinjë-thinjë
Poshtë reve,
Dy vetë
Frymën jepnin nën dëborë,
Dy vetë
Balsamoste lart stuhia,
Dëbora, vdekja
Të tria të ftohta.
Aherë unë e ti
Edhe komshia
Në klub
Përpiqnim dominotë,
Aherë gagareli
Ndiqte pas,
Me jakë të ngritur
E këpucë varka,
Ndonjë nga flokëprerat,
Në asfalt,
Q'e kishte zënë
Rrugëve darka.
Aherë çuni im
Dhe yti flinin
Me buzëqeshje fëminore,
Dhe èndrra
Për arinj
E lepuj shihnin,
Për mace
Dhe gogolë
Prej dëbore.
Dy vetë balsamoste lart stuhia...
Aherë shoku im dhe yti
Në minierë
E linte turnin e tia
Dhe shkonte

Pinte çaj me erë,
Aherë në opera basi këndonte
Dhe mbushte zemrat
Plot me mallëngjim,
Aherë sputniku
Kozmosit mbaronte
Të katërmijtin
rrotullim...

6.

I treti, që u rrëzua, ish druvar,
Prandaj në tinguj të sharrave u shndërrua;
Iu duk sikur, i veshur si ushtar,
Mes shokëve në pyje kishte shkuar...
Dhe pa borigën që iu thyen krahët,
Se dhëmbët e sharrës e rrëzuan...
Pështynë duart e mëdha druvarët
Dhe drurin e shtrirë e qëlluan.
Dhe oshëtiu përroi,
Ograja,
Pylli
Nga krismat e sépatave të mprehta
Gjersa nga maja pishash doli ylli,
Gjersa e nisi këngën gjoni fletësh.
Dhe zjarri lojti valle në lëndinë.
Druvarët tregonin anekdota...
Atij ende tingujt e sharrës i vijnë
Në vesh gjithnjë,
Gjithnjë më të forta.
Këta tinguj nuk i ndahan,
E hedhin ndër ëndrra
E kujtime të largëta:
I duket sikur pas zjarrit

Këmisha i thahet
Dhe i nxjerrin avull
Çorapet e lagëta.
Mes avullit e tingullit të sharrës
I del fytyra e babait druvar;
Tok me atë punoi dy vjet më parë
Gjersa i erdhi letra për ushtar.
Djalosh,
E kush nga ne ka mbetur vallë
Pa qenë ushtar,
Pranë pushkës pa qenë?
Dhe vetë ne poetët
Në radhë
Me ushtarë,
Bujq,
Druvarë
Jemi vënë.
Ti u largove,
Shoku im,
Një vjeshtë
Ushtar diku në pyjet veriore,
Po sharra jote e rebeltë
Nuk ra në heshtje;
Atë të tjerët e morën në dorë...
Po dhe atje ku derdhë vrer thëllimi,
Mbështjellë me kapotën e ushtarit,
Të dukej sikur vinte tingëllimi
I sharrës shekullore të druvarit.

7.

Edhe i katërti u shtri si tre të tjerët...
E kush mund të mendonte
Se një ditë,

Një ditë në mëngjes të ftohtë
Herët,
Një telegram i hidhur do të vinte
Dhe babës do t'i thoshte:
S'ke më djalë,
Dhe mua do më thoshte:
S'ke më shok?
E pse më ngriu në gjuhën time fjala, *mif*
E pse m'u tha pështyma?
...Dhe shkoj tani në dhomën ku jetonte:
Një furçë dhëmbësh,
Një peshqir në gozhdë,
Pasqyra që shikohej kur pastronte
Fytyrën djaloshare në atë odë.
Sa herë vija këtu!
Sa herë zihesha me të
Kur më tregonte vjershat në fletore!
Së pari zemërohej,
Pastaj nuk bënte zë,
Dëgjonte,
Ulte sytë e tij rinorä.
...Më duket
Sikur ende është gjallë,
Sikur i qetë rri në gjumë!
Mbi këtë shtrat kur vinte nata,
I mbyllte sytë
E shihte èndrra shumë...
Akoma asnje grua s'i pat hedhur
Këpucët me takë
Nën krevat të tij...
Këtu në dhomë kurrë s'kishte ardhur
Ndonjë femër
Për të bërë dashuri.
Ai s'e kishte ndier në atë dhomë
Ende erën e pudrës dhe pomadës
Së grave...

Shoku im i njomë,
Mundohej t'u thurte këngë
Yjve, hënës, natës,
Mëngjeseve dhe tokës plot aromë.
O, pse ia shaja vjershat shokut tim?!
Kjo më mundon tani që s'është më.
Të dashura fletorka me vija të njohura,
Me faqe të mbushura një pas një,
Në tryezën e tij me mall po ju shoh!...
Megjithëqë s'jam sentimental,
Një lot
Më bie e faqen posi prush ma ngroh.
Diç dua të them,
Po s'e them dot...
Po shoku im,
Megjithëse ia shaja vjershat,
Mund të bëhej poet
Më i mirë se unë,
Dhe të këndonte vreshtat
E ngarkuara me rrush mbi lumë,
Të këndonte ullinjtë,
Që dega e kaltërt
E tyre është simbol i pages sot,
Të këndonte malet e larta
Me kraharor thesaresh plot.
Ai mund të këndonte!...
Pse lotët më bien?
Pse them: «mund të këndonte?»
Ai këndoi
Baladën më të bukur
për atdhenë,
Kur krahu i fortë i erës e mbuloi
Me jorganin e bardhë
Të bjeshkëve...

...Dhe mbeti
 Vetém njéri
 Nëpër bjeshkë.
Të tjerët, si ndër përralla,
Gur u bënë.

Përmbi fytyrat
 Nxirë posa eshkë
Dëbora virgjëreshë
U ka rënë.

Dhe mbeti
 Vetém njéri!
 Po s'u ndal,
 Mbi katër shokë
 Derdhi katër pika loti,
 Dhe këmbët shtyu
 Mes lisave në mal,
Ku egërsohej moti...
 Kaloi përbri koliveve
 Që verës
 Barinjtë i ndërtuan ndër lëndina
 Dhe dimrit trashëgim ia lanë erës,
 Që sjell edhe pështjell me trokëllima.
 Kaloi përbri...

kaloi, po mund të ndalej
 Dhe mund t'i fshihej dimrit dhe detyrës.
 E kush do merrte vesh
 Se lart në male
 Ai në kolibe kishte hyrë
 Dhe me të vetmen shkrepse,
 Q'i kish mbetur,
 Një zjarr kish ndezur,
 Ishte çlodhur?
 Dhe kur furtuna bjeshkëve të ish tretur
 Të ndiqte rrugën?...


...Por i la pas kolibet ballëvrenjtur...
Te qafë e Ali Çelës erdh;
Shtrëngoi automatikun
Dhe u ul,
Si të ishte në llogore;
U mbështet,
Nga djersë e vdekjes
Bërë qull:
— Këtej s'kalon njeri,
 s'kalon!
O ti që vjedhurazi futesh,
Më dëgjon? —
Dhe zëri u bashkua me një zhurmë
Ortiqesh nëpër bjeshkët
Plot llahtarë,
Dhe era fryu
E mbushi gropë,
Gjurmë,
Kallkan e bëri kufitarë...
Po dora
Këmbëzën shtrëngoi
Dhe, kur i ndali zemra
Një krismë grykave
Kumboi...
Dhe mbet si karakoll i tmerrshëm
Me sy çelë.
Eh, qafë e Ali Çelës!
Ali Çelë!...

9.

Qëndro,
Gjeolog,
Lëre torbën tënde

Te ky obelisk pishe
Mbi përrua!
Ne me pëllëmbë
I njohim këto vende
Dhe frymën dehëse
Të pishave e duam...
Këtu dëborë e maleve të lartë,
E flakur nga tufani i tërbuar,
I mbylli dhjetë sy
Të zez, të kaltër,
I mbylli dhjetë sy të dashuruar.

1960



MUND TË MENDOJMË

Nuk jemi të përjetshëm, po zbardhemi
Dhe vitet po na shkojnë një nga një;
Nesër nga kjo botë do ndahemi.
Do na përcjellin me lot e pa zë.

S'jam ëndërrues i krisur i viteve që ikën,
Veç sonte më ka pushtuar një mall.
Ç'u bë ai çuni i vogël, që mbante në brez thikën,
Që gdhendte shkopinj thane në mal?

Ç'u bë shkollari Dritero me bojë në duar
E me penë të thyer në xhep?
Ç'u bë admiruesi i zogjve krahëshkruar,
Që i ndiqte nga lisi në lis, nga plepi në plep?

Udha zgjatet. Nuk jemi të përjetshëm.
Ç'u bënë letrat e dashurisë tërë zjarr?
Ç'u bë i pari tregim, e para vjershë?
Ç'u bë vendi dhe froni i fshehur në bar?

Q'u bë vullnetari i rreptë i hekurudhës,
Që mbushi vagona me gurë e me dhë,
Që fjeti në kasollen, që i ngjante kërpudhës
Dhe dëgjoi shiun, kur binte në teneqe?

Dje Pënsioni

Po ikim. Po të tjerëve do t'u lëmë
Të paktën një tregim, a një varg,
Që mos skuqen kur në raft t'i vënë
E kur t'i shfletojnë në dhomë a në park...

1964

NGA KUJTIMET E HERSHME

Kishin ikur të gjithë e kishin lënë
Vetëm erën e djersës e bishtat e cigareve.
Hingëllinte kali në lëmë
Dhe u binte demi me brirë mullarëve.

Më kish lënë përgjithnjë e bukura!
E kuptova se s'duhej t'i bija pas atë natë,
E kuptova se s'donte nga unë të puthura,
E kuptova dhe kalin përkëdhela në qafë...

Erdhi demi e me gjuhën e trashë
Më lëpiu në faqe e në veshë.
U shtriva i lodhur në kashtë.
Nata binte erë grurë e pjeshkë...

1964

LARG DO TË TË SHPIE

dash

Në bashkë hajt të shkojmë larg në male,
Në vende aq të kaltra, aq të bukura;
Të rrjedhë gazi yt në buzë e faqe,
Të zërë dora jote e vogël flutura!

C'kujtove ti, se unë jam i thatë
Dhe këngë s'mund t'u thur bregoreve,
Zambakëve e plepave të gjatë
Në epokën e plastmasës, reaktorëve?

C'kujtove ti, se unë jam i lënë,
Që mos të të them lule, po raketë?
Do vish me mua, kam për të të shpënë
Livadheve e pyjeve me fletë.

1964

nënsa

E URTA, E MIRA

Për H. A. polli

Nëna ime, e bukura Hatixhe,
Më e bukura nga gjithë fshataret,
Përmbi një minder nën penxhere
Më polli mua kur u kthyë nëga arat.

...E britma ime u hap mbi dhé,
Bashkë me zërin e demit e kalit.
Nëna ime, e bukura Hatixhe,
Heshtte e i gëzohej djalit.

Pastaj u mblohdhën fshatarët e mi,
Faqet e parruara ulën mbi mua
E thanë: «Shumë ara do lërosh ti
E shumë ujë do pish në krua!»

E vërtet, nën qiellin me re e pa re,
Lërova ara e kapërceva pragje
Dhe për nënën time, të urtën Hatixhe,
Ngrita këngë e thura vargje.

ELEGJI PARTIZANE

Ti s'duhej tē vriteshe atje, xha Rexhep,
Ti gjysmën e udhës s'e kishe bërë.
Ta gjetëm kutinë e çibukun në xhep,
T'i gjetëm opingat me gjak e me rërë.

Ti kishe lënë në kuti pak duhan,
Pak sa tē mbushje çibukun një herë,
Duhan selishteje grirë me havan,
Nga plaka jote e mjerë.

C'e pije tē shkretin, kur vritej ndonjë!...
Çibukun e mbaje me dhëmbët e rrallë,
Mendoje e flisje pa zë,
Shtrëngajoje pëllëmbën e trashë në ballë.

Tē thamë tē gjithë mos shkoje andej,
Po kishe mall tē shihje fshatarët,
Që tokës parmandën ia fusnin në dej
E hidhnin farë.

Ti s'duhej tē vriteshe atje, xha Rexhep,
Dhe s'duhej ta lije duhanin pa pirë,
Se arat tē prisnin diku nën një shkrep
T'i mbillje më tē gdhirë...

D E T I

— *Peizazh* —

Shoh dhjetëra e qindra metra thellë,
Ku lëvizin miliona qenie të gjalla.
Në kusinë,

ku ziente detari gjellë,
Bredhin peshqit e rrallë;
E në kabinën,

ku rrinte kapedani,
Merimanga deti e gaforre
Fole për sulm e mbrojtje kanë
Për të pamëshirshmen luftën shtazore.
I mbuluar me barin ujor të zbehtë
Një automatik pranë një shpate është shtrirë,
Afër një termosi është një gavetë
Dhe ca pranga robi e zinxhirë.
...Ku vanë ujqit e detit, vallë,
Që kripa e valëve ua kripi flokun,
Që erdhën ujérave vërdallë,
Që malli i mori për tokën?
Ku vanë kapetanët,

detarët

E ata që vozisnin robërít deteve?
Ku vanë peshkatarët e zgjedhur e shpatarët?
Ku vanë mjeshtrit e torpedeve?
Të gjitha ti i pive, det!
Të gjitha ranë në fundin e enës sate...
Unë rri e mendoj e ti buçet
E në gjirin tënd miliona qenie ziejnë...
Po s'u përpinë gjurmët e thella të lavdisë,
Mbetën mes ujérave të tua shenjat e gjakut,
Mbetën plumbat e trimave të Selam Musa Salarisë,
Mbetën plumbat e Mujo Ulqinakut...

TREGIM PËR NJË GAJDË

Po më vini në mend me radhë,
Ushtarë të revolucionit, me pushkë e nagantë,
Po sonte po kujtoj Myftarë,
Partizanin që mbante nagantë e gajdë.

Gajda e tij ish e vetmja muzikë në çetë,
Që, kur e dëgjonim pas zjarrit, në mesnatë,
Na vinte në mendime nën yjet e zbehtë,
Na shpinte në të dashurat e gratë,

Na shpinte në ngrohtësinë e vatrës,
Na shpinte të dëgjonim këngët e gjymit,
Pranë oxhakut të vakët,
Nën tavanin e nxirë prej tymit,

O, ku s'na hidhte ajo gajdë,
Gajdë e Myftarit të urtë,
Rreth zjarrit në mesnatë,
Ku digjeshin drutë!...

Veç një mbrëmje tingujt s'u dëgjuat
Tingujt e gajdës së Myftarit të shkruan
Në gurët muzikanti ish rrëzuar,
I ish shpuar gjoksi dhe gajda nga plumbi

NËNA IME

Nënë, ti akoma s'je mësuar
Në qytet, ku rruga zhurmëron;
Ditën mbi asfalt shkon e hutuar,
Natën për kodrinat ëndërron.

E mërzitur ç'më ankohesh mua:
— Pse mos mbajmë, biro, ndonjë shpend?! —
Flokëbardha ime, çfarë thua?
Si të mbajmë shpend
në apartament?

Unë e di, ta k'ënda, moj e shkretë,
Herët të të zgjojë një këndes,
Jo kryeartikulli i gazetës,
Që jep radiua jonë në mëngjes.

Të merr malli shumë, nëna ime,
Mall që s'ka të shuar asnjëherë
Për ugare, kodra e burime
Dhe për qëngja, kecër edhe shpezë...

1962

FIRDUSI

...Vetëm njëri heshtur pinte kafe,
Dhe pastaj u ngrit e fjalët mati:
— Ju bekoftë zotë, pse kaq llafë?...

D. Kedrin

Dhe tha Anzariu: «O, ka shumë vjet,
Që vuani e heq Firdusi-poet».
U kthyeni në Tusë e rri në shtëpi,
Ushqehet nga kopshti i vogël i tij.

H. Hajne

Pinin bejtexhinjtë në çajhane,
Vera u pikonte nga mustaqet;
Nëpër gojë ç'e merrnin dynjanë;
Bridhte fjala nga qoshet e caqet.

Flisnin pleqtë, vinin bast të rinjtë,
Mençuri e gjithë Horasanit:

— Për allah,
filan nga bejtexhinjtë

Ka medalje tē artē prej sulttanit!

— Pér allah,

pashai dërgoi e mori,

Bejetet nē saraje t'ia këndoje,

E lëvdoi veziri nga oborri:

«Aferim!

Pér ty kemi nevojë!»

Ziente çajhaneja plot me njerëz,

Mburrnin njëri-tjetrin,

mburrnin bejetet,

Dilte nga dritaret era e verës,

Era që me mjegull vishte dertet.

Vetëm njëri heshtte nē një qoshe,
Me peshqir tē vjetër kokën lidhur,
Nëpër dhëmbë gjysmë vargu thoshte,
Pinte veresie çaj tē hidhur.

— Ç'është ai?, — tha një nga bejtexhinjtë.

— Një matuf! Abul-Kasim i Tusës!

Vetëtinë unazat nē gishterinjtë;

Rrodhi vera cepave tē buzës.

Si ta dinin vallë nē çajhane,

Ku pari e vendit kuvendonte,

Se ky plak i kërrusur me nallane

Fund pér «Shah-Namenë» po mendonte?!

Bejtexhinjtë qeshnin,

bënin zhurmë,

Hanin shishqebap me gaz e shije,

Plakun vargu e mundonte shumë,

Plaku pinte çajin veresie.

Dhjetë shekuj që atëherë vanë!
Humbën bejtexhinjtë e çajhaneja;
Kockat nëpër rërë u shpérndanë,
Udhëton në botë «Shah-Nameja».

Dritëro Foll.

Dikëro
Agollë

dash

ME FJONGO TË GJELBËR

Rugicën e shkollës
un' prapë e marr,
Tani burrë i pjekur
tridhjetëvjeçar.
Dikur, në një bankë
u ula pa zhurmë,
I vogël, me xhybe
shajaku të murmë;
Pa mora kalemin
me majë të hollë,
Pa hoqa një vijë,
pa bëra një njollë;
Këtu, te kjo dërrasë
e zezë, e zezë,
Aherë mësova
të mbledh pes' e pesë.
Aty ish një çupkë
e qetë, e qetë,
Me fjongo të gjelbër,
si gjeth, në gërshtë,

E vogël, e vogël,
e zbehtë si hëna,
Që hynte në klasë
trak-truk me nallëna,
Që rrinte në bankë
me penë në dorë,
Me kokë mënjanë,
me sy në fletore,
Që nuk i pëlqente
aspak gjeometria:
Figura, figura,
figura e vija!
...Dhe ja, unë i vojtur,
dhe ja, unë i rritur,
Te porta e shkollës,
nga kali kam zbritur,
Me flokë mbi ballë,
tridhjetëvjeçar,
Më njeh ti, prashitës,
më njeh ti, rojtar?
Jam unë ai çuni
me xhybe të murmë,
Që shkoja rrugicës
i zbatchur, pa zhurmë.
Ç'u bë ajo çupa,
dikur, aq e qetë,
Me fjongo të gjelbër,
si gjeth, në gërshetë?
— Sa ujë ka shkuar
nga malet në det,
Kujton se një fjongo
e gjelbër të pret?
Dhe qeshën dy burrat:
prashitës, rojtar.
Pse bëhem fëmijë
tridhjetëvjeçar?

Ku dinë njerzia
se ku do të jetë
Ajo, që kish fjongo,
dikur, në gërshetë!?

1959

dost e Rumb

PËRSERI

1.

Eh, moj turtulleshë, si na ndodhi!
E çuditëshme, vërtet!
Romantika vallë ku s'na hodhi,
Njëzet vjet me radhë, njëzet vjet!

Brodhëm nëpër shtigje të vështirë
Dhe në trotuarë në qytet.
Ti u bëre mijelëse e mirë,
Unë u bëra, siç e sheh, poet.

2.

Nënë bark të lopës ti ngre kokën,
Gishti të shpëton nga sisë e saj,
Një rrëkezë qumësht bie në tokë:
«Paska ardhur djali i xha Rizait!»

Lopa sheh me sytë e saj të xhamtë,
Lopa hesht e jonxhën e përtyp,
Unë para teje rri me çantë,
Mua më huton hutimi yt.

3.

Ndofta edhe ndryshe mund të ngjiste,
Mund të bëhesha në fshat lopar,
Dhe aherë vetë do më prisje
Të t'i sillja lopët në qilar.

Do mbështetesha në kërrabën time,
Pranë grazhdit plot tërfil të ri,
Etur do qëlloja me vështrime,
Kur të milje lopën në kusi!

Dhe në dasmën tonë djelmuria
Me raki do vinte vu e vu!
Sikur mos më merrte poezia
Mua do më merrnin sytë e tu...

4.

...Nënë bark të lopës ti ngre kokën,
Gishti të shpëton nga sisë e saj,
Një rrëkezë qumësht bie në tokë:
«Paska ardhur djali i xha Rizait!»

Po kam ardhur tē t'i ngre kusitē
Edhe lopës pak tērfil t'i jap,
T'i spérkat me qumësht poezitë,
Shtigjeve tē tua t'i pérhap.

1965

d. e. humb.

D A S H U R I A

Të mbështolli burri me najlon
Sjellë me vaporë deteve,
Këmba mbi qilima fluturon,
Zemra fshihet prapa derteve.

Shumë pako burri merr në vit,
Thonë bota: s'ka ç't'u bëjë lekëve!
Restorantet ndiqni dit' pör ditë,
Shniceli buron prej çeqeve...

Unë e dua modën dhe najlonë,
Unë i dua mëndafshet e bukura
Dhe s'kam qejf t'i shoh rrugicat tonë
Me çitjane si me re të mbushura;

Po nuk dua që mëndafshi i shkretë,
Ardhur nga një çek, të të mbështjellë
Dhe të dergjesh prapa tij e qetë,
Të ngurrosh të marrësh frymë thellë.

Do tē vij një natë nē shtëpi,
Do t'iu bie me gurë xhamave,
Dua tē ta prish atë qetësi
Mbi krevatin dysh, prapa jorganëve;

Dua si aherë tē ta prish,
Kur me shkop trokisja pas kanatave
Dhe tē thosha: sonte do tē vish,
Se tē pres nën fletët e lofatave.

Si tē merrja unë, s'e kujton,
Kur tē lagnin shirat shtogjeve?
Si më thoshe vallë, e harron?
— Puthmë pér inat tē shoqeve!

Si më luteshe me zjarrin tënd:
— Hajt tē shkojmë tutje maledive,
Ku rreh deti mbushur me argjend
Mbi kurriz tē madh tē valëve...

Ikëm ne tē dy e ikëm larg,
Fjetëm shumë net kazermave
Dhe me vullnetarët hymë varg,
Hëngrëm bashkë gjellën e gavetave.

Eh, ku shkove, eh, ku shkove ti,
Vajza e gëzimeve, e derteve!
Si tē ka mbështjellë ty ai,
Me najlon tē sjellë deteve!

Qetësia jote s'më pëlqen,
Se je fshehur bukur pas najloneve;
Dua të të ngas, se keq më vjen
Bota e dikurshme e pasioneve...

ZEMİRIMI I POETIT

S'dua

vjershat

t'u pëlqejnë

djemkave,

Q'asfalteve

të nxehtha

nisin

motoçikletat

e ftohta,

Të blera

prej

pakove

e qeqeve

Të etérve,

e gjyshérve

mbetur

kurbeteve;

S'dua

të thonë

dashnoret

e tyre

budallaqe:

«Oh, Berti!

Më pëlqen

poezia!»

Dua

mornica

t'u dalin

në faqe,

Kur sytë e ëmbël

t'u shkasin

në vargjet e mia;

Unë natyrën

time

e kam

të qetë,

Po sharjet

në vargje

më pëlqeijnë:

Ju turrem

atyre,

që një motoçikletë

Me qindra

poetë

e qindra

revolucione

s'e këmbejnë.

Ç A S T

Kodra të zeza, hënë e verdhë,
Natë e zbehtë limua...
Pemëve flenë zogjtë në çerdhe.
Ti mërzitesh për mua,

Hesht e kafshon jakën e bluzës.
Muzgu rëndon në dritare.
Unë zjarrin në kodrat e Ulzës
Ndez e dredh një cigare.

E tymi i duhanit mbrëmjes limua
I heq një vijë të kaltër.
O, mos u mërzit aq shumë për mua,
Zgjuar mos rri tërë natën!

Mos u mérzit!

Ç'duhen mendimet e kota!

Unë çlodhem pas zjarrit,
Shoku im tregon anekdota,
Vesa spërkat fijet e barit...

1964

PËR KUJTIM

Unë tregoj histori të bukura,
Ti bëhesh si foshnjë kureshtare,
Shikon me faqe të skuqura
Dhe hesht e humb fare.

E di historinë e Van-Gogut,
Historinë e veshit të tij?
Ty zemrë të rreh si zogut
Dhe thua ngadalë:
S'e di!

Van-Gogut i thoshte një femër
«Vinçent, ke veshë të bukur!»
Dhe qeshte me gjithë zemër,
Siç qesh ti me mua,
moj flutur!

Van-Gogu në këmbë kërceu,
E nxori thikën një ditë
Dhe veshin e bukur e preu
Dhe tha:
«Mbaje kujtim, moj dritë!»

Habitesh?
Kështu ka ngjarë
Njëherë një mëngjes.
Pse trembesh?
Ai ish i marrë.
Pse trembesh?
Unë veshin s'e pres!

Dash + Mary

PRANË SAJ

Merrmi kryet e vemi në gjoks:
Dua të çlodhem

nga rruga.

Shih si buza udhës m'u poq,

Më fshiku veriu e juga.

Hiç mos më pyet,

c'ndodhi andej,

Nga brodha poshtë e përpjetë,

Vetëm më lër prehje të gjej

Në gjoksin tënd

të qetë!

Kohë kemi,

do flasim pastaj

Për erëra,

lule,

limonë...

Hesht e kryet në gjoks m'i mbaj,

Flokët ngadalë ledhatomë.

Është i etur

për ledhatim.

Ai që baltëra ka çarë,
Ai që ka parë muzg e agim
Dhe duart e rënda ka vrarë.

1964

PAZARI

Pazar, shesh i shëndetshëm,
Ku zbrejt me tërë begatinë vjeshta;
Në rininë time të hershme
Me orë rrija shikoja e heshtja;

Gjithë heronjtë e mi të dashur
I shihja të shkonin bri kofinave plot.
Ai atje më ngjante me kalorësin buzëplasur,
Me ëndërronjësin don Kishot.

Ai përtej, që hante një pjepër
Dhe që i hidhte gomarit luspë,
Më sillte në mend Sançon e shkretë,
Që ëndërrroi bollëk, mish të shijshëm e supë.

Më tutje shihja Til Ulenshpigelë
Me gjoks të madh si bregore,
Pas tij Gargantuanë me një dash në shpinë
E me një miëshqerrë për dore.

Po para të gjithëve Gjergj Elez Alia shkonte;
Ai më mirë se kushdo pazarin e njihte,
Ai patkonj pér kalin e tij kërkonte,
Ai Til Ulenshpigelit pér topuzë e balozë i fliste!

Pazar, në sheshin tënd gjithë heronjtë
E librave të trashë
Mund t'i takoja, t'u flisja ngrohtë,
Të ndieja zërat e tyre të vrazhdë.

E ata më dukeshin se ishin të gjithë nga imja krahinë,
Nga fushat e grykat me pisha;
Ishin ata që mbanin malet mbi shpinë
Dhe plisa në bahçë thërrmonin me gishta.

1965

50

RAPSODI VJESHTE

Rëndon luledielli

nga farat,

Rëndon luledielli,

si vjeshta,

Unë shkoj pér t'i shtuar në arat,

Vjershës sime ca rreshta,

Unë shkoj e pengohem në kunguj,

Nga vetëkënaqësia të fryrë.

Era këndon,

si mijëra grumbuj,

Era me krahë më rreh në fytyrë.

Lëngu i frutit në gjoks më bie e ngrin.

Më pëlqen e ngarkuara vjeshtë,

Prandaj çdo libër

që jap pér botim,

Ka pér vjeshtën

të paktën një vjershë.

Unë bredh

e më thërret vjeshta

Nga skuta
në skutë,
nga sgjolla
në sgjollë:
— O njeri i mirë,
që thur vjersha,
Hip në mollë,
ha mollë!
...Ku jeni,
heronj të poemave të mia?
Vjeshta më fton
e bririt i bie;
Rëndoijnë nga fruti dardha,
hardhia,
Pëlçet kungulli nga vetëkënaqësia.
Unë do shkoj...
Kur të kthehem nga fusha,
Së dashurës lule s'kam për t'i sjellë,
Po torbën mbushur me mollë,
si grushta,
Me dorën time
vjelë...

1964

E BUKURA

E bukur, tokësore, e thjeshtë, lozonjare,
E tillë për mua je ti.
Unë vë kokën e zezë, si ugar, në supet e tua ledhatare

Dhe rri.

Unë rritem kur jam me ty, si Anteu,
E gjaku muret e aortës godet.
Të dy jemi bërë nga lulet, nga dheu,
Të dy njëri-tjetrit i duhem me ditë, me net,
E bukura, tokësorja, e thjeshta grua!

1964

KĒNGA E TOKĒS

Unë jam marrë shumë
 me tokën
 Dhe e njoh
 më mirë se agronomët,
 Kur ul në brazdat e ugarit
 kokën,
 Ndjej rrahjet e damarëve të dheut
 e aromën.
 Unë i fus gjer në bërryla
 të rëndat duar
 Në tokën e zezë,
 në tokën djerrë
 Dhe s'lë plis
 pa thërrmuar,
 Dhe s'lë rrënje
 pa nxjerrë.
 Aherë
 me duar lyer me dhe në arë,
 Me këmbë
 ngulur në brazdë thellë,

Zemra,

një metër afër tokës,

Të mbinjë më rreh e pret farën

e gjelbërimi

të zgjatet në djellë...

CRITICUS

C'le' Re'

1.

Kur ka pare,
restorantet
frekuenton;
Rosto,
shnicel,
verë Narte
preferon;
Ngre pirunin,
bën ca shenja
edhe flet,
Prapambetjen nacionale
e godet:
— Letërsia?
Jemi mbrapa,
hej, hej, hej!
Sot lexova
një roman
nga Heminguej!

Ky roman

ka qyrk romani,
 mor aman,
Jo ai
që pati shkruar
 një hajvan!
Po piktura?
 Jemi ende mu në bisht!
Ja,
Van-Gogët,
 Pikasotë,
 sigurisht!...

2.

Vjen në mbrëmje
 tek i ati me qylaf,
Lekët nuk i paskan dalë
 e ha pilaf!
Lugën merr
 e zgjat në sofër
Plaku hundët shfryn
 në çanak,
 në vatër
Nëna
 në oxhak,
thërrimet në çitjane
 rri i mbledh
Grushtin mbush
 e pranë pjatave i hedh!

3.

Del pastaj
 në klubin tonë
 dhe shet mend:

- Ç'jemi ne?
Remarku s'lindet
 te ky vend!
A e dini
ç'do tē thotë
 letërsi?
Dans,
konjak,
reklama xhami,
 dashuri!

Jash, Lekane

PËR MALESOREN DHE PËR VETË

Më qëlluan natën prej frëngjive
Edhe rashë anës lumit Drin.
Qofsh mallkuar Qafa e Gjarpinjve,
Që ma mpikse gjithë gjakun tim!

Më qëlluan!...

Qave ti mbi mua,
Me bucelë Drinë e madh ma dhe,
Loti nga qepallat t'u thërrmua, *me shqip*
«Lage buzën pak!»
Në vesh më the.

C'më vështron?

Kjo s'është e vërtetë,
Jam poet dhe stisa një tregim!
Mund të ndodhë dhe kështu në jetë
Para njëzet vjet mbi lumin Drin.

Mund tē ndodhte po tē na kish parë
Ati yt i ashpēr me çibukë.
Me dyfek tē dyve na kish vrarë
Dhe do rridhte gjaku tej nē lug.

Ç'më vështron?

yt atë do kish shtënë
Nga frëngji e mureve tē gurtë.
— «Çupa më turpëroi, — do kishte thënë —
Çupa në shtëpi më mbeti murgë!»

Dhe kjo përrallë e shkurtër e harruar
Nuk do ishte përrallë, o shpirti im!
Përrallë u bë se ne jemi takuar
Njëzet vjet më vonë në lumin Drin!

E U R E K A

1.

Kur Arkimedi thosh: «Eureka!»
Në banjë kur po lahej,
Andej mes kampeve të luftës
Ushtri e huaj shahej.

Strategët mbledhur në limane
Çaplonin këmbë e buzë...
«Eureka!», — thoshte Arkimedi
Atje në Sirakuzë.

Dhe nuk shikonte se romakët
Po vinin me kaike
Atij një ligj ia /nxhente mendtë,
Një ligj matematike. /

2.

Në breg të detit bënte rrathë
Dhe fliste herë-herë:
— «Ky perimetër djemtë e vajzat
Të qetë s'do t'i lërë!

Ky perimetër e kjo rreze
Ky hark e diametër
Do t'i mundojë mbi dëfterë
Me bij edhe me etër...»

3.

Ndërkohë erdhi me shigjetë
Mes rërës vrap romaku,
Po kur filloj t'ia prishë rrathët
Bërtiti ashpër plaku:

— Javash, javash, or i bekuar,
Javash mos m'i shkel rrathët!
Dhe përsëri në mes të rërës
Qëndronte këmbëzbathët.

Ushtari lart e ngriti shtizën
I vrenjtur hundë e buzë...
— Nuk e marr vesh, — tha mekaniku —
Ç'po ndodh në Sirakuzë!

Dhe u rrëzua përmbi rrathët
Pas tufës me purteka
Dhe duke vdekur tha ngadalë:
— Eureka!

DIKU NË NJË PIJETORE

Për agr. F. Cekodhimën

Diku në një pijetore
Me mure përgjysmë lyer me bojë,
Agronomi me shokët e tij duke pirë,
Emrin tim do zërë në gojë:
«Edhe ai e kish qejf shkumën mbi birrë,
I kish qejf shakatë e anekdotat
Dhe si ne, me natë brodhi
Fushat, luginat, malet, kodrat
Dhe elb e pjergulla mbolli.
Elbin e pjergullat i donte shumë
Dhe pranë tyre buzëqeshte ngaherë,
Se donte të shihte birrë me shkumë,
Se donte të shihte shokë e verë.»
Kështu do të thotë në një pijetore
Agronomi me shokët e tij,
Me gotën e birrës në dorë,
Me farën e elbit në torbë,
Me pjergullat e njoma përbri.

1962

VAJZË E VOGËL

Vajzë e vogël,
Të ka mbyllur në dhomë yt atë
E ti vështron nga xhami rrugët,
Vështron e heshtur, e ngratë,
Pastaj duart e mitura shtrin të lash pjatat, lugët...

Vajzë e vogël,
Kush, vallë, kaq raki ka pirë mbrëmë?
Kush, vallë, ka zbrazur kaq pjata?
Kush, vallë, kaq kocka pule ka lënë?
Kush, vallë, ka tymosur perdet e pastra?

Vajzë e vogël,
Mos qaj pas xhamit e mjerë,
Unë do të marr me vete shokët e mi,
Do të vij që ti të qeshësh njëherë
E të thuash: «hiqmëni nga kjo shtëpi!»

Vajzë e vogël,
Me shokët e mi gaztorë
Do të të marrim ngadalë,
Të shkojmë nën malet me borë
Të ngremë hidrocentralë.

PËR GRATË TONA

Sa pak këndoymë për gratë tona!
Për gratë e bukura e të mira,
Që na përkëdhelin me duar të njoma,
Kur kthehem nga rrugë të vështira.

Gabohemi shumë, kur flasim e gjimë
Rreth gotës me birrë, rreth gotës me verë,
Se gjoja gratë tona e humbën freskinë,
Se gjoja na ishin të këndshme njëherë!...
Ah, vëllezër, s'humbet hijeshia e tyre!
Ato përtërihen, ato lulëzojnë,
Mjafton të qëndrojnë pak në pasqyrë
Dhe bëhen prapë vajza të njoma!...

E si të mos këndoymë, poetë,
Për ato që kanë ditur në jetë
Të lindin kreshnikë e perri,
Në maternitet e shtëpi,
Në mal e në arë
Duke prerë dru e duke hedhur farë!...

TË SHKRUAJMË BALADË . . .

Të shkruajmë baladë për komunistin që ra,
Të shkruajmë baladë në mënyrë komuniste.
Nuk ka rëndësi se kishte a s'kishte
Atë natë hënë dhe ujë mbi zallishte.

Të shkruajmë baladë e të themi që ra
I madh, i fuqishëm me plagë në kokë;
Të themi:

u shtri dhe rrënjet i hodhi në tokë
Dhe askush nuk guxon ta shkulë,
shokë!

DITAR PARTIZAN

U këput edhe një nga kolona jonë...
Mbi buzët e thara u përkul një luleshqerrë,
Ai tani s'e ndien e s'i merr dot erë;
Veç gjakun dërgon në Valbonë...

Kjo copë hekuri nga fluturoi mbi barin e njomë,
Kjo copë hekuri nga Ruhri nxjerrë!
Kjo copë hekuri la një nënë të mjerë
Nënën e atij që ecte me ne në kolonë.

Ç'të bëjmë? Të rrëmë të lotojmë?
Gjendrat e lotëve baruti na i ka tharë!
Ç'të bëjmë? Njeriun me helmetë kërkojmë.

Kërkojmë atë që mbante copën e hekurt të Ruhrit,
Që shokun tonë nga lulet pat ndarë
Mes tymit të thartë të barutit.

DEGA ME LIMONË

E dini si e vranë himarjotin tonë?
Nga Këlni ishin ata që e zunë
Dhe nga kasollja e varfër e shpunë
Në kopshtin e madh me limonë.

Iu varën degët e gjelbra mbi kokë,
I dërguan erë limoni...
Rënduan në duar zinxhirët e ftohtë,
Kafshoi shkëmbinjtë e murmë Joni.

Qëndroi himarjoti në barin e njomë
Dhe ngriti duart e lidhura
Të kapte një degë plot mall me limonë
Mes dy bajonetash të hidhura...

Po pushkën aherë ushtari pat zbrazur.
Në bar himarjoti u shtri
Dhe mbeti përjetë dega e dashur
Në sytë e kaltër të tij...

2. Poema

17
Dritter Agotti!

DEVOLL, DEVOLL

1.

Po, Devoll,

i tillë qen kam unë,
Paskam marrë baltën tënde arave,
Në një trastë leshi
ndënë gunë,

Për t'ia sjellë

Lidhjes së Shkrimtarëve.

Nuk e di,

se ç'dreq poet më bëri

Balta jote, bari yt i dendur.

Unë jam një plisi yt i tëri

Dhe një copë shkëmb

i pagdhendur.

Dhe ky plis

ngaherë ish i fortë:

Shkoi n'Evropë,

brodhi në Azi,

Po kudo,
nga flokët
gjer në thonjtë
Mbeti devolli...
Dhe në vargjet
mbeti ajo baltë,
Mbeti ai bar,
ai tërfil,
Mbeti ai fyell,
ai mjaltë,
Mbeti ai gjemb e trëndafil...

2.

Kush për mua thënka aq i etur,
Se nuk qenkam devolliu i parë,
Se pak zall Devolli
më ka mbetur
Dhe humori poshtë paska marrë?
Gjepura!
Në klubin e gjahtarëve
Le të vijë
për të më soditur,
Kur tregoj për lepuj fshehur arave,
Kur tregoj për zogj të arratisur,
Kur tregoj për udhë romantike,
Kur ngre lart gishtrinjtë e mi
të trashë,
Kur godas kurrizë për karrige
Edhe qesh me zërin tim të vrazhdë.
Këtë zë patjetër e ke ndjerë
Dhe atje,
në grykat me lajthi,
Ku zhumbrica kundërmon në verë,

Ku prin cjapi
një tabor me dhi,
Ku zinxhirët në arë lë traktori
Dhe bie nafta krojeve të qeta,
Ku pëllumbi i egër shpellat mori,
Trembur prej kërcitjeve të rrepta...

3.

Po, Devoll,
i tillë qenkam unë,
Paskam marrë baltën tënde arave,
Në një trastë leshi
ndënë gunë,
Për t'ia sjellë
Lidhjes së Shkrimtarëve.
Unë e di,
nga gjaku im i shumë
Jam i kuq
e rrjedh shëndet e jetë,
Se kam pirë ujë në atë lumë,
Se kam marrë fryshtë
nëpër fletë;
Ndaj kam qejf
mos rri
me gojë hapët
Dhomave të ngrohta mbi mangall,
Po të shkoj vargmaleve të largët
Edhe prap'
në horizont të dal;
Ndaj kam qejf të nisem me gjahtarët,
Ku mëllenjat krahët i përpjekin,
Ku pas gjurmëve lehin zagarët
Edhe lepurin e egër
ndjekin...

Ndaj kam qejf tē dal t'u them
shoferëve:
— Merrmëni dhe mua
nē makinë,
Shpjermëni mes shirave
e erërave,
Bashkë udhët tona t'i përpjimë...
Dashuria ime s'është pozë,
Pozë
e poetëve lirikë,
Që këndoja
ndënë qiellin rozë,
Buzë lumit rozë
si me frikë.
Unë s'hyj
në tufën e poetëve,
Që mërzejnë aq me dashurinë,
Që betohen
për jetë
të jetëve:
«Oh,
të dua
ty, moj trëndelinë!»
Dashurinë
e dua tē shëndetshme,
Femrën tē shëndetshme
krah meje,
Që mbështet nē gjoksin tim tē leshtë
Kryet
dhe ndien rrähjen nëpër dejë...
...Ndaj kam qejf
tē shtrembëroj turinjtë
Nga raki e fortë
në filxhan,
Vallen ta bëj tym
me devollinjtë,

Të më zërë koka
në tavan,
Të ulem
e të marr
një spec të fortë,
Spec
që sytë lot të kuq të nxjerrin,
Ku mezeja
sofrën mbush në odë,
Ku te porta
dashi pret
ta therin...
Dhe atij të drojturit
të mjerë
FAQJA MOS T'I MBETET PA MORNICA,
Mjekra pa fuqi
në gjoks t'i bjerë,
Kur të shohë
vallen devolliçë.
Ndaj i dua dasmat dhe harenë,
Ku bie erë mollë
dhe lakror,
Ku nga vallet,
vajzat gjintë ngrenë,
Ku nga këmbët
pluhur del në oborr...
Eshtë dasma frys i lagur djerse,
Ku mbi sofër
çlodhet dorë e rëndë,
Dora,
që ka mbledhur bar me vesë,
Dora,
që me plug ka ngjallur vendë,
Dora,
që ka hedhur farën në arë,

Dora,
që në gjoks të femrës shkoi,
Dora,
që në të errët
 ndezi zjarrë,
Dora,
që agimin përqafroi,
Dora,
që ngre lart e kripë e bukë,
Dora,
që godet.
 me afsh në sofër
Dhe përpjetë hedh
 raki e lugë
Dhe merr dasma zjarr
 e bëhet shqotë...

4.

Unë shpesh,
 Devoll, nuk jam i qetë
Unë shpesh,
 Devoll,

unë shpesh
Shqetësimet m'i ke dhënë vetë,
Kur më bëre nga kjo baltë e murme.
C'baltë dreqi qenka, balta jote,
Baltë plot trazira, shqetësime,
Herë fllade fsheh e herë shqotë,
Herë lot e herë ëndërrime...
Natën ndiej

Nga antena ^{se si} godet antena.
 krisma hyn në shpirt,

Hapet nëpër dhoinë
e merr dhenë:
— Hej, alarm,
alarm,
o komunist!
Jam njeri i fortë
i pagjumë
Dhe çdo tingull kap,
çdo tingull gjuaj;
Dhembje njerëzore
kur ndjej unë,
Sentimentalizëm nuk e quaj...
Ndaj unë komunisti nga Devolli,
Që kam pendë,
letër
edhe armë,
Që hedh firmën:
«Dritëro Agolli»,
Ngrihem,
kur kap tingullin:
«alarm!»,
Se e di,
që komunistët s'flenë,
Vetë komunizmit i përkas,
S'pres
që nga dysheku të më ngrenë
Ngrihem vetë
edhe armën zbraz!...
Hej, Devoll,
sa armë zbraza unë
Për këtë të uruar komunizëm!
S'të kujtohen çukat gjithë zhurmë,
Kur betejën plumb e gjak e nisëm?
S'të kujtohen krismat anembanë,
Vetullat e djegura në flakë;
S'të kujtohen nënët partizane,

Dritëro
Agolli

Kur na lidhnin gjokset tërë plagë?
S'të kujtohen devollinjtë e rënë,
Me opinga baltërave të tua,
Qepën e Bozhigradit pa e ngrënë,
Këngën devolliçë pa kënduar?

Hej,

Devoll,

ç'u bënë e ku vanë
Ata njerëz të ashpër e të mirë?!
Grykave të tua

ndofta janë,
Përkëdhelin barin,
që ka mbirë.

Hej,

Devoll,

sa armë zbraza unë
Për këtë të uruar komunizëm!

Mbeta maleve të tua pa gjumë,
Vrava tradhti me nervozizëm...

Dhe sa herë lul'e ballit tim
Është marrë mirë në shënjestër,
Po më paske bërë mua trim
Se kam mundur plumb edhe

gënjeshtë!
Në shënjestër prap' më kanë vënë
Snajperët e shquar pértej deteve.
Unë s'dridhem,

unë s'e ul zënë,
Mbetem komunist pér jet' të jetëve...

5.

S'e mohoj,

i ashpër jam,

i forte,

Dhe duhan me okë do kem pirë,
Dhe s'jam mallëngjyer për një tortë,
Lugën katër ditë duke lëpirë,
Po megjithatë jam shumë i butë.
Ti, Devoll, më bëre delikat.
Unë i dua zogjtë edhe drutë,
Barin që burimi e spërkat;
Unë e dua grurin,

(kur ul kryet;
Kur në duar i thërrmoj kallinjtë,
Si të kem thërrmuar tërë yjet,
Sikur të kem tokur perënditë.
Dhe aherë kokërrza e zhveshur
Zjarrin jetësor tek unë ngjall,
Gjithë qenia ime është e qeshur,
Zbuten sytë e zbut ngadalë një mall.
Është gruri, kokërrza e grurit,
Pjekur verës, arave nën diell,
Që trondit e zbut zemrën e burrit
Dhe e ngre në qiell...
Është kokërrza e vogël,

që ka brenda
Diellin, qiellin edhe yjet — ar...
Nuk e di

pse kaq ma paska ënda
Grurin ta lëvdoj, si një fshatar!
...Unë e dua grurin

edhe zogjtë,
Barin, që burimi e spërkat,
Dhe, megjithëse zemrën kam të fortë,
Si një devolli jam delikat:
Unë qaj, kur shoh në bar një zog
Krahëthyer,

që nuk fluturon.

Ulem,
me ngadalë
e vë në gjoks,
Zemrën ia dëgjoj kur i gufon...
Unë,
që kam pirë aq duhan
Dhe gishtrinjtë i kam
me nikotinë,
Mundet për një zog të rri të qaj,
Zhytur në mendime,
në lëndinë.
Po, Devoll,
i tillë qen kam unë,
Paskam marrë baltën tënde arave
Në një trastë leshi
ndënë gunë
Për t'ia sjellë
Lidhjes së Shkrimtarëve.
Thellë kësaj balte
përmbi lumë,
Që aq breza rrënëjësh e lëvrinë,
Unë,
devolliu i pagjumë,
Gjeta vargjet,
gjeta poezinë.

Mars 1964

POEMA E TË PAGJUMËVE

*Ne jemi të pagjumë,
Ne kudo na gjeni!*

1.

Natë pa gjumë
Natë me ëndrra pranë tryezës së vjetër!
S'trokët askush tek unë:
Pena gërvisht me majën e trashë në letër.
Jam vetëm!
Dua ca vargje të vrazhda t'i vë në radhë,
Ca vargje pér veten,
Ca vargje pér dhomën time, mes botës së madhe,
Se ndodhem mes botës së madhe këtu
Unë me dhomën time kubike.
Ndodhen dhe të tjerë në botën e madhe diku,
Në dhomat e tyre,
përkultur kështu në karrige.
Ne jemi të pagjumët
Punëtorë, astronomë, poetë, konstruktorë;
Ne jemi të pagjumët,
Që gërvishtim në letër me penë në dorë.

Ti më thua:

«Ç'të duhen të pagjumët e tjerë në botë?
Shih pagjumësinë tënde, o i pagjumë!»
Të përgjigjem nga dhoma ime me zërin e fortë:
«Njihem me ta,

si ata jam unë,

Pa gjumë!»

2.

Natë pa gjumë!

Natë me ëndrra pranë tryezës së vjetër!

S'troket askush tek unë:

Pena gërvisht me majën e trashë në letër.

Pse kaq trazira më vijnë në shpirt

Në natën pa gjumë?

Mos vallë se njëri nga shokët po më braktis,

Mos vallë të tjera mendime të zymta më derdhen

me zhurmë?

Mos vallë se dikush në botë rri zgjuar
Dhe mua më gjuan,

dhe mua më ndjek

Me gishtin në këmbëz shtrënguar,

Me plumb në dyfek?

Po!

Ai gjuan me plumb e me sy!

Ne, të pagjumët e botës, e dimë mirë!

Ja, ai bën stërvitje anës Rinit e Misisipit: «Një, dy!»

Helmetën ul nën ballin e nxirë!

Po ne, të pagjumët, jemi racë e zgjuar,

Ne, punëtorë, konstruktorë, astronomë, poetë,

Ne kemi uranium, yje e vargje në duar,

Le të bëjë «një, dy» ai me helmetë.

3.

Natë pa gjumë!
Natë me ëndrra pranë tryezës së vjetër!
S'trokët askush tek unë:
Pena gërvisht me majën e trashë në letër...
Kush tha se unë jam i vetmuar?
Po të pagjumët e tjerë?
Astronomi ka marrë një yll në duar,
Punëtori çekanin tund e djersa pikon nga balli i gjerë...

Kujt tha, se unë do bëja mirë
Sikur të mendoja vetëm pagjumësinë time të mjerë,
Po i përgjigjem:
«O njeri i përhirë!
Unë jam i pagjumë, se ka të pagjumë të tjerë.»

POEMË MALORE

I.

Më mori malli të ngjitem në mal,
Kjo nuk është diçka idilike.
Prapë trastën do marr

e do dal,
Ku kryet lot pisha epike.
I tillë jam.

Dua të udhëtoj përhera,
Të udhëtoj me gazeten në xhepa,
Me fletore shënimesh,

Brigjeve me pisha, me dhjetë cigare «Riviera»
lugjeve me plepa.

II.

A u mërziten
shqiptarëve malet?

Me ujin e maleve

kur lindëm, na lanë.

Që atëherë malli për to filloi të na ngjallet,

Që atëherë na vunë qeleshe,

malësorë na thanë,

Djepin etërit na e gdhendën nga boriga

Dhe gjyshërit me legjenda në gjumë na vunë,

Prandaj nuk shkëputemi nga romantika,

Megjithëse flokët brymë të bardha na zunë.

III.

Le të mblidhen rrëth meje shtazët e malit

Dhe lulet aromën gjer në fund le ta japid,

Le të ulen mbi mua retë portokalli

Dhe guvat e errëta

shkrepat t'i hapin!

Rrëth meje le të këndoja gjithë zogjtë me natë,

Le të çelë edhe ajo lule,

Që çel një herë në njëqind vjetë...

Le të ndrisin lumenjtë, si teha shpate,

Kur të më shohin mes tyre, të lumtur, të qetë!

Sa ju gëzohem,

pemë,

bimë,

gurë

Dhe ty, përrua — nepërË e shpejtë!

Ju shoh e nuk çmallem dot kurrë.

S'kam shefa mbi krye,

kam zemër të lehtë.

E cili është ai guximtar

Të më thotë:

«Bëj këtë,

bëj atë?!»

Unë jam udhëtar,
Që zogjtë mbaj vesh në shullë.
E cili është ai redaktor
Të më thotë:

«Punoje vargun një çikë!»?
Jam vetë mes jush editor,
Jam njeriu — Adam,
që s'njeh mes natyrës metrikë.

IV.

Ç'po flas,
ç'po flas,
Po vallë mes fletësh i dashur mal!
Ku çdo dru e gur mund të jem i qetë,
Një kujtim, një kujtim më ngjall,
një mall
...Kjo daulle një ngjarje të rreptë?
Kjo daulle që bie,
Në zemër më shtie, që thërret
Në zemër më vret:
Kjo binte në male,
Kur frikë e fricë kjo binte një ditë,
Ishin një sinonim, një ankth,
Kjo ndodhë at'herë, një mornicë...
kur gjethi kalbej në lis.

Po u rrëzua daullja me gjithë ushtri
Përrenjve të tu,
 gérxheve-kurrizë,
Në gropën e zezë,
 nën trungun e zi.
Male shqiptare,
 enigmë shqiptare,
Me shpella e lugje përposh,
Nga malli për ju,
 që digjte si zjarri,
Naimi u bë tuberkuloz,
Dhe Bajram Curri mbeti në shpellë
Me gishtin në këmbëz,
 me shkrepë mbështjellë.
Që dritën revolucioni ta shpinte
Mbi gérxhet tuaja të errëta pus,
Gjakun Qemali e la të rridhte,
Gjakun zhuritës,
 gjakun prush.
Male shqiptare,
 enigmë shqiptare,
Këtu u kalbën eshtra e shpata
Dhe kokën hëngrën sa sundimtarë,
Kur ngrihej dielli,
 kur binte nata!

V.

Por ju,
 njerez të fisit tim,
 gjyshër,
Herë-herë maleve me gropë jeni zënë
Me dyfekë e jataganë të vjetër
Dhe kockat përrenjve keni lënë!

Male shqiptare,

enigmë shqiptare,

Ka krisur pushka e hakmarrjes mbi ju
Dhe thonjtë e saj kanë hapur varre
Nën qiparisa,

nën dushqe,

nën të kalbura dru!

Po çunaku me duar tërë bojë
Dhe ai fëmija im,

që ka emrin e gjyshit tim,
Do hapin sytë kur t'u tregojmë
Dhe do thonë:

«Gjyshër,

Gjyshër, e keni pasur gabim!

ju heqim kapelën...
Keni qenë snajperë të rrallë,
I bëtë të hanë dhenë me dhëmbë
Ata, që u derdhën t'i shkelin
Luginat tuaja,

kreshtat,

Por, gjyshër, çukat valë-valë,

Kur njëri-tjetrin keni bërë gabim të marrë,

keni vrarë!»

VI.

Le të më djegë vetullat harku i rrufeve,
Le të shkrepë shkëndija elektrike
Mbi kreshta

kreshnike

mes reve,

Si në botën e perëndive antike!

Po

perënditë e grekëve të vjetër
Këtu e kishin altarë,
Këtyre grykash lëshonin rrufetë,
Këtyre guvash ndiznin zjarrë.

611

612

Male shqiptare,
enigmë shqiptare.

Në cilin kapitull,
në cilën faqe

Homéri ka folur pér ju?

Janë po ato gryka, po ato caqe

Vëç era ka ndërruar këtu.

Një fill elektriku kalon mbi borigë

Dhe dy shkëmbinj të fjetur shkund,

Në lumë shpatullat ka vënë një digë,

Një ushtimë turbine në zgavra humb.

...Po shumë do ketë turbina e diga,

Do ketë tunele,

sonda,

sirena

Dhe përrallës malore, mbushur me diva,

Ne do t'i vëmë antena!

VII.

Mendime e rima dua të gjej

Pér ju, male,

pér ju, pérrenj,

...Kanë ardhur këtu Majakovski, Heminguej

Mirë se vjen, Majakovsk, mirë se vjen, Heminguej!

Po pak ju kuuptojnë në këta shkëmbej.

Veç ai çunaku me duar tërë bojë,
Që njeh Arkimedë, Etnë e Pompej,
Doemos dhe ju do t'ju kuptojë,
Hej Majakovsk, hej Heminguej!
E di,

edhe këtu do të dridhen antenat
Dhe do të digjet elektriku rrëzë honit.
E përshëndes jetën,

i përshëndes sirenat,
E përshëndes shkëmbin

dhe shtyllën e tensionit.

VIII.

Fémija im
Mban emrin e gjyshit tim,
E gjyshit tim,

Ai fle në krevat e nëëndërr psherëtin,
E nëëndërr qesh e thotë ca fjalë.
Fémija im

Mban emrin e gjyshit tim...
Ti, bush i vogël,

Gjyshi im të gdhendte me durim
ti, dru në rrëpirë,
Dhe prej teje

Gjyshi im, që jetonte mbi këtë çukë,
Deshi të bëhej artist,

Edhe njerëz, jo vetëm çibukë;
Po plaku s'u bë artist,

të gdhendte në dru
ai vdiq këtu...

Mes këtyre borigash,
që ziejnë prej erës:
Fle mjeshtri i çibukëve,
gjyshi im,
Admirues i këngës,
mik i pranverës,
Udhëtar i përhershëm burim më burim...
Emrin e tij çuni im mban,
Emrin e tij
ilirian.

IX.

Papritur

Në pyll u ndodha mes zanave.

Mëngjes ishte,

Zhurmonin fletët

Dhe lehnin qentë stanieve,

Nektar mblidhnin luleve bletët.

Së pari zanat s'i njoha fare!

M'u dukën si vajza kooperativiste,

M'u dukën si vajza druvare,

M'u dukën si gra aktiviste.

Pastaj iu nisa një ligjërim

Të shtruar, si erë bjeshkësh,

Mës pyllit veshur në gjelbërim,

Mes drurëve me gunga eshkësh:

— O shoqe zana,

o shtatçetina!

O shtatçetina të pyjeve shqiptare! —

Po njëra prej tyre e preu fjalën time:

— Na fol për gjendjen ndërkombëtare! —

Mos jam në ëndërr?

Zanat c'po flasin?!

Zanat, që i njoh në folklor,

Kërkojnë të dinë edhe për OAS-in
Edhe për Berlinin Perëndimor!
— Të dashura, shoqe, zana!

.

X.

Male shqiptare,
 enigmë shqiptare,
Sa gjëra këtu kanë ndërruar!
Nuk janë ato zana,
 ato vllastare,
Nuk janë ato idile të shkuara
Sado ngadalë,
 sado ngadalë
Që fija e telave të dritës të zgjatet,
Prapë shekulli ynë ngjitet në male,
Lë gjurmë në gërxhet,
 lë gjurmë në shpatet!
Sado të zbathur,
 sado të grisur
Të shoh nëpër lugje,
 në barin e prerë,
Sot fisit tim një kokërr misër
S'i duket e frikshme si panterë.
Po shumë duhet të bësh,
 fisi im,
Që truallit mos flesh, që gjizë mos hash,
Kullave dritë t'u vësh me guxim,
Të zhdukësh turqizmën:
Unë e di, «javash-javash!»
Fëmijët e tu brekushe me arna mbajnë
Dhe çokollata
 një herë në vit hanë a s'hanë;

Unë e di,
fisi im,
ende
Ti gruan ngarkon me dru e djep...
Po ditët e mëdha
janë përpara,
Ato nisën
të vijnë
Kur krisën armët e para
Në revolucionin tonë,
Mes malesh me zgavra e hone.
Unë e di,
fisi im,
ti ende jeton vështirë
Dhe jeta s'të jepet
si beze e lirë.
Po ti, fisi im, ke muskuj të fortë,
Muskuj,
që malet mund t'i lëvizësh,
Muskuj,
që sipër çdo porte,
Dinë të vënë kurorën e dritës...

XI.

I tillë jam,
udhëtimet i dua
Brigjeve me pisha,
lugjeve me plepa,
Me trastë në krah,
me gazetën në xhepa.
I tillë jam,
o male,
tungjatjeta!

BALADË E RE PËR KOMISARIN

I.

Në grurë kish rënë drapri,
Ish tharë bari ndër varre,
Pëlciste për ujë gjarpri
Dhe binin mullarëve zjarre.
Opingat komisarin e vrисnin
Lëndinave të bëra eshkë.
Katër vrasës në hendek prisnin
Me katër dyfekë.
I vetëm ecte komisari,
Me rrodhe mbushur çorapet,
Kërciste nën opinga bari
I bëre shkrumb prej vapet.
Ç'mendonte ashtu ai vallë,
Kur ngjitej në çorape rrrohdhja?
Mendimet ia rrudhnin ballë,
Apo ia rrudhje lodhja?
I vetëm shkonte në fushë,
I digjte këmba në çorape,

I fshinte rrëketë e djersës në gushë,
I fshinte e i mblidheshin prapë.
O romantikë e atëhershme,
Mua me vete rrëmbemë,
Në ditët e ashpra, të ethshme,
Pas komisarit shpjemë,
Të flas për kuvendet e tij në shtëpitë,
Ku flaka lëpinte kusinë,
Të flas si dëgjonin të rintjtë
Dhe pleqtë si mbanin habinë;
Të flas për hutimin e egër
Të armikut, që gjuante e priste
Në vreshta,
në pllaja me thekër,
Në skérka,
zallishte!

2.

Ku vinte komisari i lodhur,
i kërrusur
Kur gruri kërkonte drapër,
Kur pjeshka me lëng ishte mbushur,
Kur pjepri s'duronte vapën,
Kur Bazi i Canit kish vënë
Hajdutë në Urën e Zezë
Dhe vetë konakun kish zënë,
Raki kërkonte e deshë?...
Do shkonte t'u thosh fshatarëve
Të nxirrnin armët nga hatullat
E pas t'u vinin luftëtarëve,
T'u merrnin maleve shpatullat.
O kohë e komisarëve,
Mua poetin rrëmbemë

Dhe pranë luftëtarëve
 Me nagantë në dorë shpjemë!
 O kohë e komisarëve,
mos më lërë
 Të ndryshkem në mendime,
 Më merr, më hidh në zheg e në erë
 Të viteve plot gjëmime!...

3.

Dielli ish ndalur mbi grurë.
 Komisarit i hahej një pjeshkë,
 Komisarit i pihej ujë,
 Se dheu ish bërë eshkë.
 Lodhja i binte këmbëve,
 Kur tytat e katër dyfeqeve
 Dolën që prapa gjembave.
 Që prapa katër hendeqeve,
 Dhe katër shkëndija barutin ndezën,
 Dhe katër plumba gëzhojat braktisën,
 E shpuan vapën mbi Urën e Zezë,
 Në gjoks komisarin goditën.
 Dhe ra komisari në fushën me grurë.
 U shtypën nën të kallinjtë,
 U trembën turtujt,

u fshehën në gurë,
 Tek nxinin shkëmbinjtë.
 Ra komisari e shtrëngoi në duar
 (Sikur të mbahej për hekura)
 Katër kallinj të rénduar
 Nga kokrrat e pjekura
 E mbeti shtrirë mes grurit në arë.
 Dielli u nda në njëqind copë
 E të njëqinda ranë mbi komisarë,

Ranë në sy e në kokë.
Unë at'herë nuk isha në fushë
Dhe s'dija të thurja poema,
Po mund t'ia shtrydhja komisarit në buzë
Pjeshkën e rënë nga pema,
Po mund t'i gjeja ujë në lumë,
Dhemben t'ia bëja të lehtë,
Po mund ta vija hasmin në gjumë
Me plumbin e nxehthë;
Unë at'herë s'e njihja metrikën,
Po plumbin dija ta nisja,
Njihja dyfekun,
 njihja mashinkën,
Dija të vdisja.
Ne nga poetët e tjerë ndryshojmë...
Ndodhka kështu në jetë:
Më parë mësuam me plumb të qëllojmë,
Pastaj u bëmë poetë!

4.

I pihet ujë komisarit,
Po toka është eshkë.
Sillini ngå kopshti komisarit,
Të lagë buzën, një pjeshkë.
Kush etjen në verë s'ka provuar,
Kur prapa dëllinjash pret vdekjen,
Ende asgjë s'ka mësuar
Për etjen...
...Sillini komisarit nga pjeshkët e kuqërreme
Me lëng të verdhë
 të mbushura.
Zvarriset vrasësi
 si vemje

Me sy tē skuqura.
Zvarriiset vrasësi, lajmin t'i japë
Bazit tē Canit nē Zall tē Herrit,
Zvarriiset nëpër vapë,
Dyllë prej vrerit...
Zvarriiset

e dridhet nga dridhmat,
Mos dalë prapë komisari
Me gjoks tē përgjakur nē drithrat,
Me flokë tē djegur nga zjarri,
E kokën mbi grurë tē ngrerë,
Ngadalë ta çapitë përruan,
Nagantin nga brezi tē nxjerrë:
«E sheh?

Ne prapë u takuam!»

5.

E lanë fshatarët dhallin pa ngrënë
Në kupat e drunjta,
E lanë fshatarët gjizën pa ngrënë
Dhe pitet e grunja;
U derdhën fshatarët nga vatha nē vathë,
Nga kodra nē kodër,
Harruan nē vatра çibukët e gjatë,
Qeleshet e bardha nē odë;
I hoqën fshatarët nga hatullat armët
Dhe drejt komisarit shkuhan:
Fjalimin e ashpër nē t'ashprin alarm
Në lëmin e madh e dëgjuan...
E komisari shtrëngonte nē duar
Me gishta ende tē vakur
Kallinjtë e pjekur,

kallinjtë e thërrmuar,

Kallinjtë e përgjakur...
Ishte fjalimi më i rreptë që mbante
Në lëmin e madh komunisti.
Heshtnin fshatarët,
 turtulli qante
Në fushë, ku piqej drithi...
O komisar,
Revolucioni me fjalët e tua
Valëve vrullin u shton,
Edhe i vrarë shumë thua,
Naganti yt qëllon.
Unë poeti, në vargjet e mia,
Sikur të të ngjaja një grimëz,
Edhe i vdekur vargje me mijë
Të hidhja në luftë për komunizëm;
As frikë mos kisha,
 as dhimbje mos kisha
Të bija me kafkë të shpuar;
Unë poeti do të doja të vdisja
Si ti,
 i madh,
 i nderuar.

6.

At'herë Bazi i Canit pinte raki në vatër
E nxirrte tym duhani nga hundët.
Hynë vrasësit të katër,
Që kishin zënë të katër udhët,
Hynë me kokë ulur në odën
E shtruar me poste e minderë.
Bazi i Canit lëvizte mbi supe kokën
E pinte raki të zier dy herë.
— Aferim, kopukët e Bazit,

Bazi nishane do t'ju japë,
Bëni haber të bien sazet,
Mileti vallen ta hapë!
Aferim, kopukët e Bazit,
E zutë komisarë,
Si tutullin në fushë pas jazit,
Si tutullin në arë.
Shumë pas tij kam bredhur,
Korijeve herët kam gjuar,
Djersë shtigjesh kam derdhur,
Kalin dori kam munduar.
Ku është komunisti i prapë
Vrimat t'ia shoh në ballë?
Bazi nishanë do t'ju japë
Dhe katër kuaj me shalë...

7.

E Bazi i Canit u ngrit në këmbë,
E hipi kalin, i pirë,
Me sy që shikonin shtrembër,
Ta shihte komisarin të shtrirë.
Të katër vrasësit shaluan katër kuaj
E shkuan të gjenin komisarë.
Thërrmoheshin kallinitë nën patkua,
Trembeshin turtujt në arë,
Cmendej nér driza gjinkalla,
Në grurë kish rënë drapri,
Shkëmbinjtë ishin të valë,
Pëlciste pér ujë gjarpri,
Vraponin pesë kuaj azganë
Të shpejtë si sharje horri;
Sa kallinj nën patkua ranë,
E sa byk era mori!

Kuajt ndalën në arën me kallinj rënduar.
— Ç'e bëtë komunistin e prapë?
U tha Bazi i Canit vrasësve shaluar
Në shalën mbuluar me napë.
Hej Baz i Canit, komisari s'është turtull,
Atë s'do ta shohësh të shtrirë kurrë
Me syrin tënd të turbullt!
Të katër vrasësit me fytyrë të nxirë
Memecë mbetën te hendeku,
Si katër tyta, të ngrirë,
Si katër tyta dyfeku...
E Bazi i Canit at'herë dha urdhër,
Të digjeshin gruri e bari
E vrasësit të zinin të katër udhët,
Se gjallë na ish komisari.

8.

E flaka kallinjtë rrëmbeu,
E mali i Dajtit pa zjarret,
Me kokrra të djegura gruri u mbush dheu
Dhe hiri e mbuloi gjakun e komisarit.
Hej, Bazi i Canit, ku shkoi komunisti?
Ndofta fluturoi përtëj arave,
Ndofta nga hiri i tij u përtëri si feniksi,
Ndofta për komunizmin u flet fshatarëve.
Hej, Bazi i Canit, s'i njeh komisarët,
Plumbi godet në ta e kthehet i shuar,
Hej, Bazi i Canit, Cani i marrë
Të tillë legjenda kurrë s'të kanë treguar!
Hej, Bazi i Canit, u ngrit komisari,
U ngrit me grurin tjetër
Dhe krahët e rëndë s'ia dogji zjarri,
S'ia dogji baruti i egër;

Ai shtrëngon me duar kallinjtë,
Kallinjtë përdhe s'e rrëzojnë,
Po gjithë së bashku me shtat të florinjtë
Përkulen e — «mbahu!» — i thonë.
Qëndron mes tyre e rritet mes tyre
Figura e tij, si mal,
E kokrrës ia jep të tijën ngjyrë
E kokrra të sajën ia fal.
E ziejnë kallinjtë,
e ulen,
e hidhen,
E mbahet për ta komisari,
Pëllumbat i mblidhen
e turtuj i mblidhen
E bukë bie erë behari,
E del poezia,
e flet poezia
Për jetën e tij të gjallë,
E nxjerr nga këllëfi koburen e tia
E shkon, si ngaherë, në ballë
E thotë i ashpër në tonat poema:
«Përpara, o djema!»

Nëntor 1964

DASHURI DHE FERROBETON

1.

Këtu nuk merren me kotësira erotike,
Që bien erë parfum të modës së vjetër,
Këtu ka front
Dhe fronti ka fryshtë epike:
Beton,
 motorë,
 tela,
 tunelë,
 gurë të egër;
Këtu nuk ka biseda të vakëta:
«Më lejoni të njihemi!»
 «Pardon!»
«Diku ju kam parë!»
«Pupu, ç'ju shkon kjo jakë,
 kjo kravatë!»
«Oh, ç'novelë dashurie!
 Kam qarë!»,

Këtu gérhet,
gérvisht,
gérmon kompresori,
Dhe vinçi kovën me beton e hedh në digë;
Shahet me hekurin e rëndë malësori
(Si dikur me kalin e tij),
duke vidhosur burgjité.

2.

Hidraulistja e re,
Me vetulla tërë pluhur,
Në lumë këmbët e mëdha i lan,
Në lumë me teknikun e betonit është puthur,
Në lumë ka shkopsitur fustanë...
Këtu nuk ka të lutura:
«Mos më gënje, i dashur!
Unazën kur do ta vëmë në gisht?»
Hidraulistja me dorën e plasur,
Flokët e mashkullit i shpupurish,
...Në mbrëmje,

Dhe katër sy majë Shkopetit del ylli,
«Është yni, majë Shkopetit yllin kërkojnë:
është yni,
Në krahë të njëri-tjetrit thonë.është yni!»

3.

Eh, mbrëmjen e ramazanit
Ç'e zunë hidraulisten në gjumë,

Ç'e zunë malësorja dhe malësori,
 Ç'e zunë me teknikun në gjumë,
 Ç'ia panë zbërthyer kraharorin
 Ç'e shanë malësorja dhe malësori
 Hidraulisten,
 që bredh shkurreve,
 Që ua paska hapur kraharorin
 Nën driza,
 nën dushqe, burrave...
 Ç'u ngrit hidraulistja e ç'ia pati:
 — «O njerëz të krimbur nga ramazani,
 Dëgjoni daullen!
 Kërcet nga monopati,
 Dëgjoni!
 Syfyr shkoni hani!»
 Ramazan,
 ramazan,
 o marrëzi,
 Kur do pushosh së thirruri banorët
 E këtyre maleve
 ngarkuar me xhami,
 Minerale,
 kobure,
 shtylla tensioni,
 motorë?...
 Ramazan,
 ramazan,
 o sprihë!
 Gjithnjë na ke thirrur me daullen e egër
 Dhe ne malësorët, me dhëmbë tërë misër,
 Xhamitë kemi qelbur
 me lutjen e vjetër.
 Ramazan,
 ramazan.
 o marrëzi!

Na thirre e na the:

«Bëhuni mjeshtër xhamish!»

Dhe s'na le të krijojmë

As «Madona», as «Divina Komedî».

Ramazan,

ramazan,

o varr dashurish!...

Ramazan,

ramazan,

është veshi yt,

Është syri yt,

është goja jote,

Që hidraulisten dhe teknikun nën yjtë

I ndjekin,

i kërkojnë me mallkim të ftohtë!

4.

Mëngjes.

Buzë lumiit dy trupa kani rënë.

Thërrmijat e arta të diellit pikojnë

Nga muskujt e tyre,

nga llërë e këmbë.

U zgjuan.

Krahët shtrijnë.

Marrin firomë.

Mëngjes.

Nga maja e Shkopetit gjëmon sirena,

Nga dinamiti fryhet e pëlçet pluhuri.

Hej, ju atje në lumë,

s'mbaruat së puthuri?

Dhe ngrihen të dy

dhe turren të dy.

Atje ku gjëmojnë shkrepa e gurë,
Atje ku e panë dashurinë në sy,
Dashurinë që s'vyshket kurrë!

5.

...Këtu nuk merren me kotësira erotike,
Që bien erë parfum të modës së vjetër,
Këtu ka front

dhe fronti ka frymën epike:

Beton,

motorë,

tela,

tuneli,

gurë të egër.

Urra

metalit,

telave,

motorëve,

Urra

nepërkës — xixë elektrike,

Që po ua heqin brekushet malësorëve,

Që po ua prishin çerdhen zanave epike,

Që po i hipin zanat në makina

Dhe në kurset e rezervave të punës i çojnë,

Të mësojnë si ndizen minat,

Që tunele të shpojnë!...

Urra

barutit,

dinamitit,

fitileve,

Që po e prishin heshtjen në oda me oxhakë,
Që po i shuajnë psherëtimat e idileve,
Në shkallët me parmakë!..

Urra

ferrobetonit,
vinçave,
darëve

Dhe muskujve,
që presin
rrufetë,
Që ua ngatërruan lutjet fetarëve
Nën çati të tyrbeve,
nën minaretë!

Urra!

Urra!

Njëqind herë urra
Për dashurinë e teknikut dhe hidraulistes,
Që kotësira parfumesh nuk ka,
As gogësima

në frona
lulishtesh!

6.

Në shkëmb të Shkopetit ka një bletë,
Ka një bletë,

në majën e lartë;
Nga kohëra të lashta mund të jetë,
Nga kohëra të lashta

shtohet,
bën mjaltë

Prej gjeneratës

në gjeneratë...
Mjalti i saj nuk është nga lule moçali,

Nga lule livadhi,
nga lule kënete,
Po nga lëndina dhe lugje mali,
Ku dielli vështron,
ku rrjedhin rrëketë.
Hidraulisten me kominoshe të kaltra
Tekniku i betonit e mori për dore:
— I pari unë do ta marr atë mjaltë,
E para ti do ta hedhësh në pjatë.
Thonë se bimbashi i turqve, kur erdhi
Të ndiqte malësorët përpjetë Matit,
Një mijë jeniçerë mbi shkëmbin i derdhi,
Që t'i sillnin ta provonte mjaltin,
Dhe s'e provoi,
ai mbeti për ty,
Për ne të dy!

7.

Ku e gjeti tekniku i betonit dashurinë?
Ai e gjeti këtu,
Ku hapet aroma e betonit
Agimeve,
Bashkë me aromën e maleve
Dhe flladin e burimeve;
Ai e gjeti këtu,
Ku kolla të mbyt ndër tunelet
Dhe gjoksin pistoleta ta trand;
Ai e gjeti këtu,
Ku shijojnë më shumë gjellët,
Se në çdo restorant;
Ai e gjeti këtu,
Ku emrat s'kanë asnë sinonim,
Po thuhen

Sig janë;
Ai e gjeti këtu,
Ku lumi bredh me rrëmbim
Dhe valët e murme
Betonin e rëndë lajnë;
Ai e gjeti këtu...
Do rrojë kjo dashuri
E lidhur,
 si ferrobeton;
Edhe sikur ndokujt t'i duket marrëzi,
Prapë do rrojë,
 si ferrobeton!
Urra!
Urra!
Njëqind herë urra
Për dashurinë e teknikut
 dhe hidraulistes,
Që kotësira parfumesh nuk ka,
As gogësima në frona lulishtesh!

1962

Nga libri
“MESDITÈ”
1969

M. PIRJANAH

R A P S O D I

*Selim Hasanit, këngëtarit
të Labërisë*

Ku shkund gurët qafë e shpatit,
Mardhur bore, djegur vase,
Mbushe, xha Selim i Bratit,
Dy hejbe me këngë labe.

Erë plumb e erë predhë,
Erë prush e erë brengë,
Erë dushk e luleshqerrë
Binin-binin ato këngë.

Se hejbetë në sëndukë
Për t'u mykur nuk i vure,
Po i more çukë më çukë,
Selim Brati me poture.

Dhe mbi malet e përpjetë,
Mardhur bore, djegur vase,
Prapë i zbraze ti hejbetë
Mbushur plot me këngë labe.

I përcolle, larg i nise,
Nëpër gjurmë gjelbërimi:
«Shkoni, bija, merrni viset,
Ju bekoftë xha Selimi!»

KREVATI I PERANDORIT

Partizani Meke kish opinga të rënda llastiku,
Kish opinga të rënda e pushkë të rëndë
Dhe në brez kish vezme me plumbë belgjiku,
Dhe një kobure të vjetër me nëntë...
Atë ditë kur hyri në pallat ishte i pangrënë,
Ish i pangrënë dhe për gjumë i kapitur.
Ç'të bëjmë, partizani Meke, ç'të bëjmë!
Edhe pa bukë e pa gjumë duhet pritur!
Dhe hapi një dhomë e në dhomë pa një krevat të bukur,
Krevat të tillë kurrë s'kishte parë,
Të pastër si flutur,
Të ndritur si pika e vesës në arë.
Në krevat pat fjetur Viktor Emanueli i Tretë,
Atë natë, kur shpëtoi nga plumbi i Vasilit.
— Eh, kobure virane, e luajte tytën e shkretë!
Tha partizani Meke para krevatit ngjyrë trëndafili...
E u ul në jorgan, e hapi kutinë e lashtë,
E ranë në jorgan coprat e duhanit të fortë,
E ranë në jorgan shkëndijat që nxori masati,
Shkëndijat që nxori masati nga stralli i ftohtë.

Dhe u hap në dhomën e perandorit
Era e eshkës e era e duhanit,
E eshkës të sjellë nga mali i Tomorit,
E duhanit të sjellë nga grykat e Mezhgoranit...
E tymi mbuloi fotografinë e perandorit në mur
Dhe mustaqet e perandorit në fund të tymit ranë,
Mustaqet që perandori i krehu në dhomë dikur,
Ditën që shpëtoi nga plumbi në një bulevard në Tiranë.
— Shpëtovë mirë aherë, — tha partizani Meke. —
Palo burrë ke qënë, megjithëse perandor,
Dhe mustaqet me krehër sedefi m'i krehke,
Dhe qeshke me zor!
Tfu! as duhan të fortë si imi s'ke pirë,
As eshkë si imja s'ke ndezur me masat!
Tfu! dhe tri pëllëmbë njeri je shtrirë
Nën këtë jorgan, mbi këtë krevat!...
Kam pasur dy djem unë Mekja
Tri herë më të gjatë se ti,
Dhe ti m'i rrëmbeve si vdekja
Dhe m'i degdise në ishujt në Itali...
Dhe vdiqën djemtë e mi dhe i hodhe në det
Dhe më le mua e plakën kërcure
Dhe më le arën pa mbjellë pesë vjet,
Dhe më le selishtën mbuluar me hithra e shkurre.
Edhe Kasëmit të Aliut ia vrave djemtë,
Edhe Kiços së Gaqos ia vrave çupën,
Atë natë kur sillnim duaj në lëmenjtë,
Atë natë kur gratë zinin në magje bukën...
Më ke dëgjuar mua, Meken, ndonjëherë,
Të them, më ke dëgjuar në Itali?
Domosdo emrin tim do ta kesh shkruar në dëfterë,
Domosdo emrin ma di...
Ja, unë jam Mekja, me opinga llastiku e me opinga lëkure,
Me masat, kobure e vezme në brez,
Unë të dogja kazermat e ushtarët t'i zura,
Që në Sicili e gjer në Bradashesh.

Kudo jam unë Mekja e kudo kam qenë
E do të jem kudo e ti do dridhesh nga unë,
E data të ka për të zënë
Edhe zgjuar, edhe në gjumë...
Tfu! të pështyj në surrat, perandor,
Një palo burrë dy pëllëmbë,
Një palo Viktor
Me dy gisht këmbë! —
E i erdhi gjumi partizanit Meke
Dhe u shtri në krevat të perandorit
Dhe opingat s'i hoqi partizani Meke
Dhe vezmet nga brezi s'i nxori.
Dhe tha ngadalë partizani Meke
Me dorën e madhe në kraharor:
— Farë e keqe,
Tani jam vetë perandor!... —
Dhe humbi në mjegull Viktor Emanueli i Tretë,
Dhe humbi në mjegull perandoria;
Opingat e llastikut qëndronin majëpërjetë
Në jorganin sjellë nga Italia...
Nën jastëkun e bardhë me pupla
Rrinte koburja nëntëshe e partizanit Meke,
Në kokë të krevatit varej pushka
Eh, ç'vajti, partizani Meke!

TË DASHURA VAJZA

Të dashura vajza,
Mblesët s'dremisin, ruhuni nga mblesët!
Skutash e qoshesh ata ngrenë veshët,
Skutash e qoshesh pritë ju zënë.
Në prita shfletojnë me mëndje kanunë,
Kafen e pinë me të liga mendime...
Të dashura vajza,
Mblesëve të dhjamur, u hapët punë
Mblidhen kokë më kokë në nulla
Dhe tundin mjekrat mblesëve thatimë.
«Dëgjo, Shemshedin, dhe tundin qeleshet:
Erdh kohë e vështirë të keqen Dulla,
Po s'kanë vetëm qeleshe të bardha, për mblesët!»

Kanë kravata

dhe borsalina,

Dhe mund të quhen

Fredër dhe Arta,

Siç mund të quhen dhe Shemshedina;

Dhe mund të pinë fërnet «me kulturë»

Dhe mund të flasin plot delikatesë

Me gjuhë të mençme literaturë

Dhe prapë të jenë

mblesë...

Të dashura vajza,

ruhuni nga mblesët,

Mblesët e dhjamur,

mblesët thatimë,

Mblesët që ngrenë skutave

veshët

Dhe skutave tjerrin të zeza mendime...

NË AMFITEATRIN E BUTRINTIT

✓

Erdhën të dy në Butrint, në amfiteatrin e vjetër;
Kish hënë e zbardhët mermeri i lashtë;
Erdhi këtu edhe Orfeu ngadalë nëpër fletët
Dhe u ul pranë statujës së bardhë.

I lodhur duke kërkuar Euridikën e humbur,
Filloi të shkruajë në pentametër një këngë të gjatë,
Ndërsa ata të dy rrinë të përqafuar nën kulpër
Mbi mermerin në amfiteatër...

«Unë ty të nxora nga nëndheu,
Unë ty të nxora nga ferri e ti prapë më ike!»
Këndonte a ndofta vajtonte Orfeu
Për të bukurën gruan e tij Euridikë!

Po ata të dy s'e kishin mendjen atje;
Nën kulpër thoshin fjalë për dashurinë e pastër
Më të fuqishme se fjalët e këngëtarit Orfe
Dhe të aktorëve, që kanë luajtur në këtë amfiteatër...

Vërtet, cilët kanë qenë ata që kanë lojtur,
Ata që kanë luajtur «Edipin-mbret» e «Prometenë»
Në këtë amfiteatër buzë Jonit të ngrohtë,
Ku yjet e kaltër bien?

Vërtet, në këtë mermer kanë shkelur
Stërgjyshrit tanë edhe si artistë edhe si spektatorë
Dhe janë trishtuar e kanë qeshur —
Thonë ballë statujës dashnorët...

Vërtet, në një mbrëmje si kjo ka qenë plot amfiteatri,
Në një mbrëmje si kjo jonike,
Dy mijë e ca vjet më parë, vazhdonte akoma spektakli
Dhe aktori, që lozta Orfenë, thërriste: Ku je, Euridikë!...

Ja, ta provoj edhe unë njëherë
Dhe të thërres si aktori, që lozta Orfenë,
Kur nga Joni jodi binte erë:
«Irenë, Irenë, ku je, Irenë?»

Dhe ata qeshnin e statujat dëgjonin,
Statujat që dy mijë e ca vjet qëndruan në këmbë,
Qëndruan në këmbë e ranë e u ngritën me fytyrë nga Joni.
E fjetën nën dhe e prapë u përmendën...

Vërtet, Irenë, ti kësaj statuje i ngjan çuditërisht,
Ndofta skulptorit stërgjyshja jote i ka pozuar
Për të skalitur një perëndeshë në Butrint;
Kështu ndodh, Irenë, perëndeshat kështu janë krijuar...

Kështu ndodh! Edhe Afërdita, e dashur,
Edhe Artemida, perëndesha e hënës,
Fytyrën e stërgjysheve tonë kanë pasur,
Ja, si ti, Irenë, kanë qenë...

Dhe ata ndenjën në amfiteatër
Aq sa zgjaste një dramë e Euripidit,
Një dramë e mëdha me pesë akte
Për spektatorët e Butrintit...

MUNDJA E LEKË DUKAGJINIT

I.

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin
E fjalë këmbeva në malet me fletë,
Po Lekë Dukagjini ishte trim e bir trimi
Dhe s'mundej dot lehtë...
Po Lekë Dukagjini nuk ishte Leka i Lecit,
Që bën njëqind lëshime në punë;
Lekë Dukagjini i rrepti i të rreptit
Ma tundte para syve kanunë
Dhe gjëmën lëshonte si shkëmbi kur bie në përrua:
«O mbaje gruan kështu si them unë,
O lëre gruan, se s'je për grua!»

2.

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin
Me gjyshin tim të nderuar,

Dhe pritë njëri-tjetrit i zinim
Në malet me shkrepë mbuluar...
Dhe unë herë-herë i bëja lëshime
Dhe ty të mundoja dhe brënda të mbaja
Dhe jetën ta mbushja plot hidhërimë;
Sus!

me zërin e egër të shaja,
Se Lekë Dukagjini ma tundte kanunë
Dhe gjëmën lëshonte si shkëmbi kur bie në përrua:
«O mbaje gruan kështu si them unë,
O lëre gruan, se s'je për grua!».

3.

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin,
Se donte lëshime nga unë.
Pritë në male njëri-tjetrit i zinim,
Ai mburrte kanunë, unë shaja kanunë.
«Eh, gjysh, ti je hedhur për gratë në flakë,
Po pse në kanun i ke sharë?
Eh, gjysh, ti gruan tënde s'e ke dashur pakë,
Pse mua që e dua më quan të marrë?»

4.

Një ditë kanunin ia mora nga dora
Dhe copë ia bëra mes malesh të lartë.
Iu drodh ajo mjekër e bardhë dëborë
Pas çetinës së lashtë...
Dhe unë thirra:

E munda Lekë Dukagjinë!

(Natyrisht e munda kanunë;
I heq kapelën për trimërinë;
Ka qenë trim si furtunë...)
Ti, grua, më pyete e sytë të ndrinin,
Më pyete ngadalë mënjanë:
«Vërtet e munde Lekë Dukagjinin?»
Dhe unë të thashë: E munda, po sytë ç'më panë!

KËRKIMI

✓

Që nga Naimi gjer në ditët tona
S'u lodhën poetët së kërkuari malet;
Kërkuan nga Vjosa e Valbona,
Kërkuan, si gjeologët mineralet.

Thesaret që zbuluan i shpérndanë:
«Janë tuajat, njerëz. Maleve i gjetëm!»
S'u grindën e për vete s'i ndanë,
Se kanë zemër të madhe poetët.

E kështu do jetë: të tjerë, që do vijnë një ditë,
Do gjejnë në male thesare më të mira,
Se malet kanë perla për të gjithë,
Sado të jenë kërkimet të vështira...

E do kalojnë vite me diell e me shi në jetë,
Do pikojnë strehët e do rrahin valët në lumë,
E vetë njerëzit do gjykojnë shtruar e qetë
Se kush kërkoi e kush nxori perla më shumë...

A I M O T . . .

V

N e erdhëm prapë pas udhës së gjatë,
Pas udhës së gjatë, mes dimrit të egër,
Me kömbë të vrara e me nga një copë bukë të thatë
Në çantat, ku mbanim granatat e fishekët.

Ne erdhëm në fshatin me dyzet shtëpi të gurta,
Me dyzet oxhakë, që tymonin si llulla me duhan të ndezur
Dhe në rrugë na pritën motrat e nënët e urta,
Dhe në oborre na u mblodhën kalamajtë e zbatur e të
zhveshur.

Dhe në strehët ne pamë të pikonin pikat e para,
Pikat e para të ujit, që ziente nën dëborë
Dhe selishtat i pamë lara-lara:
Ia kish zbuluar dëbora dheut kraharorë.

Dhe ndjemë erën e bukës në dyzet shtëpitë,
Se gratë kishin ndezur të dyzet furrat
E piqnin për ne çyrekë e pite
E këndonin për ne këngë nga më të bukurat.

E kënga e grave përhapej me erën e bukës
E me erën e pikave të strehëve,
E me erën e bardhë të jugës,
E me erën e vajit të dyfekëve:

E këndonin këngë gratë në furra
Me duar me brumë të bardhë, të bardhë,
E thoshte kënga që të ktheheshin burrat,
Të ktheheshin shëndoshë nga lufta e gjatë vite me radhë;

Të ktheheshin me lirinë e bukur,
Të ktheheshin të rrisin kalamajtë,
Të ktheheshin të rrisin bukën,
Të ktheheshin të përqafonin gratë;

E thoshte kënga për atë mot që do kish bukë shumë,
Për atë mot që do mbruhej brumi në magje,
Për atë mot që do vaditej ara mbi lumë,
Për atë mot që do mbinin lule nën strehë e pragje...

E thoshte kënga për atë mot që do çelte qumështi i grave
Si trëndafil i bardhë në gjokset, që ishin tharë
Që shëndeti t'u vinte kalamajve,
Që të bëheshin burra të fortë e të mbillnin në arë.

Dhe ne rrinim e mendonim në fshatin me dyzet shtëpi
Dhe thoshim me vete: ky mot do vijë patjetër,
Dhe udha prapë na thërriste në ndeshje syngji më syngji,
Se revolucioni kishte armiq të egër.

ESKIZ

Ne jetojmë në këtë qytet të madh me reklama,
 Me bulevarde zhurmonjës, ku bërtasin afishet nga muret,
 Me uzina që i thërresim «Partizani», «Stalin», «Tirana»,
 Me teatro e pallate kulture.
 Në këtë qytet të ri e të vjetër,
 Mes valëve të detit të njerëzve,
 Ne mund të mos e takonim njëri-tjetrin
 Dhe mund të ishim të huaj: emra mes emrave.
 Po një ditë rrugët të dyve na poqën
 Dhe burrë e grua filluam shoku-shokut t'i flasim
 Dhe tani në shkallë ulim e ngjisim karrocën
 E fëmijëve, që sa kanë nisur të barasin.
 Dhe në këtë apartament me libra e saksi
 Vjen zhurma e qytetit tonë,
 Vijnë gjëzimet e tij e shqetësimet e tij,
 Vijnë përherë edhe kurrë s'pushojnë
 Dhe na pushtojnë se janë të pushtetshme si era
 Dhe gjëzohemi e shqetësohem tok me qytetin,
 Tok me dritat në bulevardet e gjera,
 Në bulevardet e gjera, që mbajnë në krahët e tyre
 apartamentin.

KULLAT

Dëborë e Dukagjinit, që mbush malin
Me thinja, na mbulon si Dukagjinë.
Në apartamente, bulevardit «Stalin»,
Ne kemi lënë gratë dhe shtëpinë.

Orteqet uturijnë tatëpjetë,
Si vargjeve të «Mujit e Halilit»,
Thërrmohen posa shkuma në përrenjtë
Dhe grykash shket jehonë e tyre e dimrit.

Ne ecim me elektricistin Pjetër,
Ngarkuar si çetina me dëborë.
Do shembëllinem me rapsodë të vjetër,
Po kemi tela dhe izolatorë.

Ku vemi vallë, ç'duam suferinës,
Pse prishim virgjérinë e legjendave,
Që hidhen prej çetinës në çetinë
Dhe natën nanurisin foshnjat djepave?

Ne shkojmë kullave t'u lidhim tela,
Litarin e kanuneve ta shpleksim.
Hej, dukagjinasa e vogël, Gjela,
Mos rri pas mureve, ne s'jemi mblesër!

E di, moj Gjelë e vogël, ti fizikën,
Korent, izolator, ampermetër?...
Afrohu dhe përcille zallesh frikën,
Izolatori izolon dhe mblesët...

Do lidhim mes tavanit të odës sate
Një llambë elektrike sa një ftua,
Nën llambë le të hidhen mbrëmjes ëndrrat
Dhe le të ligjerojnë si një krua.

Ne erdhëm me elektricistin Pjetër,
Që tok të lidhim kullë më kullë tela,
Që vjershat t'i dëgjosh në tela nesër
Me lajmet e gazetës, Gjela!

Furtunë e Dukagjinit e mbush malin;
Dëbora është e ashpër dhe e hidhur.
Na prisni, gra, në bulevardin «Stalin»,
Se kemi shumë tela për të lidhur!

1968

S A L U T !

Salut atyre që s'u plakën
Dhe s'u shteron krijimi kurrë,
Që malet pash më pash i matën
Dhe lanë djersë e gjak në gurë.

Me shpirt të madh ngaherë mbetën,
S'ua ndryshku mendjen dot skleroza
Dhe s'psherëtinë e s'nëmën veten
Me këmbët futur në pantofla...

Salut atyre që s'u plakën,
Po ndoqën hap më hap rininë
Dhe smirë talenteve s'u patën,
Se s'njohën kurrë pleqërinë!

K U A J T

✓

U në i kam dashur kuajt shumë,
(Ndokush mund të më quajë anakronik),
I kam shpënë të pinë ujë në lumë
Dhe në lumë i kam larë në korrik.

Në lëmë grurë e thekër kam shirë
Dhe me kamxhik i kam ndjekur: hop! hop!
Dhe në mbrëmje e në mëngjes pa gdhirë
U kam varur në qafë torbat me elb plot.

Po kjo s'do të thotë që s'kam ëndërruar
T'i lë kuajt e të udhëtoj me aeroplanë,
Dhe grurin e verdhë kallirënduar
Ta shij në arë me autokombajnë.

Vërtet, me gjithë dashurinë time për kuajt,
S'më ka ardhur keq t'i ndrroja ata
Me traktorë mes arave me duaj,
Me makina e me kombajna të mëdha.

Por të duash makinën, s'do të thotë të zemërohesh
me kalin
Dhe të kesh druajtje ta përmendësh në varg,
Akoma kali ka për të ngjitur malin,
Gjersa helikopteri është larg...

TELEGRAFI

Dhe mua tridhjetepesëvjeçarit të parruar,
Mes pyjeve veriore në Pukë,
Më vjen një telegram i gjuar:
«Të lindi çupë!»

Në mensën e ftohtë, i mbështjellë
Me pallton e trashë,
Lexoj telegramin mbi pjatën me gjellë,
O grua e dashur!

Ndërsa era ulerin ah më ah...
Vallë q'emër t'i gjejmë çupës?
Kërcasin sëpatat druvare: trah-tarah!
Në pyjet e Pukës...

Mblidhemi, druvarë, të gjejmë emrin e lashtë,
Emrin e lashtë ilirian,
Të dalë emri nga dritaret jashtë
E era ta dërgojë pa telegram?

At'herë mua tridhjetepesëvjeçarit të parruar;
Mes pyjeve veriore futur,
Do më kthehet telegrami i gëzuar:
«Emër i bukur!»

FILLI ELEKTRIK NË VARGJE

Unë e di,

në vargje ende ka dokrra,
Po kur me fill elektriku të lidhen
Kelmendi,

Dukagjini,

Mokra,

Kush do durojë që vargu të bjerë erë tym kandili?
Dhe dot s'do ta fshehim impotencën poetike,
Dhe do themi: «Kështu ishte shkruar dikur...»
Se vargjet e mbuluara me pluhur
Do t'i zbulojë llamba elekrike...

1968

KUR TË VIJ NJË MËNGJES

Do jetë mëngjes dhe unë do vij patjetër.
Mbi xhaketën time do kenë rënë petale
Nga lulet e kumbullës së vjetër,
Nga lulet e thanës së thartë.

Aherë ti s'do jesh zgjuar akoma.
Unë do them emrin tënd në xhame
Dhe do vërvshellej të dashurën këngën tonë:
«Ti çele herët, moj bajame!»

Do vërvshellej ngadalë-ngadalë
E s'do prish gjumin tënd të bukur,
Do bien mbi mua petale
E do ulet në sup një flutur...

E, kur sytë të hapësh, do shohësh
Romantikun e përjetshëm në xhame
Dhe këngën e dashur do njohtësh:
«Ti çele herët, moj bajame!»

DUKE U MENDUAR

N e e ruajmë nga burimet e rinisë sonë
Gjer në pleqëri rrëkezën e kulluar.
Edhe kur kujtojmë se është vonë,
Rrëkeza e vogël rrjedh pa kuptuar...

Ne i ruajmë rrëkezat e rinisë ngaherë,
I ruajmë gjer në pleqërinë e thellë,
Ashtu siç i ruan toka për në verë
Rezervat e ujit të kthjellët...

Ndofta kjo na shtyn të mos pohojmë kurrë,
Që u plakëm e vamë!...
Lulet t'i duam dhe thëllëzat në gurë
Dhe këngët djaloshare në buzë t'i mbajmë.

R E M B R A N D T I

Në një mulli të vjetër në Holandë
Një vajzë dashuroi një millona
Dhe lindi nga të dy Rembrandti
Dhe qeshën përmbi djep ata...

E shkundi miellin millionai mbi djep
Dhe erë miell pelenat e tij ranë.
Përgjonin zogjtë degëve në plep,
Që t'uleshin në djep e miell të hanin...

Atë mëngjes u lindën shumë princa
Dhe emrat ua shënuan kalendarët;
Kambanat oshëtinë nëpër kisha
Dhe natën ndritën sheshesh llampadarët.

Rembrandtin nuk e mori kalendarin,
Kambana majë kishës nuk buçiti,
Nga vatra veçse ndriti djepin zjarri,
Trokashka në mulli mbi gur trokiti...

Ai më vonë kambanës i ra vetë,
Gjëmoi nëpër Holandë e nëpër botë;
Kjo ishte kambana e artit të vërtetë
E tundur nëpër studiot e tablotë.

Dhe princave as zilka nuk u mbeti,
As emri zverdhur nëpër kalendarkat;
U ngrit mbi ta Rembrandti i madh si deti,
Ai që e përshëndeti veç trokashka...

K È N G A

*Duda ish prej Elbasani...
Duda ish e shkoi e vate,
Varri iu mbush manushaqe.*

Popullore

Po cila do ishe ti me këtë emër,
Që erdhe mes viteve në këngë?
Me siguri dikush me mall në zemër
Këndoi për ty e derdhi gaz e brengë.

Ka qenë ndofta një qejfli i marrë,
A ndofta udhëtar karvani;
Te rrapi i Bezistanit të kish parë
Dudi prej Elbasani!

A ndofta të kish ndjekur gjer te porta,
A nga avllitë e larta ishte ngjitur
Dhe pas ullirit netëve të ftohta
Ka pritur e ka pritur...

Ne fatin tënd të shkretë nuk e dimë,
Nuk dimë se në ç'rrugë shkoi karvani,
Dhe ç'ish ai që prishi dashurinë,
Dudi prej Elbasani!

Veç kënga nuk të la, po pas me vete
Të mori e të shpie në udhë e praqe,
Dhe ti përjetë e dashruar mbete
Dhe varrin e ke plot me manushaqe...

LARG QYTETIT

Në qytet bie shi dhe me ombrellë
Në kafe «Tirana» futesh ti.
Unë jam në pyjet në Munellë,
Ku rënkon një sharrë e një qysqi.

Pylli oshëtin nga shiu i çmendur,
Pesëfish më i çmendur se atje;
Zogjtë nëpër ahe janë trembur,
Heshtin të tulitur në fole.

Unë me druvarët pranë zjarrit
Duart ngroh në prush e pi duhan.
Nëpër ahe shiu i zgjat litarët
Dhe të zgjatur dy-tri orë i mban.

Dhe druvarët flasin për shtëpitë,
Flasin për fëmijë e për gra;
Flasin si mes pyjeve u rritën
Me sëpata e sharra të mëdha...

Flasin si një djalë nga druvarët
Na rrëmbeu një çupë në një fshat
Dhe e ngjiti sipër gjer në sharrat,
Sipër nëpër pyll e monopat;

E rrëmbeu se gjyshi s'desh t'ia jepte,
E kish rritur vetë pa baba!
Shfrynte plaku pranë vatrës rreptë:
«Nuk e jap në pyje tek ata!...»

...Dhe druvarët mu në pyll të dendur
Djalit i dhuruan një peshqesh:
Një krevat prej ahu të gëdhendur,
Një dyshek të mbushur krejt me lesh.

Dhe i thanë: «Bëfsh fëmijë shumë,
Që mos zërë kurrë sharra ndryshk
Pyjeve me shi e me furtunë,
Aheve me fletë e me myshk!»

Dhe kjo çupa qenka kuzhinierja,
Që më zjeu një supë mua dje;
Supë kaq të shijshme asnjetëherë
Ndofta nuk kam ngrënë, të bëj be!

Në qytet bie shi dhe me ombrellë
Në kafe «Tirana» futesh ti;
Ç'të tregoj për ty unë në Munellë,
Ku rënkon një sharrë e një qysqi?

T'u tregoj si gjurmëve të ndoqa,
Si kaprollin kreshtave në shkëmb,
T'u tregoj ç'më ndezi e se ç'hoqa
Gjersa ti më quajte burrin tënd?

Fati ynë ka diçka të afërt
Me atë që ndodhi dje këtu:
Si e ndoqi çupën nëpër ahet
Djalin që çan dërrasa e pret dru...

T'u tregoj si malli në Munellë
Më pushton për ty dhe qetë s'rri?
Nga kafe «Tirana» me ombrellë
Ndofta sot ke dalë tek bie shi...

K O M I S A R I

Baladë

Nën një shkëmb murrash të shtrembër,
Që mban emrin Gur-Kusar,
Rrugën gjeti gjer në zemër
Plumb i nxeh të, komisar!

Re në krah nën shkrep të vjetër,
Re në krah e s'lojte dot.
Pishë e re qepallëgjelbër
Nga qepalla derdhi lot.

Lot i gjelbër ra në faqet
Afër shkëmbit Gur-Kusar,
Dhe nën shpatull manushaqet
Ulën kokën, komisar!

Unë rrija pranë teje,
Udhën sillja nëpër mend:
Si u hodhëm në beteja
Shteg më shteg e vend më vend,

Si naganti nuk na ngeci
Që në Kuç e në Korab,
Kur na thrriste Shefqet Peçi,
Komandanti ynë lab,

Kur vraponim ne si retë
Pranë shkëmbit Gur-Kusar;
Shtnim shtatë e vrisnim tetë
Për lirinë, komisar!

Unë rrija pranë teje
Me nagant e me mauzer,
Nga mërzia nëpër deje
S'rridhte gjak, po rridhte vrer.

Ç'do më thoshte nëna plakë,
Kur të shkoja prapë në fshat?
«Ju përcolla të dy bashkë,
Ti më kthehesë fillikat!»

Nëna s'tha të tilla fjalë
Buzë vatrës me pak zjarr,
Vetëm pyeti: «mos ka dalë
Majë shkëmbit Gur-Kusar,

Që dushmanin ta shikojë
Dhe ta ndjekë shteg më shteg;
S'ma merr mendja të pushojë
Një nagant e një dyfek...»

...Dhe naganti nuk na ngeci
Që në Kuç e Vishegrad;
Ngriti këngë Shefqet Peçi,
Komandanti ynë lab...

Nën një shkëmb murrash të shtrembër
Që mban emrin Gur-Kusar,
Rrugën gjeti gjer në zemër
Plumb i nxehthë, komisar!

NË KËTË HOTEL

Në dritaret e këtij hoteli të madh ne rrimë.
Perëndimi ka hedhur spirancat matanë qytetit.
Elektrovinçat sqepat vërtisin e oshëtijnë
Në këtë qytet buzë detit.

A

Ne ia hoqëm këtë qytet vdekjes ahere,
Duke çminuar të katër qoshet e tij
Dhe, në vend të minave të luftës, vumë vinçat me potere,
Që të ngrihej i madh dhe i ri.

B

C

Mes këtyre vinçash e korpusesh të pambaruar
Ty të kërkova e sot rrimë e mendojmë
Në këtë hotel me qilima shtruar
Dhe me dritare të mëdha që detin shikojnë.

D

E

F

G

H

I

J

K

L

M

N

O

P

Q

R

S

T

U

V

W

X

Y

Z

Ne vitet partizane një çerek shekulli më parë.
Trimëria dhe dashuria më kanë ndjekur tërë jetën
Dhe jam i lumtur që të dyja kanë qenë bashkë
Në luftë për të vërtetën...

Frym erë nga deti i kaltërt
E valët në betonin e pistës kokën përpjekën.
Ti mërdhin në dritaren e katit të katërt
Dhe unë mbi supe të hedh xhaketën...

G J Y S H I

V

Në lëndinën me varre nën një borigë
Me gjyshër të tjerë fle edhe gjyshi im Nesim;
Mbi lëndinë vërvëllejnë telat elektrikë,
Elektroni në tela lëvrin...

Nën borigë kalin e zgres e ndez një cigare
E gjyshin Nesim mundohem ta sjell në mend.
Ai lëroi me parmandë shumë ugare
E këndoi: «Oi, si do t'ia bëjmë hallit tënd!»

E, kur vdekjen e ndjeu, tha: «Mbulomëni nën borigë,
Që të këndoja boriga: «Oi, si do t'ia bëjmë hallit...»
S'e dinte se do vërvëllenin telat elektrikë
Këngën e elektroneve mbi borigën pas malit;

S'e dinte gjyshi Nesim se do vija dhe unë
E do shkruaja katër strofa të thjeshta
Nën borigën, si roje e lashtë me gunë.
Që mban mbi krahët e saj dyqind vjeshta...

NË VJESHTË

Aheve nxitoj me bluzë veshur;
Ahet flakë e verdhë i ka ndezur,
Flakë e verdhë e vatrës që ka vjeshta,
Flaka që pjek misra edhe vreshta.

Ahet qeshin: «Mblidhi udhës fletët,
Janë letra vjeshte për poetët!»
Dhe më japin zarfe si postierë,
Shkruar me kalem vjeshtor të verdhë.

Vjeshta një përgjigje pret patjetër,
Pret t'i them ca fjalë në një letër;
Dhe poeti s'bëhet aq i prapë
Letrave përgjigje mos t'u japë,

Letrave që nis me postë vjeshta
Udhëve në pyje, ara, vreshta,
Natyrisht poeti ka plot punë,
Po një letër s'ha dhe kohë shumë!...

KUR LIBRI ËSHTË NË SHTYP

Kur libri është në shtyp e tipografi i heshtur
Me duar me bojë shkronjat e vjershës radhit,
Diku në një digë betoni i fundit është hedhur,
Diku në një fshat elektricisti llambën e fundit lidh.

Diku në një rrugë një vajzë ecën e dashruar
Me një buzëqeshje të lumtur me vete,
Diku në një fushë të bleruar
Një lule mbush kërcellin me fletë...

Kur libri është në shtyp, poetit në mend i vijnë
Të tjera vargje e mendimi krahët e kaltër tund:
Eh, të kisha shtuar edhe këtë varg, edhe këtë rimë!
Po tipografi fshin duart me bojë: fund...

E PAHARRUARA

N_gaherë pyet nëna e ngratë:
Ku do jetë partizania që fjeti atë natë??!

Pyet e ul kokën me thinjë
Në mbrëmjet e vona në fshatin Sinjë.

Asaj i kujtohet vajza me yll në ballë,
Që rrobat ia thau e i dha qumësht e dhallë.

Dhe kur iku, në prag i tha: udhë e mbarë!
Dhe mendoi: «Ta kisha nuse për Mevlanë!»

Po Mevlani u vra në Malin e Thatë
Në Brigadën e Katërt a në Brigadën e Shtatë.

Dhe tok me djalin në mendje i mbeti
Vajza që natën në odë fjeti.

Dhe ngaherë pyet për të: ku do jetë?
Sikur nusen e djalit ta ketë.

DËSHMORI

Artikulli im s'u shoqërua me foton e tij.
Kërkova në fshatin e lindjes shtëpi më shtëpi,
Po më thanë: «S'doli në foto kurrë,
Se larg fotografëve thyente në gurore gurë.

Dhe fotografët s'vajtën në atë vend,
Se kish shumë gurë e shumë shkëmb,
As çeta, ku shkoi, s'kish fotografë,
Ish luftë e ishim të varfër.

Po kur u vra nën shkëmbin e ndezur zjarr,
U ndodh në çetë një këngëtar
E këndoi tok me ne mbrëmave:
Lule djemtë e nënave»...

Artikullin tim për dëshmorin Ali
Gazeta e nxori pa fotografi,
Po unë vura këngën që u këndua mbrëmave:
«Lule djemtë e nënave!...»

« D A N A J A »

Në oborrin e princeshës Izabelë
Zbavitej gruaja e Rubensit, Elena;
Përhapte erën e perfumeve dantela
Prerë nga Parisi e nga Vjena.

Dhe Rubensi i lumtur pinte verë
Dhe qeshte tavolina nga shakatë;
Elena në kadril me kavalierë
Përdridhte mesin dhe trokiste takat.

Ndërsa mbi një kanal të Amsterdamit
Një dritë e zbehtë në dritare nderiste,
Në shtrat Saskia, gruaja e Rembrandtit,
E lodhur nga veremi, vdiste...

Rembrandti me një xhybe zhele-zhele
Qëndronte mbi krevat dhe heshtte.
Në oborrin e princeshës Izabelë
Elena në mazurkë qeshte.

Në portë të Rembrandtit fajdexhijtë
Trokisnin e kërkonin borxhë;
Tuberkulozi Saskias mushkëritë
Ia gërryente dhe ia mbushte plot me blozë...

— E lumtura Elenë, — thosh ngadalë
Në shtrat Saskia verdhur nga veremi.
Rembrandtit i pikonte lot i valë
Dhe binte në jastëkun bojë kreml

«Danaja» që nga muri shihte rëndë.
Rembrandti, i menduar, thosh me vete:
«Danajës unë i dhashë fytyrën tënde,
Dhe ti, Saskia, do të rrrosh përjetë...

I madhi Rubens, Rubensë të tjerë
Elenat do harrojnë në shkëlqime,
Me ty në dashuri do bjenë,
Danaja ime»!...

Në portat e princeshës Izabelë
Elena në karrocë vetëtinte,
Saskian në qivur, për në varreza
Rembrandti fillikat e shpinte...

Shënim: «Danaja» është një tablo e Rembrandtit me temë mitologjike
dhe numërohet si një nga kryeveprat e picturës botërore.

V J E S H T È S

I shoh tek rriten pjeprat e kungujt e shalqitë,
I shoh tek u nxin kurrizi në bahçe mes fletësh,
I shoh tek sisën tënde si shqerra pinë
E mburren: jemi bijtë e vjeshtës!

I shoh e një mendim i çuditshëm më vjen në mendje:
Léri të vijnë edhe vargjet e mia,
Të pinë pak qumësht në sisën tënde,
Të ngjallen e të dalin të shëndetshëm nga shtëpia.

E të vrapijnë me erën tënde mes zhurmës
E të kërcejnë fushë më fushë e luginë më luginë
E t'u futen udhëtarëve në mëngët e këmishës e të gunës
E t'u tregojnë si sisën e vjeshtës pinë...

POETËT QË VIJNË

V

Mbi fletorka me vija natën vonë,
Diku në fshatra të largëta e qytete,
Të lodhur nga puna rrinë e mendojnë
E vargje thurin e flasin me vete;

Dhe ngrihen mëngjeseve e nisen
Sërish në torno e kombajna;
Vargjet i ruajnë e vargjet i grisin
Dhe prapë kur kthehen shkruajnë.

Mbi fletorka me vija në konvikte
E në baraka e në auditore
Krijojnë asonanca e rima e ritme
Dhe ballin shtrëngojnë me dorë.

Dhe çfarë shkruajnë e cilët janë
Ne ende s'i njohim, ne ende s'i dimë;
Po dimë se tryezat me vargje i kanë,
Atje ku arat blerojnë e tornot ndrijnë;

Po dimë se diku gatuhet poezia,
Gatuhet poezia e madhe, poetë,
Në fletorkat e thjeshta me vija,
Nga vajzat tonë e djemtë.

Dhe ne para saj do mahnitemi patjetër,
Po s'do na vijë keq për vitet që vanë,
Se në godinën e poezië së vërtetë
Ca gurë e ca djersë dhamë...

~~MONOLOGU I CINIKUT~~

Të desha,
s'të dua!

Në jetë ndodh dhe më keq.

Ka njerëz dashnorë gjersa bëhen pleq,

Ka që dashnorë janë vetëm një muaj.

Të desha,
s'të dua!

Ke lindur të vuash,
vuaj!

Jam burrë i ndershëm,
pëlqejej të vërtetën.

Ka njerëz që s'duhen,
po gënjen
tërë jetën.

Jam burrë i drejtë,
i ashpër në ton;

Të them

«s'të dua»

në telefon!

1964

LULET

V

R^hedaktor, ne lulet nuk i kemi harruar ende
Dhe barin e pakorrur nuk e kemi harruar,
Nuk e kemi harruar ylberin me shtatë lente,
Që lidh me dy cepat e tij dy male të bleruar.

Ne ndërtojmë uzina e vëmë torno shumë
Dhe bien nën torno lentet e metalit të gdhendur.
Në formën e luleve e gjethive, që varen në lumë,
Në formën e ylberit e barit të dendur.

Nuk është e vërtetë që dashuria pér lulet e barin
Na qenkësh anakronike,
Ne lulet në dasma me vete i marrim,
Ne lulet i vëmë në dritaret e laboratorëve kibernetikë.

Dhe kujt nga ne s'u pëlqejnë livadhet e blerta
Dhe lulet, që ngrenë kokën e njomë,
Të puthura në mëngjes nga bleta,
Të prekura nga vesa natën vonë?

Redaktor, unë kam respekt për rreptësinë
Dhe për durimin tënd të lartë,
Po çuditem pse vargjet për lulet të shtien mërzinë
Dhe me inat nga libri i nxjerr jashtë...

Ne bashkë me uzinat e duam edhe barin, që ngjall gurin,
Që erë qumësht bie e erë mjaltë;
Ne Azotikun e ngritëm edhe për barin edhe për lulet
 edhe për grurin.
Ne Azotikun e ngritëm që blerimi të mbijë edhe në zallin
 e thatë...

Parvjet, kur ende dita s'kish gdhirë,
Vdiq një redaktor, një miku im i ngushtë.
Mbi varr i vura lule, si kujtim të mirë,
Të mbledhura në fushë...

Po lulet mund të mos ia vija sipër varrit,
Se lulet m'i hiqte sa ish gjallë nga vjershat,
Se gjoja lulet zbusnin shpirtin e revolucionarit,
Se gjoja humbte baruti në rreshtat...

Redaktor, lulet nuk i harrojmë kurrë
Dhe barin e pakorrur nuk e harrojmë,
Se zemrat i kemi të mëdha në këto male me pemë e
 gurë,
Ku lumenjtë zbresin e turbinat rrrotullojnë...

MIKROBORG JEZI

V

C'të vrasim mendjen?

Rrimë në kuzhinë;
Bie erë gjellë, pa ngrënë s'mbesim;
Na pihet ujë,
Na rriten thonjtë,
 pimë;
 i presim!

VDEKJA E DRUVARIT

V dekje ndofta edhe s'mund të ishte.
Vdekja, thonë, hijen ka të rëndë,
Po ai e ndjeu se në ahishte
Ajo bridhte dhe kërkonte vendë.

Mbi një trung la sharrë e sëpatë,
Mori torbën, iku ndër dy ahe,
Ra mbi fletët, ra sa gjerë e gjatë;
Gjoksi i madh nuk naxori «ohe» e «ahe»...

Drutë i desh si njerëzit e shtëpisë
Dhe gjëzohej kur mbinin filizët,
Kur e hidhnin shtatin si fëmijët,
Që sa rriten s'i nxënë këmishët.

Dhe kur ndonjë pemë zverdhët fletët,
Thoshte: «U sëmur e vate!
Vallë do shërohet dot e shkreta?»
Ulej e pastronte me sëpatë...

Ndenji gjysmë shekulli me pemët,
Nga ato mësoi të gjelbrën gjuhë.
Po u shtri një ditë herët-herët,
Se iu duk sikur iu lodhën gjunjët...

Drutë, si në djep, e vunë në gjumë,
Ahet degët sipër tij i varë
Dhe i thanë: «Hesht, u lodhe shumë,
Ndonjë tjetër sharrën le ta marrë».

Dhe një tjetër erdhi mori sharrën.
Sharrës dhëmbët nuk iu ndryshkën kurrë;
Ahet dherin spërkatin me farë,
Ahet bien e fara mbin në gurë...

VALLE LABËRISHTE

*Dhe vallja jonë di të ziejë
Në dasmë e në betejë... .*

Sot nuk jam poet e gazetar,
As druvar i zymtë në ahishte,
Jam qejfli i krisur kërcimtar,
Kërcimtar i valles labërishte.

Vallë vallen ku s'e kemi hequr!
Dhe në dasma dehur nga rakia,
Dhe përpara sulmit tej hendekut
Dehur nga guximi, trimëria!

Thonë se Selam Musai me shokë,
Para sulmit mbi telat me gjemba,
Gunën zhveshi dhe bëri me kokë:
— Djema, hop! —
e djemat:

hop, në këmbë!

Pa ia morën valles labërishte,
Pa ia hodhën valles si furtuna.
Vala e valles zjeu në Drashovicë,
Vala telat ç'i mbuloi me guna...

Hej, ti valle labërishte, valle!
Cili lab s'u ndez si prush prej teje?
Ti je hequr dhe në çaste dasme,
Ti je hequr dhe në çast beteje...

KËNGA PARTIZANE

Unë zgjatja qafën time të ligur
Nga xhaketa e grisur ushtarake,
Këndoja me zërin e ngjirur
Në netët partizane mes flake.

E hapej kënga gurëve të egër,
Ku binin shiu, breshri, plumbat,
E hapej kënga në misër e thekër,
Ku kokrra kërkonin pëllumbat.

Na shpinte kënga të ruanim pusitë
Dhe kokën ta mbanim ngritur.
Këtu ishim bashkë: spektatorë e artistë
(Qëllimi më i madh i artit kish mbërritur).

Unë zgjatja qafën time të hollë
Nga xhaketa ushtarake e grisur.
Kjo ish më e madhja shkollë,
Shkollë për kanto betejave nisur...

DJALOSHARE

Do vij e derën do hap me ngadalë
Herët në mëngjes pa gdhirë.
Do ulem te koka pa thënë asnje fjalë,
Do shoh fytyrën tënde të mirë.

Ti as do ta ndiesh që do jem pranë.
Do thuash, kur sytë të çelësh:
«Mos jam akoma në ëndërr, vallë?»
Do qash e do qeshësh...

NAIM FRASHËRI

V argjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë
Dhe na duket sikur me qenien tonë janë shkrirë,
Se i kemi thithur mes qumështit, frutave, erës
Dhe në burime me ujin i kemi pirë.

Çdo rrokje e varg e poemë është rritur
Tok me lisat e gjatë e me barin në gurë
Dhe në kurorat e pishave është ngjitur
Dhe, si në pisha, s'humb blerimi kurrë.

Ti, si bujk i mirë, lërove arën e fjalëve,
Arën e fjalëve të stërgjyshërve mbetur djerrë,
Mbuluar nga barëra të liga maleve;
E lërove që djerrë mos mbetej asnëherë...

Ish punë e vështirë plugimi i asaj are.
Fjalë të tjera frymën ia merrnin fjalës stërgjyshore,
Po ti gjoksin ia vure përpara
Dhe rrënjet gremit të hidhur ia nxore.

Dhe tek lëroje këtë arë në vapë e në shqotë,
Gabove kur the se perëndia na qenka kudo: në lulet e
lisat,
Pse s'the që vargjet e tua do të ishin kudo: në tokën e
ngrohtë
Në lulet, në barin, në plisat...

Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë
Dhe na duket sikur me qenien tonë janë shkrirë.
Rrugën marrim në male e në buzë i mbajmë ngaherë:
«O malet e Shqipërisë!...»

Frashër 1969

PEIZAZH PAS SHKREPTIMËS

Korriku i ka pirë lumenjtë
Dhe lëngu i damarëve të pyllit është i pakët.
Xhezvja e kafes mund të valojë në shkëmbenjtë,
Që ngrihen mbi përrua të plakur.
Në çast një heshtje e trishtuar
Pushton kurorën e pishës e rrudhat e lumit.
Era frymën e pret nën qiellin e trazuar,
Vrapimin e ndalin retë ngjyrë plumbi.
«Diçka do ndodhë», — pylli mendon.
Pastaj rrufeja krahët thyen diku larg,
Ku puthet dheu me qiellin në horizont,
Duke u përpjekur si katarakt...
Dhe mbushen rrudhat e tokës
Me lëngun që reja, e bija e saj, hodhi
Dhe pylli i urtë tund të gjelbrën kokë:
«Mirë që ndodhi kështu, mirë që ndodhi!»

PIRAMIDAT

Brigjeve të Nilit, e djersirë,
Puna brodhi e ngriti piramidë,
M bajti gurët nëpër shkretëtirë
Dhe me gurë i bëri vdekjes sfidë.
S'mbajmë mend ne emra faraonësh,
Emrat vdiqën mbyllur nëpër gurë,
Emrat vdiqën nën rërën e kohës,
Piramidat s'vdiqën kurrë,
S'vdiqën se i bënë vdekjes sfidë...

NJERIU I TOKËS

Këtyre grykave jetova dhe u rrita.
Ngrihej dielli nga malet e binte në det,
I spërkontakte hëna shelgjet e borigat,
Ku flinin zogjtë tulitur në fletë.
I bëra miq shpezët e bagëtitë
Dhe në bar i mahnitur u shtriva e të flija rashë.
U mundova ugareve përditë
Dhe asnjë grusht toke pa e mbjellë me një filiz s'lashë!
Akoma ç'të flas?
Më ke parë ti, atdhe, se cili kam qenë,
Edhe nëse jam lodhur për një çast,
Kokën në prehrin tënd kam vënë!

DUKE KËRKAAR DASHURINË

Zemra sot me rima e ritme m'u mbush;
Një kovë ekskavatori me trishtim e zbraza,
U bëra gazmor e nga gazi në faqe kam prush,
Rinia godet me grusht në thinjë e brazda.

Ashtu si Kolombi, kur pa në oqeanet e stuhishëm
Të bardhat çajka e thirri: tokë, tokë!
Unë pashë të bardhat çajka të dashurisë
E thirra: është afër, shokë!

Vërtet ish afër, po unë Kolombi, s'e dija,
Veçse kërkonte varka ime me velë të hapur
Dhe shkuma e valës më binte në thinja;
Unë direkun e saj kisha kapur...

Mirë thotë një kolegu im i vjetër:
Në dashuri duhet të jesh Kolomb patjetër!...

FILLIMI I NJË POEME PËR
QEMAL STAFËN

pensong

Kur të rrethuan ish fillimi i majit.
Dyqankat e Tiranës kishin hapur qepenët herët.
Në tavolinën tënde «Kapitalin» e Marksit
E frynte era...
Violina jote ish hedhur në kanapenë e gjatë
E harku i saj ish vënë mbi kapak.
Shopenin nuk kishe kohë ta luaje atë natë,
Atë natë që gjaku pikonte mbi zambak...

KËSHTU MUND TË NDODHTE

Sikur të bija nga plumbi i nxeh të,
Nëna s'do merrte telegrame.
Do vinte korrieri i çetës
I veshur me tallagane,

Do shtrohej i lodhur në vatër,
Me shkop do trazonte zjarrin
Do sillte mendimet në hatër,
I heshtur do pinte cigarin;

Do thoshte:

«Yt bir, nënë...»
Dhe dora e nënës me deje të trasha
Nga dridhmat në gju do kish rënë,
Në prush do shpëtonte masha...

Pastaj do çonte kokën e bardhë,
Do mbyllej në odën tjetër...
Do ngrihej korrieri nga vatra
E pas do t'i binte çetës.

A s'mund tē ndodhте një vdekje e tillë?
Me gjakun tim tē përgjakja hënën,
Dhe ju tē shihnit tē mbillte trëndafilë
Mbi varrin tim nënën?...

PËRSËRI PËR TOKËN

Unë tokën si njerkë kurrë s'e kam parë,
Po e kam parë si nënë.
Dhe po të mundja hënën do kisha marrë
Dhe në gjoks si gjerdan do t'ia kisha vënë...

P E I Z A Z H

Në mes të rrugës,
Kur dielli rri në zenit,
Etja zvarriset nga shkrepat e gurët.
At'herë burimi vrapon, pengohet, shushurit
Dhe etjes udhën ia pret e ia shuan urët.
Unë qëndroj e në burim vë buzët e mia të trasha
E thëthij forcën e lëngut të tokës bujare
Dhe ndiej si kjo forcë e lashtë
Më vjen e më rend në damarë...

UOLLT UITMAN

Kur nxori Uitmani «Fijet e barit»,
Nju-Jorku heshti, heshten recenzentët;
Estetët mburrnin «lulet e beharit»
Që tundnin vithet nëpër kabaretë.

Për ta «Fijet e barit» ishin fije,
Që prishnin modë e gusto e etikë;
Po Uitmani për vete shkroi një vijë:
«Jam Uitmani i madh, o Amerikë!»

Estetët qeshën hidhur: «Eshtë i marrë!
I marri mburr pa turp veten e tija!»
Kjo ndodhi njëqind e ca vjet më parë:
Kush ish i marrë e zgjidhi historia.

LISI BLERON VONË

Blerojnë gjithë pemët e tjera në fusha e kreshta
Dhe në fund bleron lisi e vesh malë.
Pastaj ikën pranvera e vera e vjeshta,
Pemët zhvishen, po lisi zhvishet ngadalë.

Ai i shëmbëllen atij që dashuron vonë,
Po zjarrin e dashurisë e mban të ndezur si furre:
Dhe njerëzit tundin kokën e thonë:
I çuditshëm, s'u plak kurrë!

D I M R I

Dhe erdhi ai i pamposhturi i bardhë,
Tundi një herë krifat dhe zbardhi gjithçka,
Në pyje e në shpella i vuri qirinjtë në radhë,
Qirinjtë e akujt si këllëfë shpatash të mëdha...

E dielli i pakët shikon në anë të horizontit,
E miliarda drita të vogla dëbora nxjerr:
Eshtë flamuri i lavdisë së tij, i bukuri e i ftohti,
Që dimri në paradën madhore e merr.

I pamposhturi i bardhë tund me inat krifat
E na bën të kujtohem i pér zjarrin që e kemi harruar,
E pér palltot e mëdha e pér gunat siva,¹⁾
E pér gjithçka që harresa e ka mbuluar.

1) sivë = gri.

Dhe tund krifat e bardha mbi tavolinën time
Dhe më kujton një varg që kushedi pse përgjysmë e
 pata lënë,
Dhe miliarda thërrime, të ndritura thërrime
Shpërndan në tavolinë, në odë, në rrugë, në lëmë...

FUND DIMRI

Dhe forcat atij i shterën, i shterën,
Si një poeti që vjen me bujë e në udhë shter talentin;
Dhe krifat i tund, po krifat dëborë nuk nxjerrin,
Dhe zemérohet, po zemérmin udhët ia tretin.

Një tjetër më i fortë se ai zë tund krifat e kaltra,
Tund krifat e kaltra e ia gris flamurin madhor,
Flamurin e dëborës me të cilin dimri mburrej netëve
 të gjata.
Një tjetër! Është pranvera, që erën pret me kraharon...

Dhe fshin me krifat e saj dëborën,
Dëborën e dobësuar, dëborën zhele-zhele,
Dhe ngre në male e fusha dorën,
Dhe miliona kërcej shpojnë dheun me turjelë...

Dhe dimri krifarënë largohet i mërzitur,
Si ai poeti që humb talentin e s'i shkruajnë më artikuj
 lavdërimi,
Në rrugë del një poet me forcë të përtëritur,
Del një poet! Pranvera shkruan miliona libra gjelbërimi...

LEONARDO DA VINÇI

Kardinalët kerkuan fytyrat e madonës e të Krishtit
Në pikturat e mureve, në letër, në pëlburë,
Ku kish vrapuar peneli i Da Vinçit,
Kerkuan po s'i gjetën kurrë!

Da Vinçi s'mund të lodhte dorën në kufoma,
O kardinalë të marrë!
Ata që ju dukën juve si krishtër e madona
Ishin hamej, fshatarka e fshatarë...

V

NË PRANVERË

Gjithçka e larë nga shirat e nga dëbora e shkrirë
 Zien e gumëzhin e dëshiron e çmëndet.
 Pemës i ha trupi nga sythet e mbirë,
 Zogut i ha gjoksi nga pendët.

E kësaj nate përgatitet të dalë një kërcell mes plisave:
 Lëviz, përpiqet, zhurmon çdo qelizë
 E kërcellit nën fletët e hedhura të lisave,
 Nën drizat e thara në lajthizë...

E kësaj nate vajza pa gjumë kafshon jakën e fustanit.
 E gërshetat e gjatë pret me gërshërë;
 E mëzi i rritur këput hallkën e kapistallit
 E turfullon e lëshohet arave të mbjella me tërshërë.

C'është kështu? Pranvera puthi tokën e qiellin!
 Edhe një varg në vjershën e gjatë, edhe një varg
 Mbiu në tryezën tonë tok me kërcellin
 Dhe, i zhytur në ozonin e pranverës, u nis larg...

P J E K U R I A

Sa vjen aq më i rëndë bëhet vargu;
Rëndoijnë netët e pagjuma në qepalla
Dhe letra griset me bojën ende të lagur
Dhe në ndërgjegje shfaqet e fshihet fjala
Dhe ti vrapon pas saj dhe prapë gris letër...
Kështu avitet ndofta pjekuria
E rëndë, e ndershme, e vërtetë,
E ashpër nga pagjumësia...
Vjen i vështirë vargu, i vështirë,
Që lehtë pastaj t'u shkojë njerëzve
I ngarkuar me erën e metalit e të grurit të shirë,
I ngarkuar me erën e miliona djersëve...



B A B A L L A R È T

1.

Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni
Të hollë si kosore e jataganë;
Kutitë hapni e çibukët ndizni,
E gjunjët çlodhni,
baballarët tanë!
Ju shpien udhët në ara e qytete
Dhe s'prehi kurrë
e s'rri ni kurrë,
Po gjithnjë kërkon i nëpër jetë,
Godisni me çekan e mbillni grurë;
Dhe hapni libra e gazeta hapni
Dhe ulni mbi shkronja kokën;
Mendimin e shekujve mundohi ta kapni,
Mendimin e shekujve e mendimin e kohës.
Dhe shkronjat, të radhitura me mundim si duaj,
Për tokën e për ju tregojnë në letër
Shkruar nga moshatarët tuaj e nga bijtë tuaj,
Nga gjyshrit e stërgjyshrit e vjetër...

Dhe shqetësohi shpesh për punën tonë
 Tek kuvendoni parqeve,
 lëmenjve.

Të bardhat koka tundni e mendoni:
 «S'ua ha dot qeni shkopin qerratenjve!»
 Mendimi juaj zgjatet edhe zgjatet
 Nga kokrra e grurit
 gjer te qeveria;

Kapton luginat,
 fushat edhe shpatet,

Nga lëmi i fshatit
 gjer te gjithësia...

Qëndroni festebardhë e mjekëroshë
 Në brigjet, ku godet një lumë i lashtë,
 I lashtë, valegër e thinjosh,
 Më i lashtë

se me mijëra etër bashkë.

Dhe shihni si lag djersa jonë digën,
 Dhe shihni si bie djersa nëpër valët,
 Që fusnin në kasolle tmerr e frikë,
 Kur shfrynin si rrebesch me nëntë ballë.
 Dhe thoni më me ngadalë:

«Të rinj kur qemë
 Për mjeshtër grazhdesh njiheshim nga lumi,
 Po bijtë tanë grazhde-diga ngrenë,
 Që lumin, si në djep, ta zërë gjumi;
 Nga pisha nxirrnim dritën në ato mote,
 Nga uji nxjerrin dritën bijtë tanë!»
 Dhe rrini bregut veshur me kilota,
 Të hollë si kosore e jataganë.
 Në quell ngrini sytë tuaj të plakur
 Dhe shihni

vija-brazda reaktivësh,
 Që dridhen në agimin e përflakur

Dhe ju kujtojnë shkronjat arabishte...
E thoni me ngadalë:

«Të rind kur qemë
Në arabara hipnim e në qerre,
Po bijtë tanë poshtë e lënë dhenë
Dhe ngrihen sipër reve!
Ahore krahë kishim ne të zintë,
Po koha krahët na i kish prerë!»
Çibukët i përpinqi në shkëmbinjtë,
Duhan i fortë gurëve bie erë...

3.

Ju,

baballarë,

mendime tirrni, tirrni,

Ju,

baballarë,

natën s'keni gjumë,

Mendoni si ne vendin nikoqirim

E thoni:

«Bijtë kanë andralla shumë!»

Dhe vjen tek ju me vrap zhurm' e turbinave,

Vjen kollë e buldozerëve të hekurt,

Vjen gulç i mbytur i makinave,

Vjen erë e kallzave të pjekur...

4.

Kjo zhurmë e erë pa gjumë ju lë natën,
Se hapin tonë ndiqni,
rrini pranë;

Të bardhat koka tundni buzë vatrës:

«Të fortë dolën bijtë tanë!»

Eh,

baballarë,

kjo vatër ne na polli,

Këta thëngijj të kuq na mbajtën nxehëtë,

Ky lesh velenxash trupin na mbështolli,

Ky prag na nisi udhëve në jetë...

Në dejtë tanë gjaku juaj ecën

I nxehëtë,

si në motet tuaj ronorë,

Kur vriteshit me plumb për të vërtetën

Në brazda e në male me dëborë.

A s'ishit ju ata që me Selamnë

U derdhët kur rënkonte Vlora jonë,

Nga grykat zutë topat italianë,

Rräzuar me tre plumbë një balonë?

A s'ishit ju ata që me Bajramnë

E shndrruat në legjendë Dragobinë?

Me gjoks i pritet plumbat dhe murlanë,

Me plagë e mbartët udhëve rininë?...

5.

Ne shpesh

në faqe malesh,

nëpër gurë,

Zbulojmë ndonjë top të heshtur

Me rrota të coptuara,

të murme

Diku hendekut hedhur...

Dhe themi të mejtuar:

«Baballarët

I bënë të pushojnë këta topa,

Gatuar me çelik nga ustallarët,
Mësuar e stërvitur nga Evropa...»
Ne shpesh

mendohemi

nëpër muzera,
Tek shohim varur stendave të ndritshme
Naganti,

jataganë

e malihera,

Të vjetër e me marka të çuditshme
Dhe themi:

«Baballarët tanë i mbajtën,
Nga brezi nuk i hoqën kurrë
Dhe në llogore hasmëve u vajtën,
Kur s'patën plumba,

shtinë dhe me gurë!»

6.

Ne shpesh

mendojmë

e hidhemi në vite,
Kur ju mbi hasra edhe dru prej pishe
Ushtarët e revolucionit rritët,
Me thërrime buke e thërrime gjize.
Dhe ishim ne ata ushtarë — ëndrra,
Që hapnim sytë në odat murën xira,
Që binin erë qepë e erë mendra,
Që binin erë hudhër e kumpira...
Që hapnim sytë nën kabatë e lashta
Përcjellë nëpër fyell e gënetë
Nën trarë e çati me rrashtha,
Që ngritën me mundime pleqtë.
Nuk fjetëm në krevatë e në susta,

Siç flinin moshatarët tanë në botë,
Dhe nënënat mbi djepat e ngushta
S'na varën kuklla,
 po gjerdanë me lot.
Me drutë e pyllit bëtë djepat tanë
Dhe plumba nëpër drutë e pyllit gjetët.
Mbi plumba,
 futur në pelena,
 qamë,
Mbi plumba
 ne,
 fëmijët tuaj,
 fjetëm!...

7.

Kështu na bëtë burra,
 baballarë!
Ne qemë ushtarët e revolucionit,
Që me durim të fortë prej kopshtari,
Guximin çast në çast ju na mëkonit.
E thoshit:
 «Shtigje të mëdha do çajnë,
Të tjera nga të baballarëve!»
Dhe ikëm nga shtëpitë partizanë,
Dhe ikëm larg pas komisarëve.

8.K

Dhe morëm pas ëndrrat tuaja të mira,
Më të bukurat ëndrra shekullore
Për lirinë e për tokat e lira,

Për njeriun e për vatrat paqëtore;
Dhe i bashkuam me ëndrrën tonë të madhe,
Me ëndrrën që quhej komunizëm^λ
Ju kuvendonit në ara e livadhe
Dhe ju dukej kjo fjalë më e rëndë si qilizëm.
Po kur armiqëtë merrnin nëpër gojë
Dhe fyenin ëndrrën tonë të shtrenjtë,
Para saj ju vinit gjokset si dëbojë,
Si para altarit të shenjtë.

9.

Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni,
Të hollë si kosore e jataganë,
Kutitë nxirrni e çibukët ndizni,
Për bijtë mendjen vrisni,
Po ndodh që herë-herë ju prishet gjaku,
Kur ne ndonjë zakon të vjetër shkulim^λ,
Ju heshtni me çibukë te oxhaku
E kokat nëpër tym duhani ulni;
Mëri u mban i mbesave të bukura,
Gishtrinjtë e thatë tundni rrëptë,
Kur kthehen natën vonë faqeskuqura.
«Na bëkan dashuri me djemtë!»
Po kur ju del inati, lini mashat
Dhe mblidhi një nga një nëpër sofate,
Mendimet zgjatni larg

si brazdat,
Si shtigjet nëpër mal e monopate:
«Eh,
ka lezet zakoni,
Na ndoqi pas zakoni nëpër mote,
Si kjo kuti me pak duhan të butë,

Si ky çibuk me pak duhan tē fortë.
Kjo guna jonë ç'llohë e ç'shira hoqi!
Tē ndahesh nga zakoni

Ky djall çerep s'qenka lehtë,
Nën këtë saç tē tillë brumë poqi
tē rëndë
Po, e tē nxehëtë!...»
baballarë,

e keni tē vështirë
Tua vishni brrucën ligjeve tē reja!
Ro me zakonin s'ikte blozë e nxirë
Dhe s'ngrihej Azotiku

e Va-Deja!
Po me zakonin èndrra jonë e bukur,
Që ju e mbrojtët para bajonetës,
Nuk kthehej në turbinë
e në bukë,

Nuk bëhej jetë...
Ju vetë ligjin e përgjakur prishët
Që kur ne dolëm malit partizanë;
Ju vetë ligjin e hakmarrjes grisët
Kur bashkë ndiqnim laron dhe dushmanë...
Ashtu si heshti krisma e hakmarrjes,
Po heshtin pashkë e ramazanë...
Se rrugën tonë drita e ka larë,
Se baballarë e bij një zemër kanë...
»

10.

Mendimi juaj zgjatet

edhe zgjatet

Nga kokrra e grurit
gjер te qeveria,
Kapton luginat,
fushat edhe shpatet
Nga lëmi i fshatit
gjер te gjithësia...
Dhe pranë radios mendjen rrini vrisni:
«Si shkojnë baballarë e bij në botë?»
Në caqet,
ku i errët është agimi,
I ndan një akullnajë e ftohtë!
Bërtasin narkomanët:
«Etërit janë mykur,
Me ta në paqe ne,
modernët,
s'rrojmö, 1
Në pleqërinë e tyre janë zhytur
Dhe mes anakronizmave notojnë!»
Dhe poetucët vargje stisin,
vargje thurin
Dhe lëngje vargjesh derdhin mbi «të vjetrit»
Ndër kabaretë modë e «izma» mburrin,
Si setra demodë i flakin etërit!
E dini
cilët janë,
baballarë?
Ata sot hedhin tuist fytyrëflakë
E nesër vrasin vietnamezë në arë,
E nesër ngasin tanket nëpër Pragë!

11.

Ju,
baballarë,
keni djem të mirë,

Se ëndrrat i bashkuam në një ëndërr,
Se grurin tok e kemi shirë,
Ndaj njëri-tjetrin nuk e shohim vëngër
Dhe kur dikush, [këlysh mikroborgjezi,
Me petkun progresiv na vjen vërdallë
Dhe sherrin etër — bij kërkon të ndezë,
Ia shkulim dhëmbë
e dhëmballë.]

Dhe kur dikush
me pantallionat-tuba
Mundohet të ngërdheshet para jush
Në trotuar,
sikur të lozë rrumba,
Ne nxehemi e bëhem si prush!
Dhe kur dikush

ka turp me ju të rrijë
Në restorant a kafené a klub,
Ne me përbuzje sylë i vetëtijmë
Dhe ndofta mund të rrihem me grusht;
Kërkënd s'lejojmë ne me ju të tallet,
O baballarët tanë,
Se ju mbi shpina mbajtët tërë hallet
Dhe Shqipërisë i dolët zot

me jataganë!
Dhe gjithçka e bukur e bujare
U ngrit mbi supet tuaj hekur
Nga pesh' e kohës krrusur edhe vrarë,
Nën saç të kohës thekur...

12.

U plakët,
baballarët tanë,
u plakët!

Ndonjë prej jush mbyll sytë ndaj të gdhirë
Dhe pranë vatrës prushin lë dhe flakën,
Çibukun dhe duhanin e papirë...
Dhe ne lexojmë, ndër nekrologjité,
Rrethuar me korniza emrat tuaj
Dhe heshtim për një çast të trishtë
Mbi torno,
diga,

libra,

duaj...

I njohim mirë ata dy sy të urtë,
Mes katër vijave të zeza vënë,
Në një nekrologji të shkurtër,
Që këndin e gazetave ka zënë...
I njohim mirë!

Ashtu ju kemi parë
Në vratat e shtëpive partizane,
Kur bukën dyzet copë e kemi ndarë,
Kur njëzet vjetë hidhnik tre jorganë,
Kur vajin e fëmijëve të mitur
E digjnit në kutinë e vjetër,
Që oda të ish e pastër dhe e ndritur,
Që ne të shihnim sytë e njëri-tjetrit.
A s'ishit ju

që në nëntor shtëpinë
E hapët edhe çelësat na dhatë,
Dhe lindëm ne te vatrat juaj Partinë
Mbi një rrugoz e një minder të varfër?
A s'ishit ju që mbajtët Enver Hoxhën
Dhe rrobat bërë qull në mal ia thatë,
Opingat partizane, grisur shqotës,
Ia qepët kur rëndonte nata e gjatë,
Kur malet në stuhi e zulm gjëmonin
Marshimeve të dimrave mes borës,
Kur nën helmeta të egra e përgjonin
Banditët e Berlinit e të Romës?

A s'ishit ju që shtigjeve brigadat
I nxorët nëpër breshër e furtunë
Në grykat e përrenjve e në shpatet,
Kur shkrepat nëpër plumba bënин zhurmë?
A s'ishit ju që vinit nëpër burgje
Dhe zemër neve,

bijve tuaj,

na jepnit

Dhe iknit shpircoptuar nëpër muzgje
Dhe tundnit kokat:

«Djema,

mos u epni!»

A s'ishit ju që bijtë kur iu vranë,
Dyfeqet stërgjyshore hodhët krahut,
Në feste vutë yjet partizanë,
Përgjysmë latë brazdën edhe vrahun?...
Ju njohim mirë:

Ashtu ju kemi parë
Të dashur,

kur ne zbrisnim në lugina,
Dhe ju na përqafonit,
baballarë,
Dhe xhepet na i mbushnit me mollçina...

13.

Dhe ne u bëmë baballarë,

baballarë!

Dhe gjaku, i përcjellë nga epoka
Te bijtë, le të rrjedhë në damarë,
Që pulsin si çekan ta ndiej toka!
E tillë qenkajeta:

valë-valë

Në dhenë e lashtë baballarët vijnë

Me një mendim të brezave
në ballë,
Si lapidar i bardhë në kodrinë.
Dhe ne na shqetësojnë bijtë tanë
Dhe shpesh për ta mendimet na trazojnë,
Se shekulli ka diell e tramundanë
Dhe s'është karamale koha jonë.
Në veshët tanë plumbat vërvënë
Ndaj erën e barutit,
përmes shkrepave,
Ne dimë ta nuhasim e ta ndjejmë
Në largësinë e treqind kilometrave:
Nga lartësi e majave alpine,
Ku bora s'e zhvesh gunën kurrë,
Gjer poshtë Konispolit në lugine,
Ku krahët portokalli tund mbi grurë...
Dhe bijve tanë u themi ashpër:
«Kërkoni,
bij,
e ndeshuni në jetë
Dhe çani rrugë të mëdha
shpirtpastër,
Siç çanë baballarët tuaj të rreptë,
Dhe mos harroni kurrë baballarët,
Që maleve të ritë e tyre lanë,
Që qenë në revolucion ushtarë
Dhe erdhën me fitore në Tiranë...»
Paçka se ndonjëherë shajmë rëndë
Dikë nga bijtë tanë çamarokë,
Ata me muskuj dhe me mendje
Më lart se etërit do ta ngrënë këtë tokë,
Se dheu i saj dhe uji i saj i kaltë,
Nën qiejt që gjëmojnë e ndrisin,
Nga vatra gjer në vatër
Veç brezë burrërorë
rrisin...

U plakët,
 baballarët tanë,
 u plakët,
 I mbushët xhepe e torba plot me vite.
 I përcëlluat gunat nëpër flakët,
 I grisët tallaganet në syngjitet
 Dhe mbetët gjithnjë të hijshëm,
 Bujarë e të çiltër si furtuna,
 Me ballë të brazduar nga mendimet,
 Me duar të lëruara nga puna.
 Dhe shkojnë motet,
 bën të sajën koha,
 Ju plaki edhe kërrusi si kosorë,
 Po para nesh ju ngrihi si epoka,
 Fisnikë,
 madhështorë!...

Prill 1969

REBELIMI I PARË

1.

Kështu e mbaj mend babanë e teqesë:
Mjekra e bardhë e sarëku jeshil,
Tespihet sedefi e postja e zezë,
Maçoku i murmë e kali cil.
E thosha me vete:

ngat qiejt ka zbritur,
Hipur në posten me qime të gjata
Tok me maçokun me sy të ndritur,
Tok me kalin me vithe të larta...
Dhe dridhmat më dridhnin kur dilte në arë.
Parmendën gjyshi linte plot temena,
Ulej në brazdë në gjunjët e vrarë:
Hejvallah,
hejvallah,
hejvallah!

2.

Dhe mua më shtynte: shko puthi dorën,
Se nxehet babai e gruri s'na piqet,

Se nxehet babai e kokërr nuk korrim,
Se nxehet babai e plevica na digjet!
Qetë shikonin me sy të xhamtë,
Qetë brirët tundnin e shfrynin,
Miza në vithe i hante,
Plisat me këmbë i shtypnin.
Dhe unë me vrap në brazdë pengohesha
Gjersa t'ia puthja dorën babait,
Me hundë në plisa rrëzohesha:
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

3.

E natën në ëndërr e shihja babanë e teqesë:
Mjekrën e bardhë e tërhiqte zvarë,
Me mjekër fshinte posten e zezë,
Dhe bënte duva të digjej gruri në arë...
Bërtisja me zë të lartë në gjumë:
Mos ia digj grurin gjyshit, baba,
Gjyshi u lodh për grurin shumë,
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

4.

Mëngjesit merrja manarin në arë
E shkoja me gjyshin me qé,
E gjyshi thoshte:
 rrite manarë

Ta bëjmë kurban në teqe,
Që ëndërra të liga mos shohësh kurrë,
Që tymi të shkojë la e më la,
Që mollë të mbledhësh e të korrësh grurë,
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

5.

Po ç'ndodhi një ditë me mua, vallë,
Kur nallban Azizi mbathte kalin cil,
Kalin cil me fre e me shalë,
Kalin cil të babait jeshil?
Nallbani cilin e shante në farkë
Tek ndreqte gozhdën me darën e zezë:
— Të rëntë qimja po s'bëre një bajgë
Në taç të babait, në prag të teqesë!
Unë rrija e heshtja në derë,
Fjalët e rënda godisnin në kokë,
Fjalët e rënda si shi me potere
Që bie e hap gropë në tokë...
Oi, kovaç Azizi shan babanë,
Oi, do mbetet pa sy e pa krah,
Oi, babai do t'i djegë shtëpi e kovaçanë,
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

6.

Dhe prisja e prisja të digjej farka,
Të digjej farka e kovaçit Aziz,
Të ngrihej e kuqe në qiell flaka,

Të nxinte tymi si plis...
Po flakën s'e pa kovaçana,
Se flakë nuk doli,
 se tym nuk doli;
Kovaç Azizi nëmte babanë:
Derr Anadolli,
 surrat Anadolli!

7.

Dhe shkova prapë te kovaçi i madh Aziz:
— Kovaç Azizi,
 pse shan babanë?
— Dëgjo kovaç Azizin

 babai është gjemb në murriz,
Babai gënjen fshanë!...
Babai na ka marrë arat e lisat e gjatë,
Babai na ka marrë mullinjtë,
Babai gënjen gratë
Dhe dorën u fut në gjinjtë...
Ç'hotë kovaç Azizi llafeturpi?
Ç'hotë kovaç Azizi për babanë?
Dridhma ma dridhte si shufër trupin
Dhe rrija i heshtur mënjanë...
Ç'hotë kovaç Azizi për qiellin,
Për qiellin nga zbrite, baba Fetah?
Për ty që dorën e shtrin e zë diellin?
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

8.

— Nënë, mos shko në teqe te jeshili,
Mos hyr nga porta e avllisë,

Babai ka zbritur nga çili
Me sy tē kuq prej rakisë.
Nënë, babai na ka marrë arat e lisat e gjatë,
Nënë, babai na ka marrë mullinjtë,
Nënë, babai gënjen gratë
Dhe dorën u fut në gjinjtë!...
— E zeza djalit i bënë magji!
Të puthsha tabanë, baba Fetah,
Sl:kruaj një nuskë, një hajmali,
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

9.

Dhe rrinte teqeja e heshtur në kodër,
Këndonin gazele rreth saj qiparisët,
Dhe shtypnin grurë në mokër
Dervishët...
Dhe këmbët lëviznin nën dollomatë,
Dhe mjekrat tundnin nën hundët,
Dhe djersët binin në mokrën e thatë,
Dhe shtypej kokrra e ndaheshin krundet...
Dhe goja u hapej,
 u flihej
 u flihej:
— Na hapet goja!
 Mëka'ë!
 Të puthshim tabanë!...

Vinte nata,
 nata do gdhihej
Mbi hashurenë, që mbushte kazanë.
Në mjegull lëkundej kube e teqesë,
Me mjekra në qiell qëndronin qiparisët,

Era fshinte barin me fshesë
Dhe shtynin me këmbë dollomatë dervishët...
Dhe dilte babai me tespihe në dorë;
— Hashure me stafidhe,

hashure me arra,
Hashure sa për katër taborë,
Hashure
dhe çanakët përpara...
Hashure,

hashure,

të ziejë kazani,
Ju — dervishë, unë — baba,
Këndoni të vijë në qejf mejdani,
Këndoni një kasida!...

Dhe kënduan dervishët një kasida:
«Fetah-ullâh, qesh!

Jam yt habesh, qesh!

Jam yt gulam, qesh!

Kabullo sun fetva...»

Qëndronte lisi në ledh si shandan

Dhe dashi i binte me brirë

Dhe priste të bëhej kurban

Në prag të teqesë pa gdhire.

Dhe tundnin kokat andej bektashinjtë

Dhe lutje i bënин teqesë

Dhe merrnin avdes dhe cirrnin turinjtë,

Se zbriste nga qielli nata e hashuresë...

Dhe hapej gazeli nga kodra në kodër,

Dhe hapej gazeli nga vrahу në vrah;

Dervishët kërcenin e shtypnin në mokër,

Hejvallah,

hejvallah,

hejvallah!
Dhe mua më dilte në mendje kovaçi,

Kasida — himn fetar

Kovaçi në farkën me flakë,
Që çilit i thoshte i nxeh të si saçı:
— Në prag të teqesë të hedhësh një bajgë!...

10.

Oi, ditën e hashuresë, oi ditën e hashuresë,
Oi, unë e nëna e gjyshi,
Oi, lidhëm manarin t'ia shpinim teqesë,
Oi, mishin ta hante babai e kockat këlyshi!
— Nënë, mos rri pas babait në poste,
Nënë, dëgjo këtë radhë,
Babai ka pirë raki të fortë,
Babai të trazon me mjekrën e bardhë!...
— E mjera, djalin mendë e lanë,
E mjera, ç'dëgjova, estakfurullah!
Baba Fetah, të puthsha tabanë,
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

11.

Në zverk të manari ndriti një thikë!
Mishin babai, kockat këlyshi,
Dhe mua më shkuan dy lot në qerpikë;
U vrenjt si mjegulla gjyshi!
— A, të ardhka keq për manarë,
A. s'dashke ta bëjmë kurban,
A, dashkë që gruri të digjet në arë,
A. dashke që gjyshi mos ketë tavan...
Babai matanë me nënën fliste.

Afronte gjurin te gjuri i saj në posten e zezë,
 Dhe dorën nënës ia ngiste
 Dhe heshtte tavan i teqesë...
 Gjaku si gjëmbi më shpoi në aortë:
 — Mjekër, dorën e nënës lëre!...
 Gjaku me grusht më hodhi në portë,
 Ika... dhe lashë prapa potere...
 Ika... dhe lashë prapa duvatë,
 Ika dhe ndjeva prapa... gjynah!
 Ika dhe ndjeva prapa shamatë:
 Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

12.

Dhe erdhi babai përsëri me kalë,
 Gjyshi në ugar i trembur foli:
 — Shko, puthi dorën,
 djalë!
 Unë vec murmurita:
 — Surrat Anadolli! —
 Gjyshi u zbeh si dylli i kosheres së bletës,
 Gjyshit fytyra iu prish...
 Në brazdën e ngrohtë foli me vete:
 — Kovaçi Aziz kovaçi Aziz!... —
 Mori hostenë,
 u hoq mënjanë,
 Kapi kaun për briri e tha:
 — Dëgjove, kazil?
 Hejvallah, E shanë babanë!
 hejvallah,
 hejvallah!

Eh, rebelimi i arë ndaj zotit
E nxehu gjyshir e shkretë...
Kjo ndodhi qëmotit
Në brazdat e arës tek ngisnim qetë...
Aherë dhe nënën përfshiu rebelimi
Dhe mbajti me mua një krah,
Dhe s'foli më fjalë trishtimi:
Hejvallah,
 hejvallah,
 hejvallah!

TOKA IME, KËNGA IME

1.

Tokë e dashur,
Ka tridhjetepesë vjet që diçka ke kërkuar nga unë,
Tridhjetepesë vjet,
Që kur kam hedhur të parët hapa.
Kur bija mbi ty e vrisja duar e gjunjë,
Ti thoshe:
S'ka gjë, bir, vritu e mos u kthe prapa!
E kam ndier këtë nga avulli yt i ngrohtë,
Nga era jote,
Që përgjërohet e dehet bujku me gunë,
Ai bujk i menduar,
Që i dhimbset çdo brazdë e gropë!
Ç'bëra unë pér ty?
Lërova,
Mbolla e korra
E shumë u mundova të të krihja me krehër fisnikërie:
Me duart e mia të vrava rrënjet e liga t'i nxora
E thitha nga ti avuj dashurie.
Edhe kur më mërzitnin plugu, parmenda,

S'të shava, se ati im, pastë ndjesë,
Kurrë s'të shante e kurrë s'të thoshte fjalë të rënda,
Po ulej në gjunjë,
Të puthte, i mbytur në djersë.
S'të shava, se nëna ime veç ty të besonte:
I falej kokrrës së grurit,
Kokrrës së vogël me vijë në mes,
E para saj duva e lutje, e shkreta, këndonte,
E para saj merrte avdes.
Po unë,
I ulur në arë në mbrëmjet e gjata,
Tim eti i thosha, që heshtte me opinga me dhe,
Që heshtte mbi plisat e thatë:
— Toka, baba, diçka kërkon nga ne...
Im atë kokën e thinjur e tundte e thoshte ngadalë:
— Kërkon!
E buajt shikonin babanë me sytë e xhamtë:
— Kërkon!
E lumi i binte shkëmbit të rrudhur me valë:
— Kërkon!
E zogu i mbrëmjes këndonte në plepin e lartë:
— Kërkon!

2.

Tokë e dashur,
Të lashë ca vjet me dëshirën tënde djerrë,
Se më thirri revolucioni im e Partia ime;
Aherë m'i pe në brez nagantin e maliherë
E zogjtë urdhërove të më përcillnin me cicërimë.
Aherë urdhërove barin e fletët e drurëve,
Aherë urdhërove lumenjtë e burimet,
Që mban në deje,
Të dilnin e birin tënd ta përcillnin udhëve

È t'i thoshin:

— Vëllaçko,

Hap sytë, se toka kërkon prej teje! —

Pér një çast, me maliher në dorë me syngji të mprehtë,
Besova në zërin tënd aq të dashur,

Në zërin që e ndjeva në lumë e bar e fletë,

Dhe buzë udhës u ula në shkëmbin e plasur!

«E di, tokë e dashur, diçka ti kërkon nga unë!»

Shtriheshe ti para meje,

E ardhur si buka e grurit në verë,

Si buka e grurit,

Kur nëna e nxirrte nga magjja,

Si buka e grurit

Me avull e erë

Në çastin kur mbretëron qetësia e paqja.

Rrija e mendimet, si zogjtë mëngjeseve, bridhnin.

E djersët i fshija me mëngë në shkëmbin e plasur,

E djersët prapë në tokën e vakët rridhnin

E thosha me vete:

«Kërkon nga unë aq shumë, o tokë e dashur!»

Dhe ti i kuptoje mendimet e mia,

Pérndryshe s'kishte përsë të më nisje aq larg;

Dhe ti e kuptoje se unë isha një grusht me shkëndija,

Një grusht me shkëndija i zjarrit tënd të madh...

3.

Unë ecja me nagant në brez në barin e njomë
E ty të dëgjoja i kredhur krejt në mendime:
Të kemi pér të mbajtur në pëllëmbët e fisnikërisë sonë,
Si bukën e ngrohtë, o toka ime!
E plumbit nazist ti lisa i nxore përpara,
E plumbin nazist e prite me shkrepë e gurë
Dhe mua më mbrojte, që prapë të vija në ara,

Që djerrë mos mbeteshe e bar, të lig mos zije kurrë.
Atyre që ranë ti s'kishe ç't'u bëje, o tokë.
Megjithëse iu vure malet e tua si prita batare,
Armiku kish përgatitur një milion plumbë vec për një
kokë,
Një milion plumbë vec për një zemër shqiptare.
A nuk të kujtohet,
Si njëri nga një milion plumbat e nxehthë,
E ndoqi atë që vinte pas meje në shteg të një mali,
Atë që ngiste në brazdat e tua qetë,
Dhe zemrën ia gjeti,
Dhe frymën ia ndali.
Ne ecëm me të me kapelë ushtare,
Me yje pesëcepash të zjarrtë.
Me trakin e parë të Partisë Komuniste Shqiptare,
Me «Kapitalin» e Marksit në trastë.
Kur sytë po mbyllte, lëvizi ngadalë buzët
E në agoninë e mëngjesit tha:
«Ne jemi bujq e si bujk dëgjo vec një muzë,
Dëgjo muzën e tokës së njomë, vëlla!»
Me dorën tënde, o tokë, pishat ule mbi trupin e tij
Dhe gjirin e hape e nxore një luleshqerrë
Pranë ftyrës së zbehtë të djalit të ri,
Pranë syve të mbyllur e ballit të çjerrë.
A nuk të kujtohet,
Si ra komisari im nën një lis?
Dhe çantën ia grisi një copë e hekurt e huaj,
Në çantë komisari listën e komunistëve kish,
Në listë dhe emri im ish shënuar...
Dhe lista e bardhë, nga gjaku, u bë lulëkuqe.
Drutë e tua mblodha e ndeza një zjarr në lajthishtë
E letrën e thava,
Po letra mbeti e kuqe,
Dhe emrat tanë mbetën të kuq në listat e Partisë!

4.

Tokë e dashur,
Unë s'mund të të lija djerrë.
Dhe në ika me revolucionin mes shiut e dëborës,
Dhe në ndërrova ca vite parmendën me maliherë,
E bëra këtë që ty të të mbaja pastaj në pëllëmbën e dorës.
A nuk e pe,
Se ç'bëmë ne të revolucionit ushtarë,
Kur u kthyem që brazda të reja të hapnim?
Ne morëm në duart tonë me plagë litarë,
Që gjoksin tënd mbetur djerrë ta masnim.
Të matëm si terziu i mirë për të prerë kostum,
Dhe hoqëm nga supet e tua zhelin e vdekur,
Hoqëm bejlurçinat e pronarët e tu,
Hoqëm turpin e mbetur në shekuj...
E çfarë s'kam bërë për ty, tokë e dashur!
Një nga miliona plumbat mund të më zinte,
Një nga pronarët, kur masja me litarin e argasur
Mund të më ngulte majën e thikës pas shpine...
A nuk të kujtohet,
Si ra sekretari i partisë,
Kur hiqte litarin në fundin e arës?
I fshehur hendekut, mes kullumbrisë,
Ia futi në shpatull hanxharin armiku i klasës.
Litari prej kërpi, që rrite ti vetë,
Mbeti i shtrënguar në gishtat e mbyllur të sekretarit...
Ti lumit i the të zbriste i qetë,
Që sekretari të flinte përjetë mes barit...

5.

E çfarë s'kam bërë për ty, tokë e dashur?
Unë shkrepat i shtyva në këmbët e malit me supa.

— Shtyhuni pak, or byrazerë!, — u thashë —
E hapni udhën të kalojë buka! —
Unë mora me grushte ujë në lumë
E vadita hardhinë të mbante bistakun.
Nën fletët e saj kutruve solla e gunë
Dhe natën e shtrova jatakun.
E mbajta për çdo rast maliherin pranë
Dhe vezmen e mbushur nën kokë.
Se s'dua të merresh nëpër këmbë prapë,
Të mbetesh djerrë, o tokë!
Vetëm ai, që ka thithur avuj ugari,
Kupton se ç'do të thotë djerrë!
Djerrë do thotë trishtim fshatari,
Trishtim që zvarriset ferrë më ferrë...
Që ti të mos mbetesh shterpë kurrë,
Unë kallot i kam sa një kokërr arre në gishta,
Unë ngarkohem në shpinë me gurë,
Unë lëroj dhe zallishta...
Që ti të mos mbetesh djerrë në jetë,
Unë bëj dashuri e gruaja ime pjell fëmijë;
Se djerrë do të thotë: mëngjes e mbrëmje mos ketë,
Mos ndritë asnë shkëndijë...

6.

Tokë e dashur,
Kam takuar, tek dorën mbushja me grurë,
Atë që e shihja në çdo kokërr fare,
Atë që e shihja kur ulja kryet të pijë ujë në gurrë,
Atë që e shihja në çdo pikë vese kur kositja barë.
E u drodha.
Gjoksi i saj çante këmishën
E me aromë mbushte ugarin e mbjellë...
E mbeta me dorën e mbushur me grurë e mendtë m'u

prishën:

Ish koha kur hidhej fara në arën e lëruar thellë.
Dhe e desha atë si fshatari arën me grurë,
Dhe mendoja për të si fshatari për arën me grurë;
U rraha për të në mbrëmjet e errëta
Me njerëz të ligj në shtigje e rrugë të pjerrëta.
Dhe kisha frikë se ndofta dikush më i mirë se unë
I shfaqej në gjumë...
Se unë për gruan e tokën
Lë kokën.
E kam kërkuar ngaherë dashurinë tokësore.
Më të bukura se madonat e muzeve
Kanë qenë për mua vajzat e gratë arbërore,
Që tok me mua u kanë dhënë ujë kuajve e qeve,
Që tok me mua kanë ecur në pllaja e shpate
Me vezme në brez e malipher në krah,
Që tok me mua kanë prashitur me shatë
Dhe grurë kanë hedhur në vrah.
Unë kam qenë ndër galeri botërore arti,
Po madona si tonat s'kam parë!
Ndaj në këngë kam kënduar për gratë,
Kam kënduar në lëmë,
Kam kënduar në arë...

7.

Tokë e dashur,
Dua të di, të marr vesh, të gjej në ty veten.
Sa herë futem thellësive të tua, aq më e vështirë më
Dikur nga trupi yt njihja vetëm një copë të vogël të qetë. dukesh.
Ëndërra ime penda e qeve ishte e një kasolle bujqish.
E bridhte kjo ëndërr livadh më livadh,
E bridhte kjo ëndërr në fletët e misrit e grurit,
Selishtave të kaltra, mbështjellë me gardh,

Atje ku binte nga shpati cefla e gurit.
Atje ku vërsnikja ime mbushte kënaçet,
Që binin erë dëllinjë e pishë;
Atje ku uji spërkaste në bar manushaqet
Dhe cirrej në gjethe një grifshë...
Po që atëherë, kur komisari shënoi emrin tim në listë,
Nën muret e strungës së braktisur të barinjve,
Ku mblidhej celula e Partisë Komuniste,
E ndjeva se vetëm një grimëz të njihja..
E dole ti enigmë para meje:
Lumturia ime e fatkeqësia ime;
Lumenjtë e tu nuk ishin lumenj, po gjaku im në deje
Burimet e tua ishin lotët e mi e s'ishin burime.
E ndjeva:
Viheshin majë për majë hanxhari e bajoneta:
Për ty.
E ndjeva.
E linte burri gruan në vatrën e lashtë:
Për ty.
E ndjeva:
Shpërthente mes shokësh të ngushtë urrejtja:
Për ty.
E ndjeva:
Digjej streha e mbeteshin kërthinqjtë jashtë:
Për ty.
E kujt do ishe? Cili do kishte të drejtë të të lante me
djersë?
Ne komunistët thamë: jona!
Dhe të ndritëm me fenerët e shpresës,
Dhe të puthëm në faqet e njoma...
Çerek i shekullit që atëherë uturiu në rrudhat e tua.
Sërish e sërish unë futem ndër këto rrudha.
Feneri i shpresës kurrë s'm'u shua.
E ashpër ish udha,
E largët ish udha...
E prapë dua të di të zbuloj thellësitë.

Nëse në fillim mund të shoh një kore, një pllajë,
Çapitem më tutje e ndiej bukuritë
Përherë të reja,
Nga maja në majë...

8.

Tokë e dashur,
E sheh edhe ti që s'jam aq i qetë.
Nga dita në ditë zihem pér ty, pérpiqem e vuaj,
Zihem me veten time të shkretë,
Zihem me shokun, kur brumin tënd nuk di ta gatuajë.
Dhe ta dish, kush farën e huaj, që mban emrin frikë,
Ugareve e pyjeve të tua shpérndan,
Grushti im, që vetë ma ke lënë si prikë,
E fut dy pashë në dhe e ti e përlan...
Se unë kam mbirë
Si smagu i grurit në brazdat e tua,
Dhe s'dua që mendimi i lig të të hajë si erozion,
Se erozioni pér ty është si skleroza pér mua,
Që blerimin e vyshk
E brinjët zbulon...

9.

Tokë e dashur,
Ti diçka ke kërkuar nga unë:
«Ndryshomë, o biri im!», — më ke thirrur nga grykat e maleve.
E gërxhe përbysa e ngrita diga në lumë
E i vura plugjet zalleve...
E me duart e mia nga ti i drejtova rrezet e rruzullit
diellor,

Të kesh më shumë blerim e të kesh më shumë dritë,
Të mbetet balli yt pérherë rinor,
Të mbetet gjoksi yt pérherë i florinjtë.
A s'isha unë ai që erdha kongreseve të Partisë
Me kokrra gruri në xhepe,
Me këpucë me dherin tënd,
E fola pér ty me zërin tim të fuqishëm,
E fola pér ty kuvend më kuvend?...
E mora vendimet e Partisë me vete,
E krahët përvesha, o toka ime, o kënga ime!
E zogjtë më ndoqën në fole e gjethe
E kokërrzat e dheut u mbushën plot ligjërimë.

10.

Tokë e dashur,
Më ra shorti i bujkut e shorti i poetit:
Lëroj arë me plug e lëroj kartë me pendë,
I hap udhë hardhisë e udhë bereqetit,
I hap udhë vargut e udhë poezisë tënde;
E s'e ndava plugun, pendën e malipherë,
Po brodha me ta nga caku në cak
Dhe gati kam qenë pérherë
Të vadit kërcellin e grurit me djersë e gjak.
...Ndaj kur sytë të mbyll diku në ndonjë brazdë,
Do doja të më mbështillje me qilimat e kaltër të tu
E të merrje me fyell një kaba të lashtë,
E t'u thoshe udhëtarëve:
«Fle biri im këtu!
Fle këngëtari i ugarit,
I brazdave dhe zogjve!...».

Mars, 1967.

BALLADË E ASHPËR

1.

Dajret bien dhe pëlçet gërneta,
Sofra nga raki e rrushit laget,
Vajzë e xha Agushit me gërsheta,
Ç'ia lëndove djalërisë plagët!
Ç'ndodhi vallë,

ku të gjetën mblesët?
Javën që të priste Rrogózhina?
A më thuaj, pa një vajzë, nesër,
Si do ecë rrugëve makina?
A më thuaj, si do rrish në mushkë
Me duvak mes shtigjeve të liga,
Ndjekur pas nga krushq edhe nga krushka
Nëpër driza,
lisa e boriga?...

2.

Dajret bien,
shtrembërohen mjekrat,

Shishja gurgullon,
kërcet filxhani
Dhe dasmorëve iu shkrihen eshtrat
Nga rakia,
nga farmak-kazani!
Plakat në odën tjetër janë mbledhur
Dhe kërcet gérshëra në gérsheta.
Shuk në dysheme t'i kanë hedhur,
Shuk në dysheme t'i kanë shkelur!

3.

Po për cilin të stolisin,
vallë,
Me gérshërë,
me këna
e bojë,
Me të kuq e me «flori» në ballë,
Me këpucë e me fustan të hollë?
Çmund të thuash,
vajzë e xha Agushit,
Dhëndrin tënd ti kurrë s'e ke parë!
Derdhu sofrës ti raki e rrushit,
Plas në vend gënetë e palarë!

4.

Ej, pa ty s'e nisim ne makinën,
Nuk të lëmë shtigjeve të liga,
Krushqit do t'i ndalim kur të vijnë
Gérxheve me lisa e boriga,
Edhe unë me të rintjtë e fshatit

Prapë me botën tënde do të rrrosh...
Vallë kot i ndalëm ne lumenjtë
Dhe i ndrydhëm valët nëpër llamba,
Me oxhak betoni shpuam qiejtë
Edhe varfërinë e lamë prapa?

6.

Mbushi odën mjegull e rakisë,
Sazexhiut të shkretë i mpihen buzët...
Ç'e zhubros fustanë e nusërisë,
Vajza më e bukur e Agushit?
Era bredh në gryka e rrëpira,
Këngët tonë tok me erën ziejnë,
Krushqit pranë sofrës janë pirë,
Krushqit herë zgjohen,

herë flenë...

Ne e dimë,

s'mund të rrish në kullë,
Kënga jonë hyn nëpër dritaret,
Të thërret të vish në hekurudhë,
Të thërret sirena në binarët.
Hesh ti, dajre,

hesht dhe ti,

Derdhu mjekrave, gërnetë,

Rrotull mos u sill, raki e rrushit,

Eshtë jona çupë e xha Agushit... dolli e nxeh të:

Nga libri
“FJALA GDHËND
GURIN,”
1977



MALLI I PARË

*O ti që largohesh nga vatra e parë,
E di se vatra ndez mallë dhe zjarrë?*

Në bulevard qëndroj një çast i heshtur
Përballë apartamentit tim të vjetër.
Dritaret anembanë janë ndezur,
Atje ku sot i lumtur rron një tjetër.

Ngatjeta, byrazer, i them më vete
Nga larg duke shikuar në dritare.
Nga pemë e trotuarit vjen një fletë
Dhe bie në jakën time me kollare.

Sa vjet jetova qetë dhe me zhurmë
Këtu ku janë ndezur sonte dritat!
Poema e artikuj shkrova shumë
Dhe dasmë bëra dhe fëmijë rrita!

Pa gjumë gdhiva netët herë-herë,
Menduar mbi fletore e mbi libër
Dhe prita miq, kur ndalën te kjo derë,
Dhe prita miq pa lodhje dhe pa qibër.

Dhe ç'pata shkruar e lexonin miqtë
Të urtë, shamatorë, kokëshkretë...
Gëzoheshin, thartonin dhe turinjtë
Dhe thoshin: «presim vargun e vërtetë»!

Dhe kushedi sa herë mora rrugët
Me ta në gjithë Shqipërinë time!
Në djall kuzhina, pjatat, kupat, lugët,
Ta gjejmë vargun tok në udhëtime!

Po përsëri me libra dhe fletore
Te ky apartament i vogël vinja
Me pantallona mbushur plot me rrodhe,
Me flokët mbushur hala nga dëllinja...

Në bulevard qëndroj e ndez cigarë
Përballë apartamentit tim të vjetër.
Nga xhami i ndezur ndizet malli i parë,
Që s'transferohet në shtëpinë tjetër.

1976

PLEQTË E QYTETIT TIM

Dhe ndodhet në qytetin tim të lashtë
Një kafene e vogël nën një rrap.
Atje karriget verës rrinë jashtë
Dhe rrapi mbi karriget degët hap.

Mëngjeseve pa dalë dielli mirë,
Kur deg' e rrapit zë e fërfërin,
Fillojnë e mblidhen, kafe për të pirë,
Të bardhët pleq që mburr qyteti im.

Dhe ndihet tavolinës ndonjë kollë
Dhe rrokulliset fjala si një gur:
«Ky rrap ka qenë at'herë pak më i hollë,
Po ndofta dhe ka mbetur si dikur!

Këtej Çerçizi zbriti tatëpjetë,
Pas portave të vjetra me qemer
Pastaj në Mashkullorë vau nja tetë,
Pastaj bimbashi ra në gjak pa nder...»

Dhe përsëri bie heshtja tavolinës
Dhe rrapi plak, më plaku se çdo plak,
Ia merr si këngë malli fërfërimës
Dhe fërfërima zbret nëpër sokak.

Troket në gur një shkop me fund të ngrënë,
Vërtitet ndonjë fjalë mbi filxhan:
«Ne bashkë me Selamin kemi qënë
Në qafën e Koçiut në istikam.

Në tela gunë e murme shkoi e vate,
E lashë si kujtim atje mbi gjëmb.
Kam marrë dhe një plagë asaj nate
Dhe plaga kur bie shi akoma dhemb».

Dhe zë kërcet kurrizi në karrike,
Në tavolinë shuhet një çibuk;
Dhe kulm' i kafenesë si kaike
Mes degëve të rrapit humb në muzg.

«Kur ra Bajrami thellë Dragobisë
Ne ishim me Fan Nolin në arrati,
Dhe thirri: «Trim tribun i vegjëlisë»,
Dhe lotët i pikuan në pëqi».

Frym era sipër rrapit nëpër degët
Dhe pleqtë ulin kokat mbi një bllok,
Dhe duken të menduar si strategët,
Me supe të bashkuar shok me shok:

«Këto i kam shënuar atë ditë
Në batalionin tonë partizan,
Asim Zeneli tankut i zu pritë
Dhe mbeti i pamort në Mezhgoran!»

Këtu me Muço Matohitin dolëm,
Fotografi në malet mbi Përmet;
Eh, vitet si burimi rrodhën, rrodhën,
Po Muçojë me mua prapë flet...»

Dhe rrapi krahët ul mbi tavolinë,
Dëgjon se ç'thonë pleqtë e kokën tund,
Dhe fjalët dalngadalë si fërfërimë
I merr e nëpër degët i përkund.

Ai qëndron i gjelbër dhe i heshtur,
Mban vesh çdo kuvëndim e çdo rrëfim;
Dhe monument i madh ka për të mbetur
Për nder të pleqve të qytetit tim...»

1977

L E J L E K U

Më vjen në mendje një shtëpi
Nën mal mbi lumin me lajthi.

Një plep i vjetër ish në breg,
Ku kishte çerdhen një lejlek.

Askush folenë s'e mban mend
Që kur në plep kish zënë vend.

Po dihet veç një gjë në fshat
Që plepi tok me të u zgjat.

Në sup e mori qysh i ri,
E solli gjer në pleqëri.

Sa gjenerata krra-krra-krra
U hodhën plepit krah më krah,

U plakën, lindën, ikën larg,
Po s'e harruan atë prag!

Paçska se shkuan në mërgim,
Sërishmi erdhën fluturim...

Dhe mars për mars dhe mot për mot
I bënë çerdhes një remont.

Remont, remont e zogj e zogj,
Sa herë fleta u përpoq!...

Më vjen në mendje një shtëpi
Me mollë, dardhë dhe avlli.

Dhe s'e harroj dot atë plep,
Ku kishte çerdhen një lejlek.

Stërnip i tij akoma vjen;
Stërnip, ngjatjeta po të them!

Do pleqërojmë ti dhe unë.
Si ne do lindin shumë e shumë...

1976

J E T A

*Jam i gjallë e jam ndë jetë,
Jam në dritë të vërtetë.*

Naim Frashëri

Njeriu jeton, krijon, lufton çdo ditë
Dhe vjen një çast dhe sytë mbyll përjetë.
Këtë me kohë e dimë që të gjithë
Dhe s'vihet në dyshim kjo e vërtetë.

Po unë kur të futesha në tokë,
Kur njerëzit të mblidheshin në dhomë,
Do desha të mendonin miq e shokë:
— Ka shkuar me shërbim dhe vjen më vonë...

1977

BABANË TËND E KISHA SHOK...

Babanë tënd e kisha shok të ngushtë,
Të dy na kish bashkuar tok një yll.
Në prehrin tim nga plagët vdiq në luftë
Mes pishave të kaltra në një pyll.

Ti s'mund ta ndieje gjëmën aq të rëndë,
Kur erdha me mandatën në shtëpi,
Veç unë e di si mbahesha në këmbë
Në odën me oxhak e tym të zi!

Veç unë e di kur gjyshja jote e shkretë
M'i nguli sytë e vojtur gjer në shpirt
Dhe nëna si qiri në këmbë e zbehtë
Sikur më lutej: mos e thuaj, prit!

Po ti at'herë, vallë, ç'mund të thoshe,
Një kalama pa mbushur katër vjet!
I strukur si rabeckë në një qoshe,
M'i hidhje sytë e vegjël në dyfek!

Më mbetën ata sy në mend përjetë,
I mora pas në luftë dhe ndërtim.
Dhe fatin tënd kaq kohë e ndoqa vetë,
O biri fillikat i mikut tim!

Dhe kam kërkuar veç një gjë prej teje:
Mos shkelje kurrë nderin e babajt;
Gjersa të rrihte gjaku nëpër deje
Të mbaheshe si shoku im u mbajt!

Dhe jam i lumtur kur me ty takohem
Në një pallat të madh ku ndrit një yll.
Një gur, një zog, dy pisha më kujtohen
Dhe ati yt në prehrin tim në pyll...

Kjo luftë e madhe klasash dhe kjo botë,
Kjo ndeshje dhe presion ideologjik
Ta kanë bërë zemrën gur të fortë,
O shembëllim i mikut tim fisnik!

Sikur të ndodhë ndryshe, do të vija
Dhe derën ta shkallmoja me mundim,
Për supesh si i çmendur do të zija
Dhe s'dihet ç'do të bëja në tèrbim!...

Babanë tënd e kisha shok të ngushtë,
Në pyll në prehrin tim nga plagët vdiq...
Dhe përsëri kjo ndeshje dhe kjo luftë
Me ty, o biri i tij, na bëri miq!...

P L E Q Ě R I A

P leqëria vjen e pakuptuar,
Vjen ngadalë pa zile, pa këmborë;
Gjurmëve të tua duke shkuar
Flokët t'i pudros me pak dëborë...

Në fillim s'e ndien qafiren plakë,
Se këmbora s'bie, kur bredh mbi tokë,
Se s'troket këpuca në sokakë,
Vetëm se dëbora zbardh në flokë...

Po pastaj të vjen të zë në gjumë,
Duke hyrë fshehur nëpër derë,
Dhe të thotë tinëz e pa zhurmë:
Mik i dashur, si s'më paske ndjerë?

Dhe at'herë shpejt për të kujtohesh;
Gjunjët zënë e therin nën jorganë,
Herët në mëngjes fillon e zgjohesh
Dhe kërkon dhe xhezven dhe filxhanë...

Ja kështu e nëmura, si erë
Rrugës lehtë shkon me shkop në dorë;
Por tek unë s'ka si vjen pa ndjerë,
Do t'i var në qafë një këmborë,

Që nga larg këmbora t'i dëgjohet
Nëpër gryka, kodra e tarraca
Dhe ta ndiej kur qaset dhe afrohet,
T'i zë prita, shpejt të marr ca masa;

T'i bërtas nga larg me tërsëllimë
Dhe ta tremb si bushtren pa mëshirë:
Shporru, qene, mos më prish rininë,
S'e shoh dot surratin tënd të mpirë!

1977

VËLLA, SA SHUMË PRITE!...

Bisedë vëllazërore

Vëlla, sa shumë prite ti nga unë,
Të bëhesha i madh e me pozitë!
Që kur të zbrisja fshatit përmbi lumë,
Të ngjallja kërshëri, habi e zhurmë.

Të bëhesha i madh e më pozitë,
Të thoshin: vjen filani nga Tirana!
Të prisnin nëpër arat dhe shtëpitë,
Të dilnin nga oborret dhe avllitë;

Të thoshin: vjen filani nga Tirana!
Të zgjatnin kokat gjyshet me ngadalë,
T'i linin moshatarët shata e brana,
Të zbrisnin çunat shpejt e shpejt nga mana!

Të zgjatnin gjyshet kokat me ngadalë,
Ta përqafonin birin përmalluar:
Të kemi mbajtur prehrit, more djalë,
Hallall të qoftë djepi nga ke dalë!

Ta përqafonin birin përmalluar
Në rrugët ku me shokët shumë brodhi,
Në sheshet ku ka qarë e ka kënduar,
Në kopshtet ku me shpirt ka dashuruar.

Në rrugët ku me shokët shumë brodhi
Me mall në gji e këngë e gaz ngaherë!
Po jo, vëlla, ashtu siç deshe s'ndodhi,
Se fati gjetkë mikun tënd e hodhi.

Me mall në gji e këngë e gaz ngaherë!
I tillë eci duke derdhur djersën,
U bë për vendin një poet i ndjerë
Dhe vjershën e lëroi si plot të tjerë.

I tillë eci duke derdhur djersën,
Në poezinë e tij nderimin gjeti,
Këndoi me mall për njerëzit e ndershëm
Dhe s'i braktisi miqtë e tij të hershëm...

Kështu, vëlla, vëllai poet të mbeti.

1977

PATAT E EGRA

M bi malet me dëborë
Me mjegull e tufan
Po fluturojnë patat
Me vargun naimjan.

Patoku shkon përpara
I matur si strateg,
Mes reve gjen një grykë,
Mes majash gjen një shteg.

Dhe tufa si gërshërë
E ndjek dhe i vjen pas
Me bindje dhe me shpresë
Drejt detit me tallaz

E mbushen retë e shpatet
Me britmat: ga-ga-ga!
E rruga zgjatet-zgjatet,
E rruga fund nuk ka!

Nën krahët e palodhur
Kjo tokë ë madhe vlon,
Çeliku del nga furrat,
Në digat rrjedh beton.

Zhurmon materniteti,
Thërret njeriu i ri;
Në magje zihet brumi,
Del tym nga çdo çati...

O viset prindërore,
O malet në karvan,
Me ç'hir lundrojnë patat
Me vargun naimjan!

Pas tyre vjen pranvera
Dhe sythi del në lis,
Kërcelli shpon ugarin
Dhe kokën nxjerr mbi plis.

Dhe malli i poetit
Trokët në kraharor,
Nga malet vijnë patat
Me vargun popullor.

Gatuam gizë e hekur,
Azot, superfosfat,
Po shpirti na ka mbetur
I madh e delikat.

Ndaj patat kur kalojnë
Mbi shpatet ga-ga-ga,
Mendimet fluturojnë
Në tufa të mëdha...

1976

~~X~~ MARO PODGOZHANI

1.

Duke udhëtuar nëpër Mokër
Ç'm'u kujtove, Maro Podgozhani!
Jemi shtruar bashkë në një sofër
Unë dhe xha Meke partizani.

Po xha Mekja vdiq, i ndrittë shpirti,
Vdekjen duke pritur me shakara;
Dhe vështron malluar nga Pleçishti
Nga dritare e varrit nën dy arra.

Dhe vështron a kanë rrush hardhitë
Dhe dëgjon a zien në zjarr kazani
Dhe mban vesh a sillen rreth dollitë
Dhe gëzon kur zë zinxhir filxhani...

2.

Maro Podgozhani kish një djalë;
Për atë s'përtonte dhe të vdiste...
Ky Bajram Trebinja hapi fjalë
Djalin fillikat në mal t'ia vriste.

T'ia shkretonte strehën e mjeruar
Dhe pa zjarr ta linte mu në vatër,
Që me shkop të shkonte e munduar
Nëpër botë si lypsare e varfér!

3.

C'pate që trazove mendtë e mia,
Maro Podgozhani me kobure!
Më kujtohet kur Bajram Trebinja
Zverdhur dyllë u fsheh nëpër ahure.

Zverdhur dyllë hyri nëpër grazhde,
Kur i dole me nagant në dorë:
«Dil Bajram Trebinja, qimekashte,
Ta kopsit me kopsa kraharorë!

Ti Bajram Trebinja je betuar
Djalin tim ta vrasësh me tre plumba,
Të më lësh kërcure të mjeruar,
Të m'i lësh dhe strehët pa pëllumba!

Dil, Bajram Trebinja, nga ahuret,
Dil, Bajram Trebinja, qimekashte,
Të t'i jap peshqesh të dy koburet,
Një me dhjetë, një me pesë a gjashtë!

O dobiç, që Mokra s'të ka pjellë,
Që lëpin me Ballin dy sahanë,
Mos m'u fut nën grazhd, nën bark të pelës,
Hajt tani, ma shpall në sy fermanë!»

4.

Obobo, ç'u lag Bajram Trebinja
Gjer në thonj prej etheve me djersë,
Fshehur nëpër kashtë si mëllinja,
Duke humbur trimëri dhe erzë!

Obobo, ç'na qe kjo gjëmë e madhe
Për Bajram Trebinjën me mustaqe,
Vjen një ketër bredhi, një kunadhe
Dhe të bën të çjerrësh flokë e faqe!

«Lipsu, xhind, nuk qeshet me kobure,
Lipsu, xhind, dhe shko me vrap te djali,
S'ta trazoj, më djegjtë kjo hashure,
S'ta trazoj, më rëntë kokës mali!

Lipsu, xhind, s'kam punë me një femër,
Lipsu, xhind, valofsha si kazani!»
Lutej kapedani dhe në zemër
Gjaku rrihte krahët si fazani.

5.

Maro Podgozhani fryu dy herë
Në dy grykat ngritur si qysqira.
Ky Bajram Trebinja gjunjëprerë
Thoshte: Maro, shko, të marrtë e mira!

Dhe u drodh prej Maros si purtekë
Dhe jetoi me turp të zi në Mokër,
Vezmet i ngarkoi më plot fishekë,
Frika s'i largohej as në sofër...

Dhe xha Mekja ngriti shumë bejte
Dhe tregoi romuze për Bajramin.
Dhe kujtimet unë i mbaj me vete
Dhe këndojoj për Maro Podgozhanin...

6.

Larg nga Podgozhani në varreza
Maroja po fle në katër mure,
Sipër saj e kaltër dridhet dredhëza
Dhe nën kokë rrinë dy kobure...

Duke udhëtuar nëpër Mokër,
Ç'm'u kujtove, Maro Podgozhani!
Jemi shtruar bashkë në një sofër
Unë dhe xha Meke partizani.

1976

KAU I BARDHË

Një ka i bardhë ecën nën muranë
Me madhështinë e punës përmbi shpatull.
I mban dy brirët lart si jataganë,
Nga hundët nxjerr dy shatërvanë avull.

Kalon ugarin ku lëroi e mbolli
Dhe ndalet sheshit tek bleron tërfili:
S'na vajti djersa kot, tërfili dolli
Që vjet pa hyrë ende mirë prilli!

Dhe hije i ka hapi i madh i rëndë
Dhe gjoksi nga del djersa ngjyrë ari
Dhe qafa që mban zgjedhë e parmëndë,
Kur këngë ngrenë plisat dhe ugari.

Dhe unë i rritur arave me qetë,
I përmalluar brazdave me plisa,
Vështroj si gjuha mbledh kërcej e fletë,
Si ngrihen brirët mbi hendek e driza.

At'herë s'më durohet dhe papritur
Kaloj ugarin, plisat radhë-radhë,
Dhe faqen e mbështet si çun i mitur
Në barkun madhështor të kaut të bardhë.

Dhe fëmijërinë ndjej si vjen me zhurmë
Mes barit të përtypur pas një zalli.
Dhe kau i bardhë kokën ngre nga unë:
— Ku je, o mik, të paska marrë malli!

1976

SHOKËT E MI

C'u bëtë ju, vëllezër, sa ju prita!
Rakia po pëlçet, jesir, në shishe
Dhe unë po lajthit, në mos lajthita,
Se malli po më djeg si dru prej pishe!

Mos kishit ardhur, vetë do t'ju vija
Mes pyjeve të Lurës a të Pukës,
Me radhë rrugët një nga një do zija,
T'ju gjeja larg në Fierzë, Ballsh e Kukës.

Pa haj t'ia marrim këngës djaloshare,
Të bëhemë sherretë kokëkrisur,
Të flasim si u hodhëm nëpër zjarre,
Të flasim si rininë e kemi nisur.

Ne kurrë s'jemi dergjur nën jorganët
Mëngjesit gjer në orën shtatë a tetë
Dhe s'jemi mallëngjyer nga fustanët
Në bulevardet, parqet, kafenetë...

Të dhemshur me shtëpitë kemi qenë,
Fëmijët si të marrë i kemi dashur,
Po shpesh në shtrat në gjumë i kemi lënë,
Andralla e telashe kemi pasur.

Me punën kemi ecur e vrapuar,
Me hapin plot gjëmim të Republikës
Dhe kemi derdhur djersën e nderuar
Mes vapës, borës, akullit e ngricës.

Me krahë fluturuam dhe u rritëm
Në fluturim fisnikë e zemërgjerë,
Dolli për socializmin tonë ngritëm
Dhe mbrojtëm si Kalanë e Krujës nderë.

S'na vjen çudi kur shohim shokun tonë
Të bëhet kryetar apo ministër,
Ne qemë tok në çeta, batalionë,
Ne hëngrëm tok patate edhe misër.

Dhe bashkë i vemi drejt e mu në zyrë
Ministrat, shokut tonë të rinisë,
Megjithëse sekretarja ka detyrë
Me firmë fletëhydrjen ta qëndisë.

— O miku ynë, ç'bën, si shkon me punë?
Na mori malli shoqërisht të rrimë;
Të vjen në mend kur dridheshim nën gunë
Nën shirat me gjëmim e suferinë?

Pa nxirre pak atë mavri veturë,
Të shkójmë andej nga lumi plot me mollë,
Të shohim kur në brazda mbjellin grurë
Ata që tok mësuam në një shkollë...

Dhe ikim bashkë si dikur gaztorë,
Dhe ikim bashkë krejt të barabartë:
Ministra, shefa, bujq e minatorë
Dhe një poet me pendë dhe me kartë...

Pa haj t'ia marrim këngës djaloshare
Dhe gjaku le të bëhet prapë i valë;
Të flasim si s'e shuam kurrë zjarrë
Dhe s'mbetëm rrugës,
ecëm veç në ballë...

1977

THIRRJA E VENDLINDJES

Qyteti im,
Më lidhin me ty lindja dhe vdekja.

Asnjë nga fisi im s'ka vdekur në qytete.
Varret i kanë në brigje e lëndina në fshatra,
Frymën s'e dhanë në apartamente,
E dhanë maleve, e dhanë te vatrat.

I pari që vdiq në qytet nga fisi im i vjetër
Ka qenë im atë, njëri nga pleqtë e rreptë,
Dhe ata që lindën nga fisi im për herë të parë në qytete
Janë fëmijët e mi.
Tani mund të them se këtë qytet e dua si vendlindjen time
Dhe jam i bindur për këtë që them...
Nga ky fis filloj gjenerata qytetare udhëtimin.
Përshëndetje, gjeneratë, vajza e djem!

Po përsëri në dyshek i shtrirë natën në gjumë
Gurgullimën e lumiit të vendlindjes e ndjej;

Dhe nga pylli e shkëmbi i murmë
Boriga e kaltër më thërret: këtej, këtej!...
Dhe ndofta, fëmijët e mi, në mos njëri, tjetri
Atje mund të ngrënë një shtëpi të bukur
Dhe unë, këngëtari, i moshuari, i vjetri
T'i ndjek pas, siç ndjek njomzaku një flutur.
Dhe kjo s'është shenjë e kthimit pas a regresit,
Kjo është dëshira e njeriut të vërtetë,
Që mund të niset nga gjiri i qytetit,
Kur shkëmbi e guri e ftojnë t'u japë jetë...

1971

NË GURIN E NJË VARRI

Padashur pashë emrin tënd të shkruar
Në gurin e një varri të vithisur.
Nga mendja ime ishe krejt i shuar,
Si një qiri i vjetër i braktisur.

S'e kam zakon të shaj ndonjë të vdekur,
Se për të vdekurit si ti nuk flitet!
Po ti ke qenë i poshtër, or i tretur,
Dhe poshtërsinë s'ta mbulojnë vitet!

Ke bredhur qehaja pas bejlurçinash,
Dhe bujqërve kafshatën u ke tharë;
Je fshehur pas hendeqesh e greminash
Dhe prapa shpine njerëzit ke vrarë...

Më duket se dhe sot nga guri i varrit
Ta shoh fytyrën tënde të pështirë.
Ti mikun tim e vrave mes ugarit
Një ditë kur mëngjesi s'kishte gdhirë.

Dhe ike duke fryrë në kobure
Mes plisave që qanin për pranverën.
Në brazdë me opinga prej lëkure
U shtri ai që ti ia mbylle derën.

Dhe qeni derdhët lotët si burbuqe,
Dhe gjakun ia lëpinte duke qarë,
Dhe prisnin qetë e shkretë si dy murgje
Të heshtur me parmandën ngulur në arë.

Ti ike po në mendjen time mbete,
Si korb në mes të plisave të murmë,
E mbajta hidhërimin plumb me vete
Kudo ku eca dhe ku lashë gjurmë.

Të ndoqa tërë jetën, hak të merrja,
Po ti nga unë u fshehe i tmerruar
Dhe zvarrë u hoqe muzgjeve si vemja
Dhe vdiqe nga një plagë e pashëruar.

Padashur pashë emrin tënd të humbur
Në gurin e një varri të vithisur...
Me kockat je harruar nëpër pluhur,
Se rrugën nëpër pluhur pate nisur.

ZGJIMI I BALADAVE

Unë eci në male e zgjoj balada,
Se baladat flenë nëpër mure,
Nëpër shpella dhe selvi të kaltra,
Nëpër gjurmë e gurë e fletë e shkurre.

Unë gjej një jatagan të ndryshkur,
Ku ka shkarë dheu pas një gremine,
Unë nxjerr nën fletëzën e vyshkur
Një fishek të vjetër karabine.

Unë marr nën plloqën e një shpelle
Një nagant të ngrënë lagështire,
Unë shtang nga kafka nën kapelë
Në një guvë mbushur errësirë...

Unë shkoj në gërxhe e zgjoj balada,
Dhe baladat malesh mbetën gjallë,
Se i mbolli rrugëve të gjata
Historia derdhur valë-valë...

S H T I G J E T

Kur nisa udhëtimin prej poeti,
E dija se në q'sheshe duhej dalë;
Po veç me mend s'e merrja unë i shkreti,
Që koka të më sillej kaq vërdallë!

Provova të kaloja në ato gjurmë,
Që kishin lënë miqtë e mi të vjetër,
Po kur në sheshe dilja s'bëhej zhurmë
Dhe nuk çuditeshin aspak të tjerët.

«A, paske ardhur po nga ato shtigje!
I njohim se andej kemi kaluar
Dhe kemi rrahur kódra edhe brigje
Dhe s'kemi lënë gjë pa e kërkuar!»

Naimi dhe Migjeni natë për natë
Më mblidheshin e vargje vërvshëllinen.
Naimi fliste: «Ruga është e gjatë,
Këtë ta them dhe unë dhe Migjeni!»

Me ta në gjumë i lodhur kuvendoja
Dhe vargjet përsërisja si një nxënës,
Pastaj të dy në èndërr i shikoja
Të verdhë si ky disk i madh i hënës.

Dhe përsëri në shtigjet poetikë
E nisja udhëtimin ditë për ditë
Lëndinave e gërxheve si thikë,
Andej nga s'mund të ngjiteshin as dhitë.

Dhe erdh një çast i madh pas udhëtimit,
Kur përsëri takova miqtë e vjetër.
Ata në gjoks më rrokën prej gëzimit:
«Vëlla, ti paske gjetur shtegun tjetër!»

1976

THEMELËT

Këtu janë themele e shtëpisë sime të vjetër,
E shtëpisë që e lashë dikur,
Këtu është dhe pragu i lashtë i derës,
Më tepër se prag — një gur.
E pragun e themelët i ka mbuluar bari i hollë
E mbi bar tundin krahët mollët starkinka,
Të panjohura në kohën kur isha fëmijë i njomë,
Mollët që moshatarët e mi i mbollën kur ika.
Flenë nën bar bashkë me pragun e gdhëndur
Vjershat e hershme në fletoret e shkollës,
Flenë e mbi to bleron bari i dendur
Dhe hedhin petalet lulet e mollës.
Po ëndrrat e vjershat e hershme zgjohen,
Kur rruga më bie nga kjo anë,
E shushurijnë tok me barin e fletët e mollëve,
E fluturojnë pranë...
Ahore ulem nën pemë e them me vete,
Duke përtypur një fije bari:
Vërtet shkrova poema në qytete,
Po mbeti esenca ime prej fshatari...

Dhe nuk skuqem që këtë esencë me vete e mora.
Esencën e ëndrrave të mira,
Se ëndrra të tjera mbi atë ndërtova,
Ëndrra të bukura, të dëlira...

1971

NË KRYEQYTET

Kur erdha këtu i mora me vete pleqtë,
Pleqtë e mi, mësuar në arat mes baltës e gurit.
Ata ishin njerëz të thjeshtë
Dhe të heshtur si kokrra e grurit.
Po shumë kohë mbetën si të huaj,
Mes betonit e asfaltit të qytetit.
Ëndërronin për pula e për kuaj,
Ulur në kolltukët e apartamentit.
Dhe këndonin ngadalë këngë fshati,
Të dy kokë më kokë,
Këndonin për barin që zinte monopati,
Këndonin për ujin që shushurinte në tokë.
Ndërsa mua më kërkonte artikuj gazeta
Për esencën e revolucionit dhe njerinë,
Për gjithçka që përbëysi jetë,
Për të shkuarën dhe nostalginë.
Unë shkruaja;
Ata ëndërronin: rritet arave drithi,

Këndon lauresha ugareve,
Hyn në rrënjet e bostaneve urithi,
Hingëllin pela për mëzin livadheve...

1971

MBRËMJE LETRARE

Më thirrën peshkatarët e Bunës pér darkë,
Më vunë pérpara peshk e putarkë.

Dhe hëna na bënte me sy e me vetull,
Dhe qefulli piqej në tjegull.

Godiste Buna ngadalë në brigje,
Godiste rakia në shishe...

Ne bashkë tërë ditën u lodhëm shumë,
Unë nëpér vargje, ata nëpér Bunë.

Po lodhjen në darkë e kapëm si qefull,
E kapëm si qefull, e poqëm në tjegull.

Tregoja vjersha, trazoja zjarrë;
Një mbrëmje letrare — njëzet peshkatarë.

Dhe Bunën peshku me bisht e rrihte,
Dhe hënën peshku me hundë e çukiste.

Eh, dreqi ta marrë, asaj nate ç'e ziem,
Vargjet me peshk i përziem!

1971

B U K U R I A

Kalojmë pranë bukurisë shpesh,
Kalojmë heshtur thjesht si udhëtarë
Dhe s'vëmë re si nis e buzëqesh,
Si pjeshka kur zë piqet në një arë.

Dhe vjen një çast kur shtangim para saj;
Ajo qëndron si pjeshkë e arrirë,
Ajo qëndron... dhe themi ne pastaj:
S'të vumë re, mes nesh ti paske mbirë!

1971

M I K P R I T J A

Nuk mund tē rri pa trokitur këtu,
Jashtë bie shi, jashtë bie llohë,
Ujërat e udhës më vijnë në gju,
Nuk mund tē rri pa trokitur këtu.

Ndofta zgjuar nuk éshtë asnjeri,
Portat me lloz, dritaret me reze,
Jashtë bie llohë, jashtë bie shi,
Qielli rëndon mbi çati.

Nuk mund tē rri pa trokitur këtu.
Hapet një portë, kërcet një dritare:
— Bujrëm, se nata në udhë tē zu,
Bujrëm, se zjarri ka dru!

Hyj e them me vete ngadalë:
S'na qenka mikpritja moderne?
Në daç haj ta quajmë patriarkale
Dhe natën ta gdhijmë në gjerdhe!

Flaka e verdhë, thëngjilli i kuq,
Rrobat në zjarr më avullojnë.
Nata largohet si zarbo gërmuq,
Flaka e verdhë, thëngjilli i kuq..

1971

Mirail Kadare

N U K D U A !

Edhe sikur të ma brejë trishtimi gjoksin e ngratë
Nuk dua të thonë për mua: gjynah!
Nuk dua të vijnë njerëzit ndaj nate
Si tezet në odë me oh e me ah!

Po dua të ulem me dhembje të thellë
Dhe vetëm mos më lënë në rrugë e në dhomë,
Të flasin për dheun e të flasin për qiellë,
Të flasin si duart i vramë për tokën tonë...

Ndofta prandaj e kam dashur don Kishotin aq shumë,
Se me gjithë disfatat e mëdha të tij
Në udhët e largëta me gjumë e pa gjumë,
Nuk lejoi ta ngushëllonte njeri...

1963

DUKE UDHËTUAR NË MALE

S'besoj të kenë kaq male vendet e botës,
Kaq male, kaq pirgje, kaq hone...
S'besoj të ketë kaq male poezia e Evropës,
Sa ç'ka poezia jonë!
Ne i kemi pasur malet mburoja në luftra,
Ne i kemi pasur malet mburoja në vargje;
Po zemrat toni i kanë mbajtur të mira e të buta
Këta pirgje e pragje.
E dini?
Unë takoj në mal një njeri,
Që s'ka me vete as fyell, as gërnetë;
Ka qejf të këndoje një melodi,
At'herë këput një fletë
E vë në buzë dhe këngë përcjell fleta e blertë.
E shihni?
Kjo ndodh në malet kryepërpyjetë...

1971

M O L L È T

Ajo doli nga kopshti me mollë;
Mbi supe kish hënën dhe degët me kokrra.
Në këmbë kish barin e hollë:
Unë rrija te porta.

Ajo binte erë mollë atë natë,
Atë natë rinore pa trazira.
Nuk më kujtohet se ç'i thashë,
Po e di se i thashë fjalë të mira.

1971

S H K È M B I

peizazh

Ky shkëmb nga deti gjoksin e ka kthyer
Dhe shpatullat në mal i ka mbështetur.
Qëndron si dëshmitar në bronz i lyer,
I heshtur me vështrim në shekujt tretur.

Mbi shpatullat e tij gjëmuani shekujt
Me shpata, bomba, mina e radarë,
Shtëllunga si në furkë mblodhën mjegujt,
Po prapë nga supet ranë, u hoqën zvarrë...

Në shark të shkëmbit, xhepave e palave
Skifterët rritën zogj në gjenerata,
Po çerdhe s'ngriti kurrë tufë e galave,
Se majë është e lartë e ka shtërgata.

Mbi shkëmb orkestra e erës zjen me vite,
Vazhdon një simfoni e pambaruar.
Ai gjykon se ç'thonë meloditë
Dhe ballin rrudh i heshtur, i menduar.

N D E R I

Kam jetuar ngaherë me nder
Dhe dorën kurkujt s'ia kam shtrirë,
Tërë jetën kam pasur veç një defter
Dhe në të kam shkruar fjalën e mirë.

E kam gjetur fjalën e mirë në qytet
E në fshat, e në asfalt, e në arë;
Dhe kam ngrënë bukë pa qibër e dert
Me ata që mbajnë lugën në gishtat e vrarë.

Ngaherë kam ecur me nënën Shqipëri
Dhe pas krahut të saj jam mbajtur;
Para saj kam qenë përjetë çilimi,
Çilimi dhe burrë i matur...

1973

NAGANTI I GJYSHIT TË RËNË

Gjeta një nagant të ndryshkur shumë,
Nga lagështia bërë dhëmbë-dhëmbë,
Kur lahesha me shokët dje në lumë
Mes shelgjeve në qetësinë e rëndë.

Ne heshtëm në çast në lëndinë
Dhe ulëm kryet mbi hekurin e vjetër.
Lëmonte lumi gurët e përjetshëm me limë
Dhe shelgjet varnin flokët e gjelbër.

1976

V R E S H T I

V argjet me kofina radhiten në vreshtë,
Vargje ku fle rakia dhe vera e mirë;
Vargje si vargjet në vjershë,
Herë të matur, herë të lirë.

Askush s'u thotë vreshtarëve:
Pse i radhitët kofinat në vargje të shkurtër a të gjatë,
Mjafton që prej vargjeve
Të dalë verë e trashë dhe raki njëzet gradë.

1971

VDEKJA E FSHATARIT

Lërove e lërove e pastaj erdhi një ditë e vdiqe.
Kokrrat e dheut të arave që i solle me këpucë
Mbetën nën gurët e oborrit dhe në tirqe
Dhe tokat e humbura të rripave të tu u ndryshkën
diku në gëmushë.

Po gruri dhe vreshtat që mbolle blerojnë
E zogjtë që të përcollën në ara hidhen pjergull më
Janë ullinë pjergull.

Janë mbledhur fshatarët rrëth teje e të heshtur lotojnë
 E gratë shamitë e zeza ulin nën vetull.
 Për çka atje lart kuvendon thëllëza?
 Për çka lopët e demat burçojnë?
 Botohet nekrologjia jote në librin e grurit në rrëza
 Dhe zogjtë me majën e sqepit firmosin e larg fluturojnë.

1972

PEIZAZH ME NJË RE TË BARDHË

Punova tërë ditën shumë
Ja një re e bardhë mbi kodrinë.
Të mbulohem me të e të bie në gjumë
Këtu në bar në lëndinë...

E prapë të hap sytë ngadalë,
E prapë në punë...
Një re si jorgan i bardhë,
Një ëndërr e bardhë mbi lumë...

1971

P U N A

Kaltérojnë thellë nën thonjtë e tij thërrmijat e tokës,
Thërrmijat që erdhën prej arave e lëndinave
Kaltérojnë si vijat e hartës së botës,
Kaltérojnë si kordat e violinave.
S'lahen ato me sapun e me ujë
Në asnje banjë të shquar.
Toka hyri në brazdat e duarve pa bujë,
Siç hyn në parmandë nën pluar.
I njoh këta gishtërinj të ngrohtë,
Këta gishtërinj të mirë.
Tim eti i kaltéronte toka nën thonjtë
Edhe kur brenda qivurit ish shtrirë.
Dhe dukej sikur ende s'kish vdekur,
Por flinte pak për t'u çapitur prapë në tokë,
Si atëherë kur pa feksur,
Rintë shtrirë me pëllëmbë nën kokë.

1971

NË QYTETIN E LASHTË

E cim të dy nëpër qytetin e lashtë
Me dritare shumë e kopshte me pemë;
Nga çdo dritare dëgjojmë një baladë,
Nga çdo portë dëgjojmë një poemë.
I ndien tingujt e vargjeve?
Vijnë nga lashtësitë e këtij qyteti me erë të vakët,
Vijnë nga gojët e statujave që flenë nën gurët
e pragjeve
E nën rrënjet e pjergullave që rëndojnë nga bistakët.
Sikur të kishe ardhur këtu dy mijë vjet të shkuar,
Skulptorët antikë
Do të të gdhendnin me mermer të alpeve
E do flije nën themelat e portave
Për një kohë të gjatë e pazbuluar,
E do viaj unë pas dy mijë vjetëve
Të të zbulojë e të të shpija në mermer në Galeri
të Arteve...
Mos qesh!
Kështu me siguri do të ndodhët.
Po më mirë që s'linde para dy mijë vjetëve të shkuar,

Se bashkë s'do të ishim takuar tani;
Në krahët e mi do të jesh më ngrohtë,
Sesa të ishe statujë në galeri...

1971

DUKE UDHËTUAR ANËS DETIT

I shkujdesur eci bregdetit të mirë,
Thërrmijëzat e rërës më gudulisin këmbët e zbathura,
Era flokët m'i krip me kripën e shkrirë,
Jodi i padukshëm m'i lyen buzët e plasura.

Deti papritur i jep qenies sime një nur fisnikërie,
Qenies sime të ashpër mbirë maleve,
Dhe shkrihet në fytyrën time një buzëqeshje rinie,
Një buzëqeshje e bashkuar me shushurimën e valëve.

E ndiej se këtë buzëqeshje e kanë pasur
Edhe poetët antikë, kur shkonin këtij bregdeti
Të menduar, të heshtur, të zbathur
Me një torbë prej lëkure dhie me vete.

Fisnikëromë pak, o det, fisnikëromë!
M'i mirë do të jem e më shumë do ta dua tokën,
Qilimët e tu të kaltër afromë
Dhe sillma valën — jastëk të vë kokën!...

B R A K T I S J A

S'di sa kohë më parë,
Shkova te gjyshja në qytetin e lashtë.
Ish dimër
 e gjyshja ma ndezi zjarrë
E u ul pranë meje me flokët si kashtë.
Më tha:
 Mos ik,
 mos ik,
Rri këtu,
 martohu këtu,
 bëj fëmijë këtu!
Shtëpi e mirë me avlëmend e çikrikë,
Zjarr i kuq me dru...
Po në veshët e mi ziente 'bota,
Mendimi im mbi tavanin më bojë vraponte,
Jashtë me grurë e antena mbillej toka
Dhe shekulli i reaktorëve gjëmonte...

1972

N A T Ė

Flenë bashkëfshatarët e mi të lodhur,
Tek-tuk nën çatitë ndihet ndonjë përçartje në gjumë.
Flenë thasët e grurit të posakorrur,
Flenë zogjtë nëpër shelgjet mbi lumë.
Çfarë shihni në ëndërr, o bashkëfshatarë?
Unë, miku i vjetër, ndiej frymëmarrjen tuaj,
Duke ecur mes grurit të korrur në arë,
Duke sjellë në mend një varg që nesër do shkruaj.
U shfaqen në gjumë brirët e lopëve laramane,
Kallëzat me hala të gjata të grurit,
Uji që vrapon misrave në ormane,
Pisha që ka lidhur me rrënjàt vithet e gurit.
U shfaqen zënkat me kryetarin
Dhe kuvendimet në sheshin e shkollës.
Eh, ç'e fyeu ai bashkëfshatarin
Nën degët e gjelbra të mollës.
Pse e fyewe ti, kryetar, pse e fyewe!
Ja, ata tani të shohin në gjumë
Dhe nesër të ngrysur
Do të të vërejnë mes brirëve të qeve

E do të thonë: «Kryetar, o lumë! ·
Dhe po të rrish ngaherë i vrenjtur,
Të rrëzojnë një ditë, të rrëzojnë
Dhe zgjedhin një tjetër,
Se kjo tokë ka shumë njerëz
Që dinë ndershëm të drejtojnë...
Flenë bashfshatarët e mi të lodhur
E shohin në ëndërr misër, lopë, jonxhë, grurë...
Frym era në arën e korrur,
Tulitet thëllëza në gurë,
Këndon bulkthi nën vreshta,
Unë eci e mendoj vargje për vjersha...

1971

PEIZAZH ASFALTI

Gjithçka mbulon kjo pelte e trashë:
Pelljet që mbanin baltë e fletë të kalbura,
Vrimat që fshihnin gozhdë potkonjsh e kashtë,
Vijat e ujit që sillnin luspa shalqini të lagura...

Tundin krahët mimozat në asfaltin — pasqyrë
Dhe hedhin balluket si vajza, në ballë
Për të parë bukurinë e tyre,
Që s'e shihnin dot në livadhe...

1970

L O P A

Lopa përtypet në grazhdin e mbushur me bar,
Unë mbështes faqen në shpatullën e saj të madhe
Dhe ndiej nga thellësi e qenies së saj një zjarr:
Ky zjarr erdhi me barin që u mblodh në livadhe.
Mbi brirët e murmë ndrit llamba elektrike
E drita bie në kusinë me qumësht.
Mua nga lopa s'më iket,
Me faqe në shpatull ndjej qumështin me shkumë.
Mjelësja kusinë ngadalë merr
Dhe me duar me qumësht pret.
Më thotë:

— Ju jeni veteriner?
Unë faqen nga lopa e heq:

— Jo, poet!

Ajo buzëqesh dhe më vështron me sytë e kaltër,
Të bukur e të urtë si paqe;
Diçka mendon, diçka sjell në hatër
Dhe e kupton se unë pa lopë nuk shkruaj dot vargje...

DUKE U MENDUAR PËR BUKURINË

Përse një shkëmb i ashpër dhe i rrudhur,
Që deti e godet, si dash, me valë,
Më duket aq i bukur,
Ku ndodhet bukuria vallë?
Më shembëllen me bustin e njeriut,
Në rrudhat sikur fshihet dhembja e botës,
Gjëmon në rrudhat breshri dhe veriu
Dhe moti shira derdh dhe i fryn shqotës,
Po shkëmbi rri fisnik si një bari me gunë
I zhytur për shelegë në mendime,
Që vijnë me këmborë e blegërimë.

1971

V A G A B O N D È T

Dy vagabondë rrahën një grua
Natën në rrugën «Konferenca e Pezës».
Lotët i rrighthnin si krua,
Mua sytë m'u veshën me cipë të zezë.
U drodha i téri e hyra në mes tyre.
Ata fyen poezinë time të pastër,
Dy vagabondë me sy téré lyrë.
Dy vagabondë në mesin e natës.
Vallë kot ne shkruam vargje për gratë?
Vallë kot ne drita në male ndezëm?
Dy vagabondë leshgjatë
Fyen rrugën «Konferenca e Pezës».
Unë u rraha me ta dhe grisa gjoks e krahë;
Si mund të rrija në paqe?
Poeti duhet të dijë të rrahë,
Jo vetëm të thurë vargje...

1971

ÇERDHET E ZOGJVE NË DIMËR

Ciniku dimër hip mbi pemë
Dhe zogjve krejt ua zhvesh foletë.
Rreth tyre gjethe e fletë s'gjejmë,
Mbi to shamilë shtrydhin retë.

Dhe ngremë kokën të menduar
Tek shohim çerdhet buzëplasur:
«O zogj, sa djersë ka kulluar,
Sa punë e madhe është dashur!

Një sqep i vogël, majëz pene,
Dy krahë sa një bllok shënimesh
Shtëpinë e ngrenë lart në pemë,
Pastaj e lënë mes thëllimesh!»

Im bir i vogël sa një zoçkë
Shikon si pikat degës derdhen
Dhe thotë, duke zgjatur doçkën:
«A s'u vjen keq që lënë çerdhen»?

Dimitro Kolev

KËNGA E NJERIUT

Shumë herë jam plakur e shumë herë jam rinuar
E shumë herë jam bërë fëmijë në krahët e nënës
Mes një lëndine të madhe të gjelbëruar,
Mes një qyteti të madh nën diskun e kuq të hënës.
E të gjitha i di: këngën, dhembjen, trishtimin,
E të gjitha përpinqem t'i di pérherë e më shumë.
Plakem — rinohem, luftë pafund e mbarim.
Një grimëz e tokës së madhe jam unë,
Por gjithçka krijoj e zbuloj...
Në veten time fle një histori e përbotshme plot zhurmë,
Unë eci, s'ndaloj, transformoj...

1972

RELIKET E HEROIT

Nuk e dinim as ne, shokët e tij të vjetër,
As rojtari plak i shkollës nuk e dinte,
Se do vinte një kohë tjetër,
Kur emri i tij mes yjeve vend të zinte.
Sikur ta dinim,
Bankën ku mësoi s'do ta linim ta mbulonte hiri,
Po do ta fshihnim në një vend me shpresë.
Rojtari plak në kutinë e duhanit
Do të ruante një copë tebeshiri
(Me tebeshir ai zhgaraviste në dërrasë të zezë).
Kështu ndodh ngaherë me heronjtë që vijnë,
Mes nesh rriten e ne s'e dimë...

1971

Ë N D Ë R R

Më dukej sikur të kisha harruar edhe në ëndërr,
Po ti diku në qenien time ishe ulur.
Dhe një ditë kur në qytet binte një shi i vëngër,
M'u shfaqe papritur në asfaltin e qullur.
Me balerina të vogla m'u mbush asfalti e sheshi,
Me balerina të vogla e flutura.
Ti qëndroje mes tyre e qeshje
Me buzët e bukura...
Dhe nuk dija ku ndodhesha
Mes balerinave, a pikave të shiut të dendur
Drejt teje afrohesha,
Si afrohemë në ëndërr...

1971

DY FJALË POETËVE QË VIJNË

N e s'kemi pasur aq kohë të shkruanim për dashurinë,
Megjithëse kemi qenë dashnorë të marrë.
Vendi kërkonte këngë për lirinë,
Vendi kërkonte këngë për bukën që piqeji në arë.
Vendi kërkonte nga ne poetët e shkretë
Të drejtonim kurset kundër analafabetizmit,
Të ngrinim diga në lumenjtë,
Të ndiznim maleve Hambën e socializmit.
Ndaj mos u çudisni, ju poetë që vini në jetë,
Dhe mos na qortoni për ato që s'bëmë.
Ne para jush do ngrihemë të ashpër si asketë,
Të ngarkuar me kallëza gruri dhe hekura të rëndë.
Ne që natën pa gjumë e kemi gdhirë,
Ne që kemi bërë kaq gjëra të bukura,
Vallë dy vargje për dashurinë s'mund të kishim grirë
Dhe s'mund të kishim belbëzuar: «oh, moj belkëputura»?
Ju do kujtoni se ne kemi qenë të thatë?
Të na kishit parë si digjeshim pranë vajzave që donim!
Ç'fjalë të bukura u thoshim në mbrëmjet e arta!
Po ne s'kishim kohë që fjalët e bukura t'i botonim
Dhe shtypshkronjat i kishim për gjëra më të larta...

NË KOHËN E VARFËRISË

Ra pika e lotit në grurishte
Dhe lagu kokrrat e vogla të grurit.
Ah, sa e rëndë atëherë ishte
Një pikë e lotit të kripur të burrit!

1971

PËR POEZINË

Nuk dua të shtirem i përvuajtur para njerëzve,
Por shpesh veten time kam ngrënë me dhëmbë,
Se poezia që kam kërkuar ka qenë e fshehur
Nën mburojë të rëndë.

Po kur mburojën me mundim e kam ngritur
Dhe poezinë e fshehur kam zbuluar,
Veten e kam parë të djersitur,
Veten kam kuptuar...

1971

S H Q E T È S I M I

Poetëve të botës

E si të jem i qetë,
Kur një njeri vritet në xhunglat,
Kur ka poetë,
Që lenë vargjet përgjysmë shpuar nga plumbat?
Unë mund të bëj metafora të bukura,
Metafora të papritura në vargje,
Metafora për flutura,
Metafora për pëllumba paqeje,
Por dëgjoj rënkinin e njeriut nga xhungla pa hënë
E rënkinin e luanit të djegur nga flakët e verdha,
E vajtimin e nënës
Mbi djepin e shpuar nga predha.
Ju kujtoni se unë s'mund të gjej një metaforë
Për këmbët joshëse zbuluar nga minifundet,
Tek ndalen kur hapin e mbyllin sytë semaforët
Në rrugët?
Ju kujtoni se unë s'mund të gjej një sinekdokë
Për lokomotivat në stacion dhe avionët në pistë?
E gjej,
Po s'më lë të qetë njeriu me plumb e gjak në kokë,

Shtrirë në xhunglat e shkretëtirën e Arabisë.


E si të jem i qetë?

Jam angazhuar në ideologji e politikë

Dhe s'hyj në stanin e atyre që janë puro poetë,

E ndiej dhembjen e njeriut dhe luftoj që dhembje mos ketë.

1971



PËRALLA E KECËRVE

Për mbesat

1.

Xhaxhi Drtero di përralla të bukura
Për dhelpra, dhi e kunadhe,
Thuajini xhaxhit, moj flutura:
Tregonja një përrallë të madhe!
Dhe xhaxhi aherë do lërë
Librin e tij në tryezë.
Përralla në mend do t'i bjerë,
Përralla për kecërit e dhinë e zezë.

2.

Na ishte, ç'na ishte njëherë...
Dëgjoni që fjalët mos mbeten në erë!
Dëgjoni që fjalët në kokë të hyjnë
Dhe njëra-tjetërën në radhë mos shtyjnë,
Mos shahen e kurrë mos bëjnë shamatë,

Se mendja pastaj i nxjerr jashté;
Dhe mendja prandaj ēshté mendje,
Se rregull kérkon nga mëngjesi nē mbrëmje...

3.

Pazarit po shkontakte ngadalë nëna dhi
Me kecërit e saj lozonjarë,
Po shkontakte në librari
T'u blinte dy abetare.
— U rritët,

— u bëtë si cjepër! —
U thoshte nëna fëmijëve —
Dhe duhet ta dini patjetër
Si shkruhet gjuha e dhive!
Dhe gjuha s'mësohet fare,
Po s'blemë dy abetare.

4.

Dhe shkuan kecërit dhe dhia
Në rrugën me dy librarira.
Në njérën që quhej «Shkëndija»
Radhiteshin libra të mira.
Dhe kecërit të dy u çuditën
Dhe brenda u futën e s'pritën.

5.

— C'urdhëroni,
moj shoqja dhi? —

Tha shoqja në librari.
— Më jepni dy abetare
Të reja fare,
Se dua t'ua mësoj fëmijëve
Si shkruhet gjuha e dhive.
S'ka hije, moj shoqe, që keci im,
Mos dijë shkrim e këndim!
A nuk i shikon se ç'kecër?
Këta nuk janë si dy karkalecër!
Po janë të mençëm dhe aq pastërtorë
Tamam si dy profesorë!
S'ka fare kuptim
Mos dinë shkrim e këndim!

6.

I bleu abetaret dhia brigjat ,
Dhe kecrit k rcenin e b nin shamat :
Sa mir , sa mir ,
Do shkruajm  me brir !
Do b jm  nj  A, do b jm  nj  Be
Ah, lumthi ti n n  q  kec r na ke!
Ne jemi kec r, ne jemi kec r,
Sa mir  q  s jemi aspak karkalec r!
Ne jemi t  zgjuar si dy profesor ,
Me libra n  dor !...

7.

8.

E ëma detyra të lehta iu vuri një ditë
Dhe shkoi të llafosej me dhitë,
Se s'mund të rrinte pa bërë dy fjalë
Me shoqet dhi në mëhallë...
T'u thoshte se kecrit mësonin çdo orë
Dhe mund të dilnin doktorë,
Tani vërtet janë keca,
Po nesër do merren me shkenca!
Ka hije që fisi i dhive
T'u dalë për zot diturive.

9.

Kur erdhi i gjeti kecrit në gjumë.
— Ah, përtacë,

po kur qenki lodhur kaq shumë ?
Ju s'paski mësuar fare!
Ç'i bëtë fletoret me gjithë abetare?
— E be-be-be,

e me-me-me,
I hëngrëm fletoret me gjithë abece,
Tani ne mësuam të bëjmë:

«Be-be-be»!
Dhe s'kemi nevojë për abece!

Xhaxhi Driteroi di përralla të bukura,
Përralla për dhi e përralla për dre...
Sikur t'i grisni abetaret,

moj flutura,
Do dini të bëni veç be-be-be
e me-me-me!

1963-1976

SA I ÇUDITSHËM

J u, vajza të vogla e djem të vegjël të mbarë,
Me sy ndonjë poet a keni parë?

Me ju poeti shembëllen, fëmijë,
Po mund t'i ketë flokët dhe me thinjë.

Dhe qejf i ka dhe përrallat dhe rrëfimet,
Çuditet me dëborën dhe blerimet.

Qëndron përpara fletëve të pemës
I krahason me vargjet e poemës.

Vrapon në breg ku valë e detit ndal
Dhe valës për habi i thotë mai.

E ndjek me sy kur fluturon një flutur,
Përpjek shuplakat: «Qenka shumë e bukur!».

Dhe niset vrap si Tani shpejt ta kapë,
Që mes pëllëmbës krahët pak t'ia hapë.

Ai si ju kudo ka qejf të futet
Në arat e fabrikat e në butet.

Bile harbon edhe në shesh të lodrave
Dhe hyn në lumë mes për mes të kodrave.

Në breg të lumit luan dhe me gurë
Megjithëse thinja ka dhe është burrë.

Atij po iu mbush mendja ngjitet malit
Në këmbë edhe në samar të kalit.

Dhe zbret t'i shohë zogjtë në gëmushë
Dhe bën si zogjtë ciu-ciu-ci me buzë!

Pastaj dhe rrrokulliset nëpër bar
Fap në kurriz, po fap edhe në bark...

Tamam si ju, o çuna, o fëmijë,
Çdo gjë trazon, çdo gjë kërkon ta dijë!

Dhe po t'i thonë: «Mos se s'është mirë!»
Si ju var buzët dhe i vjen vështirë.

I di fabrikat, arat, lopët, vreshtat,
Se po s'i diti nuk i bën dot vjershat.

Pastaj rri zgjuar edhe natën vonë
Dhe vargje shkruan dhe lëviz në dhomë.

Vrapon pas fjalës shumë të vështirë,
E kap si peshk dhe qesh se i vjen mirë.

Dhe hidhet me një këmbë në parket,
Tamam si ju, «e gjeta!» zë thërret.

I thotë mami: «Fli, po zbardh mëngjesi!»
Ia kthen: «Akoma s'po këndon këndesi».

Sa i çuditshëm qenka ky poeti
Tamam si Tani, Lona, Vjollca, Meti...

Tamam, tamam..., po vetëm se di shumë,
Kur flini ju si zogjtë, nuk bën gjumë...

1976

MBESËS DHE MACES

Mace kaq të mençme ti s'ke parë,
Mace kaq të bukur e bishtlarë.
Po të rrish te soba e mërzitur,
Kokën do ta kruajë pas këmbës,
Në pëqi do ulet e papritur
Shtruar-shtruar do t'ia marrë këngës:
Mër-mër-mër!

Po t'ia prishësh këngën, moj e mjerë,
Po ta zësh pér veshi pa kulturë,
Thonjtë si çengela do t'i nxjerrë
Dhe do hapë via në lëkurë:
Shoqe, mos ma prish avazin kurre,
Mër-mër-mër!

1963-1976

DY VËLLEZËR DHE UJKU

përrallëz

Na ishte seç na ishte, more njerëz,
Kullosnin shtatë dele dy vëllezër.

Një natë ranë ujqit në të shtata,
Rrëmbyen dy dhe ikën me të katra.

Vëllezërit kur pikasën, thirrën qentë,
I ndoqën ujqit dhe shpëtuan dhentë.

Nga qejfi që shpëtuan bagëtitë,
I ftuan në gosti të gjithë miqtë

Dhe pinë shtruar gjersa iku nata
Dhe hëngrën jo dy dele, po të shtata!

TANI DHE LARANI

1.

Në një fshat ku bredh mbi male
Hëna natën si ogic
Mama Klara lindi djalë,
Mama Lara polli viç.

Çdo mama e mburr të birë
Dhe nga gazi s'mbahet dot;
Mama Lara qesh me brirë,
Mama Klara qesh me lot.

Djali emrin e ka Tani,
Viçi emrin thjesht Laran.
Edhe Tani dhe Larani
S'blejnë qumësht në dyqan;

Se mamatë kanë gjinjtë,
Dy burime pa shterim;
Gjinjtë rrjedhin në turinjtë,
Kur i thithin me përtim.

Miturakët hapin gojën
Dhe secili vetëm pi;
Dhe një lloj e kanë bojën
Të dy qumështet në gji;

Veç se njërin e bën Lara,
Kurse tjetrin teto Klara!

2.

Sa çudira ka kjo jetë!
Moshatarë djalë e viç,
Viçi bredh me vrap si qetë,
Djali s'lot nga djepi hiç!

Viçi lind e drejt në këmbë
Tek një dardhë, tek një plep;
Djali lind pa fjalë e dhëmbë
Dhe pelena ka në djep.

Sa çudira ka kjo botë,
Një Laran dhe tjetrin Tan!
Njërin qimja e mban ngrohtë,
Tjetri s'ngrohet pa jorgan!

Sepse njérin e lind Klara,
Kurse tjetrin e pjell Lara.

3.

Lari shkon në djep çdo ditë
Dhe nxjerr gjuhën e përqesh:
— Je i vockël sa një mizë
Dhe nga bota nuk merr vesh.

Ka kaq dit' që kemi lerë,
Ti s'lëviz nga djepi hiç;
Unë u ngrita menjéherë,
Unë u ngrita se jam viç!

S'ma kalon në qumësht mua!
Ti me zor pi një filxhan,
Kurse unë po të dua
Mund të pi dhe një kazan.

Vetëm sot s'kam pirë shumë,
Një kusi edhe një tas!
Mama Lara tha se unë
Krejt oreksin po humbas!

E mbaroj sa t'i ve hundën
Atë qumësht që pi ti;
Ti nuk fle po nuk të tundën,
Unë fle se s'jam njeri;

Sepse unë jam i Larës,
Kurse ti i teto Klarës!

4.

Mama Klara ngre të birë
Dhe në gji me këngë e mban:
— Shih Larani sa ka pirë,
Ndofta, ndofta një kazan!

O Laran, mor laraman,
Léri Tanit një filxhan!
Shko i thuaj mama Larës:
Jepi qumësht teto Klarës!

Ah, o viç që kokën kruan
Tek një dardhë, tek një plep,
Disa vite po kaluan
Do ta shohësh ç'bën ky djep!

Nga ky djep prej coprash pishe,
Ku hap syté ky njeri,
Pak më i gjatë se një shishe,
Ti ç'do dalë nuk e di!

Nga ky djep do dalë burri,
Që do ngrerë gjer në re
Pirgje muresh gur pas guri,
Diga plot betonarmé.

Do tē tundë mal e kodër
Edhe tokë e oqean;
Për atë do jesh si lodër
Ti i bukuri Laran!

Po aherë do jesh plakur
Nëpër brazda plis më plis;
Do përtosh tē hash një lakër,
Të ngresh bishtin në kurriz.

Ballin tënd do ta lëmojë:
«Eh, u plake, o qyqar,
Ti je ka e s'flet me gojë,
Po shko çlodhu pak në bar!»

Ah, o viç që kokën kruan
Tek një dardhë, tek një plep,
Disa vite po kaluan
Do ta shohësh ç'bën ky djep!

Nga ky djep i lashtë, i hijshëm
Del një div i plotfuqishëm!

1976

KUSH NUK SHEH VETEN

Dy macka qimebardha posi shkumës
Në pjatë hanin tok përshesh me qumëشت.

Dy qen shikonin vëngër të mërzitur
Dhe kuvendonin, veshët duke ngritur:

— Këto nuk kanë fare edukatë,
Se fusin hundët bashkë në një pjatë! —

Pas pak u ra një kockë mu në këmbë,
U shqyen qentë vap e vap me dhiembë.

U bë potere, zhurmë e shamatë
Dhe macet thanë: «ama edukatë!»

UJKU

Një ujk nga lukunia iku natën
Dhe shkoi diku t'u gjente dhenve vathën.

Dhe dhentë sa e panë u mbushën frikë,
Po ujku tha: «Kam bërë autokritikë.

Të njëjtën gjë do bëj në vathën tuaj,
Që shpirtërisht mos heq edhe mos vuaj.

Kam sjellë të këqija sa jam lodhur,
Pasi në kushte ujqish pata ndodhur».

Kështu jetoi me dhentë ditë me radhë
Dhe sillej shumë i matur e shpirtbardhë.

Dhe thanë dhentë: «Iku, motra, frika,
E bëri ujkun qengj autokritika!»

Dhe rrodhi koha depove të saja,
Me dhentë loste ujku ndër ograja.

Bile shakara bënte dhe ahengje
Me urtësi, me lepe e me peqe!

Po erdhi dita dhe kërciti dhëmbët
Dhe vuri dhentë me tërbim nën këmbët.

Për tokë gjysmën e kopesë shtriu,
Si ujqit e xhindosur ulëriu!

Nga kjo prej kohësh një proverbë rron:
Zakonë e vjetër ujku s'e harron...

1977

MONOLOGU I PSEUDOS

Jam popullor e qejf e kam rrogozin
Dhe këmbëkryq rri shtruar si çoban;
Ma sjellin që ta pres me thikë kosin
Dhe gushën e gjeldetit në sahan.

Jam popullor, ndaj popullin e dua,
E dua dhe tabanin kombëtar
Dhe dashin mund ta ha dhe në katua,
Bile kur s'kam ç'të bëj, dhe në qilar.

Jam popullor, për popullin s'më flihet
Dhe natën mund ta gdhij me gaz mbi mish,
Gërneta prapa veshit le të ngjiret,
Do lodhem pak, po lodhja nuk më prish.

Jam popullor, në popull hyj i tëri,
Kërkomëni në popull në rrugoz
Dhe do më gjeni, pa m'u dredhur zëri,
Mbi gushë gjeli, ndofta dhe mbi kos.

Jam popullor dhe s'trëmbem nga terreni,
Në popull gjej burimin kryesor:
Gëzimi rrjedh e zien karadyzeni
Tamam si nëpër përralla e folklor.

Jam popullor, në popull veç më gjeni...

1975

DHIA DHE MAÇOKU

Maçoku në gosti e thirri dhinë,
I vuri mish e peshk e zogj në sofër;
Ia hapi zemrën, derdhi dashurinë,
E priti me respekt të madh si motër.

Po dhia s'hëngri, s'vuri gjë në gojë,
Për të kjo darkë ishte shumë e varfër;
Dhe duke ikur tha: «Maçoku të na rrojë,
Po ky kurnac kurseu të nxirrte lakër!»

Poeti nga kjo prallëz do rrëfejë
Në dymbëdhjetë rreshta me pak fjalë:
Të gjitha gjërat rreth e rrotull teje
Nuk maten dot me shijen personale...

1977

P J E P R I

Erë e jonxhës vjen nga ara,
Erë e jonxhës aq e mirë
Dhe në fushën lara-lara
Prehet pjepri i arrirë.

Ne të dy sa kemi zbritur
Nga kolltukët e veturës,
Pimë filtër të mërzitur,
Pimë NISH — cigare — Durrës.

Ne të dy sa kemi ardhur,
Ku lëruan gjyshërit tanë;
Koha flokët na ka zbardhur
Dhe në qafa na vu dhjamë.

Koha shefa na ka bëré,
Shefa t'ashpër e të mirë,
Por servilë na ka lënë
Ndaj një pjepri të arrirë.

Dhe i flakim republikat,
Çajmë kallëzat e thekrit,
Dhe nga xhepat nxjerrim thikat,
I përulemi xha pjeprit.

1972

MAÇOKU DHE MINJTË E VEGJËL

Mijnjtë e vegjël të mahnitur mbetën,
Kur e panë maçin laraman.
Plot fisnikëri qëndronte vetëm,
Zemërbardhë, i dashur, babaxhan.

— Ah, ta dish, moj mami, ç'kemi parë!
Gjetëm më në fund një gjysh, një mik!
Ishte aq i pastër, aq i larë,
Qeshte nën mustaqe si fisnik! —

Mami zgjati kokën pak në vrimë
Dhe u drodh prej syve të mëdhenj.
— Ah, këta naivë gjë nuk dinë,
Budallenjtë e nënës, budallenj!

Ky bandill i qeshur me mustaqe,
Ky shpirtbardhë i heshtur e fisnik
S'bën me sojin tonë kurrë paqe,
S'bëhet kurrë gjysh, vëlla e mik! —

BRESHKA TE NALLBANI

E dini se meraku breshkën
E digjte si shkëndija eshkën,

Se desh të bëhej sa një kalë
Me fre, me yzengji, me shalë;

Kish qejf të mbathej me patkonj,
Megjithëse kishte shumë thonj.

Ndaj sapo doli nga kallami
Shkoi shtruar-shtruar te nallbani

Dhe ngriti këmbën dhe i tha:
— Më fut një gozhdë, o usta! —

Dhe që atëherë doli fjala
Me bukuritë e saj të rralla,

Që ju në mend të gjithë e mban:
«Mos shko si breshka te nallbani!».

1957-1976

MULLIXHIU DHE PULA

Një mullixhi në jaz kish ujë pak
Dhe ishte bërë vrer edhe farmak.

Nga dera doli me inat e bujë
Dhe pa një pulë që po pinte ujë.

Për gryke e përfshiu i nxehur shumë:
— Tani ta ndreq — i tha — samarin unë!

E di pse kam pak ujë në mulli,
Në jazin tim, ti, zullumqare, pi! —

Dhe kokën ia këputi
Dhe shpejt në thes e futi...

Ai që mullixhiut të drejtë i jep,
Kur puna nuk i ecën, gjen sebep!

1957-1976

DHELPRA DHE DEVEJA

Deveja tok me dhelprën na u nisën
Në një udhëtim të largët shumë;
Po në një grykë mali kur arritën,
U kishte dalë shtigjeve një lumë.

Deveja futi këmbët po si hunjë
Dhe tha, duke provuar thellësinë:
— Ky lumë nuk na shkon as gjer në gjunjë,
Ndaj, hajde, motër, ç'pret atje në brinjë!

Po dhelpra e mërzitur e shikonte
Devenë brenda lumi shumë ftohtë
Dhe larg në breg me hidhërim mendonte:
— Nuk janë gjunjët tanë të njëllojtë!

1957-1976

AKREPI DHE BRETKOSA

Akrepı kishte mbetur tek një lumë
Dhe s'hidhej dot matanë bregut tjetër.
Takoi bretkosën dhe iu lut aq shumë
Që ta ndihmonte udhëtarë e vjetër.

— Ti rri në shpinën time, — tha bretkosa —
Po veç mos më picko me thumbin tënd kurrizë!
— A, mos më thuaj, se tani vendosa
Ta mbaj përpjetë thumbin si një drizë. —

Po kur kaluan lumin e tërbuar,
Akrepı e thumboi bretkosën tonë.
— Ç'më bëre!, — tha bretkosa e helmuar.
Akrepı u përgjigj: «E respektoj zakonë!».

KATËR VETË

E ndiqte mamin çuni si ogiçi,
E ndiqte Larën hap pas hapi viçi.

Të katër ecnin bregut me ngadalë
Dhe sipas qejfit thoshin ndonjë fjalë.

— Ky viçi, mami, pse ka katër këmbë
Dhe nuk ka krahë, gishta dhe pëllëmbë?

— Se është viç, — tha mami — ndaj s'ka duar,
Se duart dalin po të kesh punuar.

— Ky çuni, mami, pse dy këmbë paska,
Tamam si harabeli dhe laraska?

Dhe si qëndron veç me dy këmbë rrugës,
A s'e rrëzon kur ngrihet er' e jugës?

Po kokën si e mban çdo çast përpjetë,
A nuk i lodhet fare kjo e shkretë?

— Kështu e kanë njerëzit, zemra ime,
Ne bashkë rrojmë e kemi ca ndryshime...

I tha mamaja viçit kureshtar,
Duke përtypur gjethe edhe bar.

— Kështu e kanë viçat, — thoshte çuni
Dhe ecnin tok të katër pas një lumi.

1976

E DREJTA DHE E SHTREMBRA

Një pishë e shtrembër në përrua
I tha një pishe krahëgjatë:
— Sa keq, moj motër, më vjen mua,
Je kaq e bukur, kaq shtatlartë! —

— Pse të ardhka keq ty, moj e shkretë? —
— Po, ja, kur shkrep në qiell rrufe,
Kur sipër malesh fryhen retë,
E para digjesh ti mbi dhe,

Se shtati yt del mbi të tjerët
Dhe do të digjesh vonë a hérët! —

Po pish' e gjatë i foli ftohtë
Dhe rrudhi ballë e vrenjti vetull:
— E unë s'rroj si ti në botë
E fshehur pas dikujt nën sqetull! —

Kjo fabul ka një të vërtetë:
Me frikë s'ke ç'të rrosh në jetë!

K U N G U L L I

Një farë kungulli u lodh nga qarkullimi,
Nga qarkullimi bujqësor që dihet.
— Më hipën dhe mërzia dhe trishtimi,
Tensioni im po shtohet e po ngrihet!

Nuk qarkulloj, do rri veç në një arë,
Të qarkullojnë pjepri dhe shalqini! —
Dhe mbeti pesë vjet në vend kjo farë
Pas gardhit pranë një burimi.

Filluan kungujt vit për vit të dalin
Të vegjël sa një kumbull e domate...
Burimi që ia dinte mirë hallin
I tha: «po s'qarkullove, vate!
Do bëhesh farë e keqe dhe bastarde!»

1977

LUANI DHE MIU

Dhe kafshët sa e panë luanin ikën,
Se gjer në palcë u futi datën, frikën.

Veç miu i vogël fare nuk tronditej,
Me sy i ndiqte kafshët dhe çuditej:

— Çuditem si po ndodh, o miq, kjo punë,
Të trembesh nga një zdap i madh kaq shumë!

Të ishte ndonjë mace, e po mirë,
Po nga një buf si ky të rrish gjakngrirë? —

Nga kjo ka mbetur një proverbë e hershme:
Për miun vetëm macja është e tmerrshme!

F I L I S T I N I

baladë

O da mbushur me kolatkë
Dhe me rafte e statuja,
Mbi qilimin butë-butë
Shkel në gishta guguftuja,

Shkel në gishta guguftuja,
Sjell filxhanin e kafesë,
Afsh i ngrohtë del nga druja
Si prej vatrës së teqesë;

Si prej vatrës së teqesë
Me përtim të vagëlluar,
Del nga push i sixhadesë,
Zbret në tylin shtruar-shtruar;

Zbret në tylin shtruar-shtruar
Tok me mallin nëpër faqe,
Shoku Zeqo i menduar
Eshtë i lodhur e do paqe;

Është i lodhur e do paqe,
Se u tret për socializmin,
Po të kishte dhe mustaqe,
Do t'i digjte për marksizmin;

Do t'i digjte për marksizmin,
Si martir me gjak të ftohtë,
Po ç'e do se rehatizmin
Na e la kjo zuskë botë;

Na e la kjo zuskë botë
Mbi kolltukë e mbi qilime;
Shoku Zeqo hedh një gotë
Edhe kridhet në mendime;

Edhe kridhet në mendime:
Jeta s'qenka lëng në lugë,
Paska halle e mundime
Edhe ulur në kolltukë:

Edhe ulur në kolltukë
Do mendosh se ç'sjell sahati,
Se të dalin nëpër hundë
Dhe zullumi dhe rehati;

Dhe zullumi dhe rehati
Fluturojnë për së gjalli
Dhe nën këmbët e një shpati
Pret hendeku dhe kanali;

Pret hendeku dhe kanali,
Pret qysqia, sharra, druja
Dhe s'të zbret si zogë mali
Mbi qilimin guguftuja;

Mbi qilimin guguftuja
Tek këndon televizori,
Tek qëndron në raft statuja,
Tek mbush pjatën taratori;

Tek mbush pjatën taratori,
Tek këndojnë kanarinat,
Tek me gaz magnetofoni
I vërtit me vrap bobinat;

I vërtit me vrap bobinat,
Hajde, hajde, ç'mall e ç'këngë!
Jeta duket si lëndina
Mbushur lule pa një brëngë!

Mbushur lule pa një brëngë,
Pa qedere kraharori...
Edhe fshati ka plot kënge
Dhe këndon televizori;

Dhe këndon televizori,
Po lezitin s'do ta ketë
Si te muri i bardhë borë
Në odën time aq të qetë;

Në odën time aq të qetë
Tek aromën hap bifteku...
Ec e bridh kur fryhen retë
Pas një brazde, një hendeku;

Pas një brazde, një hendeku,
Futur baltës, zhytur llucës, *dur*
Ec e qaj me mall të mekur
Për lustrimin e këpucës;

Për lustrimin e këpucës,
Për pizhamet vija-vija
Do na dridhet cep i buzës,
Do na derdhet vrer zilia;

Do na derdhet vrer zilia *nef*
Për shkëlqimin e tribunës,
Obobo, halle mavria,
S'ju lan dot as lumi i Bunës;

S'ju lan dot as lumi i Bunës,
Po të ndodh ajo që pritet...
S'e besoj!... Jam qen i punës
Dhe s'jam laro i simites;

Dhe s'jam laro i simites
Dhe s'jam lake pupulake...
Shokun Zeqo mesi i ditës
Seç e gjen të ndezur flakë;

Seç e gjen të ndezur flakë,
Hapur sytë nga statuja...
Duke shkelur përmbi take
Vjen ta zbutë guguftuja;

Vjen ta zbutë guguftuja:
Zeqo — paqe, Zeqo - paqe!
Larg nga brenga, larg nga buja,
Bota qenka lëmsh pa caqe;

Bota qenka lëmsh pa caqe,
Ndaj ti heq për socializmin,
Po të kishe dhe mustaqe
Do t'i digjje për marksizmin...

Do t'i digjje për marksizmin!
Mjaft me profka dhe betime,
Se ne rrugën socializmit
S'do t'ia shtrojmë me qilime!

S'do t'ia shtrojmë me qilime
Dhe me cipëz prej statuje
Nën cër-cëre kanarine,
Nën sandale guguftuje!

Asaj rruge ne s'e shpjemë,
Ku ti gojën hap i mekur.
Socializmin ne e ngremë
Mbi beton, çelik e hekur.

Mjaft me ty «hero» i vjetër,
Po të zboj dhe nga balada,
Se m'u ngjite përmbi letët,
Si në buzët marmelata!...

Hej, baladë, merr firomë!
Ty heronj të rinj të presin:
Bukur dinë të jetojnë,
Bukur dinë dhe të vdesin.

Unë ty s'të bëj pafshirë
Me ca Zeqo, byk e kashtë,
S'kam pér ta aspak mëshirë
T'i përzë e t'i lë jashtë...

Dhe t'u shfryj me zjarr së largu:
Hej, ju bufër, ju gallofa,
Hajde mbushuni nga vargu,
Hajdeni shporruni nga strofa!

1975

BALADA E RRUSH-RUSHITIT

*Tre mbretër morën një vendim,
Që Xhonit Kokërr Elbi,
T'i zhdukej fara me tërbim,
T'i humbte fare thelbi!*

R. Bërns

1.

C do vit në vreshtë me babanë
Krasitnim tok hardhitë
Dhe zgjidhним degë dhe fidanë,
T'i mbillnim prapë një ditë.

Të bëhej vreshta më e madhe,
Të rridhte gazi lumë;
Në but ta hidhним dhe në kade,
Të kishim verë shumë.

Im atë rrushin përkëdhelte,
I thoshte: Rrush-Rushit,

Dhe me fidan në dorë qeshte:
«O Rrush-Rushit, buçit!»

Për Rrush-Rushitin një legjendë
Ngaherë më tregonte;
Bile kur çlodheshim nën pemë,
Legjendën ma këndonte:

«Tre kapedanë u inatosën
Me Rrush-Rushit Vreshtanë
Dhe me tërbim të madh vendosën
Ta fusin në hapsanë.

Lëshuan tok ferman e urdhër:
Të kapej shpejt jeziti,
Të shtypej në havan si hudhër,
I poshtri Rrush-Rushiti!

2.

Ndërtuan pash më pash hapsanën
Pa dyer, pa dritare:
— T'ia zhdukim krejt jezitit famën
Dhe zhurmën zullumqare! —

E ngritën burgun me dru lisi,
Mbërthyen tunxh e hekur,
Që nga hapsani Rrush-Rushiti
Të dilte veç i vdekur.

Pastaj e gjetën dhe e zunë
Me kosh si egërsirë,
Me kosh në burg me vrap e shpunë
Të dergejë në errësirë!

Në prag të burgut kur arriti,
Tre kapedanët thanë:
— Si qen të ngordhësh, Rrush-Rushiti,
I mbyllur në hapsanë!

3.

Qëndroi mes mureve të drunjë
Dy javë Rrush-Rushiti,
Të tretën muret zu t'i tundë
Dhe burgu zjarr buçiti.

Dhe kapedanët plot poterë
Ferman e urdhër dhanë:
— Ky Rrush-Rushiti duhet zjerë,
Si dashi në kazanë!

Po duhet zier dalngadalë,
Me pika të pikojë,
Që shpirti me mundim t'i dalë,
Pastaj të avullojë! —

Ndaj kapedanët ndezën zjarrë
Dhe flaka gjuhën qiti,
Kazanin në çengel e varë,
Të zihej Rrush-Rushiti!

U tund kazani me buçimë
 Dhe kapedanët thirrë:
 — O qen, ty gjakun do ta pimë
 Se prapë nuk rri mirë!

Dhe mbushën plot të tre filxhanët,
 Në grykë lëngu zbriti...
 U shkulën gazit kapedanët:
 — Mbaroi dhe Rrush-Rushiti! —

Po kapedanët pinë shumë,
 T'i merrnin hak jezitit:
 — O le të rrjedhë poçja lumë
 Me gjak të Rrush-Rushitit!

Eh, Rrush-Rushiti ç'u tèrbua
 Dhe ngriti tramundanë,
 Si trim i marrë lart u çua
 Dhe kapedanët ranë...

I shkundi tre sahatë ashpër
 Dhe kokat u pérpoqi,
 I shtriu përdhe në qoshe bashkë
 Dhe gradat ua hoqi!

I pari kapedan bërtiste,
 I dyti isc mbante,
 I treti kapedan nuk fliste,
 Po fshinte sytë e qante!

S'i urdhëronin gjunjë e duar,
Mezi lëviznin gjuhën,
Se Rrush-Rushiti i tërbuar
Desh ta mbaronte punën...

U lutën shumë kapedanët
T'u ikte shpejt jeziti:
— Ne do përmbysim dhe kazanët,
Veç ik, o Rrush-Rushiti! —

Po Rrush-Rushiti orën priste,
Pastaj të ikte vetë,
Ta ndiente vreshtën kur ta thërriste,
T'i thosh:
— Po vij, moj vreshtë! —

T'i thosh ç'e shtrydhën, ç'e munduan
Në bute, në kazanë,
T'i thosh ç'e kapën, ç'e valuan
Të mbyllur në hapsanë...

5.

Po kapedanët fjalën hapën,
Se tok kishin vendosur,
Që Rrush-Rushitin do ta kapën
Në shkurt për ta varrosur.

Ky shkurti, koha e krasitjes,
Do shihte lemerinë!
Do vinte ditë e hargalisjes
Me Rrush-Rushit fatzinë!

Atij me thikë do t'ia prisnin
Në vreshtë krahë e kokë
Dhe me inat do t'ia vithisnin
Në varr të zi, në tokë...

6.

Dhe erdhi shkurti dhe e zunë,
Pa mbushur ende viti,
Ia prenë krahët dhe ia vunë
T'i kalbeshin jezitit!

Dhe fjetën mendjen kapetanët
Dhe ikën të gëzuar:
— I lave, Rrush-Rushit, sahanët
Dhe s'ke për të jetuar! —

7.

Po prilli fryu në male e kreshta,
Rushiti krahët nxori,
Krenar e trim u ngrit në vreshta
Dhe zemër divi mori.

Pastaj në gusht i tundi veshët
Si shporta nëpër fletë,
Dhe çdo hardhi filloi të qeshtë:
— Kam qenë e jam në jetë!

Dhe erdhën prapë kapedanët
 Dhe prapë u inatosën,
 Dhe prapë u futën në kazanët,
 Në bute e vulosën!

Sërishmi tundi Rrush-Rushiti
 Dhe bute dhe hapsanë;
 Nga vojtja gjaku i buçiti
 Dhe kapedanët thanë:

— Vellezër, kapeni zuzarë,
 Se na turproi oxhakun!
 Dhe nën kazan t'ia ndezim zjarrë,
 T'ia pimë prapë gjakun! —

Dhe doli gjaku nga jeziti
 Dhe kapedanët pinë,
 Dhe përsëri nga Rrush-Rushiti
 Të tre përdhe u shtrinë...

Ashtu të shtrirë, gjunjëvrarë
 Filluan e t'i flasin:
 — O Rrush-Rushit, o trim i marrë,
 Largohu se s'të ngasim! —

Po kapedanët shpejt harrojnë
 Dhe ngrenë kurthe lufte
 Dhe Rrush-Rushitin e mundojnë,
 E mbyllin nëpër bute.

Po Rrush-Rushiti ngrihet prapë
 Dhe hedh mbi ta shigjeta
 Dhe batalionet dhe brigadat
 I shton çdo vit në vreshta...

Dhe shumëzohen kombinatet
 Me bute për jezitin,
 Caktohen ditët dhe afatet,
 Ta varin Rrush-Rushitin.

Dhe merret rëra ku hesht deti
 Dhe mblidhet nga çdo anë,
 Të bëhen shishe, enë qelqi,
 Faqore, damixhanë.

T'i mblidhet gjaku nëpër xhame
 Rrufjanit kokëkrisur,
 T'ia zbutin zemrën edhe xhanë,
 Ta bëjnë të sajdisur...

Takohen shumë inxhinierë,
 Teknikë dhe drejtorë,
 Dhe laborantë dhe portierë,
 Dhe plot degustatorë...

Dhe mblidhen mjeshtër të sprovuar
 Mbi letra si strategë,
 Që Rrush-Rushitit të tërbuar
 T'ia njohin rrënje e degë,

T'ia njohnin lindjen edhe sojin
Dhe gjithë biografinë,
T'ia njohnin trupin edhe bojën,
Qëndresën dhe fuqinë,

T'ia njohnin vendin nga ka dalë,
Zullumet që ka bërë
Dhe t'i shënojmë dalngadalë
Me pe e me gjilpërë.

Dhe si e njohnin mirë e bukur,
Fillojnë operacione:
— Rushit, dil sheshit, ku je futur,
Se qejfin ta tregojmë! —

Po Rrush-Rushiti ngrihet prapë
Dhe hedh mbi ta shigjeta:
S'e ndalin dot as dyllë, as tapë,
As zjarre, as raketa...

Dhe thotë: — Silluni me mua
Të matur, pa zullume
Në sofër qofshi a katua,
Bankete a bodrume!»

10.

Kështu legjendat rridhnin-rridhnin
Nga buzët e tim eti,
Ku pjergullat bistakë lidhnin,
Ku kënga ime mbeti...

Im atë i ngjante Robert Bërnsit,
Kur me legjenda fliste,
Megjithse vjershat e skocezit
S'i dinte dhe s'i njihte.

S'e njihte vjershën për një Xhoni,
Një Xhoni Kokërr Elbi,
Që dhe kazanët ta valonin
Atij i mbinte thelbi.

Siç thotë Bërnsi i Skocisë,
Ky Xhoni bëhej birrë;
Ia nxehte gjakun njerëzisë
Dhe ziente këngë e mirë.

Po Bërnsi kurrë s'kish dëgjuar
Çudira prej jeziti
Ky Xhoni ishte i tërbuar,
Po jo si Rrush-Rushiti!...

PLESHTI

poemë

1.

dhe i zi.
Ky emrin e kishte Plluc,
I thoshin edhe Pleshtuc,
I ati emrin e kishte Prrështan,
I thoshin edhe Pleshtan,
I dashur lexues, mos qesh,
Kur emrin në pleshta ta gjesh;
Se xhuxhat janë të vjetër,
Dhe emri u duhet patjetër.
E shihni si Plluci i zi
Ra brenda në dashuri?
Filloi akoma të nxihej,
Filloi akoma të ligej...
I ati e shihte e bëhej vrer:
— Pse Pllucit shëndeti s'i merr?

2.

Një natë i foli
ngadalë
në vesh:
— Ç'të dhemb,
Mos të hyri
një gjemb,
O djali im
plesht?...
Nuk fliste
pleshti bir,
Nga xhami i dritares
veç bënte
sehir,
E bënte sehir
xixëllonjën e bukur,
Meraku
në gjoks
i ish futur...
I ati pranë — në bisht,
I biri në gojë — një gisht,
Hic!

— Oi,

më lojti mendsh

Më gjeti

djali,

Fol halli!

një fjalë,

Eh, o bir!

vuan e bën

Djali hiç, sehir!

Në bisht!

Ç'ke,

o biri im

Pse hesht? plesht,

Ç'të bësh?

Hidhu njëherë,

Të nxjerrësh qederë,

Hidhu

fësht

Dhe pësht!

Hidhu,

të keqen babai,

Se zura të qaj!

Babaj ka dëshirë

të bëhesh

Të bëhesh, gaztor,

Të shkosh aktor,

me shokë

Të ndjekësh në shkollë,

Institutin e Artit,

Se ke edhe mendje
të hollë,
Që është thesar
i thesarit,
Se jemi një soj
aq i vjetër,
Sa s'gjendet
në botë
soj tjetër.
Mjaft ndenje
në xham,
O xhan!
Bëj fësht
Dhe pësht!

3.

Dhe Plluci
tha:
— Baba,
o baba! —
I foli Prrështani:
— T'u bëftë babaj,
o biri im
plesht,
Thuaja
babajt në vesht! —
— Baba
Prrështan,
Shiko
në xham!
Prrështani baba
e mori vesh
menjëherë

Dhe hop
në derë!
Mendja i tha
se Plluci i tij
Kish rënë
brenda
në dashuri!
Ndaj ish
në merak,
Ndaj ish
në maraz,
Ndaj ish
në farmak.
Ah,
ç'qenka
kjo
dashuria!
T'u sjellka
vërdallë
shtëpia!
Të bëka mornica-mornica,
Sikur të mbushkan me spica.
Të bëka
vend të mos gjesh,
O plesht!
Prrështani u ul në bisht
Dhe ngriti një gisht:
— Ah,
ti dashke
xixëllonjën,
Ta sjell
sa të hapësh
— Atë e dua,
babat,

Dhe po nuk e mora,
nuk ha!

Ajo
më pëlqen
aq shumë,

Sa fësht
kërcej
në gjumë

Dhe hidhem
në tra,

Baba,
o baba! —

Dhe pleshti bir
në faqe
lotët
i ranë.

I ati plesht
i rrinte
pranë,

I ati plesht
ia fshinte
lotët
e shkretë

Dhe qante
vetë:
— Të keqen
babaj,

Mos qaj,
Se edhe unë
lotët
s'i mbaj!

Jam plak
E bëhem
merak!

4.

Kapedan Prrështani
 Rrëmbeu jataganin,
 E tundi në erë
 Dhe hop
 në derë.
 U nis në dyzet shtëpi:
 — Im bir, Plluci, ka rënë brenda në dashuri;
 Të mblidhemi
 të bëjmë
 kuvend,
 Plluci
 për nuse
 po mbetet pa mend! —

5.

Dhe dolën
 nga vrima
 e postiqe e tesha
 Treqind pleshta
 e pleshtesha
 Dhe thanë:
 — Oi,
 o më i miri
 i pleshtave,
 Do shkojmë
 ta gjejmë
 nusen
 vreshtave.
 Ne,
 mblesët pleshta,
 s'të lëmë
 të vuash,

Mjafton

që nuse
të duash!

Ku gjen ajo

një djalë
si ti
topolak,

Që hidhet

hop
në prag;

Ku gjen ajo

një burrë
kaq namusqar,

Akrobat,

kërcimtar!

Ku gjen ajo

një burrë
që di kaq valle,

Që ka fituar

në tre festivale,

Që ka marrë

Tri herë

çmimin
e parë! —

Tha pleshti baba:

— Bah!

Im bir

po më nxjerr
nga shtëpia,

Ju pleshta,

e dini
ç'të bën
dashuria!

Të ngre
edhe qimet përpjetë,
Të bën
të matesh me retë,
Të bën
të futesh në dhe,
Bre!
Ah,
dashuria pleshtore,
Mizore!
Dredhore!
Të bën fësht
Dhe prrësht! —
— Tamam
ashtu do të jetë,
Kapedan Prrështan,
i madh e i urtë,
Ti ke
aq të drejtë,
Sa edhe neve
na lëvizën
Vërtet pak trutë;
s'e lëmë pa marrë
Atë xixëllonjën që bredh
nëpër arë.
Ajo do pranojë patjetër
Të lidhet me sojin
e vjetër.

Ne kemi
kulturë
Dhe gjak
të kuq
nën lëkurë... —
Kështu
e kështu
i thanë
Prrështanit
plak
Në dyzet shtëpitë
sa shkeli
në prag.

6.

Dhe u nisën
në vreshta
Treqind mblesë
pleshta!

Hopa,
Hopa,
Në driza,
në gropë!

Hopa,
Hopa,
Në hithra,
në shqopa,
Në sheshe,
në vreshta
Treqind
pleshta!

Merrja
këngës,
plesht,
Mos
hesht!
Të hapet
kënga
pleshtore
Në lugje,
bregore:
«Ne jemi pleshta,
Ne s'kemi eshtra,
Përpara!
Ne — elastikë,
Ne s'kemi frikë,
Përpara!
Pér kërcimtarin
Nusen ta marrim,
Përpara!
Një xixëllonjë
Gosti do shtrojë,
Përpara!
Ne jemi mblesë
Me sy, me veshë,
Përpara!
Një xixëllonjë
Do bëhet zonjë,
Përpara!
Jemi gaztorë
Në plot taborë,
Përpara!
Ne s'kemi gjumë
Se kemi punë,
Përpara!
Ne mirë rrojmë
Me thumb thumbojmë.
Përpara!

Ne prrësht kërcejmë
Dhe frësht dëfrejmë,
Përpara!
Kush bje në gjumë
E shpojmë shumë,
Përpara!
Kush fle në postiqe
Ka plot rreziqe,
Përpara!
Kush mban kolltuqe
Ne kemi huqe,
Përpara!
Kush dergjet shtrembër,
I dalim në èndërr,
Përpara!
Ne jemi pleshta,
Ne s'kemi eshtra,
Përpara!
Përgjojmë natën,
Të kallim datën,
Përpara!
O fis pleshtar,
Thumbo e korr,
Përpara!
O soj ziosh,
Mos irri bark bosh,
Përpara!
Sulmo çdo prag,
Jeto me gjak,
Përpara!

7.

Dhe u takuan
pleshtat

Me xixot
në vreshtat.
Dhe qindra
xixa
shkëlqenin
në fletë
Plot jetë
Dhe vesa
nxirrte
ylberë
të kaltër,
Dhe sheshi
lëshonte
tinguj
të pastër,
Si gota
me xham
të kristaltë.
Xixëllonjat
me yje
në ballë
Dhe xixot
me yje
në gjokse
Këndonin
e hidheshin valle
Të zënë
për dore
si shokë
e shoqe.
Dhe vreshta
krejt vetëtinte
E gjelbër,
e kaltër,
e bukur

Si krahët
në flutur...

Nga dritat
pleshtat
dolën
në shesh,
Tamam siç ishin
xhuxha
korrozinj
si lesh.

Dhe thanë
pleshtat
me vete
pësh-pësh:
«Uh,
këtu,
sa qenka
shëmtuar,
ç'të bësh!

Mes kësaj drite
të keqe
mendimet
të humbin

Dhe s'ke ku ta futësh
as thumbin!

Kjo qenka
një dritë
kaq e pështirë,

Ne jemi
më mirë,

Se kemi
përreth
errësirë.

Atje mendimet
s'na humbin.
Se kemi ku fusim thumbin!

Këtu e paskan
me lepe
e peqe,
Uh,
ç'atmosferë
e keqe!
Po nusja jonë
e mirë
Do vijë
me ne
në errësirë.
Shpëtimin
e saj do ta gjejë
Në botën
pleshtore
me gaz
do dëfrejë!»
Kështu
u takuan
me treqind
xixo
e xixëllonja...
Tha pleshti i madh:
— Plesht,
thoja! —
Dhe foli
më i vjetri
nga pleshtat
Në vreshtat:
puff,
çuff:
— I biri i kapedan Prrështanit të dëgjuar
Pardje me vajzën tuaj qenka dashuruar.
Ju kapedan Prrështanin do ta njihni
Më mirë akoma, kur krushqi të lidhni.
Krejt fisi ynë mburret me Prrështanë,

Ai lufton me shtatë jataganë!
Po njërin jatagan e mban në dhëmbë
Dhe gjashtë jataganë mban në këmbë.
I biri i tij Plluci mëson për artist
Qëndron me këmbë lart, po dhe në bisht!
Po kapedan Prrështani ka çifliqe,
Një mijë centimetra vend postiqe,
Jo centimetra thjesht, po katrore,
Që mund të rrojnë pesëqind tabore;
Ka katër milion milime.ra vend minderë,
Ku pret me qindra mijra miq me vlerë.
Pardje kish ardhur prift' i tartabiqeve
Dhe mbeti i hutuar prej çifliqeve
Dhe piu në një minder raki të kuqe,
Se edhe prift' i tartabiqeve ka huqe.
Dhe kapedani erdh më qejf prej miqve,
Premtoi të merrte fenë e tartabiqeve,
Po prifti mori vetë fenë e pleshtit
Dhe mbrëmja fluturoi në qiell të qejfit.
Po ju s'e njihni kapedan Prrështanë,
Që prifti tartabik i dha dy jataganë...
Kjo ishte biografia e Prrështanit,
Treguam shkurt që mirë mend ta mbanit,
Se po të doni, flasim dhe më gjatë,
Po, do na duheshin tri ditë dhe një natë...
Me kaq ia bëjmë fësht
Dhe pësht!
Prandaj

ne erdhëm
në vreshtat,

Se duam të bëjmë
Më i miri
Ka rënë
krushqi;
nga pleshtat
në dashuri:

Ka rënë në dashuri
e nuk ha
e nuk pi,
Nga mendja
s'e heq
çupën
tuaj
Dhe hop
vuaj!
Ne Pllucin e kemi
yllin
e pleshtave.
Ne Pllucin e kemi
armik
të gënjeshtave.
Plucci
çdo natë
kush fle
nën jorgan.
E pret
me jatagan!
Se ka
trimëri të marrë,
Kreshnik si
ai
Po u fut
s'keni parë!
Për nder, nën jorganë,
Po u fut
bën hatanë!
Ec pa
në postiqe,
hiqe,
Vdiqe!

Po t'u ngjit
 në kurriz,
 Të shpon
 si murriz!
 S'më bie
 të mburrem
 se jam
 modest,
 Po ju
 e dini
 se ç'domethënë
 plesht!
 Dëgjuam
 se çupa
 juaj është e ndershme
 Dhe ruan
 ca zakone
 të herëshme;
 Ne djalin
 e kemi
 xhevahir,
 Dhe shumë
 nikoqir,
 Nuk prish
 asnjë pare,
 Kur shkon në pazare.
 A, ka edhe huqe,
 Pi verë
 të kuqe,
 Po pare
 s'prish
 kurre,
 Se pi
 nën lëkurë!
 Pastaj
 di kaq valle

Dhe ka fituar
në tre
festivale

Dhe ka marrë
Tri herë
çmimin
e parë.

E dimë
se çupa juaj
e rritur

Do jetë e denjë
në bregore,
për vatrën pleshtore,

Do jetë më ngrohtë
diku në postiqe
se sa në vreshta,

Alegro do shkojë
se ne jemi pleshta,

Artistë
të shkathët

Me titull:
të zgjedhur,
«Hedhur»

Dhe hidhemi
hop!

Ta pimë,
pra,
plot,
bromb!

Ne ju nderojmë
si sua,

Që kur se duam
një grua,

Vërtet ju s'jeni
aq trima

Dhe s'dini
të futi
në vrima,
Po keni
zakone
fisnikë
Dhe pikë!
E jepni,
E marrim,
Sa kemi
beharin!...

8.

Kështu tha
më i vjetri
i pleshtave
Dhe hop
kërceu
vreshtave
Dhe përr-përr-përr
fletët
Në degët...
Treqind xixo
e xixëllonja
dëgjonin
Treqind pleshta
përgjonin.
U ngrit
e tha
më i vjetri
xixo
në vreshta:
— Ju faleminderit,
o pleshta!

Më mirë

ju pyesni

nusen

se ç'thotë,

Se fjala ime

do jetë

e kotë.

Ne s'japim e s'marrim

me mblesëri,

Ne japim e marrim

me dashuri.

I bëni kapedan Prrështanit selam,

E dimë që ka jatagan,

Po ne zakonet tona i mbrojmë

Dhe çupën e pyesim kur e fejojmë. —

Pastaj më plaku xixo thirri çupën sheshit,

Se donte t'i përgjigjej pleshtit:

— Xixi e bukur,

Eja, ku je futur! —

Dhe erdhi dalngadalë në shesh Xixia,

Rrethuar nga kurora me shkëndija,

Dhe gjithë sheshi ndriti dhe më shumë,

Dhe rrezet bënë valë si një lumë.

Dhe pleshtat — mblesë vesh më vesh seç thanë:

«Çuditemi me kapedan Prrështanë!

Nuk qenka kaq e bukur kjo Xixia

Na paska ca gjerdanë me shkëndija

Pleshteshat tona janë më të pashme,

Xixia qenka shumë e javashme.

Pleshteshat tona sa t'i shohësh hidhen

Dhe këmbët si këtyre nuk u lidhen;

Kjo s'paska turp, kjo rri e të vështron,

Kjo kushedi sa burra dashuron.

Ky kapedan Prrështani s'e ka mirë,

Që merr një imorale për të birë!

Ne kot e mburrim fisin e tyre,

Ç'të bësh! Në valle do kërcesh, po hyre!»
Dhe u dëgjua zëri i Xixisë:
— Përse më thirrët prej shtëpisë? —
Aherë më i vjetri xixo tha:
— Më i miri i pleshtave ka shtënë sevda! —
Dhe mblesët pleshta
mbajtën vesh
xixëllonjën,
Se ç'fjalë do të thosh,
kur të hapte
gojën.
— Plesht?
S'dua
t'ia shoh
bojën!
Se unë
kam Xixanin
tim
Në fluturim.
Xixanin
tim e dua
Një Plluc
s'i vjen
as gjer në thua!
I thoni kapetan Prrështanit,
Se unë s'bëhem plaçkë e dyqanit.
Sikur ta marrë vesh Xixani im,
Do derdhet përmbi mblesët me tërbim.
Xixani sonte ka një konferencë
Dhe flet për dituri e shkencë.
Sikur të ndodhej sonte, mor të mjerë,
Do bëhej plot rrëmujë dhe poterë!
Po ikni sa pa ardhur vrap Xixani,
Se flakë do të ndizet krejt mejdani! —
Mbaroi Xixia fjalën dhe ktheu krahët
Dhe mblesëve u erdhi shumë tharët.

Treqind mblesët — pleshta
 Në vreshta
 Me treqind xixot
 u zunë
 me fjalë:
 — Na falni,
 po qenki imoralë;
 Ju s'paski zakone me kripë,
 Se s'paski cipë!
 Ju qënki tepër vagabondë,
 Gënjeshtren e përhapki si një modë!
 Ju paski një Xixi të ligë,
 Ta kishim ne, e vinim shpejt në thikë!
 Ju qënki vërtetë
 truthatë,
 Ju heqin për hunde
 gratë!
 Përr,
 Përr,
 Për perëndi,
 Hiç,
 Hiç,
 Hiç s'lidhim krushqi!!
 Fat,
 Fat,

Fat qenka pér ne,
S'u,
S'u,
S'u lidhëm me fisin tuaj me fre!
Dhe ikën
mblesët — pleshta
Nga vreshta.
Hopa,
Hopa,
Në driza,
në shqopa,
Hopa,
Hopa,
Në brazda,
në gropë!
Dhe këngë
s'këndonin,
po shanin
Dhe nganin:
— Hajvanë,
Hajvanë,
Ah, që s'u kemi
Diku
nën jorganë,
Ah, ç'do t'u bënim
me jataganë!
Ah, që s'u kemi
Diku në postiqe,
T'u shponim
në vithe!
Na zutë
veshët
gër-gër e gër-gër,
Po dimë dhe ne
të bëjmë
përr-përr!

Hopa,
Hopa,
Në sheshe,
Në vreshta
Treqind
mblesë — pleshta!

10.

Dhe erdhën
te dhëndri
tym,
Të zinj
si gjym.
Të treqindët
u shtruan
në postiqe,
I thanë
të parit:
— hiqe!
Hiqe
llafin
nga goja,
Ç'na tha
xixëllonja!
Dhe foli
i pari:
— O më i miri i pleshtave,
Mos u marto
me atë
që bredh
vreshtave!

Ajo

njëzet e ca burra
ka ndarë,

Ajo

njëzet e ca burra
ka marrë,

Ajo

farmak
e ka gojën

Dhe tha

se pleshtit
s'ia shihte dot
bojën!

Ajo

na qënkësh
një zuskë

Me krushk

e me krushkë!

Ajo

na qënkësh
një ashkël
e hedhur

Me bisht të përdredhur!

Ajo

nuk paska
as nder
as respekt

Dhe kurrë

me të mos u pleks!

Ata

nuk qenkan
fisnikë

Dhe pikë! —

Iu ngritën mustaqet

kapedan Prrështanit

Dhe dorën fap

jataganit:

— Prrësht,

Frrësht!

I preva,

I griva,

I shtriva!

Prrrësht,

Frrrësht,

Ca palo xixo që s'kanë seç hanë,

Të shajnë kapedan Prrështanë?

Ca palo xixo bilmesa

Më fyen mblesë dhe mblesa!

Prrrësht,

Frrrësht!

I shtriva,

I griva!

Dëgjoni, o burra, të fisit tim pleshtor,

Harram e paçi gjakun njerëzor!

Na erdhi koha, o Plluc,

Ta bëjmë sheshin nga gjaku të kuq!

Ta marrin vesh anembanë

Se ka kapedanë Prrështanë!

Prrësht,

Frrësht!

Kam priftin tartabik

Mik

Bekimin e tij me vete e kam

Këtu në jatagan!

O prifti tartabik,

Që hëngre e pive me mua tri netë,

Ma jep dhe njëherë bekimin më vete!

O prifti tartabik,

O mik!

Uroje së largu kapedan Prrështanë,

Të bëjë hatanë,

I shtriva,
I griva!
Një zuskë
që bredh
vreshtave,
Të shajë
sojin
e pleshtave?! —
Kur dëgjoi
pleshti bir:
— Firr!
Ah, si s'e kam,
Këtu nën jorgan!
Fap,
jatagan!
Baba plesht
Mos hesht!
S'e dua
për nuse
Se ka plot minuse!
Nga nuset
kam frikë,
Pikë!
Ta kapim;
Barkun
t'ia hapim! —
Tha pleshti bir
Dhe
firr!
Dhe
hop!
Në shkop!
Tha pleshti baba:
— Plesht bir,
Bëj sehir!

Dhe

hop

në tra!

Pésht

Dhe fësht!

11.

Dhe u nisën

të kapin

xixëllonjën

Që s'donte t'ua shihte

bojën,

Që shau

vreshtave

Sojin

e pleshtave.

Plesht bir,

plesht baba

Nga!

Ikë

Pa frikë!

Fap

Rrugën hap!

Bumb

Si plumb!

Shaj

Kusur mos mbaj,

Të keqen babaj

Hopa.

Hopa.

Në gurë,

Në gropë!

Puf!

Yxhym me duf!

Ah,

Xixëllonjë,

T'u thaftë

ajo

gojë!

Firr!

Bëj sehir!

Plaç

Në daç!

Qesh

Në shesh!

Dhe kapedan Prrështani me furri

E nxori pallën nga këllëf i zi

U hodh e thirri zymtë mbi një thanë:

— Pa dilni shihni kapedan Prrështanë!

Se kapedan Prrështanë me të birë

Ju ende nuk e keni njohur mirë.

Ku je, o fis i dritës lajkatare,

Që po m'i prish gëzimet familjare!

Ku je, o fis i djajve imoralë

Pa din e pa iman në ballë;

Ku je, o fis me xixa i dreqosur,

Ky jatagan qysh sot e ka vendosur

Të bëhesh shkrumb pa llaf e pa mëshirë,

Ose të vish me pleshtat në errësirë!

Të bëhesh rob i kapedan Prrështanit

Dhe yzmeqar nën teh të jataganit.

O fis shejtan, ma nxirr në shesh Xixinë,

T'ia bëj me vrima gjoksin dhe turinë,

Xixinë që pati sy e faqe

Të shante Pllucin, trimin me mustaqe,

Dhe bashkë me një laro të harbojë,

Me një Xixan, një karafil me bojë!

O ju, dëgjoni kapedan Prrështanë,

M'i nxirrni shpejt Xixinë dhe Xixanë

T'i shoh kur Plluci im në shesh t'i therë,
T'u pijë gjakun dhe t'u marrë erë!
— Baba Prrështan — tha Plluci menjëherë
Do t'i thumboj, po nuk do t'u marr erë,
Se po i mora erë, më teshtihet
Dhe kur teshtij, më flihet! —
— E, mirë, Plluc, kjo hiç nuk na prish punë,
Mos i merr erë, se teshtij dhe unë!
Mos thirrë, se ky vend ka vesh spiuni!
Dhe na lëshojnë erë e na merr gjumi
Pësht,
Shët!

12.

Kur heshti pakëz kapedan Prrështani,
U derdhën mijra xixa si tufani
Tufani ish prej drite aq të bardhë
Sa dukej edhe qimja në një dardhë.
Sa dukej dhe gjilpëra mes një sheshi,
Sa dukej dhe mustaqja e një pleshti
Dhe kapedan Prrështani i hutuar
I zuri sytë shpejt e shpejt me duar
Dhe tha i dëshpëruar dhe i gjorë:
Këta rrufjanë kanë projektorë!
O Plluc, mbulo me duar të dy sytë,
Që dritë e poshtër sonte mos na mbytë!
— Lele, bobo, — tha Plluci — s'dua nuse,
Më mirë haj të futemi në puse!
Lele, o babi, ç'deshe që na vdiqe,
Të shkojmë dhe të hyjmë në postiqë!
— Pusho, mor Plluc, se trimi kurrë s'qan
Se edhe qorr, do grij me jatagan!

Sa vinte drita, bëhej më e madhe
Dhe llamburisnin vreshta dhe livadhe.
Në mes të dritës derdhur si tufani,
Qëndronin tok Xixia dhe Xixani.
Dhe mijra xixo shkrepnin, vetëtinin
Dhe shpatat krejt të bardha lart i ngrinin,
U ndje një zë i mbushur plot me dritë
Dhe natën me rrëmbim e bëri ditë.
— Ti kapedan Prrështani ku ke hyrë,
T'i shohim dhe mustaqe dhe fytyrë!
Të dogjëm shkrumb po hodhe dhe dy hapa,
Se fisi ynë kurrë s'kthehet prapa!
Dëgjoi me dhembje kapedan Prrështani
Dhe iu fundos këllëfit jatagani.
I tha të birit Plluc me shpirt të gjorë:
— Ah, s'ke ç'i bën, se kanë projektorë! —

13.

Dhe kapedan Prrështani me të birë
Ia nisën vrapijt shpejt në errësirë.
Po duke ikur panë një shkëndijë,
Që ra në mes të barit në një brinjë.
Dhe Plluci thirri me zë pleshti,
Me gaz të madh sikur ç'e gjeti:

— Baba

e kapëm
xixëllonjën,

Që s'donte

të na shihte
bojën! —

Baba plesht,
Bir plesht,

Hop
në shesh,
Qesh!

14.

Ah,
ajo
s'ish xixëllonjë,
po shkëndijë
oxhaku!
U dogjën
pleshtat,
biri
dhe plaku...

1970-1976

3. Kënga e komunistëve



K O M U N I S T È T

poemë

1.

Kalon një kohë e duke udhëtuar
Mes vargjeve e këngëve të mia,
Tek ju qëndroj i heshtur, i menduár,
Si udhëtar i kthyer tek shtëpia.
Dhe ndjej se ju kudo më mbani vesh:
Se ç'këngë ngriti shoku juaj, vallë,
Tek brodhi mal më mal e shesh më shesh,

Tek fjeti

në kantiere e mullarë,

Tek rrugën mori

tej diku

në botë

Larg vatrës prindërore dhe oxhakut,

Tek heshti

i trishtuar

mbi një gotë,

Kur mendja

fluturoi

me vrap

te praku...

Dhe gjoksi zemrën time zë e shtrydh:

Mos vallë vargjet

vlagëن nuk e kanë,

Mos vallë vargjet

kanë zënë ndryshk?

Vaditmini,

vëllezër,

në m'u thanë!

Në se mes tyre

fshihet

helmi i verdhë,

Siq fshihet një kapsollë nëpër prush,
Më shkundni rreptë

Ma vishni

dridhma të më zerë,

në surrat

Mos druhi

me grusht!...

Mos trembi

se më hipën pesimizmi,

Kështu na qënka thënë,
se vras veten si bohemë;

komunizmi

Nuk dashka

tar-na-na

nëpër poemë!

2.

Kalon një kohë,

e shoh

se bota juaj

E tëra s'hyri dot

në vargun tim;

Aherë

ankthi më pushton e vuaj,

Ahere

zhytur rri në dëshpërim

Dhe them:

në djall të vejë poezia,

Kur s'ngrihi ju

në vargje

si legjenda

Me madhëri

epoke,

historie,

Të thinjur

e të rinj

si jetë.

A
LL
D

3.

Nga dolët ju,

nga erdhët ju,

vëllezër,

Mes maleve
e shpateve
hanxharë?

Ju s'kishit
ndonjë filozof me mjekër,
Që t'ju drejtonte
gérxheve
shqiptarë.

Ahere
filozofët
pinin kafe

Në bar
«Kursal»
a restorant

Me krëhër italian
«Evropa»,
Dhe qeshnin
krihnin mustaqet

Ahere
e tregonin anekdota.
filozofët
psherëtinin:
«Oh,
jeta!

C'domethënë
Dhe hapnin
kjo zuzare?».

gojën
në dremi
«Allah
e flinin:

e Krisht,
na shkoftë
puna
mbarë!»

Nga dolët ju?
 Ju s'patët historianë
 Të zverdhur nga reliket në arkivë,
 Se historianët rrin
 rrin në mejhane
 Dhe çmalleshin me vithet e çengive.
 Ndërsa në mal të ritë tonë
 vyshkej
 Dhe nëna s'kishte gji për kalamanë
 Dhe burrëria për ca misër ndryshkej
 Dhe gjethi kalbej sipër në muranë;
 Ndërsa në gjole ethet drithërimin,
 Peshonte burri dyzet kilogram,
 Korriku në dyshek e fuste dimrin
 Dhe varret në varreza s'zinin bar.

5.

Në tokën e munduar
vérshéllente

Kamxhiku
tok me vojtjen
e me erën;

Hajduti pasanik
mbi barin
shkelte

Dhe vidhte
muskujt,
nderin
dhe pranverën...

Çatitë
s'dukeshin

Dritaret
nga natë e rëndë.

Dhe zogjtë
s'dukeshin
nga errësira.

Dhe cicërimat
flinin
futur nëpër pendë

Kish zënë nata
shuheshin
të mpira.

Kish zënë nata
palcëzën e pemëve,

Kish zënë nata
zemrën e kujtimeve,

Kish zënë nata
vargjet e poemave,

Nën peshqit,
lëngun e blerimeve.
karavidhet
e mushkonjat

Këneta

llokoçiste

turbull-turbull,

I kishte marrë

muzgu

xixëllonjat

Dhe në krater të gërxhit

i kish futur.

Gërmadhë e kalbur

mbushur myk të vjetër

Në gjakun njerëzor

po shtrinte

napën,

Vetmira

e shkretëtira

kish në zemër,

Gjarpinjtë

kishin marrë

egër

arpën...

6.

Dhe shekulli

ahere

ish ngarkuar

Me bomba,

plumba,

topa

dhe helmeta,

Vërtitej

gjithësisë

e rënduar

Me hekur,
tanke
e filil
planeta.

Vraponin
aeroplanët
botës mbarë,

Vraponin
trenat
plot gjëmim
e frikë,

Ngarkuar
me rekrutë
e ushtarë,

Ngarkuar
me fantazma
dhe mehitë.

Të dukej
se planeta

Pa njerëz
do vërtitej
veç me kocka

Dhe dielli
paskëtaj
mbi gërmadha
Në qiel
do të ngjitej
plot me dhembje

Por jo!
dhe me vaj.

Njeriu
akoma
nuk kish vdekur,
Njeriut
në dorë
i vetëtinte
palla

Dhe ziente
«Internacionalja»
nëpër shekull

Mbi hekur,
tanke,
bomba
e kokalla.

Ahere
ju u ngritet
për të mbjellë

Në zemrat flakë
farën

T'i hidhnit
natës
komuniste,

Mikrob i saj
veç një grusht me djellë,
në gjakun njerëzor
të vdiste.

Në gjoks
të barrikadës botërore

E conte grushtin
rreptë
Shqipëria

Dhe tingujt
«Internacionalja»
në llogore

I niste
të përflakur
nga liria.

Dhe trup i tokës
shpuar
e gjakosur

Me plumb
të mitralozëve të huaj,

Si trupi
i një vajze të plagosur,
E thithi
pambarim
ozonin
tuaj...

7.

Nga dolët ju,
tregojnë
vetë
malet,
Tregojnë
rrugët,
sheshet e qyteteve,
Ku bridhnin
varfërítë edhe hallet,
Ku shtypte
shpinat
peshë e rëndë e derteve,
Ku shkelte
çizme e huaj
në kalldrëme,
Ku kish çdo vrimë gardhi
bajonetë,
Ku merrte flakë
gruri i ri
në lëmë,
Ku qanin
për të zotin
qetë.

8.

Nga dolët ju?

Ju s'mbitë

nga mérzitë

Mes ballosh

në sallone a bankete,

Siç mbijnë

nga mérzitë

sot

hipitë,

Që fryjnë

nëpér ishuj

e qytete.

9.

Nga dolët ju

tregojnë kovaçanat,

Që mbetën

në muzera

si relike;

Tregon

shtëpi e vogël

në Tiranë,

E vogël

si kaike...

Po kjo kaike

çau një det

epoke,

Se kishte

mjeshtër

bijtë e kësaj toke,

Ndaj kurrë nuk u mbyt

mes dallgëve,

Ndaj kurrë s'u fundos
prej plagëve.

10.

Vajtuan

«baballarët kombëtarë»:

«Lele!

Ai ju mblodhi
në kaike
T'ju mbysë,
o çiliminj
të marrë,

Lele!

Fëmijë
të etur
për rreziqe!»

Ndërsa

kaikja
çau,
u bë torpedë,

Paçka se ziente

bota
nga stuhia,

Paçka se ziente

qielli
nga rrufetë;

Se kush u mbyt,

e shkrojti
historia...

11.

Ai që ju mblodhi

natën e Nëntorit

Tridhjetëtrevjeçar

aherë ishte,

Me vete kish

mësimet

Dhe Marksin

e Totorit

Po «Kapitalin»

e Leninin kishte.

S'jua shtroi

dhe «Materializmin»

në tavolinë

si llokume:

«Ja,

hani

pak llokume

komunizmi,

Ja,

hani pak

dhe gjumë»...

Ai ju tha

se Marks

dhe Lenini

Mësohen

nëpër krisma

mitralozësh,

Ku grykave

gjëmon

e pret thëllimi,

Ku derdhen

nga çatitë

copra

blozësh.

Kështu

ju tha

atje

rreth asaj

vatre

Në një shtëpi të vogël

Kur ndezi

në Tiranë,

komunizmin

Në qellin

atë natë

shqiptar

me tramundanë.

12.

Ai

dhe mund të rrinte

Të lozte

qetë e ngrohtë,

në «Kursal»

Bile të merrte

a hotel «Dajti»,

udhën

Me një valixhe

nëpër botë

nga t'i queshte

Ai

fati.

mund të qëndronte

Të priste

dhe në Francë,

dhe të kthehej

S'ka pasur,

për vakancë

vallë,

Që hiqnin

«revolucionarë»

në vakanca

këmbën

zvarrë?

A s'ka tē tilla
koka
që nē botë

Shëtisin
me valixhe
e me çanta,

Mbi Marksin
dhe Leninin
derdhin
lotë,

Në vend tē pushkës
zbrasin
pjata?...
A s'ka tē tilla
koka,
që nga Moska

Drejtojnë
gjer nē Alaskë e Honolulu,
Tek hanë borshin rus,
tek brejnë kocka,

Tek Dusjes i lëpihen:
«Dusja,
ulu!»

13.

Të tillë
Enverin
nëma
nuk e lindi;

Rënkimin popullor
kur ndjeu ai,

Evropën e Parisin
e braktisi,

Kur malesh
vihej koka
në tepsi.

Atë e thërriste
dhembja popullore

Dhe ju kërkoi
në brigje e në male,

Dhe ju kërkoi
në puset vajgurore,

Dhe ju kërkoi
në shpate e moçale.

Dhe etja
kur e mori
s'shkoi në «Dajti».

Të pinte «kronenburg» a limonatë,
Po piu mes vapës
ujë
në gjurmë kali,

Tek ish mes jush
me ditë
e me natë...

Me të në ballë
çetave,
brigadave

Ne çamë katër dimra
të përgjaktë

Nën zjarrin
e mortajave
e kanonadave,

Në rrugën
e vështirë
c të gjatë...

Kur qeverisnin
 mbretrit
 Shqipërinë,
 S'kam qenë
 as artist,
 as vjershëtar;
 Sikur të kisha qenë,
 poezinë
 S'ua kisha falur
 kurrë,
 gjer në varr...
 Më mirë
 trupin
 baltrash
 ta zvarrisja,
 I lodhur,
 i munduar
 dhe ulok,
 Më mirë
 krahët
 gjer në bërryl
 t'i prisja,
 Se sa të belbëzoja:
 «Rrofsh,
 o Zog!»
Për Enver Hoxhën
këngë
thur
tërë jetën,
 Se nëna ime
 bukë i dha me dhallë;
 Me të
 në dhomën pa tavan
 ne fjetëm,

Na puthi ne,
fëmijët,
mu në ballë.

Na puthi ne,
fëmijët e rreckosur,

Na puthi ne,
fëmijët e tymosur
Në tymin
e kandilit

Të zverdhur
prej rigonit
e të pishës,

Dhe pa
në sytë tanë

Dhe pa
ata

që ngrenë sot turbina.

15.

Dhe pa
fëmijët,
Dhe pa

bijtë e partizanëve,

fëmijët,

bijtë e shamizezave,
Që nuk u ndriti gusha

Po mbajtën dru
prej gjerdanëve,

mbi shpina
ferrave,

Po ndreqëن	strehët	-
Po hodhën	e rrënuara,	
	farë	
	në arat	
Vajtuan	e shkretuara;	
	në minder	
	të vrarët	
Dhe qumështi	maleve	
	iu tha në gjoks	
Po gjokset	prej hallevë;	
	mbanin ëndrrat	
Që fluturonin	aq të bukura,	
	gjeth më gjeth	
	si flutura;	
O ëndrrat		
	e nënokeve,	
	të mirave,	
Që u dhanë		
	bijve	
	edhe bijave	
Të pinin sisë		
	plumbave	
	e shirave,	
Të pinin sisë		
	tymrave,	
	shkëndijave,	
Shkëndijave		
	të arave	
	të djegura,	

Thërrmijave
 të misrave
 të pjekura,
Po kurrë s'thanë:
 placi,
 partizanë!
Me lot
 e qumësht
 plagët ua lanë.

16.

Fëmijë,
 ku ta dinim ne
 aherë,
Se vendi
 do na thosh:
 tani në dorë
Do merrni
 banka,
 trena,
 buldozerë,
Fabrika,
 ara,
 varka dhe vaporë...
Fëmijë,
 ku ta dinim
Do piketonim
 se një ditëz,
 Fierzë
T'i lidhnim
 e Va Dejë,
 tela
Mokrës
 dhe Mirditës

Dhe maleve
t'u thoshim:
eh,
me lejë?
Me lejë,
male?
Lërnani
Miliarda vje:
diçka ju keni mbledhur,
Me xhevahire
keni bark të majmë,
Na jepni
xhevahiret
mbajtur fshehur!
S'i duam
xhevahiret
për konakë,
Që muret
të na ndritin prej stolive,
Se s'jemi bijtë
e kontërve
Po jemi bijtë
guakë,
I duam
t'i shpérndajmë
e komunistëve.
Nga malet e Vermoshit
nëpër popull,
Se ne s'harrojmë
natën
me dëborë,
Kur ndau nënoja
gjysmën
e minderit

Dhe pranë vatrës
në odëzën e gjorë,
I shtroi
të flinte
tok me ne
Enverit.

17.

Ku jeni ju,
o miqtë e mi
të mirë,
Dyzetvjeçarë
të djersirë,
Në uzina,
grunjra,
vreshta
e në misra,
Punëtorë,
bujq,
poetë
e ministra?
Ku jeni,
miq,
dyzet e ca vjeçarë,
Që mbani
në pëllëmbë
Republikën,
Që shtrydhni
nga lumenjtë e egër
dritën,
Që ndeshi
në OKB
me Amerikën?

Dikur

ju bridhnit

udhes

pa kepuc,

Ju thoshin

partizant:

qeratuc!...

Ju keni qn

ndofta

dhe apkn,

Ndaj edhe trembeshin

pr ju memurt,

Por shpirti i klass

kurr

s'ju ka ln,

Nga kraharort tuaj

s'u tund kurr.

18.

Dikur

dhe un

bja marrzira,

Dhe ndofta

marrzish

kam qen i etur,

Por shpirti

ka vrapuar

nga e mira,

Ndaj udheve

djalosh i ri

kam mbetur.

Jam rrahu

dhe me shokt

n rrugica,

Kam lojtur
 me shkopinj
 në mes të jonxhës,
 Kam hipur
 nëpër dardha
 e gorrica,
 Bile kam shkelur
 mbi qitap
 të hoxhës!
 Kam shkelur
 atëherë
 kur qitapit
 I thoshin
 pleqtë
 libër
 perëndie,
 Po unë
 ia kam varur
 qafës
 Me rebclim
 të madh
 cjapit
 prej djalërie.

19.

Do thoni ju:
 kur mbush
 Fillojnë
 të dyzet vjetët,
 e thahen
 Vëllezër,
 fletët e hardhisë;
 s'vyshken
 gonxhet
 edhe fletët,

Kur mbetet

shpirti i parë

i djalërisë!

Do thoni ju:

po plakesh

në mendinë,

Po bëhesh

dalngadalë

konservator,

Se vargjet

kanë ritëm, kanë rimë,

Se vargjet

kanë shpirtin

popullor...

Ky shpirt

të lulëzojë

varg pas vargu,

Pa vërmëni

llagape

sa të doni!

Atë si simfoni

e ndiej

së largu,

E ndiej

si bubullimë

dhe jehonë.

20.

Ne,

komunistët,

jemi aq modernë,

Ne,

komunistët,

jemi novatorë,

Modernë janë korpuset që ngremë
Dhe novatore — ç'fryte nxjerr kjo dorë!
Moderne janë vargjet dhe romanet,
Kur komunizmi mbin në katër anët.
I dua gjithë vargjet, gjithë këngët,
Të matur, të pamatur e të lirë,
Mjafton të kenë gazin edhe brengën
E. popullit të madh e zemërmirë.
I dua gjithë modat e gëzimet,
Që rruga si në festë le të qeshë,
Mjafton të mos vërshojnë cikërrimet,
Mjafton të mos marshejnë qafëleshët...

Nuk dua

të na humbin

ëndrrat tonä,

Që komisarët

gjokseve

na ndezë,

Ato

s'i ndërroj

me jakë

e pantallona,

Ato

s'i ndërroj

me dy-tri metra bezë...

21.

Rinia jonë,

zog

i kaltërsive,

S'e shuan

kurre

ëndrrën

komuniste,

Këmbehen

modat

stinëve

e viteve,

Po ëndrra

nuk këmbehet

veçse rritet!

O çupa

simpatike,

çupa-flutura,

Ju yj
të vargjeve
të matura,
të lira,

Për ju
do gjejmë
fundet
më të bukura,

Për ju
do gjejmë
basmat
më të mira!

Edhe sikur mos endin
kombinatet,

Do sjellim
deteve
dhe oqeaneve...

Veç mos harroni
nënëzat e ngrata,

Që nuk i hoqën
kömbët
prej nallaneve;

Veç mos harroni
nënëzat e shkreta,

Që mbanin
një fustan
të nusërisë

Një gjysmë shekulli
sepeteve
të vjetra.

Një gjysmë shekulli
në kulm të pleqërisë!

Veç mos harroni
arat
dhe minierat,

Ku balta

edhe tymi i gurit
tundet,

Ku kokrra

e grurit
s'rritet

Ku qymyrguri

s'del nga
minifundet;

E dini se

zharseja
mbin nga gruri

Dhe minifundi

del

nga qymyrguri?...

Më falni

që u bëra i mörzitshëm

Dhe vargjet

po i mbush

me didaktikë,

Me frymë

agitacioni

të përditshëm,))

Pa abstraksion,

po drejt

e në praktikë!

Po ndonjëherë

duhet dhe praktika.

Që thellë

të kuptohet

poetika...

Kalon një kohë
 e duke u menduar
 Për çka këndova
 e shkrova
 Më delni ju
 vjet me radhë,
 përpara
 Me shqetësime,
 të ngarkuar
 munde,
 luftë,
 halle.
 Mes dhembjeve
 të forta,
 Ju lindi
 të gjakosura,
 komunizmi
 nëpër zjarre,
 Që dhembjet
 në karvanë
 T'ia fshinit
 të pasosura
 gjithë botës
 Dhe dhembje
 shqiptare.
 s'kishte pak
 kjo botë
 Një gur të rrokullisje,
 e maleve;
 Rënkinin
 do dëgjoje
 kombëtar
 si ankth të valëve

Në breg të detit
para se të agojë.

Por ju
përveshët krahët
dhe si buaj

Iu futët
Shqipërisë
lënë djerrë

Dhe në djerrinë
mbollët
jetën tuaj

Që s'ishte mbjellë
kurrë ndonjëherë...

Dhe njerëzit
për ju
në flakë
u hodhën,

Se patët
zemrat
njerëzore
hap pas hapi;

Dhe malet hijerëndë
frymë morën

Dhe mijra lule
ish-djerrina
hapi.

Urryet fodullëkun,
pabesitë

Dhe rrënjët
ua kërkuat,
ua shkulët

Dhe te ky vend
i kaltër
dhe me dritë

Me maskarenj

në sofér

nuk u ulët.

23.

Nuk dua
të ndyj
vargjet
në poemë

Dhe emrin
e Hrushovit
të përmend,

Që zvarrë
na u ngjit
si krimb,
Si vemje
mbushur
si vemje,

Ia mbajmë mend
jargë
nëpër krënd...

blokadat,

Të rënda,
djallëzitë,

e të egra
Ia mbajmë mend
e të ashpra;
bërtitjet,

«U shitët
ju
për nja tridhjetë
aspra»!...

Ky personazh

më prish

Se kush u shit

vargjet e mia,

Dhe historia

e shkrojti historia...

S'tregohet me

kockë e vështirë,

banditët

Hrushovin

ia dha varrit

zemërmirë!

Kapituj ruan

pus të errët,

Ndërsa

edhe për të tjerët;

ne ngrihem

në kaltërsitë

Të larë

me mëngjese

e me drithë!

24.

Eh,

ku e ngritëm ne

Atdheun tonë,

Gjëmimet

komuniste

le të thonë!

Ka shumë vjet

që dhëmb për dhëmbi

vemë

Me gjithçka

që marshin tonë

ndal,

Betimin
kemi bërë
që ta shpjemë

Patjetër
komunizmin
gjer në mal.

Premtimin ne ia dhamë
historisë

T'ia fshijmë
vojtjet
popullit nga dolëm,

T'i vëmë krahë
gjithë Shqipërisë,
Ndaj muskujt
edhe mendjen tonë

Ne jemi
dhjetëra mijëra
mbollëm.

Pas nesh
me qindra mijëra
komisarë,

Ne dielli i komunizmit
do të vijnë;

Ne ngremë
na ka larë,
lart
në piedestal

Ne jemi
dhjetëra mijëra
njerinë.

Na zjen ndërgjegja
komisarë,
e klasës
në damarë

Na zjen
si valë e madhe
heroizmi,
Deviza jonë:
Rroftë
komunizmi!

31 tetor 1971

II

Gjrohaster

NËNTORIA ADA
Nëntoriada
poemë
poeme

1. I

Nëntoriada

II madhi Nëntor e hapi sërishmi ditën e parë,
Siç hap në gjoks këmishën njeriu i punës së madhe,
Ngre kokën e zjarrtë dielli mbi malet shqiptare,
Mirë se ardhe, byrazer i përjetshëm, mirë se ardhe!

Tomor e Cukal e Korrab e Gramoz e Kollatë
I vunë mënjanë festet e lashta me yje;
Mandilet e bardha i tund Adriatiku me natë
Dhe ziejnë si miliona fyej lisat e pishat në pyje.

Mbi supet e shoku-shokut i kemi duart e ngrohta
Dhe shkëmb në këmbë qëndrojmë me malet përjetë,
Mirëmëngjes, byrazeri i kuq, i lindur nga zjarri e shqota,
Mirëmëngjes, byrazeri i kuq, që mban në grushte rrufetë!

2.

Po unë me çfarë t'i pres agimet e tua, vallë,
Agimet e tua, ku ngjyej furçën dhe penën?
Partia më tha, si nëna ime, një fjalë:
Dërgo në Kongres delegate poemën!

Vështirë, vëllezër, të marrësh një barrë të tillë në shpinë,
Delegate poema nuk zgjidhet aq urtë e aq butë,
Se duhet ta mbajë si tesra e kuqe çdo varg pastërtinë,
Si tesra e kuqe të ngrejë kushtrimin në punë e në luftë.

Ta marrë në xhep delegati, pa rënë shigjeta e mëngjesit,
I ardhur nga tornot, nga arat, nga pushkët, nga skedat
shkencore,
Ta vëré përkrah diskutimit të tij në prag të Kongresit
Dhe strofat e mia t'i hedhë me laps në fletore.

3.

S'ka ndodhur që mua agimi i Nëntorit, zbritur prej shpatit,
Diku të ma gjejë fletoren pa varg e poemë.
Do ngrihesha edhe sikur të dergesha shtratit
Me age serumi të ngulura thellë në venë...

Se dua të flasë poema për muskujt, ëndrrat dhe mendjen
e artë
Të popullit tim, që shkundi shekujt e rëndë
Dhe, larë me bronz revolucionesh, i ngjitet shkallës së lartë,
Pa shkarë në katet qiellore një gisht, një pëllëmbë;

Pa epur e dredhur në rrugën e gjatë gjunjët e fortë,
Ngadhnjim pas ngadhnjimi, horizont pas horizonti,
Me faqe të ndritur ndaj gjithë njerëzimit në botë,
Ushtar komunizmi pa luajtur nga fronti.

4.

I flakti Nëntor ia hapi sërishmi cipën e pastër mëngjesit,
Siç hap flamuri ngjyrën e kuqe në shesh në Tiranë,
Siç hap Enver Hoxha raportin e madh të Kongresit,
Tek ndihet trokitja e së ardhmes në gjokset plot tramundanë...

E nesërmja i bart me vete dhe vitet që shkuau,
I bart në themelet e saj të patundur;
Si gurë kalaje ëndrrat kthyer në jetë i ruan
Në shekuj kristal pa myk, pa ndryshk e pa pluhur.

Ato i ndërtuan të rënë e të gjallë në male, lugina, qytete,
Atje tek një lule, burim, kovaçhanë e shkollë,
Atje mbi një gur, mbi një trakt, mbi një fletë,
Atje mbi një vezme lëkure me rripa të hollë...

Atje nën një natë të rëndë si çadër betoni,
Nën shiun e hekurt të predhës e plumbit,
Vërtiteshin ëndrrat, që nesër themelet do shtronin,
Vërtiteshin ëndrrat të bardha si krah i pëllumbit...

Ato përsëri nuk na lënë të qetë në rrugët e gjata,
Sado që të tjera të bukura ngritëm e ngremë;
Prandaj në raporte kongresesh shkruhen me shkronja të arta,
Prandaj i skalisim në zemër, në gur, në poemë.

5.

Kur vjen ti, Nëntor, si fillimi i vitit na dukesh ngaherë,
Sikur na spërkat me rininë tënde në shpirt e fytyrë,
Sikur i pushton të gjithë muajt e tjerë,
Sikur u përhapet ngjyra jote e kuqe në ngjyrat e tyre;

Sikur më shtohen vitet e mi dhe dekadat e mia,
Se ngrihen mendimet dhe piqen mendimet,
Se ngjitet populli im dhe thinjet, rinohet dhe rritet Partia,
Ndaj rishtas më dukesh gjigant me çastet e tu dhe agimet.

6.

Nëntori i fundit i urtë themelin e ka mbi të parin,
Nëntor më Nëntor themeli mbetet i tillë,
Themel me gurë të lidhur me hekur, mbrujtur në gjakun
e zjarrin,
Themel i ndërtuar at'herë kur bëhej çdo mal Termopilë;

Themel i ngritur at'herë kur vdekja kanoste çdo skutë,
Themel i ngritur me krahët dhe mendjet nga mjeshtrit
e rrallë,
Nga mjeshtrit e rrallë që s'fjetën kurrë në shtretër të butë
Dhe drejt llogaritën të mbanin tërmete mbi dhjetë e ca ballë.

Prandaj, sa herë që vjen, mendojmë për rrugën e çelur,
Mendojmë si nxënës mësimet e tua t'i nxemë,
T'i kthejmë në forcë, në bukë, në dritë, në hekur
Dhe lart si statuja të bardha mermperi t'i ngremë.

7.

Ne shpesh në vend të themi Nëntori, themi Partia,
Se vetëm Partia ta ngriti si mal pavdekësinë,
Se vetëm Partia ka bërë të ziejë me emrin tënd histori
Dhe viteve në emrin tënd t'ua mbledhë tok madhështinë.

Dekadat kalojnë me luftë, mundim e përpjekje,
Ti mbetesh Nëntori i popullit me shpatën e zhveshur,
Që s'njeh gjunjëzim dhe zvarrisje në pluhur për vdekje,
Po njeh veç ngadhnjime shqiponjash me hasmin përleshur.

8.

O krahë shqiponjash, më shpini një çast në Nëntorin e parë!
E ndiej si gjëmon historia në dhomën time me libra e letër:
At'herë Qemalë e Vasilë, që mbeten në shekuj në këngë
të bardhë,
Qëndronin si degët e lisit rrëth Enver Hoxhës në odën
e vjetër.

Të gjithë të rinj me flokë pa thinja, me flokë pa borë,
Të gjithë të dalë nga djepi i varfër i nënës me halle,
Të gjithë të repte e të urtë e në shpirt njerëzorë,
Të gjithë mendimin e ndritur të shkruar në ballë.

Po ç'bënин atje asaj nate, kur hidhte hapat e parë Nëntori,
Kur jashtë vraponin hijet me ura në duart skëterrë,
Kur çmendej makina e luftës me mijëra motorë,
Kur lidhnin ushtarët anijet si bushtra në tokën e mjerë,

1 Kur shihnin në djepe fëmijët ëndrra llahtare,
Kur zgjasnin fytyrat mes telash me gjemba diku
të burgosurit,

Kur prisnin pa gjumë nënët e zeza me ankth në dritat,
Kur toka s'i treste në varr të varrosurit?

2 Po q'bënin atje asaj nate në pragun e dimrit të egër,
Të mbledhur në grusht si profetë legjendash të lashta?
4 Po merrej vendimi për shembjen e botës së vjetër
Dhe hidhej themeli i botës që vinte në shtigje të ashpra.

9.

Të nesërmen sheshet gjëmuani nga thirrjet e para,
Partia Komuniste Shqiptare dilte përjetë në jetë,
Përjetë me armët e lara,
Përjetë gjeni i vërtetë!

2 Partia, sa lindi, nuk priti të tundej në djep nga dadot e buta,
Nuk priti t'i zgjasnin në djep biberonin me qumësht,
Sa lindi, i mbathi opingat e saj të lëkurta,
E hodhi supit dyfekun dhe çau mes furtunës!

10.

Po gjer at'herë në male njihet dhe përrallë e profetëve,
Që mund të mblidheshin tok e të bënir çudira,
Për shembull, ta thanin ujin e deteve
Dhe detet t'i mbillnin me mel e kumpira;

Për shembull, ta kthenin në akull njerinë,
Ngaherë ta linin mesaku jsh në gjumë!
Për shembull, të zbrisnin nga qelli flori në lugine
Dhe lumin ta pinin të terin në kupë si verën me shkumë!

Po s'nihej akoma legjenda e re e vërtetë,
Legjenda me emrin e madh Nëntoriada,
Që nesër do fliste për dyqind komunistë profetë,
Që popullit rrugën të parët t'ia hapnin për ditë të bardha.

11.

Në dhjetra Nëntorë, katër na shkuat në male,
Të katër të rinj partizanë me vezme në brez e nagante.
Të katër të rinj kordhëtarë me yllin në ballë.
Secili lirinë, që rritej çdo ditë, në duar e mbante.

I pari ia jepte të dytit, i dyti të tretit nën suferinë,
Ashtu siç ia jep mes deteve dritën fanarit fanari:
Ta mbash, byrazer, të kulluar lirinë,
Ta mbash, byrazer, komunizmin që ndezi i pari.

12.

Ta mbash të kulluar, o bir i munduar!
Kjo ishte dëshira dhe thirrja që dilte nga çarjet e tokës,
Që dilte nga gjiri i ndërgjegjes së njerëzve,
Që dilte nga gjaku i tharë dhe hiri i kockës,
Që dilte nga qelli i ëndrrës së brezave...

Ta mbash tē kulluar, o bir i munduar!
Kjo ishte dëshira dhe thirrja e shekujve epikë malorë...
Në breza tē tërë qëndroi jatagani në duar,
Po kurrë s'e vuri në jetë ëndrrën madhore.

Vraponte ëndrra,
Pas ëndrrës djemtë dhe vashat e maleve vinin
Sa linin shpërgajtë në djejet prej druri.
Afrohej ëndrra, po kurrë s'e zinin.
Dhe tokë i treste dhe emrat e tyre i ruante veç guri.

Kur ndizeshin luftëra, protesta, stuhi, rebelime,
Në ballë, me shpatën e lashtë, tē lënë nga gjyshërit e lashtë,
Qëndronin tē bukurit e nënës, tē rritur me mall e mundime,
Po prapë në shpellat e maleve ëndrra humbiste si zogu
i kaltër...

13.

Të rënët me shpirt tē lënduar kokën e ngrinin nga varri
Të shihnin dhe tokën dhe qiellin e ndezur
Nga shpata e predha e plumbi e zjarri:
A erdhi ëndrra që pritëm e ramë, vëllezër?

Nga toka e plasur dilte trishtimi i hidhur:
Nuk erdhi, vëllezër, nuk erdhi, vëllezër tē ngratë,
Se ëndrrën e mbajnë për shpellash tē lidhur,
Të lidhur e mbytur në gjak, pabesitë, grabitjet, paratë...

14.

Té dua

Sa?

Dhe binte sérishmi muzgu i murmë mbi supet e maleve,
 Gërvishitë lëkurën e tokës parmenda e shkretë
 Dhe zggjonte kujtimin e vuajtjes dhe hallev
 Dhe zienin përbrenda djemtë, fëmijët dhe pleqtë.

Mundoheshin, de more de!
 C'ti bënин barrës së rëndë të botës,
 Që hekur rëndonte dhe kërruste shpinat e varfra,
 Që thyente trarët e ahut të vjetër të odës
 Dhe gjurmët i linte në djepe, mindere e vatra.

15.

Dhe mpriheshin shpatat sérishmi në zjarr kovaçhane,
 Dhe ngriheshin prapë në gryka humnerash shqiptarët,
 Taborë e hordhi shkatërronin me princër nishane-nishane
 Dhe kockat mbi kocka lëvrinin në varret...

Po vinte ëndrra në gjysmën e udhës e kthente kurrizë,
 Po vinte liria në gjysmën e udhës e mbetej në udhë,
 Nga dhjami rëndonin princër, bejlerë e vezirë,
 Nga dhjamiën jteshin mbretë, hajdutë, përtacë e kukudhë.

Sérishmi të rënët nga varret kokën përgjakur e çonin
 Nën qiellin me tym, mbi tokën me breshër
 Dhe grykat e lashta me plagë rënkonin:
 A erdhi ëndrra e madhe që pritëm, vëllezër?
 Nuk erdhi, vëllezër, nuk erdhi, vëllezër,
 Në rrugë ka gjemba dhe ndoshta vjen nesër!

16.

J. Love you PSt

Mos vallë në mote të egër dikush me zemër të nxirë
 Mallkimin fatal e kish shkruar pa dhembje me dorën
 e shtrembër,

Në pragun shqiptar të gjakosej ëndrra e mirë,
 Në pragun shqiptar të mbetej ëndrra pa emër?

Jo, ëndrra nuk mbeti pa emër, ëndrra s'u lidh dot nga
 prangat;
 Kjo tokë e ruajti ëndrrën në malet si foshnjën në djepet,
 Kjo tokë përzuri nga ëndrra e saj merimangat,
 Kjo tokë i shtypi nga ëndrra akrepët...

17.

Më gjeni një vatër të lashtë pa bij e bija therorë,
 Më gjeni një brez të lashtë pa kockë të shpuar me plumbë,
 Më gjeni një grykë lugine pa shembur taborë,
 Më gjeni një degë borige pa zogj e pëllumba...

Më gjeni një muaj të vitit pa ngjarje epike e këngë,
 Më gjeni një muaj të vitit të fjetur si ujë kënete.
 Çdo muaj qëndron përmendore në këmbë,
 Të shkruar me gjak biografinë, të mbushur anketën me jetë...

Po vetëm anketë e Nëntorit qëndron mbi anketat e tjera.
 E shkruar me shkronja të zjarrta radhë për radhë:
 Në Krujë, në ditën e njëzetetë me shira e erëra,
 Nëntori takoi Skënderbenë hipur në kalin e bardhë.

TJAMO

Në muret bedena-bedena vuri flamurin e lashtë
Pa hëna-të ngrëna, pa çallma dhe bojëra të huaja;
Dëgjoi Skënderbenë në sheshin e madh-të kalasë:
«Lirinë s'e solla me vete, e gjeta mes zemrave tuaja!»

18.

Në Vlorë, në ditën e njëzetetë, nën qiellin e vrenjtur,
Nëntori qëndronte, me flamur në dorë, në ballë
Përmallur, përlotur me sytë nga deti të tretur,
Me duar shtrënguar me plakun e madh, Smail Qemalë!

Pas pesëqind vjetësh takohej Nëntori i shkretë,
Me gunë të grisur me teh jatagani,
Me vetulla djegur nga flakët, baruti, rrufetë,
Munduar në shtigjet e zëna nga hasmi, xhelati, dushmani...

19.

Po prapë të rënët nga varret kokën përgjakur e çonin
Nën qiellin me tym, mbi tokën me shira, stuhi e tufanë,
Dhe shpellat e grykat e lashta me plagë rënkonin:
Vëllezër, a erdhi èndrra? Për èndrrën u vramë!

Dhe zëri përgjigjej trishtuar, trishtuar
Mbi koren e tokës, tek heshtte parmendë e shkretuar:
Nuk erdhi, vëllezër, nuk erdhi, vëllezër,
Në rrugë ka gjemba dhe ndofta vjen nesër!

20.

SAGA Po

Në rrugë ka gjemba dhe ndofta vjen nesër!
Kjo «nesër», kjo «nesër» e gjatë me vite e shekuj
Nën lodhje, nën djersë, nën gjak e nën plumba si breshër,
Nën çizme, nën sharje e ankthe zinxhirësh të hekurt.

Kjo «nesër» do zbardhte kur farin ta ndizte Nëntori,
Kjo «nesër» do niste rrugën vetëm me Thirrjen e Parë,
Kur uji i valuar të rridhte me vrap nën dëborë...
Kur bashkë njëherësh të tundeshin malet shqiptarë,

At'herë të rënët s'do shkonin me zemër të thyer në tokë,
S'do pyesnin, a erdhi èndrra e kaltër me fletë,
Se ne do t'u thoshim: èndrrën që pritët, vëllezër e shokë,
E vumë, e vëmë në jetë!

21.

Në dhjetra Nëntorë, katër gjëmuan në krisma e tmerre,
Po katër në zjarrin e luftës bëjnë nga katër akademira.
Në shkollën e luftës, po ngele në klasë, le kockat dhe kokën
e mjerë,
Besimin dhe èndrrat e mira...

Po ne strategjinë e taktikën e luftës në male i nxumë,
Nën qiellin furtunë, nën qiellin e kuq të marksizmit,
Dhe dolën strategë që para brigadat i shpunë
Dhe hapën në tokën e vjetër shtigje të rinj heroizmi.

FOR EVER

Fshatari që dinte ta mbante par mendën në brazdat,
Punëtori që dinte të bënte drapinj e çekanë në kudhër,
Mësuan t'i hidhnin në sulm e përleshje brigadat,
Mësuan pa harta t'u presin hordhive grykat e udhët;

Barrikada mësuan të ngrejnë në hundët e tankut në shesh,
në qytete,

Makinën e shtetit të vjetër e shembën me xhins e memura,
Mësuan të bëjnë vula të reja me yjet që mbanin me vete,
Mësuan t'u flisnin me Marksin zotrinjve: jemi ne diktatura!

22.

Nga shekujt në shekujt në gjji koncentroi Shqipëria,
Të mbledhur pikë për pikë, atë eksploriz madhështor,
Që ende s'e kishte shënuar në librat e saj historia,
Atë eksploziv që gjëmoi në Nëntor.

Atë eksploziv komunistët ia vunë botës së vjetër
Në gjoksin e kalbur nga plaga tuberkulare,
Nga kolla që hapte mikrobet në shtratin e vdekjes,
Ia vunë pa pasur mëshirë nga lutjet e saj lajkatare...

Ne kishim hesape pa mbyllur me botën gërmuqe:
S'harrohen dot vezët e nxeha nën sqetull në bimca,
S'harrohen dot vijat mavi të prangës në burgje,
S'harrohen dot thonjtë të mbushur me spica...

S'harrohen surretrit fodullë dhe trupat e dhjamur të zotërvë,
S'harrohen kasollet pa bukë në netët e gjata të dimrit,
S'harrohen bastisjet dhe lotët e nënave, grave e motrave,
Internimet, uria, etja, torturat dhe dhembjet e shpirtit...

Zhëtem jet' uime

Ai eksploziv gjëmoi Nëntor më Nëntor i furishëm
 Në grykat e maleve, në gjirin e fushave, në mes të kënetave
 Dhe lindi një shtet proletar i fuqishëm,
 Pa tkurrjet e astmave, pa dridhjet e etheve...

Dhe unë i këndoja këtij shteti, që vura rininë
 Në gurin e madh të themelit pa mort,
 Si bir i një toke që rriti në djepin e lashtë lirinë,
 Dhe si komunist që, për nderin e vendit, kurrë s'hedh short.

Dhe unë ia shtoj Republikës pirgjet me këngë çdo ditë,
 Marr udhën në fusha dhe këmbët më shtyjnë nga mali,
 Dhe ulem në sofrat e bardha me dritë,
 Që erë borige më mbajnë dhe erë shkume hidrocentrali.

Nën dritën e llambës që varet tavanit si dardhë,
 Më mirë shoh ujin, verën, rakinë dhe bukën;
 Nën vrap të turbinës dhe shkumës së bardhë
 Më mirë shoh kazmën, librin dhe pushkën.

Dhe ndiej si gjëmon e zien e vrapon pa pushuar
 Motori gjigant, i pandalshmi motor, i klasës motor
 Me zjarrin e tij llamburitës, që kurrë s'do ketë të shuar,
 Me emrin e ndritur Nëntor!

Në mote na janë kanosur me dritën e fillit të bakrit:
 «U shpik elektriku një shekull më parë,
 Ju ende kandilin e mbani pas mashës dhe draprit.
 Dhe ende tymoni me pishën e ndezur nën trarë!»

Na vidhnin me bakër, me naftë e me hekur,
Dhe prapë na tallnin, na qeshnin, na shanin:
«Ju rroni akoma si popujt e vdekur,
Me lopën dhe demin dhe dashin rrogozit flini dhe han!»

Zotërinj, me plugun e zi të kanosjes ju hapët brazdat e frikës,
Po shpejt jua dogjëm në furrat metalurgjike që ngritëm.
Ne llambat ia varëm në gjoks si gjerdan Republikës,
Bile dhe në brirët e demit dhe dashit i ngjitëm.

Tek ju, që dikur elektrikun të parët e shpikët,
Akoma në vatra kandili shpon sytë si ferra,
Po ne kandilin përjetë në mure e fikëm,
E vumë ta shihni dhe ju në muzera...

25.

Kur isha i ri, me parmendën e gjyshërvë tokën e çaja
E plisat i ktheja në krah t'i ngrohte si klloçkë dielli,
E zogjtë me këngë më ndiqnin e iso u mbaja
E mbushnim me këngë arën, lumin e qiellin...

Po ishte një këngë që ecte pas meje si era e bukës:
Të kishim çelik, t'ia bënim plorin të mprehtë parmendës,
Të kishim çelik, t'ia bënim tytën të gjatë pushkës,
Të kishim çelik, t'ia bënim krahët të fortë ëndrrës.

E mbajnë çelikun malet në gjokset e vjetër,
E mbajnë çelikun pirgjet me gurë e me shkrepë,
Do vijë një ditë ta marrim patjetër,
Ta pjekim në furra si bukët nën saç në çerepa...

Më vjen në mendje si zogu në degë kjo këngë,
Kjo ëndërr e gjyshit, që kurrë s'e vuri në jetë,
Dhe lotët e mallit më zgjojnë, kur shoh tek ngrihet në këmbë
Uzinë e çelikut shqiptar buruar nga malet me fletë.

O ëndërr e gjyshërve e nipërve e mbesave,
O ëndërr me krahë çeliku, na erdhe
T'ua shtosh qëndresën dhe forcën vjershavë,
Të derdhesh në diga, në vatra, në çerdhe!

Ku janë ata që e tundnin kanosjen me dhëmbë çeliku,
Ku janë ata që donin të mbillnin farën e frikës,
Tani nga duart kanosja u vate, u iku,
Mburojë çeliku i vumë në gjoks Republikës!

Tani na shijon në sofër buka më mirë,
Tani na ka hije llamba në mes të tavanit;
Ta pimë një gotë me fund, o vëllezër të lirë:
Bromb, Metalurgjik i Elbasanit!

26.

Në shekuj na janë kanosur me bukën, duke e tundur në dorë
Si armë të tmerrshme me gishtin e djathëtë në këmbëz:
«Do jepni shpirt në humnerat e murme, të gjorë,
Do jepni shpirt të pangrënë një natë nën hënëz!»

Dhe hëna në kupën e qiellit të vuajtur
Fëmijëve tanë u dukej si buka e misërt
Dhe zgjasnin krahët e hollë të druajtur,
Ta zbrisnin në sofër, ta hanin me kripë e me hithër...

Për bukën u mbushën plot me legjenda mali, lumi dhe jazi,
Me fjalën bukë u mbushën këngët dhe vjershat,
Me fjalën bukë u mbushën betimi, mallkimi dhe gazi
Dhe burra të fortë për bukën humbën në gryka e kreshta...

O, kushedi ku do shkonte legjenda e shkretë,
Legjenda rrëqethëse e maleve për bukën,
Sikur mos vinte Nëntori i zjarrtë në jetë
T'i nxirrte pushtetin dhe bukën prej pushkës!

Në shekuj me bukën bota kanosjen e mbajti të ndezur,
Në shekuj kanosja kaloi refren pas refreni,
Tani dhe kanosjen e fundit ia hoqëm nga thonjtë, vëllezër,
Ne bukën tonën e kemi!

27.

Të tillë të gjithë Nëntorët i njohëm:
Të pastër, pa hije veremi në gjoks e në trup pa ekzemë,
Sado që tallaze mikrobesh përplasen e çohen,
Sado që rrebeshet rrebeshe të turbullt të ngrenë;

Ne jemi mësuar të ndjekim vetëm një vijë kristali,
Një vijë pa vija të tjera që zgjaten në izëm,
Ne jemi mësuar t'i falemi vetëm atij ideali
Me emrin e kuq — komunizëm!

Në emrin e kuq — komunizëm — s'lejojmë shtesa të tjera,
Në shkronjat dhe rrokjet e tij s'pranojmë të shpiken hije
e vija;
Ne jemi mësuar ta shohim ngahera
Ashtu siç e ka në raportet Partia.

28.

E shihni? Po rri kuvendoj me Nëntorin me vargjet,
Se jam edhe bir, po jam dhe vëlla i Nëntorit.
Qëndroj para tij dhe s'më skuqen as veshët, as faqet,
Se zemra me pulsin e tij më rreh kraharorit.

Ka njerëz që skuqen t'i dalin Nëntorit përpara,
Kur shkon nëpër rrugët me yllin e kuq në kapelë,
Se zemrën dhe shpirtin i bënë si zift të palarë,
Si zarf të harruar në park idealin e shenjtë e shkelë.

Ka njerëz që kafen me vrap pas Nëntorit me lajka,
E mburrin në sy dhe prapa shpinës e shajnë vrerosur;
Nëntori ngrys ballin e gjerë dhe shpejt i zë data,
Të zbuar si qen të zgjebosur...

Dhe jashtë dhe brenda ka njerëz që thonë:
«Sikur të vishej Nëntori modern e të bëhej i butë!
Këto pantallona, kjo bluzë e kapelë s'i shkojnë,
Se shekulli ynë ndryshon në sekondë e minutë!»

29.

E dimë, Hrushovët e veshën Tetonin me rroba moderne,
Kauboj pantallonat dhe flokët hipë përmbi supa,
Sa vjen zbret shkallët diku në tavernë,
Pi vodkë dhe lot rokenrroll me nuse e çupa.

Bile dhe Gierekët, bile dhe Zhivkovët, bile Cedenbalët
I ndërruan dhjetorët, shtatorët, korrikët e ç'janë,
I veshën për turp e yrnek si tellallët
Dhe brezit kobure, raketa, thika dhe droga u lanë.

30.

Ndaj gjumi s'e zë Nëntorin, po djersa i vete si çezme
Në frontin e madh për dijen, naftën, çelikun dhe bukën,
Barutin e mban të thatë në xhep e në vezme
Dhe kurrë s'i ndan nga dora kazmën dhe pushkën.

31.

Me luftën, me punën, me ëndrrat të mbledhura bashkë,
Me teserën e kuqe në dorë hyj në Kongres kryelartë
Solemn, i menduar për çka në jetën e popullit dhashë
Dhe ende për çka nuk kam dhënë si shokët e mi delegatë.

Krah meje kalon delegati i zgjedhur në Fierzë,
 Që sa po ka dalë nga zemra e malit të murmë.
 Xhaketa e tij sjell erën e minave që ngrenë njëherësh
 Nga shtatëqind mijë tonelata me shkrepë e gurë.

Vështroj në krismat e Fierzës çelikun e nxjerrë nga malet
me borë,
Vështroj në krismat e Fierzës shtypshkronjën me librat e mia,
Vështroj në krismat e Fierzës kazmën, pushkën, traktorë,
Vështroj në krismat e Fierzës si qesh Shqipëria.

32.

Me mua qëndron delegatja e rritur atje mes Këmishtajt, Që krahët përveshi dhe mbushi hambarët me grurë e misër, Që dje nëpër arat capitej dhe kthente nën diell plisat Dhe sot socializmi e bën mes ministrash ministër.

Mes ministrash ministër! Kështu socializmi dikur e ka marrë
Atë partizanin e thjeshtë që zbriti nga mali tok me lirinë:
Pa hajde këtu, djalë i mbarë,
Të mbash qeverinë!

Krenohem që rroj, punoj e luftoj në frontin tënd, socializëm,
Se ti drejtësinë e gjakut e djersës e mat si mjeshtër i rrallë,
Punëtor le të jesh, bujk le të jesh, poet a ministër
E njëjta lavdi të përket kur ndodhesh me shokët në ballë!

33.

Shtrëngojmë duart të dy me sharrëxhinë që mprehu sharrën
e lashtë,
Që vite me radhë me pishat u mat nëpër pyjet epikë,
Që veç komunizmi e ngre barabar me malet e lartë,
Që veç komunizmi e merr dhe e zgjedh anëtar të Byrosë
Politike!

Po ç'kishte druvari? Veç sharrën, një copë të thjeshtë çeliku.
Po ç'mbante druvari? Një zemër që malet të gjithë i merrte!
Dikur të hipje në vend të ministrit, të duhej çifliku,
Të paktën sejmeni me dadot dhe dhjetëra bujqër me derte...

34.

Na thënkan pastaj se qënkemi konservatorë,
Na thënkan pastaj se paskemi mbetur të egër...!
Zotërinj, a s'vete më mirë në qafën tuaj kjo palo këmborë,
Që shpesh na mërzit me avazin e vjetër?

Kur flisni dhe ju për novatorizmin, na vjen për të qeshur,
Ju vlerën njeriut ia masni me rubla e dollarë,
Ju urën e luftës e mbani në duar të ndezur;
Ju bomba lëshoni në sofra dhe mprehni hanxharë;

Ju fronet e njëri-tjetrit helmoni me helme mesjete,
Për frone ju vrisni, si gjahun në pyll, presidentë,
Ju mbani mafiozët që shtetet i bëjnë për vete,
Ju therrni mes ditës dhe natën duart i lani të qetë;

Ju flisni për miq dhe lidhni çdo çast aleancë,
Ju flisni për paqen dhe luftën për hir të progresit,
Po thikën moderne dhe shokut tuaj ia ngulni në palcë
Dhe zgjidhur e mbani grykën e madhe të thesit...

S'harrohen Koreja, Kili, Çekia, Angola e Palestina,
Në xhunglat vietname akoma të çelura gropat e bombave janë;
S'harrohen gërmadhat dhe krromat që pa me sy Hiroshima,
Asfaltet e Pragës akoma dhëmbët e tankeve ruse i kanë...

35.

Na thënkan pastaj se qenkemi konservatorë,
Se s'paskemi sheshe pornografike e striptiza...!
Në tokën tonë ne s'kemi ngritur laboratorë
Të rrisim si ju insekte kolere dhe miza...

Ah, dashki që ne t'i thyejmë kazmën dhe pushkën,
Të derdhim mbi ashklat e tyre konjak në tavernë,
T'i zbratzim katundet dhe juve t'ju zgjatim duart për bukën,
Pastaj të na thoni modernë?!

Ah, dashki t'i veshim këngët, poemat dhe vjershat
Me mini e maksi orë për orë,
T'u rrisim romaneve dhe operave leshrat,
Pastaj të na thoni: «o'kej, novatorë!»

Ah, dashki të shkojmë t'i falemi priftit në kishë,
Të lusim dhe ditë shënktorësh dhe pashkë,
Ta puthim qitapin me myk të xhamisë,
Pastaj me ju ta ndajmë progresin bashkë!

36.

Ah, shumë ju s'dashki: të shtrohemi tok në një sofër si miqtë,
Të ngremë dolli, të hamë tok kikirikë,
Për emrin s'ka gjë, le ta kemi prapë komunistë,
Dhe qejf, o qejf politikë...!

Zotërinj, Partia e Punës ka mbushur dekada në jetë,
(3) Do mbushë dhe shekuj në fushat dhe malet me gurë,
Po gjersa t'ju mbetet fara diku në planetë,
Partia e Punës s'do shtrohet me ju në një sofër kurrë!

Dhe mbajeni mend:

(4) Më sa mund të futet në vrimë gjilpëre një buall me këmbë
e me kokë,
Aq mund të hyjnë tek ne pasanikët, borgjezët dhe «-istët»,
Blerimin në shekuj të madh do ta ketë kjo tokë,
Këtu udhëheqin dhe sot dhe nga mot komunistët!

Me ëndrrat e bukura që kurrë të qetë s'më lanë,
 Me këngët e shokëve, miqve, vëllezërve hyj solemn në
Kongres.

Nga kjo lartësi horizontin e shoh tejembanë,
 I shoh idealet që mbrojta rrebesch më rrebesch...

Nga kjo lartësi më pushton me krahët e saj krenaria,
 Si çdo luftëtar të armatës së vet komuniste,
 Që rriti mes luftës e punës e gjakut e djersës Partia,
 Që ti Shqipëri, e lumtur përjetë të ishe.

⑤ Armata ime e madhe, ti s'prehesh e qetë dot kurrë,
 Se kurrë nuk prehet ai që kemi në ballë,
 Ai që shokë na quan në malet e fusha me grurë,
 Ai që çdo vatre ia njeh dhe gjëzimin dhe hallë;

⑥ Ai që bashkë me ne u thinj për Rilindjen e Madhe,
 Rilindjen e Madhe të tokës së shenjtë shqiptare;
 Ai që na rriti besimin për ditën e bardhë,
 Kur vuri themelin e shtetit dhe gurin e parë.

⑦ Dhe unë i lumtur jam, o armata ime e luftës, e punës, e nderit,
 Që rroj e luftoj në epokën dhe frontin e madh të Enverit!

31 tetor 1976

NËNË SHQIPËRI

— Poemë —

1974

H Y R J E

1.

Po hap në poemë fletën e parë, fletën e dytë,
Si fletët e portës ku kurrë s'kam hyrë;
Mbi supet e mi miliona yj çelin e mbyllin sytë;
Pas shpinës sime treni i kohës gjëmon duke shfryrë;
Gjëmon mbi urat e larta të hekurbanit,
Gjëmon, uturin dhe i fryn sirenës;
s'mbu. Treni i kohës me yllin e kuq të Nëntorit
Bën dritë mbi portën e re të poemës.

2.

Poema ka huqe si mushka xanxare,
Po s'dite ta ngasësh, të hedh nga samari.
Ankohen për mushkën xanxare poetët,
Përpiken ta zbusin, s'e zbusin dot lehtë...
Kaç vjet po e ngas poezinë-mushkë
E prapë s'mësova ta ngas aq mirë;

Eca shaluar në mal e në fushë
E prapë e pata vështirë.
Kur thosha se bukur e kisha mësuar
Dhe rrija samarit krekosur,
Xanxarja — një vickël dhe unë i rrëzuar
Me buzën dhe hundën gjakosur!...

3.

Pegasin shalonin poetët antikë
Dhe rrugët e botës i merrnin pa frikë...
Po sot ka poetë që hipin Pegasin,
Me boks Helikonin modern e godasin,
Me leshra gorille, me rripa, me tela,
Me mjekra shtëllunga, me vëthë turjela,
Me britma në gojë, me dhëmbë përjashta,
Si antropomorfët në guvat e lashta:

Hum-hum e ham-ham!
Bum-bum e bam-bam!

4.

Po ka dhe të tjerë që muzën si shqerrkë
E ndjellin t'i japid llokum e sheqerkë:
Oh, muzkë,
Oh, nuskë,
Më mbete
Në buzkë!

Oh, gili,
Oh, vili,
Ia thoshte
Bilbili!...

5.

Pegasi me krahë i ngre lart në retë,
Betohen:

Ne jemi bardë e poetë...
Po unë të kam shaluar ty mushkë,
Ngarkuar me kazmë, libër e pushkë,
Ngarkuar me lapsa, me pena, me letër,
Të gjitha më duhen si buka, patjetër!
Ndaj lipsur Pegasi, ç'e dua Pegasin,
Pegasit gurët thundrat ia vrasin.
Mushka xanxare nga gurë s'ka frikë,
Vrapon nëpër shpate hanxharë e thikë.

6.

afresh
O mushkë xanxare, sa shumë më lodhe,
Shpeshherë në shtigje si djalli më hodhe!
Po unë s'u epa, paçka se s'të zbuta,
Ku desha të shpura, ku desha të futa,
Me zor e me dashje, i rreptë e i qetë,
I ngrysur, i çelur, me shokë dhe vetë,
Me duar me kallo, me gjunjë të vrarë,
Me setër me arna, këmishë të çarë...

7.

O mushkë xanxare, të dua xanxare,
 S'të dua të butë si dele manare.
 Të dua të çiltër, të dua të pastër,
 S'të dua të fshehtë, s'të dua të ngathët.
 Të dy do kalojmë në shtigje plot derte,
 Ti mbetu pérherë xanxare e serte!

8.

Po hap në poemë fletën e parë, fletën e dytë,
 Si fletët e portës ku kurrë s'kam qenë;
 Shtëpia ime mes malesh pérzihet me yjtë,
 Mendimet më mblidhen si bletët rreth nënës.
 Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!
 Trokasìn rrokjet, trokasìn vargjet,
 Trokasìn hapat në Jug e Veri,
 Trokasìn pikat nën strehët e pragjet:
 Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!

9.

Përpjekin krahët pëllumbat e turtujt
 Dhe nisen nga strehët drejt reve,
 Kur çel ylli i mbrëmjes, kur zbresin muzgujt,
 Sérishmi kthehen nga qielli foleve.
 E prapë ajo këngë e dashur, e mirë,
 Zefir, fërfërimë, shtrëngatë, stuhi,
 Vjen erë limoni, borige, rrëshire:
 Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!

10.

Dhe vijnë lejlekët në strehët që lanë
Me gjethin e plasur në plepa...
Valon e gjëmon e zien anembanë
Kjo botë me pisha, ullinj e me shkrepë.
Mbi lisin e vjetër qëndron një shkëndijë,
Një çerdhe zverdhon nën yll e nën hënë,
Në djep — një fëmijë,
Mbi djep — dy sy nëne.
E prapë ajo këngë e gjerë e kaltër
Bregdetit me valët flori
Prek yjet që lahen me buzë e me flatër:
Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!

11.

Po hap në poemë kanatin e portës,
Ndiej valën e gjakut në mur të aortës;
Shfryr treni i kohës mbi shina shaluar
Me yllin në ballë e me zjarr e sirenë;
Ti, nënë, me mua natën rri zgjuar,
Yt bir mundohet e heq mbi poemë,
Lëmoma pak ballin me dorën e shtrenjtë,
Lëmoma si nënët lëmojnë,
Që fletët e qeta në këndin e qetë
Të nisin me vrap të këndoja!

12.

Poetit zemra i rreh si e zogut,
Kur gishtat pakëz ia shkojnë në ballë,

I duhet dhelja e nënës dhe shokut,
Që kënga të ngasë si vela mbi valë.
Nga gjithë qeniet e gjalla poeti
E do ledhatimin më shumë,
Se vuan i varfri, se digjet i shkreti
Për njerëzit natën pa gjumë.
Këtë s'e kam nxjerrë nga mendja dhe lapsi,
Këtë e ka shkruar në libra Karl Marksi!

15

13.

Mundohem e vuaj mbi rrokje e vargje
Se dua ta ngre poemën në këmbë,
Djersët më rrjedhin nga balli në faqe
Dhe majën e lapsit pastaj ha me dhëmbë,
Se dua që vargu të mbajë jo vetëm një agim,
Dua të mbajë me shpatulla kohën që zien e gjëmon,
Siç mbajnë digat liqenet në Drin
Miliarda kub ujë me hekurbeton.
Poema nuk është një pritë kanali,
Po digë e rëndë hidrocentrali
Me qindra mijë kilovatorë,
Që bën të ngjiten në male vaporë...

14.

Po hap në poemë fletën e parë, fletën e dytë,
Kanatet e portës në oborrin e ri të panjohur...
Vargje të ciltra, vargje të sarta, hyni si yjtë
Nga vatra e nënës ngrohur...

KREU I PARË

1.

Lërmë të bie në prehrin tënd të ngrohtë,
O hallemadhja ime shekullore!
Të puth duart e tua, më të mirat në botë,
I ngazëllyer të hesht me heshtje foshnjore;
Duart e tua që u regjën nga puna
Dhe gishtërinjtë
Që zunë kallo nga këmbëzat e dyfekëve,
Dhe supet që u varën nga xhoka e nga guna,
Dhe mesin që u hollua nga gjerdanët e fishekëve,
Dhe ballin që u rrudh e u lërua nga mendimi,
Dhe beben e syrit që u mpreh nga shënjestra,
Dhe këmbët që u zmadhuan nga ecja e mundimi,
Dhe qerpikët që u dogjën nga baruti në shkrepas...

2.

Ti sytë lan në mëngjes me ujin e krojeve të maleve,
Ti llërët lëmon në mëngjes me shkumën e deteve,

Ti faqet fshin me peshqirin e madh të livadheve,
Ti flokët lyen me lëngun e luleve të bjeshkëve...
Dhe çdo mëngjes bëhesh më e re
Dhe përzë zhura e rrudha;
Ne rrimë në prehrin tënd e dorën
Na shkon në flokë,
Thinjat na fshin kur gjunjët na dhembin nga udha,
Lodhjen na heq kur zgjuar na tretesh mbi kokë...

3.

Qëndroj para teje,
Ja tek më ke,
Në krahët e duart e tua.
Mua,
Birin tënd,
Shembëllimin e qenies tënde,
Atë që tha, sa hapi sytë në djep:
«Të dua!»
Dhe fjalën e peshës së rëndë
E ruajtën malet e rëndë...

4.

Qëndroj para teje,
Ja tek më ke,
Për ty falem,
Për ty bëj be!
Gjithë dashuritë për nënët që janë e do vijnë
Në prehrin tënd të madh i kam vënë.
Gjithë dashuritë për gratë, për shokët e miqtë
Ti kam sjellë t'i ngrohësh, o nënë!

Jeton dashuria pér ty,
Se birin tënd s'e thau civilizimi,
S'e thau shekulli i atomit
Dhe i zbritjes në Hënë;
Në buzët e plasura s'iu vyshk belbëzimi,
Belbëzimi i foshnjës që përgjërohet pér nënë.

5.

Biri yt di të ulet
Në sofrën që shtrojnë fshatarët në oborr,
Siç ulet në banketet që shtrojnë kryeministrat;
Biri yt di të hyjë në laboratorin termobërthamor,
Siç hyn në arën ku zgjatin mustaqet misrat...
Çdo gjë që më dhe trashëgim e kam mbajtur
Kudo që kam shkuar,
Kudo që kam vajtur.

6.

Ja, e ndien si flokët dhe vetullat e mia
Erën e barit tënd kanë dhe erën e miellit të sitës
Dhe në buzët e thara me via
Ka mbetur në shekuj shija e kripës?
Është era e miellit tënd dhe shija e kripës tënde,
Pa miell e pa kripë çdo gjë do të ishte pa shije,
Pa miell e pa kripëjeta do të ishte e rëndë,
Pa miell e pa kripë dashuria s'do kishte shkëndijë...
Ne kripën e kemi hedhur edhe në fjalë,
Kur mbetet fjala pa kripë bëhet gjellë e shpëlarë,
Ritmin e humb e vërtitet pa jetë e çalë,
Ngjyrën e hedh si fleta nën brymë e djegur, e tharë.

7.

Le të venë raketat në Hënë, Mars a Venerë,
Le të ziejë shekulli i reaktorëve rrëth Diellit,
Njeriu ka nevojë për dashurinë e nënës ngaherë,
Njeriu ka nevojë
Për shijen e kripës dhe erën e miellit,
Njeriu ka nevojë për këngën dhe legjendën,
Njeriu ka nevojë për çudirat e rralla,
Njeriu ka nevojë për fletën dhe degën,
Njeriu ka nevojë për të vërteta e përralla.

8.

Njeriu ka nevojë të këndojojë për njeriun e lindur
Në kohën kur emrin ia vë për ta mbajtur në shekuj,
Njeriu ka nevojë të qajë hidhur
Për të dashurin, njeriun e vdekur.
Njeriu ka nevojë të fshijë frikën, skamjen, urinë
Njeriu ka nevojë të shembë padronë,
Njeriu ka nevojë të shohë lirinë,
Të ndezë revolucionë!

9.

E dua guximin e madh njerëzor në udhët kozmike,
Por s'dua zemër roboti me valvula tekniqe.
Le të ziejë shekulli i reaktorëve duke uturirë,
Njeriu bëhet më i madh e më i mirë!

KREU I DYTË

1.

Kokën kam vënë në jastëkun e maleve, nënë,
Menduar për ty,
Për malet, për fushat, për detin.
Mbi ballin tim vrapijnë diell, yje e hënë,
Me dritën e tyre mendimet e mia lindin e shkrepin.
Jastëku i ngrohtë me frymën tënde,
Qëndisur aq bukur
Me pisha, ullinj, borzilok, luleborë
Në katër cepat e kaltër ka nga një flutur,
Në katër cepat e kaltër shqiponja bën rojë.

2.

Hapmi hiret e tu,
Perlat që lënë pa mend udhëtarë,
Se sot di t'i shoh më mirë se kurrë,
Se sot di t'i ndiej e t'i çmoj, të zhytem në to si i marrë,

Si bard, si gjahtar, si fëmijë, si burrë,
Se shumë kam nxënë,
Si nxënësi yt i pérhershëm,
Se ti m'i hollove ndjenjat në rrugën e gjatë!
Ja, shtrihem në fund të luginës në barin e gjelbër
Me sytë nga qielli, shpuar nga malet e lartë.
Shoh festet e tyre të bardha, mullarë qiellorë,
Kurkush s'guxon t'ua prekë me hi bardhësinë,
Veç retë amvisa me furçat e bardha në dorë
Në agim e në mbrëmje i fshijnë.
Shoh shpinat e tyre si muzgje të murme,
Ngarkuar me mijëra e mijëra shekuj,
Bërë me brazda, rrudha, gunga e gjurmë,
Bërë me rebra e damarë të hekurt.
Janë larë me shira
E janë shkruar me vija të bardha
Nga pérrenjtë e bardhë që zbresin të prehen në fusha,
Miliona vite ka që vrapijnë veri me të katra
Mes ahesh e pishash në gërxhe e gëmusha.

3.

Unë ozonin e tyre thith
E gjaku më rend në damarë siç rendin pérrenjtë,
At'herë më bëhet sikur do jetoj tërë jetën,
Të ngas me vrap,
Të hip në shkrepë, të zbres në lumenjtë,
Të gjej, të zbuloj, të përsos të vërtetën,
Të mpreh mendimin për gjërat rrëth meje,
Të shtoj ndiesitë, të shumoj kërshërinë,
Që kurrë gjaku mos ecë i qetë në deje,
Të rrahë e të ngrejë në gjoks suferinë...

4.

Unë s'i dua ata që rrinë të akullt
Para çdo bukurie zbuluar në malet e rreptë,
Unë s'i dua ata,
Që rrinë të akullt siç rri hardhuca në hatull,
Se vetëm hardhuca ka gjak të ftohtë e të qetë!
Rrëmbemë, o bukuri e maleve, rrëmbemë,
Ashtu si në prallat e Bjeshkëve të Nemura,
Me qilim fluturues në shpella e pyje shpjemë,
Ujë dëbore të pi si div në borigat e dendura!

5.

Rrëqethem nga malli,
Kur shoh Valbonën që pret shkëmbin me shpatë,
Me shpatë të kaltër që kurrë nuk ndryshket,
Kur shpatën e lë dhe puth degën e gjatë
Tek varet nga pisha që kurrë nuk vyshket.
Dhe unë dua të ulem si dega e pishës me vesë,
Që val' e Valbonës të vijë me nur të më puthë,
Në vesh të më thotë:
«Eh, djali i Hatixhesë,
Ti prapë je nisur për udhë?»...

6.

Male,
Sa herë jam ndodhur larg në vende të huaj,
Lahuta e vjetër me drurin e bardhë të panjës
Më sillte blerimin dhe erën e gurëve tuaj,
Si nënës që i sjell kujtimet rimore sepeti i pajës.
Pas drurit të vogël si foshnja pas lodrës mbahesha

Dhe tok me këmishën e trupit e varja në dhomë,
Nën tingujt e dashur të këngës lahesha
Ende pa prekur me gisht telin e hollë.
Copa e drurit të panjës tinguj vetë lëshonte,
Mendja në gjurmët e këngës lart fluturonte:

Mes dy malesh me dëborë
Ra një trim vetullahollë.
Nënë, motër, grua bashkë
Prisnin mbi minder me kashtë.
Me kandil te koka rrinin,
Llozin derës nuk ia vinin.

O ju korba, mos më ngani,
Sytë e zez ju mos m'i hani,
Po më pret kërcurja nënë
Pranë vatrës e pangrënë.
Më kérkon e zeza motër
Mal më mal, kodër më kodër,
Mbathur burrë me poture,
Me gjerdan e me kobure...
Kam një grua, një lanete,
Bëhet qyqe, flet me vete,
Vjen behari, del për mua
Shkëmb më shkëmb, krua më krua.

O ju korba, që po nxini,
Sytë e zez, të zez m'i lini,
Të shoh nënë, motër, grua,
Të shoh pragun mos m'u shua!

Më vjen gjumi në dëborë,
Kam të shpuar kraharorë
Me tre plumba nga tri vezme

Nga del gjaku në tri çezme.
Çezmet bëhen një përrua
Dhe vadisin mollë e ftua
Atje poshtë në një brinjë,
Ku një tra ma mban shtëpinë!
Oi, oi, oi...

7.

O malet e mi,
Me shkrepaj që ngjajnë me dema e kuaj,
Që ngjajnë me njerëz hipur deveve me gunga,
Fytyra ime gdhendur në gurët tuaj
Dhe kënga ime shkruar nën retë shtëllunga...
Kam marrë shumë nga ju e do marr!
Një copë gur do më jepni kur sytë të mbyll,
Një copë gur do më vini mbi varr,
Një copë dërrasë do merrni në pyll,
Një copë dërrasë për qivurin e qetë,
Një copë pambuku për bezen e hollë,
Një copë hekur për gozhdën e mprehtë,
Një lulëkuqe që bezja të ngjyhet me bojë...
Dhe unë at'herë do jem me ju i pandarë
Biri juaj në gjirin tuaj do flerë,
Dhe pylli këngës së tij do t'ia marrë
Dhe fyelli i përjetshëm do bjerë:
Vëlla poet, këngëtar i gjëzimeve e hallevë,
Clodhu pakëz në hijen e maleve!
Te koka në shekuj do rrjedhë burimi,
Mbi gjoks do hedhë fletë të kuqe agimi.
Vëlla poet, këngëtar i tokës e grurit,
Clodhu pakëz në hijen e gurit.
Si ti janë clodhur miliona e miliona
Që nga Bistrica e gjer te Valbona
Dhe kanë lindur miliona të tjerë

Të heshtur, të rreptë, të zgjuar, të ndjerë,
E prapë të tjerë do çlodhen në hijen e maleve.
Si ti, poet i gjëzimeve dhe halleve,
E malet të përjetshëm do rrinë festebardhë
Si kordhëtarë, rapsodë e bardë,
Dhe do këndoijnë mbi ty gjithë këngët e rapsoditë,
Të mbledhura gjeneratë më gjeneratë
Me tërë fjalët e tërë meloditë,
Që njihen e s'njihen nga shekujt e gjatë...
Vëlla poet, këngëtar i gjëzimeve e halleve,
Çlodhu pakëz në hijen e maleve,
Se kënga s'do heshtë e s'do bjerë në gjumë,
Do rritet në djep e do dalë në botën me zhurmë:

Fustanin e hollë
Zvarrë nëpër shkallë,
Si t'ia bëjmë hallit,
Moj bardhoshkë e bardhë.
Do të bëj një djepkë
Të më rritsh një djalë,
Si na shkojnë punët,
Moj bardhoshkë e bardhë!
Do të bëj një fyell
Djali të këndoje
Kënga, nëpër male
Zog të fluturojë.
Dhe ta marrë nipi,
Nipi e me radhë...
Si t'ia bëjmë hallit,
Moj bardhoshkë e bardhë!

8.

Unë shoh në male
Si ndehen në diell këmishët e fëmijëve,

Në kopsht lidhur me tela mollë më mollë,
Këmishët e vogla
Të nxënësve, njomzakëve, kërthinjve,
Të reja e me arna, qepur me perin e hollë.
Shumë shpejt nga bezet do dalin
E do nisen në shkolla, uzina, ara
Punëtorët e nesërm,
Bujqit, poetët, rojat e shërbimit,
Po s'do harrojnë
Si ndeheshin në tel këmishët e lara,
Të vogla sa një letër në makinën e shkrimit.
Të gjithë kështu dolën nga këmishët e thjeshta
Dhe ikën
Në botën e madhe të punës, luftës, gazit e dertit,
Që nga shkencëtarët e vreshtarët në vreshta
E gjer te burrat e shtetit!
Po, në male i thanë këmishët
Skënderët, Naimët, Qemalët, Çerçizët...
Miliona e miliona këmishë të vogla malet do thajnë
Dhe vulën e maleve
Në trup gjeneratat do mbajnë!

9.

Male,
Sikur të hapej historia thjesht si një valixhe,
Dhe të kërkonim, siç kërkojmë pas udhëtimit,
Do shihnim: trimëri, vrasje, kode, ligje,
Njerëz vënë para pushkatimit.
Do shihnim rresht ushtri me shpata, topa, mitralozë,
Me qerre, araba, triçikla, tanke, autoblinda,
Do shihnim Jul Cezarë, Muratër, Musolinë,
Bajlozë të vjetër e modernë bajlozë,

Me përkrenare, helmeta, çallma, borsalina...

10.

Sikur ta hapje thjesht, si një valixhe, historinë
Dhe të dëgjoje heshtur ti në dhomë,
Do ndieje lemeri e ulërimë
Nga qindra mijëra turma:
Hordhi, taborë, divizione.
Sa perëndi në hira tretur e harruar!
Sa frone pashallarësh rënë përngahera!
Sa strategjira lënë pa mbaruar!
Sa koka të gjakosura, të prera!
Sa helme e dredhira e intriga!
Sa magjistarë mjekroshë e sa shtriga!

11.

Male,
Vetëm nga gradat, dekoratat e nishanet
E gjithë atyre që erdhë valë-valë
Në grykat, sheshet, pyjet dhe stanet,
Do ngriheshin Tomorë, Korabë e Cukalë!
Ku vanë?
U mbytën pluhurit?
U dogjën zjarrit?
Këtë e di veç shpata e shqiptarit,
Që mbeti jashtë millit shekuj radhë
Në male si një monument i bardhë.

12.

O malet e mi,
Sa herë ndërroni ngjyrat në faqet!
Në agim derdhen mbi ju trëndafilët,

Në mbrëmje derdhen mbi ju manushaqet,
Përcjellë me mall nga bilbilët...
Pelerina juaj e manushaqtë e bardhë e murmë
Vjen nga shekujt e shkon në shekujt,
Hedhur supeve fisnikë;
Vjen nga shekujt e shkon në shekujt e qetë e me zhurmë,
E bukur, e dashur, e rreptë,
Që bart edhe mall edhe frikë,
Përcjellë nga gjëmimet e rrufeve,
Zhubrosur nga uturimat e orteqeve,
Coptuar nga akujt dhe litarët e reve,
Grisur nga furtunat e deteve.
E prapë përtërihet,
Qëndisur si para një dasme,
Një dasme të madhe
Me daulle, fyej, xhura e dyjare
Me sofra mbuluar me sofrabeze basme,
Shtruar me kofshë deshësh, mjaltë e verë bujare,
Me sofra ku hidhen rreth tyre diva e zana,
Kreshnikë e kapedanë me mustaqe si drapër,
Me heshta, topuzë, shigjeta, jataganë,
Që me një të goditur shkëmbin e çajnë si lakër!

13.

Ja, mbi sup të Nemërçkës
Dielli ngre kokën si dashi,
Mbi vetull të Dajtit hëna - mënjanë si feste,
Korabi hesht me lara të bardha
Siç hesht pas kullotjes balashi;
Shkëlzeni si dhëndër i kaltër pret nusen në feste.
Tomor e Shpirag,
Njëri me hark,
Tjetri me shpatë,

Qëndrojnë veshur gri si shqytarë ilirë;
Cukali mban topuzin me krahun e djathtë
Me gjoks nga Buna e lirë...
Gramozi përgjon në kufi me vështrimin e lashtë
Dhe flet me Moravën me bluzë të gjelbër;
Mali Ivan tund kokën e thinjur kashtë,
I thotë Maliqit ngarkuar me grurë, shalqinj e pjepër:

«Maliq vëllai,
Më jep një shalqi me zemër të kuqe,
Jam plak e plaku ka huqe!»
I kthehet Maliqi, nikoqiri i madh i hambarit,
Që ruan si banka thesarın e arit:
«Shalqinjtë janë të shtetit, Ivan,
Ti e di, Maliqi s't'i mban!»
Mali i Thatë hap gojën e madhe,
I etur pi në liqen
Dhe s'nginjet,
Sikur të ketë kullotur, si viç, shtatë livadhe,
Ndaj pi si viç në legen...
I thotë Ohri i kaltër:
«U nginje, o viç?»
Përgjigjet Mali i Thatë:
«Hiç!»
Kështu legjendat hidhen në lisat e gjatë,
Në lugje, lëndina, guva e shpella,
Se madhështinë e maleve
Legjenda e ndjek ditë e natë,
Jatak i legjendës janë pirgjet e grykat e thella.

14.

Dielli ngrihet e zbret e vizaton me radhë
Hijet e maleve dy herë në ditë

Mbi qilimin e grurit të verdhë
Dhe pambukut të bardhë
Mes Myzeqesë larë në dritë.
Janë ato lule që hedh nusja e re në qilm:
Ca krahë shkëmbinjsh, ca degë borigash, ca bar,
Janë vetë fytyrat e maleve
Bërë nga dielli - artist çdo agim e çdo perëndim
Me shije të rrallë e karakter kombëtar.

15.

Kështu, dy herë në ditë, me miliarda vjet,
Vazhdon dielli-artist vizatimin e maleve!
Kur Myzeqesë s'i mjaftonte qilimi,
Hijet shkonin në det
Dhe humbisnin mes valëve...
Po Myzeqeja as para tridhjetë vjetësh që shkuant e vanë,
S'i nxinte format e maleve, e dini?
S'harrojmë Tërbuin, Hoxharën, Karavastanë,
Kur brenda në Lushnjë hynte delfini!

16.

Vjen dimri.
Qëndrojnë shtëpitë e fshatrave paqësorë,
Mbështetur e lidhur pas shkëmbinjve të egër
Dhe nga oxhakët tymi heq via mbi dëborë
Të kaltra si vijat e çibukëve të pleqve të vjetër
Ka ikur frika nga dëbora me kohë
Dhe mbi dëborë gjurmët era ka fshirë,
Mbi bardhësi ylberi ngre qemerin e hollë,
Bashkon dy male si dy vëllezër të mirë.
Pëllasin lopët lara në ahuret,

Se malli për viçat e vegjël i merr,
Shkëlqejnë llambat elektriKE në katër muret
Dhe brirët, kryqëzuar si shpata, bëjnë ylber.
Xhaxhai mustaqet dredh i menduar:
«Si ndodhi në mal, or të mirë!
Ku qenka parë e dëgjuar,
T'i vihet elektrik lopës në brirë!»
Në mend i sjell dy vargje duhani i thatë:
«O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë
Fushat e gjera me lule që u kam në mend ditë e natë!»

KREU I TRETE

1.

Lërmë të bie në prehrin tënd plot ledhatime,
O hallemadhja ime shekullore!
Le të hyjë në shpirtin tim çdo fëshfërimë
E fustanellës dhe xhubletës sate malore!
Eh, fustanella jote,
Sa herë u corr,
U gris e u shqye
Në shtigjet e shekujve me gjemba farmak! *si mb.*
Këllqet t'u nxinë
E gjoksi me ngjyrën e kuqe t'u ngjye,
O hallemadhja me par mendë, pallë e bajrak.

2.

Të shihnin të tjerët me fëmijë në gji e në duar
Tek ecje sfilitur pa ngrënë e pa pirë,

Qeshnin dhe thonjtë i ngulnin në tokat e tua:

«Kjo copë për ty,
Kjo copë për mua,
Kjo copë e mirë...»

3.

Dhe zogjtë e tu të mjerë, të shkretë
Braktisnin të heshtur foletë;
Kabaja qante në gryka e zalle
Për botën e ndrydhur në halle;
Kabaja bartte hidhërimin e maleve,
Si zemra e vajzës së valëve,
Që priste mbi gurin e zi anës detit,
Mbetur si qyqja në mes të rrëmetit.

Kabaja vajtonte strehët e lëna,
Lagur nga shiu e zverdhur nga hëna:

Ç'ka që s'mbin bari në qafë,
Ç'ka që hesht lëndinë e ngratë!
Ju të ligj e ju sakatë,
Amanet ju lëmë gratë,
Marrim rrugën e kurbetit
Dhe s'e dimë ç'vjen prej detit.
Rruga jonë, dreq o rrugë,
Zgjatet për një copë bukë,
Shkon në fundin e dynjasë,
Akujve të Kanadasë...

4.

Kabaja bartte barrën e dertit,
Si zemra me vrer e asqerit:

Mbeçë, more shokë, mbeçë
Përtej Urës së Qabesë!
Falini shëndet nënësë
Të dy qetë të m'i shesë,
T'i japë nigja së resë;
Të më shesë ka e mushkë,
Të më rrisë djalë e çupë!
Oi, oi, oi...

Ku mbetën fëmijët, djemtë e vajzat si yje,
Ku vanë të parriturit e nënës!
Grindej era në pyje,
Gjaku spërkaste hauzin e hënës...

5.

T'u hodhën, t'u derdhën çakenjtë ~~sincal~~
Dhe lanë thonjtë e zinj në shkëmbenjtë.
Dhe ti
S'kérkoje terzi
Të arnoje fustanellën e shqyer,
Dhe ti
S'kérkoje mjek të shëroje gjoksin me plagë;
Ti tirrje lesh për arnë
Me furkën nën sqetull mbërthyer
Dhe bar të rrallë mblidhje e plagës ia vije ngadalë.

6.

Ku mbetën fëmijët e shkretë!
Në Krujë kthehej djali yt hipur në kalë të bardhë,
Vinte ai që emrin Gjergj në djep ia kishte vënë,
Vinte ai që emrin ia kishin marrë

Dhe në rërën e shkretëtirave ia kishin përzënë;
Vinte ai me emrin që ti ia vure në ditën e lindjes;
Mbi vithet e kalit të bardhë
Rëndonte nata e mesjetës,
Mbi jelet e kalit të bardhë
Binte mëngjesi i Rilindjes,
Mbi trokun e kalit të bardhë
Kushtronte zëri i trumpetës...

7.

Dilte Naimi në malet, që mbanin kryet përpjetë
Me pendë e kartë.
Penda i rrinte në dorë
Si kërcelli i degës në shkozë;
Dilte Naimi me vjershët e gjuhës së zjarritë,
Dhe merrte, nga malli për ty, tuberkulozë...
I vure lecka në ballë me ujin - balsam të burimit,
Po plagët s'iub myllën Naimit.
E prapë thirri me zërin e madh gjer në varr:
«Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emrin

shqipëtar!»

8.

Në gërxhet e thata shfrynte Rrapo Hekali
Dhe plumbat si breshër i binin mbi supe,
Martina e palla
Gjëmonin e ndrisnin sa tundej mali
Dhe zinte në gryka pashanë me «shtatë tuje»,
Dhe nëna këndonte: «O djem, o pallëvetëtima,
Ç'ju grisën fustanellat nga martina...»

Doli Rrapoja në Sinjë:
Primë, o Isuf beu, primë!
Në të zënça, s'ke të mirë,
Gjakun ta kam për të pirë!
Foli Rrapoja në Sinjë:
Primë, o Isuf beu, primë!
Do ma nxjerrësh ti mërzinë,
Po ta poqa dot mëlçinë!...

9.

Mes Myzeqesë tek derdhte shira nëntori,
Ecte karroca me fronin me kashtë,
Ecte në baltra e shpinte Plakun e Vlorës në Vlorë
Të ngrinte flamurin e lashtë,
Që pesë shekuj e mbajte qëndisur,
Fshehur sepeteve e mindereve të grisur...

10.

Sulej Selami dhe gunën era ia merrte,
Kali lëshonte nga thundrat çika,
Naganti në dorë shkëndija derdhte,
Selami zinte topin nga «grika»!
Për birin lart ballin e ngriti nënokja,
Në prehër e vuri lahutën e maleve lokja:

Ç'u derdhe nga Drashovica
Me njëqind e ca komita,
Grykën nagantit s'ia ule,
Lule Selam labi, lule!

Parisit ecte Avniu me duar në xhepa ngadalë,
 I huaj, i vetëm, student i një toke të varfër...
 Ku donte të dinte Franca se vinte një djalë
 Që nga Libohova në Senën e kaltër!
 At'herë në Vlorë tre plumbë rrëzonin përdhe një balonë
 Dhe hidhte Selam Salaria gunën mbi tela... *Rue castilicune*
 Çapitej Avniu me kobure në xhep në «Ry Kastilione»,
 Në «Kontinental» Esati pinte «Bordo» e hante thela.
 Në «Ry Kastilione» balona nuk binte,
 Në «Kontinental Hotel» dhe guna nuk hidhej,
 Në «Ry Kastilione» një vajzë me ty mund të vinte,
 Në «Kontinental Hotel» francezka me ty mund të gdhihej...
 Po ty të thërrisin kockat e shpuara,
 Po ty të thërriste hiri i murmë i të rënëve,
 Po ty të thërrisin strehët përdhe të shkrumbuara,
 Po ty të thërrisin shamitë e zeza të nënave:
 Avni, ka shkuar pashai në «Kontinental»
 Të prishë paratë që shiti nënën e mjerë,
 Kasollet po qajnë me ligje në mal,
 Kështjellat vajtojnë nën mjegull e erë...
 Ç'ish kjo? A këngë a refren i vajtimit të largët,
 A vinte nga malet e Lunxhit, a gjol i Tërbufit?...
 Refreni futej në «Ry Kastilione» dhe brigjet e Senës së
vakët

Dhe ngjitej në Kullën Efel e në Ark të Triumfit,

Eiffel

Pritmë, o Esat Pasha,
 Pritmë, o qostekartë,
 Dita është e shkurtër,
 Udhë është e gjatë!
 Drekë ku ke ngrënë,
 Kafe ku ke pirë,

Në ç'hotel je ngrysur,
Në ç'bordell je gdhirë!
Jam nisur nga malet,
Malet më dërgojnë,
Shallvaret e gjera
Malet t'i kërkojnë.
Shallvaret e zeza
Me oçkur të bardhë,
Mbuluar me pala
Radhë, radhë, radhë,
Seç i duan malet
Krenuar me shpate
T'ia bëjmë qefinin
Nesër zotrisate.
Shallvaret e tua
Dyzet kut pëlhirë
Veshin tre tabutë,
Veshin tre qivurë,
Veshin tre tabutë
Veshin dhe arrijnë:
Një për frymën tënde,
Dy për tradhëtinë...

Pritmë, o Esat Pasha,
Pritmë, o jelekartë,
Dita është e shkurtër,
Udha është e gjatë!
Ky «Kontinental»
Pasqyra, pasqyra,
Mban një krromë brenda
Me dyzet fytyra.
Krroma kthetra — kthetra
Po e shet për pesë
Shqipërinë e gjorë,
Nënën shamizezë,

Kush të shtron dyshekun,
Kush të hedh jorganë,
Katër karakurva
Seç të rrinë pranë!
Një të shtyp kurrizë,
Një të kreh mustaqen,
Gili-gili gushën,
Gili-gili faqen...
Qesh e hargalisesh
Në bordell në Francë,
Dergjet Shqipëria
Me syngji në palcë!
Ah, koburen time
Ç'e ka marrë malli!
Pasqyra, pasqyra
Ndrit «Kontinentali»...

Pashai e thau dhe shishen e tretë të verës,
Mustaqet i fshiu me pecetën e markës «Kontinental»,
Vetura e priste tre hapa larg derës,
Kur gryk' e kobures në gjoksin me dhjamë u ndal.
Një zë u dëgjuat mes dhëmbësh: «Esat!...»
Dhe shau dy herë në gjoks revolveri;
Në «Ry Kastilione» u mpiks nëpër pluhur gjaku bastard,
I vrenjtur heshti Avniu si dikur Robespieri,
Avninë të tillë e njohe, Paris:
Koburja në dorë, pashai në kurriz!...

12.

Vinte Bajrami shtigjeve zënë prej ortekëve,
Rënduar nga vitet, nga hallet, nga dertet;
Mes borës së maleve, në guvat e bjeshkëve

Plaku i niste Leninit Letër:
«Hazreti Lenin.
Hazreti Lenin,
Nga malet — shëndet!
Nga bjeshkët — shëndet!
Shqipëria heq,
Shqipëria ngrin,
Hazreti Lenin,
Hazreti Lenin,
Një plak me kobure në dorë të flet!...»
Shponte koburja e plakut natën në Alpe,
Zogu mustaqet krihte diku në pallate:
«Leninit selam?
Ham, ham!»
Zogu mprehte thikat në farkë
Nga mëngjesi në darkë.

13.

Zogu ustallarë evropjanë kish marrë,
Që fronin e madh mbretëror t'ia ndreqnin në odën me
qelqe,
Zogu kish thirrur bejlerë, priftërinj, hoxhallarë,
Që kurorës së mbretit
T'i hidhnin temjan me lepe e peqe.
Që nënën ta mbanin të zbatbur, të çjerrë, të grisur,
Që zanat bjeshkët t'i linin të shkreta,
Që loti i hidhur burimet t'i bënte të hidhur,
Që ujquit nga skutat të zgjatnin nofullat e mprehta...

KREU I KATËRT

1.

Eh, xhubleta jote,
Eh, fustanella jote,
Moj loke!
Vërtitej në skenat tragjike
Në amfiteatrin e madh të Ballkanit!
«Një copë, një copë!
Një çikë, një çikë!»
Ulërinin ujqit mes zhegut, kallkanit;
Dilnin nga shpella si në legjendat e vjetra
Veshur me mburoja kalorësie,
Fshehur kokë e turi në helmeta,
Zbutur me frak diplomacie,
Zgjatnë këmbën si në përrallën e Dhisë e Kecave:
«Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!»
Po nëna e dinte gjuhën e gënjeshtreve,
Lokja rrinte pa gjumë.

2.

«Tuk-tuk!

Hape!

Jam unë!

Vij nga Kongresi i Berlinit,

Vij nga Traktati i Londrës,

Vij nga Mbledhja e Versajës,

Jam gjyshja, jam gjyshi, jam çuni i dajës...

Tuk-tuk!

Ia hiq llozin portës,

Këmbën e kam të bardhë,

Këmbën e kam të mbarë!

Tuk-tuk!

Hape! Jam unë!»

E nëna rrinte pa gjumë.

3.

Xhambazët

Që e nxirrin nënën në pazarin e zi të Ballkanit,

Bënin duva dhe kërcenin rrëth kurorës së mbretit,

Trullo sur nga tingulli i lirës së arit,

Dehur nga era e temjanit

Në oborrin e madh të dovletit...

Po tutje Myzeqesë kalbej kallami në baltë,

Kalbej njeriu tok me kallamin e madh si zabel.

Bujkut i vinte dimri mes vapës,

Bujkut ia shpinte dimrin mushkonja anofel...

4.

Anofel, anofel!

Hape me thumbin e vogël varre në baltra,

Plake nuset e djemtë pa vënë kurorë,
Plake kërthijntë me qafa si kashta e thekrës te vatra,
Zbraze qumështin nga gjokset
Dhe gjokset i mbushe me borë,
Borë ethesh në gusht,
Borë ethesh në shkurt!

5.

Po larg nga kulla e bardhë e Vrionit
Urdhrat gjëmonin:
«Bereqet, bereqet!
Peshoni, peshoni!
Kaq lira të kuqe,
Kaq cent!»
Zvarriteshin lutjet nga vrahut në vrah:
«Ka para?
Ka allah!
S'ka para?
S'ka allah!»

6.

Dhe hapnin vrima nën pragje e mure
Me kazmë, me bel e me thonj të palarë
Dhe qypat e arkat me ar i fusnin në dhe si qivure
Me ankth e me dridhma,
Si ai që gërmont përvete varrë.
Floriri i vdekur dergjej në tokën e zezë,
Lëngontejeta dembele e zotrinjve mes mizave,
Pa të ardhme, pa dritë, pa shpresë
Rreth qypave groposur vrimave.

Mejhaneve lozni nën dajre çingitë
Dhe hapnin gojët me jargë ashikët.
Vërtiteshin mes ere livandosh dimitë
Dhe nxinin lyer me bojë qerpikët.
Sokakëve bejtexhinctë këndonin këngë dylberësh:
«Aman, aman, mre çun i bukër»,
Odave kërcenin mijra pleshta njëherësh
Dhe valle losnin në sofrën e bukës!
O jetë me myk nën qylaf, qostek, borsalinë,
Në dhëmbë të krimbur e tru të mpitë,
Më mirë të ngordhja për bukë diku në bujtinë,
Sesa të kisha të bëja me ty qoftë e një ditë!

7.

Këtej nga vrimat zotériu i falej qypit
Si kokës së zotit të lashtë,
Andej nga malet si mure qiellorë
Njeriu e shkelte përtokë burrérinë si kashtë
Për grushtin e misrit, për kokrrën përrallore.
Dhe binin poetët në shtrat nga veremi
Të verdhë si kokrra e misrit në vatër,
A s'ra e s'u ngrit në Pukë Migjeni,
Filizi i korrur me drapër?
Akoma kishte shumë t'i thoshte botës poeti,
Me krahun e fjalës të ngrinte kudo tramundanë,
Po kokrra e misrit si plumb mushkërive i mbeti
Dhe copë mushkëritë i ranë.

8.

Fshatarit që dinte të bënte çudira me tokën e ngratë,
Që mund të krijonte nga balta dhe vetë Adamin
Me sy, me veshë, me dhëmbë,

Një hiç — bejlurçinë që kishte në vendin e truve bathë,
I bëhej perëndi, i rrinte mbi kokë, e vinte nën këmbë!...
Po prapë hiç — bejlurçinën dridhma e zinte
Nga sfurku që mbante fshatari,
Dhe sfurku në èndërr i shfaqej me majë përpjetë
Dhe veten e shihte të ngritur mbi sfurk
Si dengu i barit
Në grazhd të qilarit për qetë.

9.

Fshatari të gjitha i di pa letër e libër,
Fshatari librin e tokës mësoi me durim:
«Do vijë patjetër një ditë
Të kërkojmë shpagim,
Të kërkojmë shpagim!
Shpagim si shpata e mprehtë, që sytë t'i err.
Shpagim si honi i thellë, që mendtë t'i merr;
Shpagim si rrebeshi, që gojën mënjanë ta çon,
Shpagim si akull Korabi, që palcën ta shpon..»
Po gjersa të vinte dita e madhe e shpagimit
Sa burra u tretën dhe humbën gjeni të vërtetë,
Kositur nga kosa e mprehtë e thëllimit,
Thëllimit të kohës së rreptë...
Ata e lanë biografinë e tyre shkruar në këngë
Në faqet e shkrepave mbushur me halle e brengë:

Unë i ziu që kur kam lerë,
Me një këmishë të çjerrë,
Hyzmeqar derë më derë,
Më ra bretku në bejlerë,
Hoqa gunën zvarrë-zvarrë,
M'u thinj floku arë më arë,
Barku bosh e zorrët tharë,
Këmbët plasur, buzët çarë.

O ju male me dëborë,
Qani me shami në dorë,
Jam me halle, jam i gjorë,
Kam me derte kraharonë!
Hallet vetëm ju m'i njihni,
Dertet vetëm ju m'i shihni;
Qani për mua të zinë
Mbushni plot me lot shaminë...

10.

Dhe gratë psherëtinin për burrat e tretur,
Gratë tonë me duar fisnike,
Me sy të mëdhenj si burimet në pyjet e fjetur
Rritur pa kreme, rritur pa kozmetikë;
Ato që uleshin, si hanin burrat, në sofër,
Pëllumbeshat tonë në fundin e odës;
Ato që vdisnin sikur s'kishin jetuar kurrë,
Kur gjaku ngadalë, në cep të minderit, u ngrinte në dej;
Ato që mbanin në shpinë vandakët me drurë,
Ato që mbanin në gjoks fëmijë të hej si kércej;
Ato që shihnin èndrra në natën e errët
Për bukën e grunjë e për vallen e trimave;
Ato që ngrinin kokën nga minderet
Dhe zgjoheshin nga nepërkat e vetëtimave...

11.

Në pallat në Tiranë të motrat e Zogut qeshnin me djem
Dhe zbusnin turinjtë me krem parizian «Margerit».
Niseshin në botë princesha Sanie, princesha Myzejen,
Malli i digjte të shihnin Paris, Vjenë, Uoll-Strit.

Ku vanë princeshat, ku vanë!
Mbetën me princat hoteleve me myk të Evropës,
U bënë tregtare unazash e pendët e kaltra u ranë
Në rrugët e Parisit, Londrës e Romës...

12.

Ku vanë pinjollët e lëpirë të trashëgimit të fronit
Me dadot, sejmenët, kuzhinierët, guvernantet!
I fshiu dhe i hodhi fshesa e revolucionit,
Të mbretërojnë përjetë në fronin e natës!
Ku vanë hamësit e pangopur të bukës së fëmijëve
Me vulat, kodet, ligjet e çizmen e hekurt!
Me defterët e të dhjetave, xhelepet e dosjet e tapive!
I morën t'i hanë me dhjamin e vënë në shekujt!

13.

Ku vanë poetët,
Që bejte u zienin me mall në tiganin e zi poetik
Dhe zgjasnin duart t'ua jepnin t'i hanin!...
Me llum i mbulove, Adriatik,
Që kurrë mos ngrihen, që kurrë mos dalin!

14.

Ku ka më bukur sesa të jesh zot në tokën tënde,
Të marrësh frymë me gjithë mushkëritë,
Të thuash:
Janë të miat këto hapësira e vende,

Dhe kokën tē ngresh nga jastëku pa ankth e pa frikë!
Ku ka më bukur se kur s'të ndrydhin as mendjen, as
shpirtin

Gogolët gri tē së ardhmes!

Të ardhmen tē gjithë e ke tënden si ditën, si vitin,
Si bukën e ardhur tē magjes!

Ku ka më bukur se tē mbjellësh grurë e tē lindësh fëmijë,
Të bëhesh gjysh e tē rritësh nipër e mbesa,
Pastaj t'i shpérndash si një grusht me shkëndijë
Plot èndrra e shpresa!

15.

Ku ka më bukur se tē rrish para maleve
I barabartë me malet, stoik dhe i ndjeshëm,
Njeri i dalë nga valët e detit tē hallevë,
Njeri i mençëm, i madh, i plotpushtetshëm,
Njeri që hije tē kanë lufta dhe puna dhe prehja
Dhe hapi që hedh dhe kënga dhe brengë dhe malli,
Njeri që hije tē kanë dhe veshja dhe krehja
Dhe brazdat që merr fytyra e balli...

Njeri, tē gjitha këto i kishe, po flinin
Nën mbretërinë e akujve tē vdekur.
Njeri, duhej më parë akujt tē shkrinin
Me zjarr, tërmët e hekur,
Pastaj trëndafili yt tē shpérthente
Mbi kraterin e vullkanit tē gjoksit që ziente!

KREU I PESTË

1.

Kokën kam vënë në gjurin tënd mbuluar me fustanellë,
Ti këngë këndon e tregon legjenda të lashta e të reja
E unë marr frymë thellë
E mbi ballin tim hedh tyl të bardhë reja.
Ti më thua:
Me plug hapja rrugën pranverës,
Që pranvera të vijë pas teje si shqerrëz;
Me kallëza gruri thuri kurorë verës,
Me mollë të kuqe bëja yllin vjeshtës...
Dhe unë mësoj;
Tërë jetën mësoj në hapësirat e tua,
Mësoj punën e luftën – dy mjeshtëritë e mia të hershme;
Mësojnë me mua
Fëmijë e grua
Dhe derdhin djersën e ndershme.

2.

Burra e gra, të rreptë e të qetë në botë,
Në pesë kontinent, ku duket po ai diell, po ajo hënë,
Më thonë se shembellej me ty këmbë e kokë.

Doemos.

Të kam nënë!

Jam karakteri yt në shpirt e në ngjyrë,
Më njohin në çdo kënd të kontinenteve,
Më njohin në këngë,
Në ecje,
Në fytyrë;
Më njohin në kutinë e duhanit,
Në vezmet e fishekëve.

3.

Në kutinë e në vezmet
Përzihen duhani, fishekët, kujtimet,
Përzihen rrugët e ëndrrave, dëshirave, shpresave,
Përzihen kërkimet,
Gërryerjet e shpirtit e mundimet,
Përzihen hallet e mia,
Hallet e bijve, nipërve e mbesave;
Të gjitha këto
Më kanë shtuar mençurinë e qëndresën,
Të di të pres breshrin
Me lehtësi siç pres vesën.

4.

Edhe nën ortekët e dëborës së maleve
Unë di të zbuloj pranverën;
Edhe nën tingujt dhe ngjyrat e fjalëve

Unë di të zbuloj gënjeshtren dhe të vërtetën;
Edhe nën çatitë e shtëpive të hedhura shkrepave
Unë di të zbuloj pallate të çuditshme;
Edhe nën uturimën rrëkerave
Unë di të zbuloj llamba me fije të ndritshme;
Edhe nën hirin e zjarreve
Unë di të zbuloj dashurinë;
Edhe nën dërrasën e varreve
Unë di të lexoj historinë...

5.

Unë lexoj historinë e çdo strehe
Që duket së largu e qetë.
Ja, kjo shtëpi me qoshe gdhendur me gletë,
Me oborr shtruar me plloça të murme malit sjellë,
Është ngarkuar nga fati përjetë
Të presë,
Të përcjellë...
Ne i themi me përkëdhelje:
Strehëz,
E bukur si pikëz e vesës!

6.

Strehëz,
Moj strehëz,
Nën tingujt e pikave të tua
Partia nxori «Thirrjen e Parë» madhore
Dhe kurmi yt me dritën e kuqe të yllit të kuq u zgjua
Dhe feksën malet ngarkuar me muzg e dëborë.
Kënduan aherë malet — rapsodë
Dhe kënga hyri odë më odë:

«Moj Parti, t'u shtoftë nami,
S'u tunde nga istikami.
Në fillim si pak e zure
Me ca të rralla kobure,
Me djem e vajza si nure
Ato që veshën poture,
Me dyfek me sakature...»

7.

Strehëz,
Moj strehëz,
Ti ishe selia e parë e Komitetit Qendror të Partisë,
Ti ishe selia e parë e Këshillit të Ministrave,
Ku hynin të gjitha ministritë:
Që nga e Mbrojtjes gjer tek e Industrisë
Nën zhurmën e plumbave
Dhe erën e shkrumbit të drithërave.

8.

Strehëz,
Moj strehëz,
Ti ishe kudo ku kish jetë:
Opar, Korab, Kuç, Zagori, Tomoricë;
Në lugje e gryka, në gërxhe e pyje me fletë
Prisje, përcillje në zheg e në ngricë...

9.

Ne vinim nga baltrat e kuqe të Mokrës,
Nga Tenda e Qypit e gurët e Kurveleshit,
Nga maja e Shkëlzenit e përrrenjtë e Skroskës,

Nga grykat e Pezës e dëbora e Martaneshit,
Ku masnim me këmbët e gjakosura tokën e të parëve
Për të hedhur themelet e pushtetit të proletarëve.

10.

Ne vinim me pallto, të grisura, marrë gjermanëve,
Ne mbanim në çantat e komisarëve zyrat e Partisë,
Ne mbanim arkivat e shtetit e skicat e romanëve,
Ne mbanim planet e kohës së lirisë.

Të gjitha pe e për pe i kishim matur,
Siç mat shkencëtarë të mijtat e gramit,
Të gjitha i mbanim me mendje, zemër e shpatull,
Që kurrë pastaj nga gabimet tonë mos qanim!

11.

Ç'kujtoni ju, se pesë vjet të rinisë sonë të mirë,
Të regjur në male nga plumbat, dhembjet, torturat
Kaluan kuturu, bam e bum në errësirë,
Kaluan kuturu pa shtruar në honet e historisë urat?...
Ne shtruam urat
Që lidhen brigjet e përrrenjve të kohës
Për të kaluar nëna Shqipëri krenare, e madhërishme;
Ne shtruam urat
Mbi shtylla të ngulura në zemër të tokës,
Që kurrë mos shemben nga rrebeshet e frikshme,
Që kurrë mos besojmë
Si në përrallën e Dhisë e Kecave,
Që kurrë mos biem në gjumë
Nga gjuha e lajkave, dhunave, gënjeshtrave:
«Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!»

12.

Në urat e së ardhmes ne vumë eshtrat tona të bardha
Dhe lidhëm brigjet nga streha në strehëz
Andej nga kaluan çeta, batalione, brigada,
Tek mbanim në buzë këngën e së nesërmes.
Sikur mos vinim eshtrat tona në ura,
Do hynte ujku i përrallës së Dhisë në toka e ujëra:
«Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!
Jam Tezja e Madhe,
Mike në vapë e furtunë!
Jam Grand Britanja,
S'kam dhëmbët që kishte Antanta,
Më dhimbset Saranda!
Tuk-tuk!
Më lini të futem pakëz,
Bëjani qejfin plakës!»

Kur ne kishim derdhur aq djersë e aq gjak,
Gjak nga njëzet e tetë mijë zemra pa nisur rininë,
Vinte Grand Britanja në prag
Dhe donte ta ndanim përgjysmë lirinë,
Që prapë të fillonim jetën e malit,
Që prapë të nisnin torturat e burgjet,
Që prapë të pinim ujë në gjurmët e kalit
Në mëngjeset e muzgjet...
Po ne s'kishim dalë prej hiçit,
Megjithëse s'mësuam në Universitet të Kembrixhit.

13.

Strehëz,
Moj strehëz,

E vogël, me trarë të lashtë,
Prite e përçolle djem petritë e vajza gjeraqina,
U shtrove dyshekët e nuseve
Dhe minderet me kashtë,
U there demat të bënин me lëkurët opinga...

14.

Strehëz,
Moj strehëz,
Ku rrjedhin pikat si rruza,
Ku zgjaten akujt e mprehtë si shpata,
S'tu drodh asnjëherë buza,
Kur bukën pér bijtë e nisje malit në udhë të gjata.
Vallë kush të harron e kush të braktis në jetë!
Ti mbajte mbi trarët luftërat e tmerret,
U dogje me bombë,
U shpove me bajonetë,
Vështrove mes tymit
Shembëlltyrat e Zogut, Duçes, Hitlerit...

15.

Strehëz,
Moj strehëz,
S'ta trembenëndrrën
Zjarri, fitili, qysqia, plumbi...
Sërishmi e sërishmi e ftovë të vinte këngën,
Sërishmi e sërishmi
E ftovë të ngrinte folenë pëllumbi,
Sërishmi e sërishmi përkunde në djepa trima e zana,
Sërishmi e sërishmi e përjetshmja «nina-nana».

16.

Strehëz, *simbol*.
Moj strehëz,
E vogël si kërpuçha,
Fluturon petriti në shi e në vapë,
Këtej do ta sjellë udha,
Këtej do kthehet prapë...
Do bëhet poet, kryetar a më shumë,
Prapë do vijë te kjo strehë, te ky lumë!
Do marrë pasaportë diplomatike,
Do fluturojë me «Bohing», «Karavellë» a «T-U»,
Do shkojë në Evropë,
Azi,
Afrikë,
Amerikë,
E prapë do vijë këtu...

17.

Le të jetë kushdo
E le të ketë dhjetra diploma me vlerë,
Po tok me diplomat nderin me vete ta marrë,
Që sytë pa u skuqur në trarët e lashtë t'i ngrerë,
Që fjalën pa drojtje ta thotë:
«Njatjeta, o trarë!»
Le të jenë ç'të duan!
Ka njerëz
Që njohin përmendsh gjeografinë dhe racat e gjindjes
Dhe tekste hartojnë për një ishull të vogël sa pjata,
Po lumin që rrjedh i kaltër nën strehët e lindjes
E lënë pa e parë me vite të tëra e dekada.
Pastaj kur ndodh që zbresin nga postet e gradat,

Kthehen ngadalë te strehëz e vogël mbi lumë:
«Gabuam,
Moj strehëz,
Gabuam, të ngratët».
E bien përlotur në gjunjë...

KREU I GJASHTË

1.

Kokën kam vënë në krahët e tu, përvëluar nga malli,
O faqebardha ime shekullore!
Të zgresin rruzat e djersës nga balli
Dhe zemrën time e bëjnë rinore.
Dua të sjellë për ty fjalët e gjuhës së mirë,
Që tok me qumështin tënd i kam pirë;
I gjeta në qumështin tënd, në barin e fletën,
Në lulen e shqerrës dhe lulen e blirit,
Në gjëegjëzën, këngën, legjendën,
Në degën me lëng të ullirit...

2.

Ti e di,
Unë s'kam kuzhinë poetike, që zien fjalë e rima,
Unë fjalët s'i ziej, po i rrit si çobani deshtë në stane
Tek bredh, me fyell e kërrabë, male, kodra, lëndina,
Tek thonjtë e bërrylat gjakos në tufane,

Tek fyt e fyt vete me ujquit natën, kur fryjnë erërat
Për tufën e bardhë, delet e shqerrat...
Shumë fjalë të fryra si kungujt në arë
S'barazohen me fjalën «mirëmëngjes!»
S'barazohen me fjalën «udhembarë!»,
Me fjalën «të pres!».
Shumë fjalë të enjtura si tullumbacket e lehta
S'barazohen me fjalën «me bereqet!»,
S'barazohen me fjalën «njatjeta!».
Me fjalën «shëndet!».

3.

Kështu, të thjeshta fjalët pér ty rreshtojmë,
Si thjeshtësia jote e pérjetshme,
Me to në buzë
Me bajonetë shkuam e me kazëm shkojmë,
Kuqur nga gjaku i ndershëm,
Lagur nga djersa e ndershme.
Ne s'marrim me qira argatë pér të na bërë këngë
Me yrnekun e të tjerëve në Evropë a Amerikë,
Ne këngët i ngremë vetë,
Siç ngremë fëmijët në këmbë,
Siç bëjmë ekonomi e politikë;
Ne s'marrim me qira oratorë
Në Organizatën e Kombeve të Bashkuar,
Universiteti ynë s'ka fakultet oratorie;
Çdonjëri prej nesh është orator i mbaruar,
Kur nderi i vendit thërret e kërkon guxim burrerie.

4.

As dje e as sot
S'kemi marrë me qira oratorë e politikanë,
Në malet gjer në retë

E në humnerat gjer në zemrën e tokës
Mësuan politikën e komunizmit politikanët tanë
Me fletore të zhübrosura në fundin e torbës.
Me fletore përzier me bukën, lapsat, fishekët
Ecën anëtarët e Byrosë Politike,
Ecën ministrat e ardhshëm, komisarët, strategët,
Eci muza jonë poetike...
Eci ai që ti, Shqipëri, nënokja e maleve,
I thua me fjalën prindore:
Bir!
Eci ai që kurrë ndaj halleve
S'ndenji të bënte sehir.
Që kokën në shekuj mos ulje kurrë,
Që ballin ta kishe krenar,
Ai u betua:
«Nderin e nënës do mbrojmë si burra,
Sikur ta dimë se hamë dhe bar!»

5.

Ne ishim krah tij bashkë si gishtat e dorës
Në akull, pranverë, dritë a terr,
Ne ishim krah tij mes skamjes, urisë, dëborës
Dhe ti i thoshe:
«Pri,
Biri i nënës,
Enver!»

6.

Pallatet e monarkëve, kuisingëve, regjentëve
Gjëmonin e dridheshin nga këmbët tonë,
Opingat e lëkurta shkisnin parketeve,

Pantallonat e grisura férkonin poltrona e frona...
Sytë tanë
Binin në cipën e pasqyrës ku bënte tualet Geraldina,
Ku Naltmadhnia e Tij
Dilte para se të mbante fjalimet
Me pamjen e atij që fsheh gjakun e mpiksur
Në gjotina,
Me pamjen e atij që dridhet nga krimet...
Ne thyem tavolinat
Ku bëheshin komplotet e zgjateshin firmat si vemje,
Kur hartoheshin listat dhe caktohej dita dhe ora,
Dita dhe ora e pushkatimit të vajzave e djemve,
Që nënët tē mbeteshin kërcure, tē gjora.

7.

Në pallatet e ministrave, xhambazëve, gjeneralëve,
Ku derdhej llumi dhe balta e shekujve,
Zbriti llava e kuqe e maleve,
Zbriti hakmarrja e tē gjallëve dhe tē vdekurve.
Akrepat e orës së monarkëve mbetën.
Akrepat e orës që kurdisën
Hitleri e Duçja nga Berlini e Roma.
Në pallatet
Që ngritën tē varfrit me gjakun e djersën
Madhërishëm gjëmuani orët tona...

8.

Madhërishëm gjëmuani orët tona
Për punën, paqen, lirinë,
Orët tona tē luftës finale;

Akrepat i vuri partizani
Që mori tokën, fabrikën, ministrinë,
Partizani që thirri:
«Bejlerë, ministra, gjeneralë,
Hapni kanale!
Ah, s'dashki të hapni kanale
Në Lushnjë, Mat e Pukë?
S'ka bukë!»

9.

Çapitej Shqipëria
Nga lufta në punë, nga gjaku në djersë,
Çapitej Shqipëria
Nga djersa në ofensivë orë për orë,
Me plagë në trup, me besim e shpresë,
Me nagant e kazmë në dorë.
Nga vrimat e pazarëve të vjetër,
Mes minjve e mizave,
Të përmbysurit — bejlerë, tregtarë, borgjezë —
Zhuzhisnin për ne si gjinkallat drizave:
«Oh, ç'pikë e zezë, oh, ç'pikë e zezë!»
Dhe hapnin buzët e vyshkura rrugicave damat,
Mbetur nga fisi Vërlaci, Vrioni:
«Oh, ç'dekadensë!
Po shesim fustanët dhe gjerdanët
Që dilnim për festë
Kur ftonte mbreti, pastaj Jakomoni.»

10.

Vajtonin hankot mbi sëndukët e relikeve,
Mbi fotot e oficerëve dashnorë,
Mbi fotot e Zogut, Musolinit, Hitlerit

Dhe éndrrat u ngjanin kaikeve
Té mbetura pa spiranca në valët e tmerrit,
Në sixhadetë e mëdha me deve shkretëtire
Frynte era e pragut të dimrit të parë,
Bodrumeve fundosur në errësirë
Derdhej vera e pashitur nga butet e çarë.
Në mes të kornizave të dritareve,
Si kujtim të trishtuar, plumbat linin vec vrimat,
Në mes të kuvalive e kafazeve
Pa frymë shtriheshin kanarinat.
Po prapa kthinave të hankove,
Me perde me lule,
Partizani shtronnte krevatin e madh sa një arë
Dhe ulej natën me vezme, kobure, thikë e cule
Dhe cules ia merrte në shtrat më të qarë;
Mendonte të sillte nënën, gruan, çupën, djalin,
Që jetën të niste dhe magjja prapë të mbushej me brumë,
Dhe hankos t'i thoshte: hanko, më falni,
Zbrisni pak në bodrume!

11.

Të përbysurit
Gérmonin bodrumeve dhe fshihnin florinjtë,
Të përbysurit
Gérmonin tokën dhe fshihnin drithët,
Mblidheshin kokë më kokë e ndiznin qirinjtë,
Allahut i luteshin në muzg si urithët.
Allahut i luteshin të binte pushteti i malit,
Që prapë t'i hipnin kalit!...

12.

Diku diplomatët e huaj
Peshkonin me grepa të markës së parë

Në llumin e turbullt peshqit e ngjalat:
Fashistë, ballistë, zogistë, judë, sarhoshë, kusarë
Dhe malit i hidhnin të krraknin si galat!

I kemi në mend pabesitë në driza e ferra,
S'harrohen pritat e tyre në shtigje të ngushta!
Tri thika në gjoks i ngulën Dilës pa dalë nga dera,
Në oborr të shtëpisë mbeti në pellgun e gjakut Shkurta;
Banditët në shtigje të errët hiqeshin zvarrë si krimba
Me thika, kobure, helme e fjalë — profka.
Pa nisur Plenumi i Partisë ra Bardhok Biba,
Pa nisur mëngjesi i shkollës ra Ndrec Ndue Gjoka!

13.

Dhe djemtë tanë
S'patën kohë t'i çmalleshin lirisë së bukur,
I lanë nënët e thinjura dhe gratë shtatzëna
Dhe shkuan të fshinin nga malet
Plehrat skutave strukur
Nga parashutat rënë...
Na vijnë në mend heronjtë e rinj legjendarë,
Që u ndeshën me bandat
Dhe bandat i prunë në gjyq në Tiranë:
Alush Leshanjakë të vrarë,
Priftërinj, bajraktarë,
Patër Antonër e Hamit Matjanë...

14.

Evropë,
Derdhe shumë dollarë e stërlina,
Mësove në fushat e tua vrasës-rekrutë

Të dinin sambo, të mbanin helme, të ngisnin makina,
Të ngulnin thika, të hidheshin me parashutë...
Mësove në fushat e tua ujq të rregjur
Të ndienin erën e gjakut,
Pas erës së gjakut të shkonin,
Në vendin e varfër, të vogël, të djegur
Pushtetin e ri të rrëzonin!...
Evropë,
Instruktorja e Madhe rrinte pas teje
Përtej Oqeanit të Qetë
Me emrin e madh Amerikë,
Dhe lëngun e drogave të krimeve ta fuste në deje
Dhe zemër të jepte mos kishe as drojtje as frikë!

Po vendi i vogël me ara fundosur në gjole
Po vendi i vogël, i varfër, i djegur, me bukë të pakët,
Që bankat e shkollës i kish në kasolle,
Nuk flinte rehat në jatakët;
Ai ish i ri në zjarr kryengritës përflakur,
Ti ishe e plakur!

15.

Sheshi i Tiranës ziente nga orët e reja,
Hidhte Enver Hoxha në ofensivë klasën:
«Proletarë, fshatarë, mësues, poetë,
Në rresht për beteja,
Që monstra e mposhtur
Mos ta lëvizë nga varri dërrasën!»
Ajo ofensivë do ishte ortek historie,
Që para do merrte botën e ferrave e beshtave,
Që kurrë mos binim nga lajka bëmirësie
Si në përrallën e Dhisë e Kecave:

«Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!
Të keqen halla, hiç mos ki frikë!
O'kej!
E pasur jam shumë,
Emrin e kam Amerikë!».

KREU I SHTATË

1.

Nënë Shqipëri!

Kemi dashur të jesh e bukur, moderne, e pasur;
U bëmë copë, na ranë në gurë e në baltë thonjtë,
U robëtuam në luftra e në punë me buzë të plasur,
Veç ty të të shihnim zonjë!

S'kérkuam në dorën e askujt krunde-tagji,
Në dorë veç pulat për krunde zgjatin sqepin,
Njeriu është zog këmbësor që s'hyn në kuvli,
Njeriu ecën mbi gurët që këmbët ia rrjepin,
Njeriu ecën në rrugë me besim e shpresë,
Që rrugën vetë ta gjejë me putra me gjak
Në gjemba e hithra.

Mundet që toka të çahet e hekuri nga ndryshku të vdesë,
Po vetëm njeriu i heq të gjitha.

2.

O ç'kemi dashur!

Të kishe qytete gjigante e fshatra me dritë,
Të kishe uzina me oxhakë e kupola,

Të kishe fusha pa gjerdhe mbushur me drithë,
Të kishe njerëz të lirë
Me mendje të ndritur e shkolla!
E mbi të gjitha të kishe klasën puntore
Të madhe, të fortë, me mendimin e lartë në ballë,
Që zot mbi zotrit ta kishte vendin në dorë,
Të hynte ndërgjegjja e saj në çdo qelizë të gjallë.
Ti i kishe filizët e saj,
Ti e thërrisje,
Shqipëri!

Asaj askush s'iu lut në bash të kumbiset,
E zuri vetë bashin e vendit në zjarr e stuhi,
Nga fronet të mykurit ngriti:
Hajt, mjaft qeverisët!
E dini?

Historia nuk ka rixha e mëshirë,
Atë e kish ftuar vetë historia,
Të dilte e bardhë, e ndritur, e lirë
Në mes të planetës Shqipëria.

E dini?

Pa klasë puntore mendimi mbetet gjysmak,
Pa klasë puntore ndërgjegjja mbetet e cekët
Si lumi në gusht,
Pa klasë puntore s'ka yll në bajrak
Pa klasë puntore njerëzit revolucioni
S'i mbledh në të vetmin grusht!

Klasa puntore shoqërisë i vë krahë të hekurt,
Me klasën puntore shoqëria s'lëngon,
Indet e trupit të saj mortin s'e njohin në shekuj,
Mushkëritë pérherë ia mbush me ozon;
Me klasën puntore

Ditët nuk zgjaten mërzitshëm si funerali,
Që pas e ndjekin fëmijët nënën e vdekur,
Ditët vrapijnë furishëm si orteku nga mali
Njëra me tjetrën duke u përpjekur...
Po klasa puntore lind gjeniun e saj të vërtetë

Mes dhembjes e gjakut, kur retë mbledhin stuhinë,
Gjeniun e madh, të urtë e të drejtë,
Gjeniun më njerëzor — Partinë...
Vetëm at'herë mijëra grushte bëjnë një grusht
Dhe botën e re e ngrenë në këmbë,
Që s'mund ta ngrinte i vetëm kurrkush,
Sikur edhe malet të hante me dhëmbë...

3.

Klasa puntore!

Ajo u ngrit nga hekuri në tym farkëtore,
U ngrit nga sharrat ku bëheshin dërrasat e vozeve,
U ngrit nga Kuçova e puseve vajgurore,
U ngrit nga barakat e marangozëve,
U ngrit nga galeritë e minierave,
U ngrit nga shegertët e vegjël e çirakët,
U ngrit nga timonët e shoferave,
U ngrit nga bujqit pa tokë e argatët.
Dikur çekanë kaliste e patkonj për kuaj,
Drapinj e kosa mprehte e qepte samarë,
Kalldrëme shtronte e nxirrte zift për të huaj
Dhe bënte plore parmendash për bujqit në arë.

4.

Na shihni?

Ne u lidhëm me partinë e komunistëve përjetë,
Ne që bënim patkonj, drapinj e plorë,
Ne që mbështillnim bukën e misrit në gazetë,
Ne që ziheshim kur na humbisnin në radhën e djathit pak
orë,

Ne që mësuam të qëllojmë me çekan e me plumb,
Ne që shpresuam të jetojmë gjer në komunizëm,
Ne që urryem e dashuruam gjer në fund,
Ne që donim gjithçka të dinim,
Po kurrë s'donim të vdisnim...
Jemi ata që dolëm nga farkat me blozë të zezë,
Që frynim me dorë kacekun
Sa niste këngën e mëngjesit gjeli,
Po sot turbina vëmë në Fierzë
Njëqind e ca mijë kilovat në çdo grykë tuneli.

5.

Ky emër Fierzë nga erdhi vallë?
Fierz — bar i gjelbër me fletë të brishta,
Dikur më gjiganti i bimëve në botën e gjallë,
Kur mbretëronte ai, ç'ishin ahu e pisha!
Atë s'e matje dot me metra e pashë,
Ai diellin e kuq e fshihte në krahët.
Ky bar vetëm në Fierzë e mori prapë lavdinë e lashtë
Dhe prapë u ngrit gjigant mbi gjigantët!

6.

Dikur udhëtarët e huaj zbrisnin në Fierzë,
T'ia gjenin fosilet shoqërisë njerëzore,
Shënonin në libra:
«Gjetëm në Evropë njerëz
Me jetën dhe doket njëzetshekullore!»

Udhëtarë,
Kaloni në Fierzë,
Ju ftojmë!

Ne librat tuaj të vjetër i mbajmë këtu
Si çdo shkencë,
Ata që flinin në fierëz, malin injeksionojnë,
I fusin shiringa në palcë si mjekët.
Si mjekët gjoksit të malit i bëjnë radiografinë
Të matur, të urtë, të zgjuar, modernë,
Që kurrë mos ftohet nga çdo suferinë,
Që kurrë mos marrë kavernë!...

7.

Klasë punëtore!
Dua t'i vë poemat në radhë,
Siç vure ti turbinat në katër lumenj,
Mendimi ngaherë të mbetet i bardhë,
Si shkuma në gojë tunelesh famëmëdhenj!
Poetëve s'u lutesh të ngrenë lavde për ty në vargjet:
«Më thurni vargje se plasa!»
Poetët ti vetë i rrit dhe i nxjerr si fëmijët nga pragjet,
Si nxënës nga banka e klasa.
Vërtet, si nxënës janë poetët,
Ka të shkëlqyer, ka të mirë, ka prapambetës;
Disa dëftesën e kanë me dhjetë,
Disa me zor i afrohen pesës!
Po ti, mësues i madh, durimin kurrë s'e humb
Në bankat e klasës me lapsin e kuq në dorë;
Ai që kupën e mbush, për supash e shkund,
Mornica t'i dalin, siç dalin në trup në dëborë,
Po ti poetët i ruan siç ruan uzinën metalurgjike,
Siç ruan digat nga plasjet e vogla si filli i telit;
Alarmin jep, kur pakëz çahet diga poetike,
Se s'do të shpërthejë liqeni...
Po ti gëzimin s'e fsheh, po e lë të gufojë buçimë,
Gëzohesh, qesh, brohoret, kur lind poezi e vërtetë,

Siç brohoret kur pret shiritin e kuq në uzinë:

«Rrofshi, poetë!»

Dhe unë pastrohem në detin tënd pa fund e pa anë;

Ku ka poet më të lumtur se unë!

Librat e mi pluhur në rafte nuk mbajnë,

I merr me vete klasa puntore në punë.

KREU I TETË

1.

Poemë për hirer e tua, o nënë,
Kushdo mund të ngrerë,
Kushdo mund të thurë dy vargje për male e burime,
Të bëjë betime për ty e gjoksit me grusht t'i bjerë,
Mbushur plot dashuri, plot mall e premtive.
Por unë jam komunist,
Dashurinë s'e kam aq të thjeshtë,
E kam të trazuar, e kam të vështirë.
T'i dua të gjitha ato që të mbushin me jetë,
T'i shaj të gjitha ato
Që shekujt t'i lanë pa pasur mëshirë.
T'i dua rrrobat punëtore
Nga Fierza, Bistrica, Ballshi, Ulza,
Ku pranë kalave të lashta ngre diga betoni,
Ku supet e maleve lidh me fije çeliku e ura
Dhe thua:
«Male, tani kuvendoni!»

2.

Male, tani kuvendoni!

Po s'ngjitej në mal socializmi si flladi në bahçe,
S'e kishte të lehtë

Të vinte kokën e tij në jastëkët — male,

S'e kishte të lehtë të fliste me ta familjarçe,

Me gjuhë llokumesh, me birinxhi — fjalë!

Ai i tundi malet me dorën e tij të hekurt,

U ra me kopan siç u biem dyshekëve,

U shkundi pluhurin mbetur nga shekujt,

U qepi arnat dhe u hoqi mykun prej leckave.

Kopani i tij gjëmoi e gjëmoi furishëm

Mbi mykun që mban emrin «hakmarrje»,

Mbi mykun që mban emrin e lig «dembelizëm»,

Mbi mykun që herë pas here do një pastrim e një larje:

Mbi mykun me emra të rinj me sufiksin «izëm».

3.

Eh, socializëm!

Po luajte një grimëz perin që mban terezinë,

Sikur mbi qepallat pak të rëndoje kandari i gjumit,

Rrëzohen e shëmben me mur e godinë

Dhe ty pastaj të merr lumi!

Ndaj rruga jonë na qenkësh topitur

Me gjak e me djersë,

U dashka me shokët e ngushtë të zihesh,

Me grusht të godasësh

E prapë i urtë të lypësh dhe ndjesë,

E prapë i ashpër të ngrihesh...

4.

Ka njerëz që presin me lugën në mes të pëllëmbës,
Që tavën që shtron socializmi ta hanë

Dhe vetë përtojnë të ngrenë një gur para këmbës,
Dhe vetë pakëz të preken,
Kohën si pejën e tyre e shajnë;
Ka njerëz që fjalë të mençme si lumë lëshojnë,
Sikur në një bankë me Marksin të kishin mësuar,
Pastaj në mes të furtunës
Krahun e majtë e të djathë harrojnë
Dhe mbeten në rrugë me shpirt të mjeruar.
Ka njerëz që tërë jetën e tyre lustrosin me lustër,
Që zemra u rreh veç për bufenë me fibër,
Që fshijnë një qime në cep të këpucës,
Që shohin kulturën te femra që pi cigare me filtër!
Ka njerëz që vitet i mbyllin në vete,
Që janë të lumtur me jetën bashkëshortore,
Që rrinë ngaherë si pikëpyetje
Dhe presin me ankth buzëqeshjen eprore!
Ka njerëz që pakëz pozitë të kenë
E ngrysin ballin dhe fjalët shtrëngojnë në dhëmbë,
Dhe janë të lumtur kur shpirtin ta brejnë
Dhe janë të lumtur
Kur ndjenjat t'i shtypin me këmbë!

5.

O njerëz, kur dega thyhet e bini,
At'herë ju njohim më mirë,
At'herë dhe duart tonë lëpini,
Aq sa lëpirjen e kemi pështirë!
Çudi!
Ku ishit gjer dje ju, xhentilë,
Ku ishit gjer dje ju, modestë?!
Ah, sa të sjellshëm, ah, sa bandillë!
Tani buzëqeshni, kur mbrëmë na queshtë!

6.

O ti, që harron një ditë popullin tënd,
Që sytë t'i hapi e të ngriti në këmbë,
Që shijen e bukës të fali
Dhe kafkën ta bëri me mend,
Që vetë hapa të hedhësh e grurë të shish në lëmë,
Që shef të bëhesh, drejtor a ministër,
Që bujk të bëhesh a atlet në palestër,
Që dërrasa të çash a të mbjellësh misër,
Që vargje të thurësh a të jesh në orkestër,
E di që vetëm populli është i përjetshëm,
Të tjerët lindin, rriten e vdesin?
Me popullin kurrë nuk humb,
Veç populli të mban në sup si pëllumb!
Këtë e ka thënë marksizmi me kohë
Dhe kurrë s'mbulohet me lustër e cohë.
Ndaj socializmi godet
Me çekanin e klasës me natë e me ditë,
Ndaj socializmi kudhrën e madhe
Mes malesh ka ngritur
Dhe thërret në kudhrën e madhe të gjithë
Pa telegram të posaçëm e ftësë me lulka qëndisur.

8.

Kështu ngjitej i rreptë në mal socializmi
Me libra, llaç, gëlqere, azot, tela, traktorë,
I hekurt në rrugë, pa sentimentalizëm,
Pishtarin e Kohës së Re mbante në dorë.
Malet herë pas here
Nxirrnin nga vrimat filxhanët e fallit,
Malet herë pas here nxirrnin nga guvat kanunë:
«Kjo vete, kjo s'vete, kjo e zakonit, kjo e sheriatit»

Po socializmi s'epej:
«Shsht, komandoj unë
Me diktaturën e proletariatit!...»

9.

- +
- S'bën socializmi shartime në pyllin e madh të kohës
Siç bën kopshtari në kopsht me fidankat e mitura,
Programi i tij me variante «izmash» s'shartohet,
Ndaj rrënjet i nxjerr çdo pemë me kokrra të hidhura.
- +
- Ata që bëjnë shartime dhe ia prishin fidanët,
I flak me tèrbim si deti në breg leshterikët.
A s'flaku Lulot, Premtet, Balluhët
Spahitë, Lubonjët, Paçramët, Yshëhet
Rrufjanët e zinj politikë?

10.

- I flak se s'do të trokasin nga jashtë.
Si ujku në përrallën e Dhisë e Kecave
Me gjuhën e lashtë
Të lajkave, dhunave, gënjeshtrave:
«Vij nga shtabi i Varshavës,
Më zuri mesi i ditës,
Më zuri mesi i natës,
Jam kamerad,
Jam tavarish!
Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!
O jes!
O zdjes!
Kam punë!»

11.

Nënë,

S'jam gëzuar veç me paqen e thjeshtë të maleve,
S'jam gëzuar veç me luftën që zboi të huajt e solli lirinë;
Gëzohem për shembjen e botës së hallevë,
Gëzohem për shembjen e shtypjes së njeriut mbi njerinë.
Liri pa të huaj mund të ketë dhe robi
E prapë të mbetet rob i rrahuar,
Ne komunistët vramë lubinë që sillte skamjen prej kobi
Dhe thyem zgjedhën e punës dhe zgjedhën e krahut.

12.

Ne komunistët jemi kockë e vështirë,
S'mallëngjehemi lehtë me fjalën «i lirë».
Ndaj mbi qytetet e lashta ilire
Ngremë uzina të rënda
Dhe ngjisim vaporin,
Ku ngjitej veç hëna, në kreshtat e thata;
Atje ku mund të ngrihej vetëm kolibja e tënda,
Akostohen anije e hidhen spiranca!
A s'e ngjitëm vaporin në Ulzë e Koman,
Ku la kështjella e shpata fisi i madh ilirjan?...

KREU I NËNTË

1.

I bie vendit tim pash më pash me këmbë e makina,
Rri me policë, bujq, ministra, shoferë;
Mbjell rrush, bëj libra, ngre ura, montoj turbina,
Këndoja e, me rast, pi raki tri herë të zjerë!
Këndoja e lajkës e smirës s'u kam as drojtje, as frikë,
Askush s'më shtyn të mburr këtë a atë,
Të gjitha janë të miat:
Shkollë, tokë, fabrikë,
Dhe unë këndoja, gëzohem e mburr me gjithë zë.

2.

Këndoja e gëzohem!
Fshatari hap brazda atje ku s'kish hapur kurrë,
Traktorin e nget e qetë i mbren e lopët i mjel,
Duart-sfurqe i mbush me grurë,

Gishtrinjtë gërshërë i hap
Dhe mollë këput e rrush në vreshta vjel;
Me gruan për krahu vjen modern në Tiranë,
Opera sheh
Dhe vërsnikët ngacmon me sy si tifoz, si arbitër,
Me kollaren në jakën e ngrirë e festen mënjanë,
Me masat e çakmak, me duhan të dredhur e filtër.

3.

Fshatari nGRE këngë e këndon për grurin në arë,
Kur rasti e sjell, bën gostira në male,
Cules i bie e fyellit ia merr më të qarë,
Ndez vallen-furtunë në skenë kur ka festivalë.

4.

Takon Enver Hoxhën kur kthehet nga ara
Në sheshin e fshatit,
Ku çezma thërrmohet në gurë,
Kutinë e duhanit të fortë ia vë përpara:
«Ndize, bre burrë!»
Dhe flet si me bujkun e regjur në grurin e mbirë,
Dhe flet si me shokun e regjur mes luftës në male;
«Për besë, e ke mirë!
E dimë, ke punë e halle;
Ata andej matanë detit e malit çoc flasin,
Niksonë, Fordë, Brezhnevë e ç'janë...
Ama, sikur pak të na ngasin,
Flakë merr stralli e flakë e bëjmë dynjanë!»
E buzën në gaz e vë Enver Hoxha,
E misër të pjekur ha me fshatarin,
Siç hëngri në luftë nën strehën me plloça,
Nën strehën që kurrë s'ka shuar zjarrin...

5.

Dhe unë, poeti, mësoj si një nxënës i heshtur,
Të rri «gju më gju» me popullin tim,
Siç rri Enver Hoxha, i dashur, i qeshur,
Pa drojtje, pa qibër, pa dert, pa përtim...
Më thoni, vëllezër, se ç'dreq poeti
Do të ishte poeti
Që kurrë s'ka ndenjur me njerëz të mirë
Dhe kurrë s'ka qeshur ku mblidhet rrëmeti
Dhe kurrë në popull një gotë s'ka pirë?...
Eh, ç'dreq poeti na qenka, vëllezër,
Kur s'di të dallojë grurë e thekër!

6.

Fshatari tokën e njeh siç njeh dirigjenti orkestrën,
Që nga trompa gjer te violina e parë,
Ndien tingujt e erës që zgjojnë nga gjumi vreshtën,
Njeh tingujt e fletës së misrit në arë,
Njeh tingujt e valës së artë të grurit,
Njeh tingujt e ujit në brazdat e verdha,
Njeh këngën e qyqes e thëllëzës pas gurit,
Njeh shushurimën e qumështit në vedra,
Njeh basin e kaut e sopranon e lopës,
Njeh tenorin e mëzit e alton e pelës,
Njeh një për një cicërimat e zogjve në kopsht,
Njeh kabanë e këmborës së deles...
Fshatari tokën e njeh siç njeh psikologu njerinë,
Njeh nervat e arës së mbjellë me grurë,
Njeh nervat e arës së mbjellë me misër,
Cakton diagnozën e bimës së sëmurë
Dhe di t'ia japë kurën e mirë...

7.

Fshatari jeton i gjallë mes të gjallëve,
Para tij e gjithë bota e madhe merr frymë,
Bota e ndershme e punës, e luftës, e këngëve e valleve
E bimëve, pemëve, kafshëve në diell, shi, dëborë e brymë.
Kjo botë e madhe e blertë
Pa djallëzi, dhëlpëri, finokllëk e karrierë
Fshatarit zemrën ia hap e sinqertë
Pa fletëhyrje, pa roja e portierë!

8.

E keni parë qengjin
Kur puth fshatarin e shtrirë në lëmë?
E keni parë kaun
Kur ballin nën mullar ia lëpin?
E keni parë qenin
Kur e ruan edhe pangrënë?
E keni parë kalin
Kur pranë tij hingëllin?
Kur vdes fshatari të gjithë mblidhen e qajnë
Dhe bari dhe gruri dhe qeni dhe kau dhe kali me mëzin
e ri,
Rreth trupit të tij ligje të lashta mbajnë
Me gjuhën e tyre që vetëm ai ua di...

9.

Fshatari i mirë, i zgjuar, i urtë,
Që gjysmën e lekut e merr në nishan
Me kobure në dyzet metra,

Që mbushi brigadat me djem e me vajza në luftë
Dhe djeg ditë për ditë kanunet e vjetra,
Lëron e mustaqet i dredh në traktor,
Kthehet në mbrëmje
Dhe ndjek në ekran kampionatin botëror...
Kush tha se fshatari s'na qenka modern,
Se s'ditka fjälën «pardon»?
Fshatari këtyre, më falni, u thotë
«Me nder...»
Dhe qesh e me cepin e syrit vështron.
E dini?
Moderni s'jeton dot pa bukë,
S'jeton dot pa preshin e mishin e freskët.
Fshatari për bukën heq viaj të gjata
Dhe del në veri e në jugë,
Ndaj ngrihet modern mbi «modernët»...

10.

Në dhjetra nëntorë e mijëra agime
Mbajta tok me flamurët këngën.
Në njëzet e tetë mijë kilometrat e tokës sime
Mbajta tok me grurin në duar zemrën.
Këtej jam hedhur barrikadë më barrikadë
Me flamur në dorë,
Kam parë çezma gjaku
Që plumbi përfaku:
Njëzet e tetë mijë kilometra katrorë
Njëzet e tetë mijë dëshmorë!
Në çdo kilometër — një çezmë gjaku!

11.

Këtu një ditë vdiq ai që jeton në këngë,
Këtu ngadalë-ngadalë zbret shamizeza nënë:

Biri im,
I vogli im, i dashuri im, i bukuri im!
Degëza e kaltër e limonit troket në dritare:
Asim, Asim! Ku je, Asim!
Deshëm të kishte kaq yje në qiej,
Kaq zjarre!
Deshëm të kish kaq limonë,
Kaq limonë si yj në dritaren tonë,
Asim, Asim,
Biri im, i bukuri im!

12.

Ai në baladat tona ngre kokër
E qesh i bukuri i nënës në balada,
Kur yjet spërkatin si vesa tokën,
Dhe erë limoni vjen nata...
Për atë rrëzojnë petalet lulet e majit,
Për atë ushtari i ri, i bukur në tokën mbeti,
Për atë ngrihet piloti mbi borën e malit,
Për atë digjen fenerët e kuq si fare deti,
Për atë fryn era e lehtë e këndon burimi,
Për atë vajza e vogël sjell lule në varg.
«Vajzë e vogël,
Mos u tremb që babi vonon nga shërbimi,
Mos u tremb që babi yt oficer është larg.
Prandaj jam shtrirë këtu nën borigë,
Që këto lule të hapin maj për maj;
Vajzë e vogël,
Hiç mos ki frikë,
Do vijë nga shërbimi babaj.
Ja pse më mbijnë lulet në varr».

13.

Emrat e tyre janë yje
Shumë yje,
Sa drurët e kaltër në pyje!
Asnjë nga ata nuk vdiq nga mosha e vjetër,
Asnjë nga ata nuk vdiq nga lëngimi në shtrat,
Ngre kokën një bir e një vajzë në çdo kilometër:
«Bukur, vëllezër,
E çuat nderin e nënës lart e më lart!»

14.

Në dhjetra nëntorë, në mijra ditë-agime
Këndoi pa heshtur djepi i maleve «nina-nana»!
Dhe del nga djepi i maleve valë-valë rinia ime,
Del të mbjellë me èndrra tokën,
Siç mbjell tinguj kambana.
Në zemër e mendje
Ruan shkëndijën që ndezëm në majat e larta.
Në ballë — èndrrën e ndritur me zjarr komunizmi,
Në buzë — këngën e bukur me flatra të kaltra:
Rini, rini,
O zog socializmi!

15.

Rini, rini!
Le emrin tënd në urat e Shkumbinit,
Që ngrihen si qemerët e legjendave;
Le emrin tënd në digat e mëdha të Drinit,
Që u vënë shpatullat liqeneve...
Le emrin tënd të shkruar me kallinjtë e grurit

Në Myzeqe, Maliq, Thumanë, Vurg, Zadrimë;
Le emrin tënd të shkruar me gjerdanë llambash
Majë gurit
Në Mokër, Dukagjin, Gramoz, Devoll, Trebeshinë...
Dikur vërsnikja jote ngjitej në malet e varfër
Me torbë misri tek qante me lot dëbore dhjetori.
Ti ngjitesh me vargun e librave
Dhe vargun e llambave në krahë,
Ti ngjitesh me çadër gjeologu e antenë televizori...

16.

Rini, rini!
E pastra, e bukura, modernia ime,
Ballin tënd të bardhë
Miliona snajperë në shenjë e marrin:
«Tuk-tuk!
Hape!
Jam unë!
Kam «seks»,
Kam mini,
Kam makse,
Kam kërcime!
Tuk-tuk!
Jemi bitnikë,
Jemi hipi!
Në qafë kryqe varim!»
Po ti përbuz goxhumelët që vrimash të ftojnë,
Çekani yt në kudhër
Shtyp izmat mbushur hashash;
Moderne s'janë britmat që kafshët në kopsht zoologjik
lëshojnë,
Moderne s'janë fustanet
Që zhvishen në shesh si në plazh...

17.

Sikur të varej modernia në rripin me tokë-patkua,
Ti bëheshe moderne dhjetë orë në ditë;
Vështirë është të bëhesh moderne me urat e tua,
Që ngjite nga koka e malit në kokë të malit
Tek frynin stuhitë.

Sikur të varej modernia në maksi e mini,
Ti bëheshe moderne në çast e sekondë;
Vështirë është të bëhesh moderne,
Ku jelet e bardha tund Drini,
Si kalë folklori me frerin që i vure në gojë...

18.

Rini, rini!

Askush s'ka të drejtë të masë me metër
Fustanin që mban a xhaketën,
Askush s'ka të drejtë të bëjë hesape në letër
Ta presë me kallëpin e qerpiçëve jetën.
Askush s'guxon të peshojë diku me kandar,
Të bëjë me gram llogari,
Siç bën me qiri inventar:
«Kaq gram shëtitje, kaq gram dashuri!»
E bukura, e mençmja, e pastra,
S'ta ndajmë jetën në ngastra!
Ti mirë e di se cila është liria në jetë,
E vetmjë liri e vërtetë,
Prandaj lirinë e mat me kut revolucionarësh,
Që detin-tallaz në gjoks të gjithë ta marrësh!..,

19.

Rini, rini,
Vetëm për hir të «ëndrrës së madhe drejt qiellit»,

Vetëm për hir të «lirisë individuale»,
Ne s'duam që trupi yt me ngjyrën e diellit
Një ditë të marrë ekzemën lubi liberale.
Shërimin ekzemat e kanë të gjatë,
Përhapen kërpudha e rriten kërpudha,
Lëkurën kalbin e kruhen me ditë e me natë
Dhe sjellin shpejt pleqërinë me zgjebë e rrudha.
Pleqëria me zgjebë e lëkurë të ngrënë
Mburret që gjysmë libri të verdhë me vete na bart,
Mburret që vetëm dy radhë nga Frojdi e Sartri ka nxënë
Dhe buzët lëpin si xhadia: ah, Frojd, ah, Sartr!
Ah, Frojd, ah, Sartr! — veç emrat e tjetër s'merr erë,
«Liri individi!», — vërtit nëpër qielzë shtatëqind herë!

20.

A je i zoti dyzet kuintalë t'i marrësh hektarit
Me jetën, me shkencën, me duar, me libër;
A je i zoti çelik e gizë të nxjerrësh prej zjarrit
Pa mburrje, pa naze, pa lustër, pa qibër?...
A je i zoti t'i thuash Marksit: të nxura,
Produktin e punës dyfishin e shpura!
T'i thuash Enverit: jam yti, Enver,
Ushtar me kazmë e pushkë e nder!
A je i zoti t'i sjellësh minierat e Mokrës epike
Në mokrën e furrave metalurgjike?
A je i zoti të korrësh dijet që mbolli njerëzimi si ara
Me djersë, me gjak, me punë, me luftë titani
Nga papirusët e vjetër e shkronjat e para,
Nga Arkimedi antik e gjer te Ajnshtajni,
Nga plaku Homer gjer te poeti më i mirë në start,
Se ne s'na çudit me Frojd e me Sartr,
Mbajtur përmendsh vetëm dy radhë,
Krejt shtrembëruar nën dhëmbët e rrallë!...

21.

O sa dëshirë kam pasur, vëllezër,
Dolli të ngrija për shpirtin zbulues: bromb!
Se s'ka bukuri më të madhe se mendja e ndezur:
Në jetë — zbulues, në jetë — Kolomb!
Kjo mendje s'e qas në brazdat e saj pleqërinë makute,
E tremb me hosten si galën që sillet pas farës;
Kjo mendje s'pranon qefinë, qivure, tabute,
Se vdekjen e zbon si në pjatën e rrushit një arëz...

22.

Në dhjetra nëntorë, në mijra ditë-agime,
Çau natën-karpuz me shpatë elektrike rinia ime!

KREU I DHJETË

1.

Kokën kam vënë në gjirin tënd të bardhë,
Moj e bardha ime shekullore!
Jam i kaq milionti yt i vënë në radhë,
Një grimëza jote qelizore.
Jam kapilari i enës së gjakut tënd,
Atje ku të dhemb dhe mua më dhemb.
Në zemër gjithë malet e tu i kam marrë
Dhe zemra gjithë malet e tu i ka nxënë;
Një tingull i lehtë që vjen nga kroje e ujëvarë
Më futet në shpirt e bëhet një këngë...
E bëhet një këngë e niset në botën e madhe,
Në botën e mbushur plot
Me furtunë, stuhi e trazira,
Ku nderi i popujve ndiqet
Me plumb, raketë /e koshadhe
Nga xhunglat e nxehta gjer në tokat e ngrira.

2.

Në këmbët e poshtërsisë dergjen Amerika, Rusia,
Lëngon Evropa e plakur me rrudha kapitali,
Në Gang e Brahmaputra hiqet zvarrë India
Nën ethe tropiku, nën skamje, nën dhëmbë çakalli...

3.

Dhëmbët kërcasin andej e këtej Oqeanit
Uashingtoni e Moska
Dhe ziejnë komplotet, çnderimet, shantazhet;
Ulérijnë flotat në dete si tufa ujqish pér kocka
Dhe ndërrohen qeveritë
Siç ndërrohet tagjia në grazhdet.
Gjeneralë armataš cinikë, ideologë të lashtë kasapë,
Presidentë shtetesh kusarë, sekretarë partish banditë,
Ca kapin shtetet si gjahun në kllapë,
Ca nxjerrin pazarit si lopët partitë.

4.

Në botën e zgjedhës përzihen: cinizëm, tallje e dhunë,
Në botën e zgjedhës me kohë ka hyrë tuberkulozi,
Në OKB Hrushovi këpucën e zbath në tribunë,
Në Uotergejt Niksoni futet në borxhe bixhozi!...
Në botën e dhunës pas luleve fshihet syngji e dyfekut,
Pas pritjesh solemne dridhet vallja: cili cilit t'ia lagë.
Brezhnjevi i nis telegram urimi Dubçekut,
Dubçeku pas telegramit sheh tanket në Pragë!

55.

Ndërsa për paqen flasin tribunave qëndisur me degë ulliri,
Ku fshihen gënjeshtër, kanosje, intrigë,
Në djepet e foshnjave pelenat mbulohen nga hiri,
Në qiejt e botës vërtiten Fantomë e Migë...
Dhe politikanët zukatën: «sovranitet,
O popuj vëllezër, sovranitet vërtet,
Po shtruar për kushtet e sotme duhet menduar:
I kufizuar!...
Pastaj kalemxhijtë në fraza rrinë e kërkojnë
Kuptimin e madh teorik të rritjes së «arsyes» mes llucës,
Pastaj filozofët mjekroshë zbulojnë
Parimin «marksist» të tundjes në OKB të këpuccës...
Shtete të fryrë me bomba, shtete pompozë,
Bëhi për turp karagjözë!...

6.

Fle planeta mbështjellë me gjelbërim e akull
Raketat, topat, mortajat të ngritura rrinë,
Diku janë fshehur pushkë e kobure në hatull,
Diku mitralozat kosisin e grijnë.
Dhe konstruktorët rrinë pa gjumë
Mbi skica, grafikë e projekte,
Të verdhë nga nervat, me qime të rralla në mjekra,
Armë të reja kërkojnë, të saktë, perfektë...
Bie erë kafe, tapa shishesh, cigare, gjak e djersë në letra.

7.

Njeriu lind, zhduket, vjen përsëri në jetë,
Nga gjakrat del e mes gjakut shtrihet,
Vishet ushtar e mbërthen bajonetë

E prapë me drapër e kazmë ngrihet!
Fle planeta, gdhihet planeta, ngryset planeta,
Njeriu i pamort mbi supe e mban,
Mbështjellë me avuj e akuj e re të errëta
E prapë njeriu i shpërndan...

8.

Andej kuponat e ushqimit vdekja i mban në dorë:
Këtë pér mëngjes, këtë pér drekë, këtë pér darkë!...
O disiplinë vdekje pér njerëz të gjorë!
At'herë shtëpia kthehet në varkë,
Në varkë pa busull, spirancë, helikë,
Oqeanit lëshuar në kreshta furtunash e valësh,
Jetuar në dhembje, në ankth e në frikë,
Mësuar me lot të hidhur, lot funeralesh...
Zezaku, i bardhi, i verdhi kanë në buzë një këngë:
«O vendi im me raketa, plasmasë e beton në rrugë,
O vendi im me hekur, ca i ushqen me krunde e brengë,
Ca i ushqen me dëfrime, uiski e bukë!»

9.

Nëntoka, nëndeti, nënshkretëtira
Në dredhje të pérhershme termobërthamore!
Atomet e grimëzat e vdekjes i pi hapësira
Dhe ditë pér ditë kollitet në astmë mortore.
Ja, vdiq peshkatari i varfër me duar lëshuar
Në krahët e valës sa gjysma e malit,
I la fëmijë e grua me sofrën pa shtruar
Dhe varrin e vet e humbi mes oqeanit...
Nëntoka, nëndeti, nenoqeani, nënshkretëtira

Në drithma tërmeti termobërthamor!
Atomet e grimëzat e vdekjes i pi hapësira
Dhe shtohen përbindëshat e lindur me zor...
Ja, lindi një fëmijë me katër kokë
Në Kaliforni në fshatra të humbur;
Gamilja polli, për habi të gamiljes, një fokë
Në rërën e Saharës mes vapës përgjumur...
E pur si muove, vërtitet në kozmos planeta,
Jeton mes jetëve të tjera jeta...

10.

Këmbëzbathurve, të sfiliturve në hetusira,
Nënave që presin njomzakët në sofër në heshtje,
Kryengritësve, që rriten në botë me mijëra,
Nga vendi im — përshëndetje!
Përshëndetje nga pikë ku ishte shumë e vështirë
Të ngjisje mbi shpatulla të bukurën, të renë!
Ndaj ne s'e humbim kurri besimin te njerëzit e mirë:
Mësimet e Marksit në tokat e mendjet e tyre do venë!
E patëm udhën të rëndë,
Po udhën përgjysmë s'e lamë,
E mbajtëm vendin si shenjt në pëllëmbë,
Paçka se bllokadat s'iud ndanë...

11.

Fjala «bllokadë» sa vinte rëndohej më shumë e më shumë
Në fjalor e në dhomë e në rrugë e në shteg,
Peshën «bllokadë» e ndienim përnatë në gjumë
Mbi jorgan, mbi jastëk, mbi peshqir, mbi dyshek...
Një shkronjë e vogël e saj me plumb-linotip në gazetë,

Peshonte një shkëmb-tonelatë!
Sikur mos kishim Partinë e Punës në jetë,
S'e mbanin dot peshën e saj as kalatë.
Ajo rëndonte në copën e bukës me djathë,
Që hanin punëtorët pranë makinerive,
Rëndonte në pjatën me grosh e me bathë
Në çerdhet e kopshet e rinj të fëmijëve,
Rëndonte mbi skicat-projekte dhe planet,
Rëndonte mbi letër e laps të shkrimitarëve,
Rëndonte mbi grurin në arë dhe baxhot në stanet,
Rëndonte mbi vezme e dyfek të ushtarëve!
Po ne, siç na shihni, s'u epëm nga pesha
Dhe shtyllë e kurrizit na mbeti e drejtë!
Sikur dhe një shekull të térë të zgjatë përleshja
Të tillë na keni: optimistë, të rreptë!

12.

U njohëm me emra të rinj që mbanin ofiqë të rinj
Dhe tok me ofiqët — skica e harta,
Dhe tok me skicat e hartat — plane të zinj
Me lajka-sheqerka, tërbime-thika, qeshje të arta...

Kërkonin:

Në hartën shqiptare mos kishte mbishkrim: REPUBLIKË,
Kërkonin:

Në hartën shqiptare të vihej mbishkrimi: THIKË!...

13.

O ç'njohëm!

Me emrat: Nikson, Ford, Hrushov, Brezhnev
Me lloj-lloj sufikse, me lloj-lloj fizionomira,

Me vetulla drejt, me vetulla hark: — son,-ord,-ov,-ev,
E dini se ngriheshin plot galerira,
Ku nxënësit të ilustronin historinë e bllokadës,
Që myllin kurrë mos ia vënë shpatës,
Që vargjet poetët t'i hedhin si trakte avioni,
Që vargjet poetët t'i ngjisim në mur si pllakata:
Mos mbyllni sy, vigjëloni!
Të mposhtet bllokada!

14.

Në botën që zien si kazan mbi flakët e zjarreve
Ngre zërin tënd të vërtetë e të lirë, o nëna ime!
Ngre zërin tënd
Nga kreshtat e digave e bedenat e kalave,
Nga majat e maleve që bartin dëborë e agime.
Kështjellat e tua të lashta e të reja
S'i dogji kurrë rrufeja,
S'i shembi kurrë beteja!
Ato, në brigje lumenjsh e thika të mprehta,
S'i ngrite si hotele gjuetie
Për t'u shtruar darkë mbretërve,
Mbretërit s'vinin te ti për gjah e bankete,
Mbretërit vinin të vidhnin
Tokat e tua e ujérat e deteve...

15.

Brenda kalave t'i s'ruajte pasqyra e poltronë të rëndë
Dhe s'thirre piktorë argatë
Të bënин portretin tënd plot salltanete;
Brenda kalave ti ruajte historinë tënde,
Ruajte legjendën, këngën e nderin përjetë.

16.

Kjo tokë që mbante kalatë anës Drinos, Vjosës e Bunës,
Për farën e re të komunizmit ishte e etur.
Dhe farën e zgjodhi kokërr për kokërr Partia e Punës
Dhe si bujk i madhërishëm
E mbolli të mbetej në shekuj e ndezur...

17.

Le të ziejë bota — kazan mbi zjarre,
Le të ziejë bota — kazan mes flakës,
Mes botës ti, nënë, qëndron e bukur, krenare
Dhe kurrë nuk rrudhesh dhe kurrë nuk plakesh.
Në botën e madhe mbushur trazira
Qëndrojmë modestë,
Modestë diçka i japim njerëzimit;
Askënd s'trazojmë dhe jetojmë me djersë
Në tokën tonë në një pikë të vogël të rruzullimit;
Nga pika e vogël kërkojmë që njerëzit të jenë të lirë,
Dhe globi ka njerëz të ndershëm
Që zërin tonë nderojnë,
Dhe thonë fjalën e ngrohtë «mirë»!
Dhe tok me ne përpiqen, luftojnë, punojnë...
Për botën e madhe ka bërë diçka partizani ynë:
Helmetën e kryqit të thyer,
Që flaku në Vjosë, e ndjenë dhe Vollga dhe Elba;
Nga toka e vogël me halle,
Ku bulëza e gjakut binte në brymë,
U nisën djemtë e vajzat tona
Gjer në Madrit e në Ebro...

Nënë Shqipëri!

Mblidhen rrëth teje burrat me thinja të lashta,

Mblidhen rrëth teje vajzat e djemtë si zogjtë,

Me tokën tënde në duart e ashpra,

Me hekurin tënd në supet e fortë.

Mblidhen rrëth teje ata që të ngritën në qiej,

Ata që të dolën zot në furtunë,

Ata që të zbritën mbi male me mijëra diej,

Ata që të dhanë liri, paqe e punë,

Endrrën tënde që shekujt s'ta prunë.

Ata që ta fshinë nga balli i madh pleqërinë,

Ata që faqen ta zbardhën në botë,

Ata që për nderin tënd natën gdhijnë

Në brazda, në torno, në libra, në topa

Në zheg e në shqotë,

Ata që urejnë shtypje, intrigë e bllokadë,

Ata që përbuzin zhabat e majme në gjol,

Ata që bëhen miq me skifterët në çdo barrikadë

Nga poli në pol;

Ata që u betuan vetëm një herë

Në «Thirrjen e Parë» në vitin Dyzet e Një:

O ngremë Botën e Re mbi gërmadhën skëterrë,

O s'mbetet nga ne as hi e as zë!

Ata që s'dinë të bëjnë shaka me «luftën finale»,

Ata që s'dinë të shkelin betimin mbi dhe:

Internacionale

Do të jetë Bota e Re!

M B Y L L J E

1.

Po mbyll në poemë fletët e fundit,
Si fletët e portës ku hyra e dola vite me radhë
Në këmbët e malit, në krahët e lumit,
Nën muret e bardhë.
Mendohem si bujku në muzg pas avllisë,
Kur vjeshta mbaron e vjen dimri:
A janë të gjitha ç'i duhen shtëpisë:
Dhe drutë dhe gruri dhe misri?
A mbahet çatia me kulmet e trarët,
A tymin oxhaku e heq mirë e bukur?
A hyjnë erërat në acar në dritaret
Dhe qaset dot ujku në oborr duke strukur?

2.

Vëllai im i dashur, i urtë e i rreptë,
Lexues i menduar me rrudha në ballë,
Që njihemi bashkë me vite në jetë,

Me ty e kam mbajtur poemën të gjallë,
Me ty i kam hapur dhe portat e reja
Në oborret e mi poetikë,
Me ty kam djersirë në punë e beteja,
Të dy kemi pasur një politikë...

3.

Ti ndofta poemën e shkon nëpër duar,
I lodhur pas punës, në shtrat
Dhe ndalesh në vargjet e rinj i menduar
Në heshtje mahmur fillikat;
Po udha të hapet e gjerë e largët
Në male, lugina, qytete
Dhe ngrihesh pa ditur se ngrihesh nga vargjet,
Këndon nëpër dhomë me vete;
Përcjell nëpër buzë dy vargje të lehtë
Me rimë të njojur me «-ri»:
«Pikojnë pikat, këndojnë strehët
Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!»
Ahere i vetëm ti s'mbetesh në dhomë,
Jam unë, poeti, me ty
Dhe mua më thua: të shkojmë, të shkojmë
Në rrugë të largët të dy...
Të hyjmë në porta të tjera të mira,
Në oborre të reja të panjohura;
Të hapet si libër i madh hapësira,
Me fryshtë e gjokseve tona të ngrohura.

4.

Po porta të reja nuk hap dot ngaherë,
Nuk futesh në oborre të reja kur të duash,
Po s'vrave dhe gjunjë dhe kockë e arterë,

Po s'mbete më muaj në shtigje të vuash,
Se mushka xanxare nuk niset nga oda
Dhe vetë si qengji s'të vjen,
Kur gojën mban hapur me ëndrra të kota
Dhe këmbët i zgjat në legen...

.5.

Kështu na qenke, moj jetë e poetit:
Hap porta, mbyll porta ngaherë
Me mushkën xanxare në mes të rrëmetit,
Ngarkuar me pena, dëfterë!...
Po bashkë me librat e mençme dhe letrën,
S'harrojmë të marrim në mushkë
Dy gjëra të tjera që duhen për jetën:
Një kazmë, një pushkë...

.6.

Dhe rruga thërret në male e lugje,
Dhe ti psherëtin: «Njatjeta, vëllezër!
Vëllezër, që çani lëndinat me plugje,
Vëllezër, që shpini fëmijët në çerdhe!»
Trokasin rrokjet, trokasin vargjet:
Trokasin hapat në Jug e Veri,
Trokasin pikat në strehët e pragjet:
Nënë Shqipëri, nënë Shqipëri!

P A S T H Ě N I E

Gjithmonë përbledhjet me vjersha të zgjedhura nga kri-jimtaria poetike e një poeti janë të vështira. Ka vjersha që autorin e lidhin me një kujtim të bukur nga fëmijëria apo nga rinia, që i sjellin në mend vendet ku janë shkruar dhe shokët që ka pasur përreth dhe ndofta edhe shkallët dhe korridoret e redaksive bashkë me redaktorët dhe recenzentët e parë. Këto vjersha për lexuesin mund të mos kenë ndonjë rëndësi të mëdha dhe mund të thotë: «Më mirë do të ishte sikur të mos ishin përbledhur në libër!» Por ç't'i bësh! Ja që autori nuk shkëputet dot, megjithëse ua njeh vlerën. Kështu, të shkëputesh nga kjo, si ta themi, nostalqji, është vështirësia e parë.

Në rrugën pak a shumë të gjatë poetike, mjaft vargje, duke ecur vitet, humbin peshën e tyre dhe zhvleftësohen. Të lehta e të çngjyrosura ato mbeten anës rrugës si fletët e rëna të pemëve. E pamëshirshmja kohë, me mospërfillje dhe pa sentimentalizëm, i ka lënë dhe nuk ka denjuar t'i marrë me vete, se nuk kanë pasur në brendësinë e tyre atë, bërthamën rezistuese, që u intereson të gjithëve dhe që u shërben të gjithëve edhe në jetën e sotme të pasurimit të botës shpirtërore të njerëzve. Duke vënë fletët me vjersha njëra mbi tjetrën në përbledhjen e tij poetike, poeti përpinqet t'i peshojë këto bërthama me peshoren e ndjeshme të poezisë. Dhe, kur shikon që mjaft vargjeve s'u ka mbetur ndonjë bërthamë, bie në mendime dhe thotë me vete: «Duhej derdhur më shumë djersë, vëllaçko!» Është mirë, kur ai

di t'i peshojë vetë këto fletë me vargje dhe nuk tërhiqet nga dashuria dhe anësia personale. Dhe kjo është vështirësia e dytë në ndërtimin e një përbledhjeje me vjersha të zgjedhura: të dish të lësh mënjanë varjet pa bërthamë.

Poezia e një poeti është biografia e tij, megjithëse në vargje nuk ka data, vendbanime dhe anketa. Në to ndihet shpirti, ëndrra dhe ideali i poetit, ndihet pulsi i arterit të tij që rreh me pulsin e kohës dhe të popullit të vet. Duke lexuar vjershat, shoku i madh i poetit, lexuesi i pahatër dhe i çiltër, e ndjek rrugën nëpër të cilën ka kaluar autori, vëren rritjen e tij dhe shikon uljet dhe ngritjet e temperaturës poetike, që shënon shigjeta poetike në këtë aparaturë të ndërlikuar. Në një përbledhje me vjersha të zgjedhura duhet të jepet kjo gjendje. Këtej del edhe vështirësia e tretë: të dish t'i japësh lexuesit, shokut tënd më të mirë, rrugën poetike, rritjen tënde dhe pjkurinë tënde, doemos, në qoftë se ti e ke arritur këtë pjkuri!

Para këtyre tri vështirësive është ndodhur edhe autori i kësaj përbledhjeje me vjersha, që është më e gjera nga ato që ka nxjerrë më parë. Në këtë përbledhje ka vjersha nga të gjitha librat e mi. Disa vjersha nga vëllimet e para janë redaktuar, por pjesa dérrmuese ka mbetur e paprekur. Prej librave të hershëm janë vënë edhe vargje që mund të mos përblidheshin. Por, siç thashë pak më lart, i kam lënë me qëllim që dashamirësi i poezisë ta ndiejë se si kanë qenë hapat e parë të rinisë sonë poetike njëzet e ca vjet të shkuar. Ato tregojnë në përgjithësi, edhe stadin e atëhershëm të poezisë.

Si gjithë brezat poetikë, ashtu edhe brezi im është munduar të shkruajë në vargje biografinë e vet dhe biografinë e madhe të Atdheut, duke pirë në gurrën e pashtershme të popullit dhe në burimin e pastër të traditës së poezisë shqiptare dhe ndërkombëtare. Poeti i merr borxh popullit për t'ia kthyer përsëri. Dhe sa më i pacenuar dhe më i begatë të jetë ky borxh i kthyer, aq më krenar dhe më i lumtur është poeti.

AUTORI
D. Agolli

Maj 1979

PASQYRA E LËNDËS

NGA LIBRI «NË RRUGË DOLA» — 1958 3

Vjersha: 5

Hyrje	7
Harabeli	9
Kur përfytyroj një nga lexuesit e mi	10
Ja, pronari	11
Në udhëtim	13
Qeni im i plakur	16
Një përrallëz e vogël	18
Vjersha e parë	19
Gjurma	22
Sorkadhja	24
Zjarret	26
Lumi	29

Poema: 31

Poema e udhës 33

Vjersha: 45

Kurbatka	47
Kllanikët	50
Vjeshta	51
Unë dhe Shkumbini	53
Vizatime në pranverë	55
Jubilare	57
Baladë optimiste	59
Yjet	61
Vargu	63
Në shtëpi të vjetër	65
Bala, lopa ime	67
Mëngjes në port	69
Nga fletorka e shënimeve	70
Këmishët	73
Thirrje	75
Skuadra	77
Peizazh nga ballkoni	79
Motivet	80
Fokstrot	81
Malli	83
Natë në arë	84
Kur bie dëborë	85
Kjo grua	86
Vajzat notare	88
Poezia	89

Poema:

91

Mendime në vjeshtë	93
Dhjetë sy	98

Vjersha: 115

Mund të mendojmë	117
Nga kujtimet e hershme	119
Larg do të të shpie	120
E urta, e mira	121
Elegji partizane	122
Deti	124
Tregim për një gajdë	126
Nëna ime	128
Firdusi	130
Me fjongo të gjelbër	133
Përsëri	136
Dashuria	139
Zemërimi i poetit	142
Cast	144
Për kujtim	146
Pranë saj	148
Pazari	150
Rapsodi vjeshte	152
E bukura	154
Kënga e tokës	155
Criticus	157
Për malësoren dhe për vete	160
Eureka	162
Diku në një pijetore	164
Vajzë e vogël	165
Për gratë tonë	167
Të shkruajmë baladë	168
Ditar partizan	169
Dega me limonë	170

Poema: 171

Devoll, Devoll	173
Poema e të pagjumëve	183

Poemë malore	186
Baladë e re për komisarin	196
Dashuri dhe ferrobeton	205

NGA LIBRI «MESDITË» 213

Vjersha: 215

Rapsodi	217
Krévati i perandorit	219
Të dashura vajza	222
Në amfiteatrin e Butrintit	224
Mendja e Lekë Dukagjinit	227
Kërkimi	230
Ai mot	231
Eskiz	233
Kullat	234
Salut!	236
Kuajt	237
Telegrami	239
Filli elektrik në vargje	241
Kur të vij në mëngjes	242
Duke u menduar	243
Rèmbrandti	244
Kënga	246
Larg qytetit	248
Komisari	251
Në këtë hotel	254
Gjyshi	256
Në vjeshtë	257
Kur libri është në shtyp	258
E paharruara	259
Dëshmori	260
«Danaja»	261
Vjeshtës	263
Poetët që vijnë	264

Monologu i cinikut	266
Lulet	268
Mikroborgjezi	270
Vdekja e druvaret	271
Valle labërishte	273
Kënga partizane	275
Djaloshare	276
Naim Frashëri	277
Peizazh pas shkrepëtimës	279
Piramidat	280
Njeriu i tokës	281
Duke kërkuar dashurinë	282
Fillimi i një poeme për Qemal Stafën	283
Kështu mund të ndodhët	284
Përsëri për tokën	286
Peizazh	287
Uollit Uitman	288
Lisi bleron vonë	289
Dimri	290
Fund dimri	292
Leonardo Da Vinçi	293
Në pranverë	294
Pjekuria	295
<i>Poema:</i>	297
Baballarët	299
Rebelimi i parë	313
Toka ime, kënga ime	322
Balladë e ashpër	332
NGA LIBRI «FJALA GDHEND GURIN» — 1977	337
1. Kënga e njeriut:	339

Ditës Agollë

Malli i parë	341
Pleqtë e qytetit tim	343
Lejlekù	346
Jeta	348
Babanë tënd e kisha shok	349
Pleqëria	351
Vëlla sa shumë prite!...	353
Patast e egra	355
Maro Podgozhani	358
Kau i bardhë	362
Shokët e mi	364
Thirrja e vendlindjes	367
Në gurin e një varri	369
Zgjimi i baladave	371
Shtigjet	372
Themelet	374
Në kryeqytet	376
Mbrëmje letrare	378
Bukuria	380
Mikpritja	381
Nuk dua	383
Duke udhëtarar në male	384
Mollët	385
Shkëmbi	386
Nderi	387
Naganti i gjyshit të rënë	388
Vreshtri	389
Vdekja e fshatarit	390
Peizazh me një të re të bardhë	391
Puna	392
Në qytetin e lashtë	393
Duke udhëtarar anës detit	395
Braktisja	396
Natë	397
Peizazh asfalti	399
Lopa	400
Duke menduar për bukurinë	401
Vagabondët	402
Çerdhet e zogjve në dimër	403
Kënga e njeriut	404
Reliket e heroit	405
Endërr /	406

Dy fjalë poetëve që vijnë	407
Në kohën e varfërisë	408
Për poezinë	409
Shqetësimi	410

2. *Kënga e buzëqeshjes:* 413

Përralla e kecërve	415
Sa i çuditshëm!	419
Mbesës dhe maces	422
Dy vëllezër dhe ujku	423
Tani dhe Larani	424
Kush nuk sheh veten	429
Ujku	430
Monologu i pseudos	432
Dhia dhe maçoku	434
Pjepri	435
Maçoku dhe minjtë e vegjël	437
Breshka te nallbani	438
Mullixhiu dhe pula	440
Dhelpra dhe deveja	441
Akrepi dhe bretkosa	442
Katër vetë	443
E drejta dhe e shtrembra	445
Kungulli	446
Luani dhe miu	447
Filistini	448
Balada e Rrush-Rushitit	454
Pleshti	464

3. *Kënga e komunistëve:* 497

<u>Komunistët (poemë)</u>	499
<u>Nëntoriada (poemë)</u>	534